monumentet



DOKUMENT

1/1981

DO NOT COPY

Kopertina e parë: BERAT (Lagjja Kala) – Banesë e rindërtuar në gjysmën e dytë të shek. XIX.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

1/ 1981 (21)

DO NOT COPY

PASQYRA E LËNDËS

ARTIKUJ

Faqe

Emin RIZA

Banesa popullore në qytetin-muze të Beratit 5

Isuf SUKAJ

Urbanistika dhe arkitektura e pazarit mesjetar të Kavajës 35

Tamara GJOKA

Mbi vlerat akustike të traditës 45

Fatos TARTARI

Kanalizimet në Durrësin e lashtë 51

Valter SHTYLLA

Ndërtime inxhinierike të fillimit të shekullit XIX në disa krahina të Shqipërisë së Jugut 70

Aleksandër MEKSI – Pirro THOMO

Arkitektura pasbizantine në Shqipëri (bazilikat) 99

Dhorka DHAMO

Figura antropozoomorfe e mozaikut të Antigonesë 149

TABLES DE MATIERS

ARTICLES

Page

Emin RIZA

L'Habitation populaire de la ville-musée de Berat 30

Isuf SUKAJ

Urbanisme et architecture du Bazar moyenâgeux de Kavajë 43

Tamara GJOKA

Sur les valeurs acoustiques de l'architecture de tradition 49

Fatos TARTARI

Les canalisations dans le Durrës antique 66

Valter SHTYLLA

Les travaux d'engineering du debut du XIX siecle dans quelques regions de l'Albanie du Sud 95

Aleksandër MEKSI – Pirro THOMO

L'architecture postbyzantine en Albanie (Les basiliques) 147

Dhorka DHAMO

Figures «anthropozoomorphe» de la mosaïque d'Antigonéa 125

DO NOT COPY

Emin RIZA

DO NOT COPY

BANESA POPULLORE NË QYTETIN – MUZE TË BERATIT

Në dallim nga qyteti-muze i Gjirokastrës dhe qendrat e tjera qytetare të vendit tonë si Shkodra, Elbasani, Korça etj. Berati shquhet për një larmi më të pasur gjinish ndërtimore, me shtrirje mjaft të gjerë kohore.

Kalaja, një ndërtim madhështor, i formuar në shekuj me kontributin e disa periudhave, ndërtimet e rëndësishme të kultit, kishat e xhamitë, e së fundi fondi i madh i banesave popullore e bëjnë Beratin një prej qendrave më të spikatura, ku mund të ndiqet krijimtaria e gjenisë shqiptare që prej shek. IV p.e.sonë e deri në ditët tona. Venja në mbrojtje shtetërore e këtij qyteti në vitin 1961, duke u cilësuar «qytet muze», krijoi kushte për studimin e kësaj trashëgimie arkitektonike, dhe restaurimin e saj. Zonifikimi i qytetit, dhe shpallja e monumenteve të kategorisë së parë, qenë përfundime të një pune të vërtet studimore, e cila siç ka treguar koha është bërë me kompetencë të plotë. Që në vitin 1965[1] u publikua artikulli i parë, i cili trajtonte probleme të arkitekturës së qytetit të Beratit, duke qëndruar kryesisht mbi tiparet urbanistike të tij, si dhe në klasifikimin tipologjik të banesës. Ndërkohë, megjithë punën e madhe restauruese, e cila për vetë natyrën e saj lidhet me një veprimtari të gjerë studimore e dokumentuese, për banesën popullore të këtij qyteti është botuar pak.

Qëllimi i këtij artikulli është të japë një panoramë të përgjithshme të karakterit dhe tipologjisë së banesës në këtë qendër, pa lënë mënjanë tiparet urbanistike të saj. Njohja me arritjet e banesës qytetare në përgjithësi, për të cilën vitet e fundit ka pasur publikime, e lehtëson trajtimin e problemit, i cili për arsye të kuptueshme duhet të gjejë zgjidhje në një kuadër të gjerë. Artikulli pra ka një karakter të përgjithshëm, pa pretenduar të trajtojë çështje të tilla si karakteri dhe zhvillimi në kohë i njësive të ndryshme kompozicionale, si dhe atyre arkitektoniko-konstruktive, të cilat padyshim janë shumë të rëndësishme, madje lidhen dhe me problemin në shqyrtim.

Siç përmendëm artikulli i parë me vlerë, i cili trajton probleme të tipareve urbanistike dhe arkitektonike të qytetit të Beratit është ai i G. Strazimirit. I shkruar pas një veprimtarie të gjerë, me kritere të shëndosha shkencore, për zonifikimin e qytetit, ai jep një kontribut të rëndësishëm veçanërisht në trajtimin e karakterit urbanistik të qytetit dhe të pasurive në fushën e arkitekturës popullore. Megjithkëtë do të thoshim se cilësimi i skemës urbanistike të qytetit si radiocentrike nuk gjen mbështetje. Por pjesa më e diskutueshme e këtij artikulli, mendojmë se është ajo lidhur me klasifikimin tipologjik të banesës së Beratit[2]. Në këtë klasifikim nuk del i qartë kriteri bazë mbi të cilin mbështetet ai, nuk sqarohen lidhjet e parashtruara me banesën fshatare, dhe së fundi mendojmë se koncepti i tipit lidhet në disa zgjidhje dhe dukuri jo thelbësore. Kalimi nga një tip në tjetrin si rezultat bashkimesh mekanike, duke u krijuar kështu

1) G. Strazimiri, **«Disa tipare të arkitekturës së qytetit të Beratit»,** në «Konferenca e parë e Studimeve albanologjike», Tiranë, 1965. Autori i këtij artikulli ka hartuar njëkohësisht zonifikimin e qytetit-muze të Beratit, dhe listën e monumenteve të kategorisë së parë.

2. G, Strazimiri, **Art. Cit.** f. 560.

DOKTORA

«tipi me një krah» dhe «tipi me dy krahë» na duket se nuk qëndron, ashtu si dhe të dy tipet e fundit: «tipi i gjatë me theksim në fasadë» dhe «tipi me rezalit në mes», nuk janë vetëm rezultat i përpunimit të tipit me dy krahë.

Në përpjekjen e dytë për klasifikimin e banesës popullore në qytetin e Beratit[3], dallohen tre tipe, ai me çardak, banesat e mbyllura me gjysmëkat, dhe së fundi grupi i tretë i banesave, ku përfshihen rindërtimet e banesave të vjetra gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, si dhe ato të ndërtuara rishtas.

Së fundi G. Samimi, në kumtesën me titull «Klasifikimi i banesave beratase; varianti i katërt i banesës me çardak dhe konceptet konstruktive të ndërtimit të kollonadës së çardakut dhe strehëve[4]», e rimerr në shqyrtim problemin e tipologjisë së banesës beratase. Klasifikimit tonë, ai i bën këto ndryshime: tre varianteve të banesës me çardak i shton një të katërt, ndërsa grupin e tretë të banesave e ndan në dy grupe të veçanta, në atë të banesave të adaptuara dhe atyre të ngritura rishtas. Lidhur me variantin e katërt të banesës me çardak, të cilën autori i kumtesës e emërton «me çardak të lirë», mendojmë se në principet kompozicionale, duke gjykuar nga shembulli i prurë, nuk kemi të bëjmë me ndonjë risi. Format e çrregullta planimetrike dhe në përgjithësi kompozimi që shkëputet nga norma e zakonshme, janë kushtëzuar nga trualli i pjerrët dhe i aksidentuar, i cili ka ndikimin e vet në mbarë tipologjinë e banesës beratase. Krijimi i dy njësive të veçanta për banesat e rindërtuara, dhe ato të ngritura rishtas, duke filluar që prej rreth mesit të shek. XIX, megjithëse duhet marrë në konsideratë, mendojmë se nuk përbën dy grupe, ngaqë ato i lidhin të njëjtat kritere kompozicionale. por brenda të njëjtit grup ato duhen diferencuar.

Siç përmendëm qyteti i Beratit ruan, krahas gjinive të tjera, dhe një pasuri të madhe në fushën e ndërtimeve popullore. Këto të fundit i gjejmë jo vetëm si njësi të veçanta, por edhe në ansamble kompakte e madje lagje, të cilat ruajnë sot e kësaj dite karakterin dhe tiparet urbanistike, që lidhen me mesjetën e mesme e të vonë. Gjatë kësaj kohe, u krijua dhe u rrit qyteti i hapur, dhe pësoi ndryshime me rëndësi një nga lagjet kryesore të qytetit, ajo brenda mureve rrethuese, e cila deri para shpërthimit të qytetit jashtë rrethimit kryesor, dmth vetë kalasë, përbënte zonën e vetme të banuar.

Lidhur me dinamikën e rritjes së qytetit, së pari duhet të konsiderohet dalja e qendrës së banuar jashtë mureve rrethues të fortifikimit. Përmendja e varoshit (Suburbia castri Bellogradi) më 1280[5] e vendos pa mëdyshje lindjen e lagjeve të para, jashtë Kalasë, në shek. XIII. Lind pyetja se në cilin truall qenë ngritur ato së pari? A. Baçe[6], duke lidhur përmendjen e mësipërme të varoshit me disa rrënoja ndërtimesh në pjesën veriperëndimore të kalasë, mendon se pikërisht këtu duhet kërkuar varoshi në fjalë. Duke u bashkuar me këtë mendim, shtojmë se edhe pjesa në jug të kalasë e cila rrethohet anash me mure; duhet konsideruar si një varosh (qytet i poshtëm) i fortifikuar[7]. Gjatë luftës ndërmjet anzhuinëve dhe bizantit, del qartë, qenja e këtij varoshi të fortifikuar. Më tej, rreth çerekut të tretë të shek. XVII E. Çelebiu, e përmend këtë, duke folur për «Kalanë e poshtme», në të cilën sipas tij, ishin ndërtuar 70-80 banesa të mbuluara me tjegulla, dhe 80 dyqane[8].

Duke u mbështetur në të dhënat e regjistrave fiskale të viteve 1431 dhe atij të fillimit të shek. XIV,[9] shohim se Berati ka respektivisht 175 dhe 561 banesa, pra një rritje të konsiderueshme. Data relativisht e hershme e lindjes së varoshit në këtë qendër, ndërtimi i xhamisë «Mbret», në shek. XV, dhe i asaj të «Plumbit», më 1553-54, në një zonë relativisht të largët nga Kalaja, tregojnë se gjatë gjysmës së dytë të shek. XV, dhe gjatë shek. XVI, procesi i formimit të qytetit të hapur ka ecur me ritme të shpejta në Berat. Kështu gjatë shek. XV-XVI, në kuadrin e rimëkëmbjes të qytetit shqiptar të kohës dhe të procesit të popullimit me banorë të rinj, kryesisht zejtarë të ar-

---

3) E. Riza, **Banesa e qytetit-muze të Beratit,** në «Mjeshtrat dhe arkitektura popullore», Tiranë, 1976.

4) Kumtesë e mbajtur në sesionin e IV Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, më 1980.

5) **A. Alb.** 441, 1280, 6.XI.

6) A. Baçe, **Qyteti i fortifikuar i Beratit,** «Monumentet», 1971, Nr. 2. Lidhur me ekzistencën e këtyre rrënojave na ka njoftuar edhe kolegu Sh. Mane.

7. G. Strazimiri, **Art. Cit.,** f. 557.

8) E. Çelebi. **Sejehatnamesi,** V. VIII, pjesa për Beratin, përkthyer nga origjinali turqisht prej V. Samimit.

9) H. Inalçik **Encyclopedia of Islam.** Vol. I, 655, Sipas Z. Shkodra, «Esnafët shqiptarë», Tiranë, 1973.

DO NOT COPY



Fig. 1

dhur nga fshati[10], kishte filluar ndërtimi në zonën e lagjes së sotme Mangalem, dhe më tej në ato të Përroit dhe Vakëfit, siç pohon G. Strazimiri. Zhvillimi i madh i lagjes Murat Çelebi në rrafshin e gjerë, në perëndim të kalasë, siç tregojnë jo vetëm të dhënat e E. Çelebiut por edhe ato të një dokumenti të vitit 1688[11], që tërthorazi flet për madhësinë e lagjeve në këtë vit, të shtyjnë të mendosh se kjo lagje duhet të jetë nga të parat e ndërtuara jashtë rrethimit, mbase paralelisht me lagjen Mangalem. Mundet që lagjja Goricë, përtej lumit të Osumit, të jetë diçka më e vonë, megjithëse jo edhe aq, duke gjykuar nga zhvillimi i saj relativisht i mirë rreth çerekut të tretë të shek. XVII. Kalimi në bregun tjetër të Osumit dhe ndërtimi në një zonë të pa përshtatshme për ndërtim, e cila vetëm në verë rrihej nga dielli, prandaj mbante emrin «Gjën Gjormes» (që nuk sheh dritë), të shtyn të mendosh se aty nga fundi i shek. XVI, apo fillimi i shek. XVII, qyteti i hapur në bregun e djathtë të Osumit kishte marrë një zhvillim të madh.

Të dhënat e udhëtarit të njohur turk Evlia Çelebiut, i cili vizitoi qytetin më 1672 dhe 1675, tregojnë qartë se në këtë kohë qyteti i hapur ishte bërë pjesa kryesore e Beratit, aty ishte qendra ekonomike e tij, pazari, si dhe shumica e lagjeve të banuara. Pazari në këtë kohë kishte marrë një shtrirje të madhe, duke filluar prej urës së Goricës dhe duke vazhduar, deri përtej zonës qendrore të qytetit. Në këtë ngrihej xhamia Mbret dhe ajo e Plumbit, ndërsa pranë saj një hamam (banjë publike) sipas njoftimeve të Çelebiut. Qenia e një

10) **Historia e Shqipërisë** (Maket) Vëllimi I, Pjesa III, fq. 28 Tiranë, 1972.
11) **Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vol. III, Qëndresa e popullit shqiptar kundër sundimit osman nga shek. XVI deri në fillim të shek. XVIII,** Tiranë, 1978 dk. 156.

DO NOT COPY



Fig. 2

pjese të mirë të pazarit në zonën rreth xhamisë «Mbret» dhe më tej ndërtimi i Teqes së Helvetive (1780) pranë saj, me konakët dhe disa ndërtime të tjera me rëndësi, ndërsa ndërtimi më vonë në këtë zonë i vendbanimit të një feudali të fuqishëm, i theksuan tiparet e qendrës së qytetit, ndërsa në akropolin e kalasë nga mesi i shek. XIX, përveç kazermave të ushtarëve, ndodhej dhe ndërtesa e këshillit[12].

Kurt Pasha më 1777, e ndërtoi prej guri urën mbi Osum, që lidhte lagjen Goricë me pjesën tjetër të qytetit. Ajo më parë kishte vetëm këmbët prej guri, ndërsa pjesën tjetër prej druri, siç shkruan Çelebiu.

Nga sa u parashtrua kuptohet se në vija të përgjithshme si shtrirja e qytetit, ashtu dhe zgjidhja e tij urbanistike, nga fundi i shek. XVII, kishin arritur në realizime, të cilat pak a shumë nuk pësuan ndryshime të rëndësishme në shekujt e mëvonshëm.

Berati, përsa i përket larmisë së truallit mbi të cilin ngrihej, paraqet një shumëllojshmëri, të dalluar në krahasim me qendrat e tjera qytetare, duke u afruar deri diku vetëm me Gjirokastrën. Aty gjejmë lagje mbi kurrize kodrinore si ajo e kalasë, mbi pjerrësi të ndryshme shkëmbore si Mangalemi e Gorica[13], ndërtime në luginëza të vogla, dhe më tej ansamble tipike mbi troje të rrafshët. Kalaja, me lagjen e banuar brenda saj, ngushtica që kalohet nëpërmjet urës së Goricës, dhe më tej lagjia Murat Çelebi, e bëjnë deri diku të përhapur qytetin e Beratit. Ansamblet e mëdhenj të lagjes Kala,

12. A. Boue. **La Turquie d'Europe,** Paris 1840, Vol. II f. 341.

13) Në këtë artikull do të përdorim emrat e vjetër të lagjeve. Emrat e sotëm të tyre janë: Mangalem, sot «13 Shtatori», Goricë, sot «Partizani», Murat Çelebi, sot «Çlirimi».

DO NOT COPY



Fig. 3

Mangalem, Goricë, si dhe asaj Murat Çelebi, qëndrojnë si njësi deri diku më vete, në kuadrin e mbarë qytetit. Ato lidhen me pazarin nëpërmjet rrugësh kryesore, që e bashkojnë mbarë qytetin në një njësi të vetme. Në përgjithësi zhvillimi urbanistik i qytetit të Beratit, është i lirë, duke u ndikuar fuqimisht nga vetë konfiguracioni i truallit mbi të cilin ngrihet.

Siç përmendëm zhvillimi urbanistik i qytetit të Beratit (fig. 1) në drejtimet e tij kryesore të vendosjes së qendrës ekonomike dhe asaj të banuar, si dhe të traseve kryesore të rrjetit rrugor ishte formuar nga fundi i shek. XVII, ndërsa banesat, që formojnë ansamblet e lagjeve të ndryshme, i përkasin kryesisht shek. XVIII-XIX. Ndër ansamblet e qytetit të Beratit, më i vjetri është padyshim ai i lagjes Kala, i cili zhvillohet brenda mureve rrethues të saj. Këta të fundit, me një konfiguracion të përzgjatur, rrethojnë nga veriu në jug kodrën, e cila bie thikë në jug në grykën e Osumit. Në pjesën perëndimore të kalasë ishte rrethimi i dytë, në të cilin rreth çerekut të tretë të shek. XVII, sipas Çelebiut, kishte përveç xhamisë, sterës dhe banesës së komandantit të kështjellës dhe 50 banesa. Lagjja e banuar (fig. 2) brenda mureve rrethues të kalasë, nga ana urbanistike përsërit tiparet e njohura të këtyre ansambleve, që karakterizohen nga dëndësia e ndërtimeve dhe nga kushtëzimi i qartë i shpërndarjes së rrjetit rrugor, nga hyrjet e kalasë. Pikërisht nga hyrja kryesore e kalasë zenë fill tre arteriet kryesore të rrugëve, dy prej të cilave zhvillohen anash përbri mureve të kalasë, ndërsa ajo kryesorja, çan pjesën qëndrore, duke u pasuruar më tej me një rrugë paralele. Prej arterit qendror shpërndahen degëzime të shumta, që krijojnë dhe kontura të mbyllura. Konfiguracioni i kodrës, ka kushtëzuar orientimin e detyruar të grupeve të ndërtimeve, njërit nga lindja dhe tjetrit nga perëndimi. Ngushtësia e truallit ka bërë që ndërtimet të jenë të ngjeshura, por jo në formë vargu. Përgjithësisht banesat kanë nga një oborr të vogël, ndërsa shumë prej tyre marrin pjesë në formulimin e rrugës.

Lagjja Mangalem (fig. 3) përbën një prej ansambleve më tipike ndërtuar mbi troje të pjerrëta, në



Fig. 4

mbarë arkitekturën popullore qytetare. Ngritur mbi një pjerrësi të thepisur shkëmbore, ajo paraqet një shembull mjaft të arritur të lidhjes së ndërtimeve me truallin. Shfrytëzimi maksimal i këtij të fundit ka kushtëzuar ndërtimet në formë vargjesh, me banesa shpesh përngjitur njëra tjetrës. Rrugët ndjekin vijat e niveleve; duke lidhur tërthorazi me kalime të pjerrta, disa herë në formë shkallësh. Banesat dalin drejtpërdrejt në rrugë, duke i gjallëruar ndjshëm ato. Hyrjet për në banesë janë në trupin e tyre, apo në ato pak mure rrethues, që kufizojnë në disa raste parcela shumë të vogla. Perspektiva e kufizuar dhe larmia e lëvizja e vazhduar e siluetave (fig. 4) karakterizojnë pamjet piktoreske të rrugëve të kësaj lagjeje. Nga larg ansambli shquan për kompaktësinë e theksuar, e cila arrihet jo vetëm nga volumet e vendosura pranë e pranë, por edhe nga trajtimi i njëjtë arkitektonik i pamjeve kryesore. Ekuilibri, dhe harmonia janë tiparet kryesore të këtij ansambli, i cili theksohet disi në qendër me njërën prej xhamive më të arritura të qytetit, asaj të «Beqarit» (1827), kompozimi volumor me gjysmëkat i së cilës të kujton atë të shumë banesave të kësaj lagjeje.

Ansambli i lagjes Goricë (fig. 5), përtej Osumit, në pjesën e sipërme përsërit karakteristikat e lagjes Mangalem, ndërsa në pjesën e poshtme, që bie relativisht butë drejt lumit, janë ndërtuar shumë banesa me çardak, me vendosje të lirë dhe oborre relativisht të mëdhenj. Lagjja Murat Çelebi, paraqet tiparet karakteristike të ansambleve ndërtuar në troje të rrafshët. Banesat; shumë prej të cilave të tipit me çardak, rrethohen nga troje të gjerë, qarkuar me mure rrethues. Rrugët plot lakime, janë të varfëra, muret rrethues, portat, dhe rrallë faqet anësore, apo të prapme të banesave, mezi thyejnë disi një far monotonie në pamjen e këtyre rrugëve.

Qyteti-muze i Beratit ruan një pasuri të rëndësishme në fushën e banesës popullore. Qendër e zhvilluar zejtaro-tregëtare gjatë periudhës së mesjetës së vonë, Berati arriti në realizime me vlera të mëdha në banesë. Në gjendjen e sotme kjo qendër ruan një numër relativisht të madh prej tyre, të cilat i përkasin shek. XVIII-XIX. Datimet përgjithësisht janë të pakta në numër, por megjithatë ato nuk mungojnë, në anë tjetër elementet e ndryshëm arkitektonikë dhe trajtimi dekorativ, lejojnë vendosjen e kronologjisë relative e madje përafërsisht dhe të asaj absolute në disa raste.

Banesat e Beratit, në dallim nga shumë qendra të tjera qytetare, shquajnë për një repertor relativisht të gjerë zgjidhjesh kompozicionale. Kjo e bën të vështirë klasifikimin e kësaj banese, e veçanërisht të disa zgjidhjeve, të cilat janë ndikuar fuqimisht nga truall mbi të cilin ngrihen. Ndërsa tipin e kullës qytetare, apo banesës me shtëpi zjarri përgjatë dy kateve, mund ta lidhim me qendra të tilla si Gjirokastra e Tirana, madje duke i cilësuar respektivisht tipet e mësipërme banesa gjirokastrite dhe ajo tiranase, Berati nuk lidhet ngushtësisht me tipa të caktuar, e aq më pak të vetëm. Për këtë arsye mbiemri beratase, për banesën e këtij qyteti duhet kuptuar si një cilësor, që lidhet me banesat e ndërtuar në këtë qytet dhe jo si një tip i veçantë, brenda tipologjisë së banesës qytetare shqiptare. Në klasi-



Fig. 5

PHOTOCOPY

fikimin e banesave të Beratit do ti përmbahemi atij të përmendur[14], duke i bërë disa saktësime. Në bazën e këtij klasifikimi qëndron kriteri më i përgjithshëm dhe njëherazi më thelbësori, ai i kompozimit planimetriko-volumor. Por për vetë karakterin e banesave të Beratit, për të tre llojet e banesave nuk do të përdorim termin tip, të cilin do ta ruajmë vetëm për banesën me çardak, ndërsa për të dy njësitë e tjera do të përdorim, thjeshtë, termin grup. Kështu banesa beratase mund të ndahet në tre grupe: banesa me çardak, banesa e mbyllur me gjysmëkat dhe me kat, si dhe grupi i banesave të rindërtuara, duke filluar rreth mesit të shek. XIX, apo të ndërtuara rishtas pas kësaj kohe. Grupi i tretë, në përbërësin kryesor të tij, atë të banesave të rindërtuara, është në lidhje të drejtpërdrejtë me të dy grupet e para.

Tipi me çardak, që formon grupin e parë të banesës beratase, ka një përhapje relativisht të gjerë në këtë qendër. Këto banesa i gjejmë të ndërtuara kryesisht në lagjen Murat Çelebi, dhe në pjesën e poshtme të lagjes Goricë. Shembuj të shumtë ruhen edhe në lagjet Prroi dhe Vakëf ndërsa tipa të tillë nuk mungojnë madje as në lagjen Kala dhe Mangalem, ku kushtet e truallit veçanërisht në të fundit, e bëjnë të vështirë vendosjen. Banesat me çardak kanë qenë ndërtuar kryesisht nga shtresa e pronarëve të tokave, të cilët jetonin në qytet me rentën feudale. Këtë banesë e gjejmë të ndërtuar në tre variante: me çardak në gjithë ballin, me çardak në një krah, dhe me çardak në qendër. Banesat e variantit të parë janë mjaft të rralla, ndërsa të dy variantet e tjerë kanë një përhapje thuajse të barabartë. Në mjaft raste variantet më të thjeshtë, pas shtesash të mëvonshme kanë arritur në skemat e varianteve më të zhvilluar. Datimi i saktë i këtyre banesave, shumë prej të cilave nga më të vjetrat e Beratit, është i pamundur sepse mungojnë mbishkrimet, por duke gjykuar nga elementet e ndryshëm arkitektonikë dhe dekorativë, shumë prej tyre duket se i përkasin shek. XVIII, apo edhe fillimit të shek. XIX. Më pas banesa të tilla nuk janë ndërtuar në Berat, me përjashtim të disa varianteve të mbyllur, që në skemën kompozicionale përsërisin ato të banesës me çardak. Arritjet vërtet të shquara të disa banesave të zhvilluara me çardak, të cilat duket se i përkasin shek. XVIII, të shtyjnë të mendosh se ky tip ndërtohej në Berat dhe më parë këtij shekulli.



Fig. 6

Kjo banesë merr emërtimin nga elementi bazë kompozicional, çardaku, i cili ze vendin qendror në kompozim, dhe sipas variantit qëndron përbri ambienteve të banimit, apo qarkohet prej tyre në dy, apo tre anë. Çardaku, gjatë stinëve të ngrohta merr funksione të qarta banimi. Kjo shihet në qoshqet e zhvilluara dhe sofatë pranë tyre. Për tu shkëputur nga sipërfaqja ndërlidhëse e çardakut, këto qoshqe ngrihen më lartë dhe në disa raste, balli që i kufizon anash, trajtohet me dritare (fig. 6), si të ishte e një ambienti banimi. Duke kaluar nga varianti i parë në të tretin, sipërfaqia e shfrytëzueshme vjen e zvogëlohet në raport me atë ndërlidhëse. Banesa me çardak është gjithmonë dy katshe, duke pasur skemën planimetrike thuajse identike, në të dy katet. Kati përdhe është i pabanuar. Ndërlidhja me katin e banuar sigurohet me shkallë guri, të cilat janë njëfishe, apo dyfishe, duke u ngritur gjithmonë mbi një sistem qemeresh. Shkallët, ndërtohen jashtë sipërfaqes së çardakut, kur balli i tij formohet nga një rresht shtyllash, druri, ose brenda sipërfaqes së tij, duke u përfshirë në këtë rast ndërmjet dy rreshtave të shtyllave. Balli i çardakut mbrohet me strehë të gjera, të cilat ndërtohen sipas dy skemash konstruktive[15] me strehë dyfishe dhe me testeke. Në disa raste, ndërmjet testekëve, vendoseshin persiane, për të penguar shikimin e çardakut.

14) E. Riza, **Art. Cit.** Tiranë, 1976.

15) G. Samimi, **Klasifikimi i banesave beratase, varianti i katërt i banesës me çardak dhe konceptet konstruktive të ndërtimit të kollonadës së çardakut dhe strehëve,** Kumtesë në Sesionin IV Shkencor të Inst. Mon. Kult. 1980.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 7

Skema planimetrike e banesave beratase me çardak, ndërtuar në troje të pjerrët, është e ndikuar ndjishëm nga forma e truallit. Kështu përveç orientimit të detyruar, i cili ka bërë, që në disa raste të ndërtohen çardaqe dhe nga veriu, koncepti i gjysmëkatit është shumë i përhapur. Krahas kësaj skemat planimetrike, në dallim nga ato të banesave të të njëjtit tip në lagjen Murat Çelebi dhe në Shkodër, janë mjaft të lira, duke pasur zhvillime që shkëputen ndjishëm nga skemat e pastra klasike, të cilat shquhen për thjeshtësinë e tyre. Banesa me çardak shquan për transparencën e theksuar të pamjes së saj kryesore, e vetmja e trajtuar me përkujdesje. Aty mbisundojnë volumet e hapura të hajatit dhe çardakut, duke pasur të parët në shumicën e rasteve në ballin e tyre një harkadë guri. Shkallët, shpesh me zgjidhje të theksuar monumentale (fig. 7) theksojnë ndjishëm pjesën qëndrore të pamjes kryesore, veçanërisht në variantin me çardak në qendër.

Banesa Nr. 1 (Tab. I), paraqet një prej shembujve të rallë të banesës me çardak të variantit të parë. Ajo sot vjen me disa ndryshime në çardak, por rikonstruksioni i saj arrihet lehtë, ngaqë gjurmët janë të qarta. Banesa ka një skemë shumë të thjeshtë, dy ambiente në secilin kat dhe përballë tyre, respektivisht hajati dhe çardaku, që ndërlidhen nga blloku i shkallëve prej guri. Ambientet e katit përdhe janë katoj, ndërsa sipër tyre është vendosur shtëpia e zjarrit dhe oda e miqve. Në fundet e secilit ambient, ngrihen komplekset e musandrave, nëpërmjet të cilave kalohet në dy ambientet sanitare. Çardaku ka një qoshk të gjerë përbri odës së miqve, ndërsa përpara zhvillohet një sofa e vogël, më e ngritur.

Banesa Nr. 2 (Tab. I), është një nga shembujt tipikë të variantit me një krah[16]. Ajo (fig. 8) është e kompozuar në volum me gjysmëkat, duke pasur në katin e banuar tre ambiente të vendosur radhazi. Oda e miqve, del përtej çardakut, ndërsa ky i fundit ka në krahun e majtë qoshkun dhe sofanë përbri tij. Banesa Nr. 3 (Tab. I), është një shembull tjetër me interes i variantit me një krah, e cila duke gjykuar nga ornamentika e tavanit të odës së miqve, duhet të jetë ndërtuar në shek. XVIII. Nga skema kompozicionale, ajo nuk paraqet dallime me rëndësi nga banesa Nr. 2.



Fig. 8

16) B. Strazimiri, **Arkitektura dhe restaurimi i banesës së Bizbiqeve,** «Monumentet», 1974, nr. 9.

Varianti me çardak në qendër, paraqet arritjet më të shënuara të tipit me çardak në banesat e Beratit. Kompozimi i theksuar simetrik, trajtimi i arritur i pamjes kryesore me kontrastin e goditur ndërmjet pjesës qëndrore të lehtë dhe trasparente me blloqet anësore të mbyllur, dhe përmasat relativisht të mëdha të këtyre banesave i japin atyre vlera të rëndësishme arkitektonike. Banesa Nr. 4, (Tab. II, fig. 9) në lagjen Goricë paraqet një prej shembujve të thjeshtë të këtij varianti. Katër ambiente në secilin kat, qarkojnë në tre anët hajatin dhe çardakun. Ky i fundit, për vetë zhvillimin e skemës planimetrike, ka funksione të qarta ndërlidhëse, me përjashtim të dy sofave të vogla, që ngrihen simetrikisht, ndërmjet dy rreshtave të shtyllave prej druri. Kompozimi i ngjeshur, zhvillohet me thyerje në planimetri, të cilat kushtëzohen nga numëri prej dy ambientesh në pjesën fundore të banesës.

Shembullin më të zhvilluar të këtij varianti, dhe njëkohësisht një nga arritjet më të shquara të banesës shqiptare me çardak e përbën banesa Nr. 5 (Tab. II) në lagjen Kala. Ajo paraqet një nga kulmet e këtij tipi, si në planin e zhvillimit, ashtu edhe në atë të vlerave arkitektonike. Skema planimetrike përsërit kompozimin e zakonshëm, duke qenë zgjidhje e vetme, krijimi i dy qoshqeve të gjerë në vazhdim të sipërfaqes së çardakut, ndërmjet radhës së ambienteve fundore dhe atyre të krahëve. Me vlera të rëndësishme arkitektonike është dhe një lloj portiku në pjesën e prapme të banesës (fig. 10).

Krahas banesës tipike me çardak, në të cilën ky i fundit luan një rol të dorës së parë funksional, çardaku në madhësi të vogël dhe me vendosje të improvizuar, ndërtohet edhe në banesa, që nuk mund të përfshihen në këtë tip. Paralele të këtij koncepti ndeshen rëndomë edhe në banesën gjirokastrite dhe atë tiranase, madje jo si vendosje të improvizuara, por të lidhura mirë me kompozimin e banesës.

Grupi i dytë i banesave të Beratit, ai i ndërtesave të mbyllura me kat dhe gjysmëkat, është në lidhje të drejtpërdrejtë me grupin e tretë, sepse numëri më i madh i banesave të grupit të dytë, ashtu si dhe ai i grupit të parë, iu nënshtrua punimeve të rëndësishme të rindërtimit gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX. Banesat e këtij grupi, që ngrihen kryesisht në tri lagjet më karakteristike të Beratit: Kala, Mangalem e Goricë, përbëjnë dhe zgjidhjet më tipike, për të cilat cilësimi beratase ka edhe një vlerë të veçantë, sepse lidhet thuajse vetëm me këtë qendër. Nëse për banesën me çardak e cila është mjaft e qartë dhe e përcaktuar nga ana tipologjike, zgjidhjet shquajnë për një tipizim të spikatur, për banesat e



Fig. 9

grupit të dytë, në përgjithësi, nuk ndeshim në principe të përcaktuara kompozicionale, me përjashtim të banesave me gjysmëkat perpendikulare. Mungesa e njësisë kompozicionale në banesat e këtij grupi, i detyrohet truallit të thyer e relativisht të vogël të ndërtimit, mbështetjes së banesës pas shkëmbit, në faqen e prapme, plotësisht, apo pjesërisht. Trualli i pjerrët shkëmbor dhe banesa, veçanërisht në lagjet Mangalem dhe Goricë, janë në lidhje të ngushtë me njera tjetrën. Banesa mbështetet në të, i përshtatet formës së tij, madje e fut atë pjesërisht në ambientet e dorës së dytë (fig. 11).

Përgjithësisht programi i këtyre banesave, që i



Fig. 10

FOTOCOPY

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 12

përkisnin shtresave të mesme të popullsisë qytetare, kryesisht zejtare, si dhe atyre që merreshin plotësisht apo pjesërisht me kultivimin e kopshteve, është i thjeshtë. Ai përmbledh katoin, një apo më tepër në numër, shtëpinë e zjarrit, si dhe odën e miqve. Zgjidhjet me një ambient të vetëm banimi, janë shumë të rralla, ndërsa ato me më shumë se një ambient banimi, përveç shtëpisë së miqve, më të shpeshta. Këto banesa janë me gjysmëkat, me dy kate, madje rrallë, pjesërisht, apo plotësisht me tre kate. Ato rrethohen me oborre, por shpesh nuk kanë të tillë, duke dalë hyrja drejtpërdrejt në rrugë. Në lagjet Mangalem dhe Goricë, ku kompozimi në formë vargu është i theksuar, një pjesë e banesave kanë hyrje nga pjesa e prapme e tyre, apo anash, sipas raportit të banesës me rrugën. Banesat e këtij grupi kanë qenë ndërtuar krejtësisht me gurë, në të dy katet, deri aty rreth mesit të shek. XIX. E. Çelebiu shkruan prerazi lidhur me varoshin e madh, siç e quan ai qytetin e hapur, «ka 5000 shtëpi të stolisura dhe të mbajtura mirë, mbuluar me tjegulla, shtëpitë janë dykatëshe, janë ndërtuar kryekëput prej guri»[17]. Banesa e mbyllur me kat dhe gjysmëkat, prej guri, ka qenë një dukuri mjaft e përhapur në Berat. Shembujt e banesave përdhese, janë jashtëzakonisht të pakët në numër (fig. 12).

Grupin e dytë të banesave të Beratit, gjithashtu, duke u mbështetur në kompozimin e tyre mund ta ndajmë në tre nëngrupe dhe pikërisht: banesat me kat, banesat me gjysmëkat perpendikulare, dhe banesat me gjysmëkat me shtrirje gjatësore. Theksojmë se për arsye të përfshirjes së gjerë të këtyre banesave në valën e rindërtimeve, gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, pak prej tyre kanë mbetur në gjendjen e tyre origjinale, prandaj në paraqitjen e shembujve më përfaqësues të këtyre nëngrupeve do të përfshijmë dhe banesa të rindërtuara.

Banesat e mbyllura me kat, siç përmendëm ndeshen rrallë në Berat. Ato nuk kanë ndonjë kriter të përcaktuar kompozicional. Shembujt e paraqitur në Tab. III, janë banesa të thjeshta, me zhvillim planimetrik të ndryshëm. Në të gjitha këto banesa, kati përdhe është i pabanuar. Ai është një hapësirë e vetme, ose në të ndërtohen një apo dy ambiente ndihmës. Volumi i shkallëve, sipas rastit vendoset në qendër të kompozimit, apo në një kënd të tij.

Banesat me gjysmëkat perpendikulare, janë relativisht të përhapura në Berat, ashtu si në Gjirokastër, Krujë, lagjet pranë kalasë së Shkodrës dhe në shumë krahina të vendit. Trualli i pjerrët, dhe programi i saj, i cili plotësonte mirë kërkesat e

17) E. Çelebi, **Vep. Cit.** f. 692.

shtresave të mesme të shoqërisë së kohës, në kushtet e ekonomisë qytetare, bazuar mbi sistemin mesjetar të esnafëve, dhe të lidhur ngushtë me ekonominë bujqësore, shpjegon përhapjen e kësaj banese edhe në Berat. Në planin e kompozimit volumor, kjo banesë karakterizohet nga vendosja e aksit gjatësor, normal, rënies së truallit, me zhvillim të pabarabartë të kateve, duke qenë ai i sipërmi, më i shtrirë, dhe për pasojë, pjesërisht përdhes. Banesa të tilla janë ndërtuar në të tre lagjet muze, por ato i ndeshim më shumë, në pjesën e sipërme të lagjes Goricë. Banesa me gjysmëkat perpendikulare, ka zakonisht në katin përdhe një katua, ndërsa shkallët janë të jashtme, përngjitur njerës faqe gjatësore të banesës. Në disa raste shkallët zhvillohen brenda volumit të banesës, për shkak të mungesës së truallit të ndërtimit, i cili veçanërisht në lagjet Mangalem dhe Goricë, është vërtet i pakët. Sipas numërit të ambienteve të banuara, këto banesa i gjejmë rrallë me një të tillë (Tab. IV). Më shpesh ato ndërtohen me dy ambiente, shtëpinë e zjarrit, e cila zë gjithmonë pjesën përdhese dhe odën e miqve (Tab. IV), si dhe me tre të tillë të kompozuar radhazi (Tab. V). Në banesat me dy ambiente banimi, zbatohen dy zgjidhje: ndërtimi i të dy ambienteve në vazhdim të njëri tjetrit, apo vendosja ndërmjet tyre e një ambienti ndërlidhës. Rrallë ndërtohen edhe dy banesa të përngjitura, për dy vëllezër (Tab. V). siç praktikohet edhe për banesa të tipave të ndryshëm të banesës qytetare dhe fshatare.

Banesat me gjysmëkat me shtrirje gjatësore, përbëjnë zgjidhje që ndeshen dendur në Berat. Pamundësia për shtrirjen e gjerë të banesës, në kushtet e trojeve mjaft të pjerrët, që praktikisht nuk lejojnë ndërtime me gjerësi të madhe, dhe synimi për të shfrytëzuar sa më mirë ata, ka diktuar kompozime të shtrira gjatësore. Familjet numerike, apo disa familje të dala prej një trungu të vetëm i gjenin këto zgjidhje mjaft të përshtatshme. Këto banesa, ku parimi i gjysmëkatit është tepër i përhapur, në katin e banuar ndërtohen sipas dy kriteresh kompozicionale: duke i vendosur ambientet radhazi, ndërsa përbri tyre në pjesën e prapme lihet një rruginë ndërlidhëse, ose duke ndërtuar dy radhë paralele ambientesh me një koridor ndërlidhës ndërmjet tyre. Në disa raste, trualli tepër i aksidentuar, ka bërë që të dy këto parime të zbatohen së bashku në një banesë të vetme. Ambientet e vargut fundor, për



Fig. 13

shkak të terrenit të pjerrët, në shumicën e tyre nuk kanë asnjë mundësi të marrin dritë nga dritare në muret rrethues, prandaj në këto raste ndërtimi i baxhave është një dukuri e zakonshme. Shtëpia e zjarrit është gjithmonë në këtë pjesë të banesës. Shembujt me një radhë të vetme ambientesh (Tab. VI) janë relativisht të rrallë. Në shembullin e paraqitur, kemi të bëjmë me një nga banesat[18] më me interes, ku shfrytëzimi mjeshtëror i truallit të pjerrët ka arritur një realizim të shënuar. Banesa ka kompozim tipik me gjysmëkat, duke arritur pjesërisht në lartësinë e katër kateve. Ndërtimi duket se i ka shërbyer dy familjeve me lidhje të afërta gjinije. Përveç hyrjes kryesore, banesa ka dhe dy hyrje të dyta, në pjesën e prapme të tij. Kompozimi gjatësor i volumeve të katit të banuar, formohet nga dy njësi ku secila ka shtëpinë e zjarrit dhe odën. Banesa në të dy ambientet qendrorë e ka të rindërtuar ballin, duke u futur teknika me skelet druri, me dritaret e mëdha karakteristike të gjysmës së dytë të shek. XIX, ndërsa të dy ambientet anësore kanë mbetur të pa prekur, duke na dhënë një shembull relativisht të rrallë (fig. 18) të bashkëjetesës së formave të vjetra arkitektonike me ato të reja. Shembujt me dy radhë

18) L. Lazimi **Shfrytëzimi i terrenit, një nga tiparet e arkitekturës popullore të qytetit-muze të Beratit,** në «Monumente historike në vendin tonë», Tiranë 1978. (Rilevimi i paraqitur është i autorit të këtij artikulli).

DOKOT COPY



Fig. 14



Fig. 16



Fig. 15

ambientesh janë relativisht të përhapur. Shpesh ata paraqesin kompozime mjaft të përzgjatur (Tab. VII) me një numër të madh ambientesh. Larmia e kompozimeve në banesat me gjysmëkat me shtrirje gjatësore, duke ruajtur principet e përmendura, është tepër e madhe, ashtu si në përgjithësi për banesat e mbarë këtij grupi. Madje nuk mungojnë dhe zgjidhjet, që mbulojnë pjesërisht kalimin e rrugës, pa e dhunuar atë (fig. 13).

Një element arkitektonik me interes në banesat e Beratit të dy grupeve të para, të cilat lidhen me formacionin feudal të shoqërisë, është dhe kamerieja. Berati përbën pikën e ndërmjeme të shfaqjes së këtij elementi, me Gjirokastrën në jug, ku kamerietë janë mjaft të përhapura dhe me Elbasanin në veri, ku shembujt e tillë janë tepër të rallë. Me emërtimin kamerie (siç duket termi vjen nga greqishtja e vjetër dhe do të thotë qemer) përfshihen disa dukuri arkitektonike me funksione dhe trajtime të ndryshme, të cilat i bashkon përdorimi i qemerit. Në Gjirokastër kamerietë[19] janë me funksione mbrojtëse dhe jo mbroj-

19) E. Riza. **Qyteti-muze Gjirokastrës,** Tiranë, 1981.

DO NOT COPY



Fig. 17

DO NOT COPY

tëse. Të parat janë njësh, dhe veças banesës. Në Berat, kamerietë, megjithëse me përhapje më të pakët se në Gjirokastër, njihen gjerësisht në të tre lagjet-muze dhe relativisht rrallë në lagjet Prroi dhe Vakëf. Kamerietë e Beratit janë të llojeve të ndryshme. Disa kamerie të mbyllura; veçanërisht në lagjen Kala (fig. 14) të kujtojnë ato me karakter mbrojtës të Gjirokastrës, por duke qenë se janë një katshe dhe sipër mbulohen me një lloj terrace, me shumë të ngjarë nuk kanë pasur funksion të tillë. Sot dy shembuj të këtyre kamerieve, janë të shkëputura nga banesat pranë. Siç duket banesat origjinale, pjesë e të cilave kanë qenë këto kamerie, ose janë shkatërruar, ose janë rindërtuar krejtësisht. Sidoqoftë funksioni i krijimit të një sheshi, një lloj belvedereje, për qëndrim është krejt i qartë në të gjitha kamerietë e Beratit, ashtu siç e gjejmë këtë funksion pjesërisht, apo plotësisht edhe në Gjirokastër. Në Berat takojmë kamerie me këtë funksion edhe përngjitur një banese me çardak (fig. 15) një shtëpie miqsh në formë kulle[20], dhe së fundi lidhur mjeshtërisht me një banesë (fig. 16) të rindërtuar thuajse krejtësisht më 1856. Por lloji më i përhapur, dhe njëherazi tipik, i kamerieve të Beratit është ai i atyre të ndërtuara mbi portën e hyrjes për në banesë (fig. 17). Sheshi mbi portë, ka lidhje me katin e banuar, kështu që mundësohet shfrytëzimi i këtyre. Kamerietë mbi portat i pasurojnë ndjishëm vlerat arkitektonike të këtyre të fundit, dhe gjallërojnë siluetën arkitektonike të rrugës.

Tre lagjet më karakteristike të Beratit, në të cilat janë ndërtuar përgjithësisht banesat e dy grupeve të para, deri aty rreth mesit të shek. XIX, kishin një pamje të ndryshme nga e sotmja. Ndërtimet prej guri në të dy katet, hapësirat e vogla të ndriçimit mbuluar zakonisht me hark gjysëm rrethor, strehët e hapura dhe në përgjithësi trajtimi i ashpër i pamjeve të jashtme, karakterizonin ansamblet e këtyre lagjeve. Sot prej këtyre ndërtimeve ruhen vetëm disa gjurmë të pjesshme në lagjen Mangalem (fig. 18).

Grupin e tretë, të tipologjisë së banesave beratase, e përbëjnë banesat e rindërtuara gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX dhe më tej, si dhe banesat e reja të ndërtuara gjatë kësaj kohe. Ritheksojmë se përfshirja në të njejtin grup e këtyre dy kategorive,



Fig. 18

20) E. Riza, H. Nallbani, **Një ndërtim i tipit kullë në Berat,** «Monumentet», 1975, nr. 10.

INST. MON. KULTURES
BIBLIOTEKA
Nr. INV. 8675

DO NOT COPY



Fig. 19

është bërë kryesisht sepse principet kompozicionale të atyre pak ndërtimeve të reja të ngritura gjatë kësaj kohe në Berat janë zakonisht të njejta me ato të banesave të rindërtuara. Lidhur me sa më sipër duhet të ndalemi në një problem të diskutueshëm, dhe pikërisht në atë të vetë domethënies, apo më saktë të pavarësisë së këtij grupi. Ashtu siç kemi përmendur më sipër grupi i tretë i banesave të Beratit, me përjashtim të banesave të reja, shumë të pakta në numër, është në lidhje të drejtpërdrejtë me dy grupet e para, sepse është fjala pikërisht po për ato banesa të cilat i nënshtrohen ritrajtimit. Vetiu del se një banesë e rindërtuar i përket njëkohësisht dy grupeve, njërit prej dy të parëve, dhe atij të tretit. Kjo paraqet vërtet diçka të pazakontë, duke qendruar pikërisht këtu, përveç të tjerash, vështirësia e klasifikimit tipologjik të banesës beratase. Por megjithkëtë mendojmë se, meqë, veçanërisht në banesat me gjysmëkat me kompozim gjatësor, konceptet e reja kanë prekur jo vetëm elementet, por në shumë raste mbarë kompozimin e banesës, ndryshimet në këto banesa janë të një shkalle të tillë, që duhen mbajtur si thelbësore. Ndryshe qëndron puna me banesat me çardak dhe ato me gjysmëkat perpendikulare. Në të parat përgjithësisht kemi mbylljen e çardakut dhe sajimin e ambienteve të rinj në sipërfaqen e tij, ndërsa në banesat me gjysmëkat perpendikulare, për vetë kompozimin e tyre, ndryshimet janë relativisht të pa rëndësishme. Prandaj për këto lloj banesash, megjithëse do të përmenden në këtë grup, kjo përmendje ka kryesisht lidhje me ndryshimet që pësuan ato, të cilat nuk duhen mbajtur si të rëndësishme. Kjo nuk mund të thuhet për banesat me gjysmëkat me shtrirje gjatësore, të cilat me ndryshimet që pësuan, përbëjnë thelbin e grupit të tretë. Ritheksojmë se mungesa e qartësisë së plotë në tipologjinë e disa njësive të banesës beratase, në dallim nga ajo e qyteteve të tjera të vendit, është e kushtëzuar nga vetë karakteri i veçantë i historikut të këtyre banesave.

Kushtet shoqërore që shërbyen si shtytëse për dukuritë e reja në mbarë banesën qytetare shqiptare, duke filluar që rreth mesit të shek. XIX, janë tashmë të njohura[21]. Fillimi i lindjes së marrëdhënieve kapitaliste, krijimi i tregut të brendshëm kombëtar, dhe fuqizimi i shtresave zejtaro-tregëtare, që tashmë po formoheshin si klasë, u pasqyruan edhe në banesë. Banesa e lidhur me formacionin feudal të shoqërisë shkallërisht filloi ti lerë vendin banesës së re, e cila së pari me konceptet e saja kompozicionale dhe ndërtimore në përgjithësi, kërkon të ndryshojë, sa e lejonin mundësitë, banesat e vjetra. Kjo dukuri është shumë e fuqishme veçanërisht në Berat, e favorizuar dhe nga termeti i fuqishëm i vitit 1851. Në tre lagjet-muze të Beratit shembujt e këtyre rindërtimeve janë me të vërtetë të panumërta. Kriteret e reja në planin kompozicional janë të njëjta me ato të banesës korçare, krijimi i një qoshku qëndror të mbyllur të theksuar në pamjen kryesore, ndërsa anash dy ambiente banimi. Në planin e elementeve arkitektoniko-teknikë kemi përdorimin e gjerë të daljeve në formë erkeri, pra dhe zbatimin e teknikës me skelet druri, e cila për kushtet e Beratit, ishte shumë dobiprurëse, sepse jepte mundësinë për shtimin e sipërfaqes së banuar në kurriz të rrugës, si dhe mundësonte korigjimin e formave të ambienteve, që përndryshe dilnin me zhvillime të çregullta. Përpunimi i kujdesshëm i pamjeve kryesore, dritaret e mëdha, strehët e mbyllura etj. kishin karakteristika me rëndësi të arkitekturës së re të banesës.

21) E. Riza, **Banesa qytetare shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, deri rreth çerekut të parë të shek. XX.** «Monumentet» 1980, tr. 20.

DO NOT COPY



Fig. 20



Fig. 21

Banesa me çardak, gjatë kësaj periudhe iu nënshtrua ndryshimeve me rëndësi, të cilat qëndronin kryesisht në mbylljen e çardakut dhe ndërtimin në të të ambienteve të rinj. Tipik është shembulli i një banese me çardak[22] në lagjen Goricë, e cila është transformuar mjaft; pa iu cënuar parimet themelore kompozicionale. Shembujt lidhur me këto shfaqje në banesat me çardak të Beratit janë të shumtë (fig. 19) duke lënë pa cenuar vetëm shumë pak banesa të këtij tipi. Datimi më i vonë i njohur është ai i vitit 1899, në një banesë të zhvilluar me çardak, por ky sigurisht nuk është i fundit. Edhe banesat me kat pësojnë ndryshime, një shembull tipik paraqet një banesë (Tab. VIII) në lagjen Kala, e cila ka edhe një kamerie mbi portën e hyrjes (fig. 20). Banesa me gjysmëkat perpendikulare, për vetë kompozimin e saj tepër të ngjeshur, paraqet mundësi të pakta për ndryshime, prandaj në këta shembuj, u ritrajtua përgjithësisht vetëm balli i katit të banuar.

Ndryshimet më të mëdha në banesat beratase, i përkasin banesave me gjysmëkat me shtrirje gjatësore. Vargu ballor i këtyre ambienteve pësoi ndryshime me rëndësi, duke dalë përgjithësisht i gjithë kati në formë erkeri dhe duke tjetërsuar kështu plotësisht pamjen e banesës. Shembujt në këtë drejtim (fig. 21) janë të shumtë. Pamjet e tre lagjeve karakteristike të Beratit, marrin kështu tipare krejt të reja. Në dallim nga gjendja përpara rikonstruksionit, ato shquajnë për ndërtimet e lehta me daljet e zakonshme në formë erkeri dhe dritaret e shumta, që me sipërfaqen e madhe e ritmin e tyre, i japin një notë të theksuar piktoreske ansambleve

22) G. Samimi, **Studimi dhe restaurimi i një banese karakteristike në Berat,** «Monumentet», 1973, nr. 5-6.

kompaktë e harmonikë, të kompozuara në formë të shkallëzuar, duke bërë që të punojnë të gjitha pamjet kryesore në një njësi me unitet të theksuar trajtimi arkitektonik.

Banesat e reja, të ndërtuara gjatë kësaj periudhe në Berat, megjithëse nuk mungojnë janë relativisht të pakta në numër. Veprimtaria ndërtimore ishte drejtuar kryesisht në rindërtimin e banesave ekzistuese, që për shumë arsye nuk mund të braktiseshin. Një zhvillim relativisht i qetë i jetës ekonomike të qytetit, gjatë kësaj periudhe, në dallim nga rritja e furishme e Korçës, bëri që në Berat të mbisundojnë dukuria e rindërtimeve në krahasim me atë të banesave të reja. Këto të fundit, paraqesin në kompozim principet e njohura të banesës korçare, pa përjashtuar edhe zgjidhjet e veçanta. Shembulli që paraqesim (Tab. VIII), siç duket i përket fillimit të shek. XX. Ai si nga kompozimi, ashtu dhe trajtimi arkitektonik lidhet qartazi me konceptet e reja të banesës qytetare shqiptare.

Në planin urbanistik, në krahasim me qytetet e tjerë të vendit, Berati shquan për larminë e jashtëzakonshme të karakterit të lagjeve të banuara, i cili kushtëzohet nga trualli, skajërisht i larmë, mbi të cilin ai ngrihet. Në Berat ndeshim që prej ansambleve tepër të ngjeshur të Mangalemit e deri te lagjja e shtrirë Murat Çelebi, e cila ka të njëjtat karakteristika me ato të qyteteve, apo lagjeve të ndërtuara në troje të rrafshët. Kjo larmi e karakterit të lagjeve të banuara, lagjja përtej Osumit, ajo brenda mureve rrethues të Kalasë, si dhe lagjja Murat Çelebi, thuajse e shkëputur nga qendra e qytetit, e bëjnë Beratin mjaft të shpërndarë. Në këtë drejtim ai mund të krahasohet vetëm me Gjirokastrën, gjithë duke pasur parasysh dallimin e rëndësishëm, atë të kompaktësisë së ndërtimeve të Beratit, në dallim nga ansamblet e Gjirokastrës, ku ndërtimet megjithëse formojnë tërësi homogjene, punojnë mirë veças. Gjirokastra qoftë për vendosjen e ndërtimeve, ashtu edhe për karakterin e ashpër dhe kompozimin dinamik e të hedhur në lartësi të tyre, shquan për monumentalitet, në dallim nga Berati që me ndërtime të ngjeshura, me shtrirje të theksuar horizontale, dhe trajtim të lehtë e plot dritë të katit të banuar, karakterizohet nga piktoreskja.

Banesat e qytetit të Beratit në kuadrin e banesës qytetare shqiptare zenë një vend me rëndësi, pa përbërë në shfaqjet e tyre tërësisht, apo pjesërisht tip, apo tipe të veçantë të lidhur kryekëput me këtë qendër. Banesat e Beratit, të cilat përfshihen në tipe të ndryshme të banesës qytetare shqiptare, zenë aty një vend të rëndësishëm me arritjet e tyre të cilat në disa raste bartin vlera të spikatura. Me shumë rëndësi në këtë tipologji është grupi i dytë dhe i tretë i banesave, të Beratit duke dhënë një shembull me shumë interes, jo vetëm për diapazonin e gjerë të repertorit kompozicional të banesës shqiptare, por edhe për dukuritë e reja, lidhur me ndryshimet në banesën shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shek. XVIII.

Banesa beratase me çardak, zë një vend të dorës së parë në tipologjinë e këtij tipi me rëndësi të banesës qytetare shqiptare. Shkaqet duhen kërkuar në shkallën e lartë të realizimeve, si dhe në disa tipare lokale të cilat karakterizojnë këtë banesë. Banesën me çardak të Beratit mund ta krahasojmë gjerësisht vetëm me atë të njejtit tip në Shkodër, ku ajo gjeti përhapje dhe arritje me vlera. Banesat me çardak të pakta në Elbasan, dhe shumë të pakta në qytete të tjerë si Lezha, Kruja, Korça, etj. paraqesin arritjet gjithsesi më pak të zhvilluara se ato të Beratit dhe Shkodrës.

Në planin e kompozimit, banesat beratase me çardak, në krahasim me ato të Shkodrës të të njejtit tip, nuk paraqesin dallime me rëndësi. Për tu shënuar është mospërhapja në Berat e variantit me shtëpi zjarri, në pjesën e prapme të banesës[23]. Çardaku, elementi më me rëndësi i kësaj banese, në shembujt e Beratit, paraqitet me një përpunim që shkon më tej se ata të Shkodrës, siç tregon mbyllja e njerës prej faqeve anësore të çardakut me një perde, prej skelet druri, ku janë ndërtuar dritare. Për tu theksuar është dhe përhapja relativisht më e gjerë e varianteve të zhvilluar me një, e sidomos me dy krahë në Berat, në dallim nga Shkodra, ku përgjithësisht varianti me çardak në gjithë ballin, ka qenë më i përhapuri, ndërsa shtesat e mëvonshme i kanë prurë ato në variante më të zhvilluara. Megjithkëtë kur krahasojmë banesat me çardak të Shkodrës, me ato të Beratit, duhet të kemi parasysh se këto ndërtime në Berat, duhen ndarë në dy pjesë, lidhur me truallin mbi të cilin ngrihen. Kështu banesat me çardak në trojet e pjerrët të lagjes Goricë, Prroi e Kala, përsa i përket kompozimit volumor, madje dhe raportit sipërfaqësor të çardakut me pjesën tjetër të banesës paraqesin dallime për tu theksuar, me ato të banesës shkodrane me çardak, e cila përndryshe është shumë më afër banesave të këtij lloji në lagjen Murat Çelebi. Trualli i pjerrët i lagjeve të Beratit, ka kushtëzuar përhapjen e gjerë të kompozimit volumor

23) E. Riza, **Banesa popullore në Shkodër gjatë shek. XVIII-XIX,** «Monumentet», 1972, nr. 4.

Poviot COPY

me gjysmëkat edhe në këto banesa. Ngushtësia e truallit gjithashtu është shkaku i sipërfaqeve relativisht të vogla të çardaqeve, që në disa raste, nuk janë veçse sipërfaqe ndërlidhëse, që bëjnë të nevojshme edhe ndërtimin e kameriesë (fig. 15). Së fundi, ndikimi i truallit, në banesat me çardak të Beratit, shfaqet edhe në orientimin e detyruar të tyre, i cili shpesh largohet shumë nga ai i zakonshmi në trojet e rrafshëta.

Banesa me çardak mbi troje të pjerrët në Berat, në dallim nga ajo mbi troje të rrafshët, merr pjesë në pamjen e ansamblit ku bën pjesë. Pra ajo, si dhe çardaku i hapen syrit të kalimtarit. Pikërisht këtu duhet kërkuar shkaku i përdorimit në Berat të persianeve që vendosen ndërmjet testekeve që mbajnë strehën ballore të çardakut. Trajtimi i pamjes kryesore të banesës beratase me çardak në përgjithësi, është më i arritur se i atyre të Shkodrës. Kjo lidhet kryesisht me trajtimin e ballit të hajatit, i cili në Shkodër është tepër i thjeshtë me kollona guri, ndërsa në Berat ai arrin realizime shumë të përpunuara me një harkadë e cila lidhet mjeshtërisht me volumin e shkallëve, i cili nga ana e tij gjithashtu zhvillohet mbi një sistem qemeresh. Ky realizim i rrit mjaft vlerat estetike të banesës beratase me çardak, në dallim nga banesat e Shkodrës. Gjithashtu një dallim për tu vënë re është përdorimi i madh i testekëve, që mbajnë strehën e gjerë e cila mbron çardakun, krahas përdorimit të teknikës me strehë dyfishe[24], të vetmes së njohur në Shkodër. Teknika me testekë e bën më dinamik konstruksionin dhe ndihmon për thyerjen e kompozimit horizontal. Një dallim tjetër për tu theksuar është dhe përdorimi mjaft i gjerë në Berat i ndërtimeve prej harqesh dhe qemeresh në dallim nga Shkodra, ku përdorimi i gjerë i drurit, dhe guri jo shumë i përshtatshëm (gur lumi, apo kave jo shtresor,), kanë bërë që të mbisundojnë mbulesat e rrafshëta.

Lidhur me trajtimin e brendive të odave, duke përfshirë dhe atë të banimit, nga ana kompozicionale nuk shihen dallime, me përjashtim të vendit të oxhakut, i cili në Shkodër veçanërisht në odën e miqve, vendoset në qendër të ballit të odës, përkundrejt kompleksit musandër-trapazan, në dallim nga Berati, i cili e ruan ballin vetëm për dritaret e shumta, që në disa raste janë pjesë e qoshkut (pjesës ballore të ambientit). Kompleksi musandër-trapazan në Shkodër dallohet për njësinë më të theksuar, nga ana e trajtimit, në dallim nga Berati ku gjejmë më shumë larmi formash.

Banesa me gjysmëkat perpendikular e Beratit, për nga kompozimi ruan tiparet e njohura të kësaj banese të përhapur gjerësisht në Gjirokastër, Krujë dhe Shkodrën e vjetër. Përsa i përket banesës me gjysmëkat me kompozim gjatësor, ajo duhet konsideruar si një shfaqje deri diku e veçantë, që lidhet kryesisht me Beratin.

Rindërtimet e gjera të gjysmës së dytë të shek. XIX, e vendosin Beratin në një vend të veçantë në mbarë historikun e zhvillimit të banesës qytetare shqiptare, si një shembull me interes të rrugës që zgjodhi borgjezia e këtij qyteti për materializimin në banesë të identitetit të saj klasor, në dallim nga rruga e ndjekur nga borgjezia korçare, e cila njohu një zhvillim më të vrullshëm, të pa mpleksur me tradita të fuqishme të ekonomisë feudale, duke kushtëzuar kështu rrugën e lindjes së një tipi të ri.

Duke krahasuar Gjirokastrën, Beratin dhe Shkodrën, tre qendrat qytetare më të shquara në fushën e arkitekturës popullore, të mesjetës së vonë në vendin tonë, mund të themi se Berati nga ana tipologjike afrohet me të dy qendrat e skajme, pjesërisht. Afëritë me Gjirokastrën i gjejmë në banesën me gjysmëkat perpendikulare, ndërsa me Shkodrën në banesën me çardak. Përsa i përket repertorit konstruktiv, deri rreth mesit të shek. XIX, ajo afrohet shumë me Gjirokastrën, ndërsa më vonë, shkrihet në klimën e përgjithshme arkitektoniko-konstruktive të kohës, nën shtytjen e dukurive të forta konvergjente, që karakterizojnë këtë periudhë.

Document

24) G. Samimi, **Klasifikimi i banesave beratase.....**, Kumtesë e mbajtur në Sesionin IV shkencor të I.M.K.

TAB. I



DO NOT COPY

BANESA Nr 4



BANESA Nr 5





KATI PERDHE



KATI PERDHE



KATI I

0 2 4M



KATI I

DO NOT COPY





KATI PERDHE

0 4 8M

KATI I PARE









KATI PERDHE

KATI I PARE





KATI PERDHE

KATI I PARE

0 2 4M







KATI PERDHE

KATI I PARE

DO NOT COPY





KATI I



PAMJE KRYESORE



KATI I



PAMJE KRYESORE



KATI I

0 2 4M.

DO NOT COPY

TAB. V



PAMJE KRYESORE



PAMJE KRYESORE



KATI PERDHE



KATI PERDHE



KATI I

0 2 4M



KATI I

DO NOT COPY

BANESE NE LAGJEN "Mangalem"
Berat



PRERJE TERTHORE



KATI II



KATI PERDHE



KATI I



DO NOT COPY

DO NOT COPY



PAMJE KRYESORE



PRERJE "A-A"



KATI I



PAMJE KRYESORE



KATI PERDHE



KATI I





KATI PERDHE



KATI I



KATI II

DO NOT COPY

EMIN RIZA

L'HABITATION POPULAIRE DE LA VILLE-MUSEE DE BERAT

RESUME

Différemment à la ville-musée de Gjirokastër et des autres centres citadines de notre pays comme Shkodër, Elbasan, Korçë, etc. Berat se distingue pour une variété plus riche de genres de construction, d'une étendue temporelle assez longue.

La citadelle, construction grandiose accomplie à travers les siècles, avec la contribution de quelques époques, les importantes constructions de culte, églises et mosquées, et finalement les fonds immenses d'habitations populaires font de Berat l'un des centres les plus distingués, où l'on peut suivre la création du génie albanais depuis le IVe siècle avant notre ère, jusqu'à nos jours. La mise de cette ville sous la protection de l'Etat en 1961, en la qualifiant de «ville-musée» créa les conditions pour l'étude de cet héritage architectonique, et pour sa restauration. La division en zones de la ville et la proclamation des monuments de première catégorie, furent les conclusions d'un travail vraiement scientifique.

Le but de cet article est de donner un panorama général du caractère, de la typologie de l'habitation de ce centre, sans laisser de côté ses traits urbains. La connaissance des réalisations de l'habitation citadine albanaise en général, sur laquelle, ces dernières années, il y a eu des publications, a facilité le traitement du problème.

Comme on vient de le dire, la ville de Berat conserve, à part les autres genres, une grande richesse dans le domaine des constructions populaires. Ces dernières se trouvent non seulement en tant qu'unité particulière, mais aussi dans des ensembles compactes et même des quartiers, qui conservent encore de nos jours le caractère et les traits urbains, qui sont liés au moyen et haut Moyen-Age. Pendant ce temps, se créa et s'accrût la ville ouverte, et l'un des quartiers principaux de la ville subit des changements importants, précisément celui à l'intérieur des murs d'enceinte, qui, jusqu'avant que la ville ait depassé les murs d'enceinte, c'est-à-dire de la citadelle elle-même, constituait la seule zone habitée.

Quant à la dynamique de croissance de la ville, tout d'arbord il faut considérer la sortie du centre habité au-delà des murs d'enceinte de la fortification. Le quartier situé en dehors de l'enceinte de la ville, le «Varosh» (Suburbia castri Bellogradi) est mentionné en 1280. Après cela, on a placé, sans hésitation, la naissance des premiers quartiers, en dehors de la Citadelle, au XIIIe siècle. A. Baçe, en liant le fait ci-dessus à certaines ruines de constructions, dans la partie Nord-Ouest de la Citadelle, pense que c'est justement là qu'il faut chercher le «Varosh» en question. Nous unissant à cette opinion, nous ajoutons que même la partie dans le sud de la Citadelle, entourée de murs, doit être considérée comme un «Varosh» fortifié.

Nous basant sur les données de l'an 1431 et du début du XVIe siècle, nous constatons que Berat a respectivement 175 et 561 habitations, donc il connaît une croissance considérable. La date relativement ancienne de la naissance du «Varosh» dans ce centre, la construction de la mosquée «Mbret», au XVe siècle et de celle du Plomb, en 1553-54, dans une zone relativement loin de la Citadelle, attestent qu'au cours du XVIe siècle, le processus de formation de la ville en dehors de l'enceinte, a marché avec des rythmes rapides à Bérat. Dans le cadre du rétablissement général de la ville albanaise de l'époque et du processus de peuplement avec de nouveaux habitants principalement artisans venus de la campagne, avait commencé la construction dans la zone du quartier actuel de Mangalem, et plus loin dans celles du Ruisseau et du «Vakef» (lieu saint). Le grand développement du quartier Murat Çelebi, sur le vaste terrain plat, dans l'Ouest de la Citadelle, comme l'attestent non seulement les témognages d'E. Çelebi, mais aussi les données d'un document de l'année 1688, qui indirectement parle de l'étendue des quartiers en cette année-là mènent à penser que ce quartier doit être des premiers construits en dehors de l'enceinte, peut-être en même temps que le quartier de Mangalem. Il se peut que le quartier de Goricë, au-delà de la rivière d'Osum, soit quelque chose de plus tard, mais pas tant que cela, en jugeant son développement relativement bon au début de la seconde moitié du XVIIe siècle. Le passage sur l'autre rive d'Osum et la construction dans une zone peu appropriée à la construction, ensoleillée seulement en été, et qui par conséquent avait le nom de «Gjen Gjormas» (qui ne voit pas le soleil), qui fait penser que, vers la fin du XVIe siècle, ou bien au début du XVIIe siècle, la ville étendue sur la rive droite d'Osum avait connu un grand développement.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Les témoignages du voyageur turc Evlia Çelebi attestent clairement qu'à cette époque-là la ville ouverte était devenue la partie principale de Berat, c'est là que se trouvaient le centre économique, son bazar, ainsi que la plupart des quartiers habités. Le bazar, en ce temps-là, avait pris une vaste étendue, commençant au pont de Gorice et continuant jusqu'au delà de la zone centrale de la ville. L'emplacement d'une bonne partie du bazar dans la zone autour de la mosqué «Mbret» et plus loin, la construction du monastère de derviches des Helveti (1780) avec les habitations et certaines autres constructions d'importance, la construction plus tard de la demeure d'un féodal puissant soulignèrent les traits du centre de la ville, alors que dans l'acropole de la Citadelle, jusque vers la moitié du XIXe siècle, à part les cazernes de soldats, se trouvait aussi le siège du conseil.

En 1777, Kurt Pacha construisit entièrement le pont de pierre reliant le quartier de Gorice avec l'autre partie du quartier. Auparavant il n'avait que les pieds en pierres, tandis que l'autre partie du pont était en bois, comme l'écrit Çelebi.

De ce qu'on vient de soumettre, il ressort qu'en lignes générales, l'étendue de la ville aussi bien que sa solution urbaine, vers la fin du XVIIe siècle avait obtenu des réalisations, qui, plus ou moins, ne subirent pas de modifications importantes au cours des siècles postérieurs.

Berat, en ce qui concerne la variété du terrain sur lequel il s'élève, présente une diversité plus grande, en comparaison avec les autres centres citadins, s'approchant dans une certaine mesure de Gjirokastër. On y trouve des quartiers sur des dos de collines comme celui de la Citadelle, sur des pentes rocheuses différentes comme Mangalem et Gorice, des constructions dans de petits vallons, et plus loin des ensembles typique sur des terrains plats. La Citadelle, avec le quartier habité à l'intérieur d'elle, la gorge traversée par le pont de Goricë, et plus loin le quartier Murat Çelebi, font que la ville de Berat est dans une certaine mesure éparpillée. Les grands ensembles du quartier de Kala, de Mangalem, de Gorice, ainsi que du quartier Murat Çelebi, se présentent comme des unités plus ou moins séparées, dans le cadre de la ville entière. Ils sont liés au bazar par des rues principales, qui unissent toute la ville en une seule unité. En général le développement urbain de la ville de Berat, est libre, il a été influé puissamment par la configuration même du terrain sur lequel il s'élève.

La ville-musée de Berat conserve une richesse importante dans le domaine de l'habitation populaire. Centre développé artisanal et commercial durant la période du haut Moyen-Age, Berat a atteint des réalisations de grande valeur quant à l'habitation. A l'état actuel ce centre garde un nombre relativement élevé de ces réalisations, qui appartiennent au XVIII-XIXe siècles.

Les habitations de Berat, différemment à beaucoup d'autres centres citadins, se font remarquer par un répertoire relativement vaste de solutions quant à la composition. Cela rend difficile la classification de cette habitation et particulièrement de quelques solutions, qui ont été influées puissamment par le terrain sur lequel elles s'élèvent.

A la base de la classification des habitations de ce centre nous placerons le critère le plus général et en même temps le plus essentiel, celui de la composition planimétrique et volumétrique. Mais par le caractère même des habitations de Berat, pour les trois sortes d'habitations on ne se servira pas le terme «type», qu'on réservera seulement à l'habitation à tchardak, tandis que pour les deux autres unités on emploiera simplement le terme «groupe». Ainsi, l'habitation de Berat peut se diviser en trois groupes: l'habitation à tchardak, l'habitation à un semi-étage ou à un étage, ainsi que le groupe d'habitations reconstruites, à partir de la moitié du XIXe siècle environ, ou bien construites nouvellement postérieurement à cette époque-là. Le troisième groupe, par sa composante principale, celle des habitations reconstruites, est en liaison directe avec les deux premiers groupes.

Le type à tchardak, qui forme le premier groupe de l'habitation de Berat connait une propagation relativement vaste dans ce centre. Ces habitations se trouvent principalement construites dans le quartier de Murat Çelebi, et dans la partie basse du quartier de Goricë. De multiples exemplaires sont conservés aussi dans les quartiers du Ruisseau (Perroi) et de Vakëf, alors que de tels types ne manquent même pas dans le quartier de Kala (la Citadelle) et de Mangalem. Les habitations à tchardak ont été essentiellement construites par les propriétaires de terres, qui vivaient dans cette ville de leur rente féodale. Cette habitation se trouve dans trois variantes: à tchardak sur tous son front, à tchardak sur l'un des côtés et à tchardak au centre. Les habitations de la première variante sont assez rares, tandis que les deux autres variantes ont une propagation presque égale. Dans bien des cas, les variantes les plus simples, après des suppléments postérieurs ont atteint les schémas des variantes les plus développées. La datation exacte de ces habitations, dont beaucoup sont des plus anciennes de Berat, est impossible, faute d'inscriptions, mais en jugeant à partir de différents éléments architectoniques et décoratifs, beaucoup d'entre elles semblent appartenir au XVIIIe siècle, ou même au début du XIXe siècle. Plus tard, de telles habitations n'ont pas été construites à Berat, sauf certaines variantes fermées, qui dans le schéma compositionnel reprennent les éléments de l'habitation à tchardak. Les réalisations vraiement réussies de certaines habitations développées à tchardak, qui semblent appartenir au XVIIIe siècle, font penser que ce type se construisait à Berat même avant le XVIIIe siècle.

Cette habitation emprunte sa dénomination à l'élément compositionnel de base, le tchardak qui occupe la place centrale dans la composition, et selon la variante reste à côté des volumes habités, ou bien il est entouré d'eux par deux ou trois côtés. Le tchardak, pendant les saisons chaudes assume de pures fonctions d'habitation. Cela se voit dans les encorbellements développés et les sophas auprès d'eux. Afin de se détacher de la surface intermédiaire du tchardak ces encorbel-

DO NOT COPY

lements s'élèvent plus haut et dans certains cas, les faces, qui les limitent sur les côtés, sont traitées ensemble avec des fenêtres (fig. 6), comme étant d'une pièce habitée. En passant de la première variante à la troisième, la surface mise à profit devient plus petite par rapport à celle intermédiaire. L'habitation à tchardak a toujours deux étages, ayant un schéma planimétrique presque identique aux deux étages. Le rez-de-chaussée est inhabité. Le lien avec l'étage, habité s'assure au moyen d'un escalier de pierre unilatéral ou bilatéral, s'élevant toujours sur un système d'arches. L'escalier se construit au dehors de la surface du tchardak, lorsque son front se forme d'une rangée de poteaux de bois, ou à l'intérieur de sa surface, se trouvant cette fois entre deux rangées de poteaux.

Le schéma planimétrique de l'habitation à tchardak de Berat, construit sur des terrains en pente, a été sensiblement influé par la forme du terrain. Ainsi, à part l'orientation obligatoire, la conception du semi-étage est très répandue. En plus de cela, les schémas planimétriques, différemment à ceux des habitations de même type du quartier Murat Çelebi et de Shkodër, sont assez libres, ayant des développements qui se détachent sensiblement des schémas proprement classiques qui se distinguent par leur simplicité.

De pair avec l'habitation typique à tchardak, où ce dernier joue un rôle fonctionnel de premier ordre, on trouve le tchardak de taille plus petite et situé de façon improvisée même dans des habitations qui ne sont pas incluses dans ce type.

Le second groupe des habitations de Berat, celui des bâtiments fermés à un étage et un semi-étage, est lié directement au troisième groupe, parce que le nombre plus élevé des habitations du second groupe, aussi bien que du premier groupe, se soumit au travaux importants de reconstruction au cours de la seconde moitié du XIXe siècle. Les habitations de ce groupe, qui s'élèvent principalement dans les trois quartiers les plus caractéristiques de Berat: Kala, Mangalem et Gorice, constituent les solutions les plus typiques, pour lesquelles l'appartenance à Berat rêvet une valeur particulière, qu'on ne trouve que dans ce centre. Si dans l'habitation à tchardak qui est assez clairement définie du point de vue typologique, les solutions se distinguent par une caractérisation plus forte, dans les habitations du second groupe, en général on ne trouve pas de principes compositionnels définis, à l'exception des habitations à semi-étages perpendiculaires. Le manque d'unité compositionnelle dans les habitations de ce groupe, est dû au terrain accidenté et relativement étroit de la construction, l'appui de l'habitation contre le rocher, par derrière, complètement ou partiellement. Le terrain en pente et rocheux et l'habitation, particulièrement dans les quartiers de Mangalem et de Goricë, sont liés étroitement entre eux. L'habitation s'appuie sur lui, s'adapte à sa forme et même l'introduit en partie dans les pièces de second ordre (fig. 11). Généralement le programme de ces habitations, appartenant au couches moyennes de la population citadine, principalement artisane, et à ceux qui s'occupaient, tout le temps ou partiellement, de la culture des jardins, est simple. Il comporte la cave, une ou plus, la maison du feu ainsi que le salon d'amis. Les solutions à une seule pièce habitée sont très rares, tandis que celle à plus d'une pièce habitée à part le salon d'amis, plus nombreuses. Ces habitations ont un semi-étage et deux étages, et rarement, en partie, ou complètement trois étages. Elles sont entourées de cours, mais souvent n'en ont pas, et l'entrée se situe directement dans la rue. Dans les quartiers de Mangalem et de Goricë, ou la composition en forme de chaîne est accentuée, une partie des habitations ont leur entrée placée en arrière ou sur les côtés, selon le rapport de l'habitation avec la rue. Les habitations de ce groupe ont été construites entièrement de pierre, jusque vers la moitié du XIXe siècle. E. Çelebi écrit de façon catégorique concernant le grand «Varosh», comme il appelle la ville ouverte, disant «il a 5000 maisons ornées et bien entretenues, couvert de tuiles, les maisons sont de deux étages et construites entièrement en pierre». L'habitation fermée à étage et semi-étage de pierre a été un phénomène assez répandu à Berat. Les cas de maisons à simple rez-de-chaussée sont en très petit nombre (fig. 12).

Le second groupe des habitations de Berat peut également être divisé en trois sous-groupes, en s'appuyant sur leur composition et notamment: les habitations à étage, les habitations à semi-étage et étage perpendiculaire et les habitations à semi-étage d'étendue longitudinale. Nous soulignons qu'en raison de la reconstruction en masse de ces habitations, durant la seconde moitié du XIXe siècle, peut d'entre elles demeurent dans leur état original, par conséquent dans la présentation des exemples les plus typiques de ces sous-groupes on a inclu aussi des habitations reconstruites.

Les habitations à semi-étage perpendiculaire sont relativement répandues à Berat, de même à Gjirokastër, Krujë, dans les quartiers près de la Citadelle de Shkodër et dans beaucoup d'autres régions du pays. Le terrain en pente, son programme, qui satisfaisait bien les exigences des couches moyennes de la société de l'époque, dans les conditions de l'économie citadine basée sur le système des corporations d'artisans, et liée étroitement avec l'économie agricole, explique la propagation de cette habitation même à Berat. Le plan de composition volumétrique de cette habitation se caractérise par l'emplacement de l'axe longitudinal, normal, la pente du terrain, le développement inégal des étages, celui de dessus étant plus étendu, et par conséquent partiellement rez-de-chaussée. De telles habitations ont été construites dans les trois quartiers-musée, mais on les trouve le plus dans la partie supérieure du quartier de Goricë. L'habitation à semi-étage perpendiculaire a d'habitude une cave dans le rez-de-chaussée, tandis que les escaliers sont à l'extérieur, jointes à l'une des faces longitudinales de l'habitation. Dans certains cas l'escalier s'élève à l'intérieur du volume de l'habitation, en raison du manque de terrain de construction, qui, particulièrement dans les quartiers de Mangalem et de Gorice, est vraiment peu abondant.

Les habitations à semi-étage d'étendue longitudinale con-

stituent des solutions qu'on rencontre fréquemment à Berat. L'impossibilité d'étendre encore dans la largeur l'habitation, dans les conditions d'un terrain assez escarpé, qui ne permettent pratiquement pas des constructions de grande largeur, et l'intention d'exploiter le mieux ce terrain, a dicté des compositions à étendue longitudinale. Les familles nombreuses, ou quelques familles de même filiation trouvaient ces solutions assez convenables. Ces habitations où le principe du semi-étage est très répandu, ont un étage habité construit selon deux critères compositionnels, en situant les pièces en rang, tandis qu'à côté d'eux on réserve un passage de liaison, ou en construisant deux rangées parallèles de pièces avec un corridor de liaison entre elles. Dans certains cas le terrain trop accidenté a fait que ces deux principes s'exécutent ensemble dans une seule habitation. Les pièces de la rangée arrière, en raison du terrain escarpé, dans la plupart des cas n'ont aucune possibilité, d'avoir de la lumière par des fenêtres appliquées aux murs de la maison, par conséquent, en ces cas, la construction de lucarnes est un phénomène habituel. La maison du feu est toujours dans cette partie de l'habitation.

Un élément architectonique d'intérêt, dans les habitations de Berat des deux premiers groupes, qui sont liées à la formation féodale de la société est la mezzanine. Berat constitue le point intermédiaire de l'apparition de cet élément; avec Gjirokastër dans le Sud où les mezzanines sont très repandues et Elbasan dans le Nord, où de tels exemples sont trop rares. Avec la dénomination de «kamerie» (mezzanine) on entend certains phénomènes architectoniques à fonctions et à traitements différents, unis par l'emploi d'arches.

Bien qu'à Berat les mezzanines soient d'une étendue moindre en comparaison avec Gjirokastër, l'on peut admettre qu'elles sont largement connues dans les trois quartiers-musées et relativement peu connues dans les quartiers Perroi et Vakëf. La fonction de la création d'une place, d'une sorte de belvédère, pour y rester est tout à fait claire dans toutes les mezzanines de Berat, comme à Gjirokastër où l'on trouve cette fonction au complet ou en partie. La mezzanine la plus répandue et la plus typique à Berat, est celle construite au-dessus de la porte d'entrée de l'habitation (fig. 17). La piste au-dessus de la porte est liée à l'étage habité, ainsi son exploitation devient possible. Les mezzanines au-dessus des portes enrichissent sensiblement les valeurs architectonique de ce dernières et animent la silhouette architectonique de la rue.

Les trois quartiers les plus caractéristiques de Berat, où sont généralement construites les habitations des deux premiers groupes, jusque vers la moitié du XIXe siècle avaient une vue différente de celle qu'ils ont actuellement. Les constructions de pierre dans les deux étages, les petites espaces d'éclairage, couvertes en général d'un arc semi circulaire, les avant-toits ouvertes et en général le traitement rugueux des vues extérieures caractérisaient les ensembles de ces quartiers. De nos jours, il ne reste de ces constructions que quelques traces partielles dans le quartier de Mangalem (fig. 18).

Le trosième groupe de la typologie des habitations de Berat est constitué par les habitations reconstruites au cours de la seconde moitié du XIXe siècle et plus tard, ainsi que les nouvelles habitations construites durant cette période. Nous soulignons de nouveau que l'inclusion dans le même groupe de ces deux catégories, est surtout effectuée, parce que les principes compositionnels, de ces peu de constructions nouvelles, élevées pendant ce temps à Berat, sont d'habitude pareils à ceux des habitations reconstruites.

Dans les trois quartiers de Berat, les exemples de ces reconstructions sont vraiement inombrables. Les nouveaux critères, dans le plan compositionnel sont les mêmes que ceux de l'habitation de Korçë, la création d'une encorbellement central fermé mis en relief dans la vue principale, tandis que sur les côtés de deux volumes habités. L'élaboration avec soin des vues principales, les grandes fenêtres, les avant-toits fermés, etc., étaient des caractéristiques importantes de l'architecture de la nouvelle habitation.

Les plus grandes modifications de l'habitation de Berat, appartiennent aux habitations à semi-étage à étendue longitudinale. La chaîne frontale de ces volumes subit des changement d'importance. Tout l'étage sort en forme de bow-windov en modifiant ainsi complètement la vue de l'habitation. Les exemples en sont nombreux (fig. 21). La vue des trois quartiers caractéristiques de Berat prend ainsi des traits tout à fait nouveaux. Différemment à l'état d'avant la reconstruction, les habitations se distinguent par les constructions légères avec les saillies en forme de bow-windov et les fenêtres nombreuses, qui avec la surface qu'elles occupent et leur rythme, donnent une note pittoresque accentuée aux ensembles compacts et harmoniques composés en gradins, faisant en sorte que toutes les vues principales créent une unité accentuée de traitement architectonique.

Les habitations nouvelles construites au cours de cette période à Berat, bien qu'elles ne manquent pas, sont relativement peu nombreuses. L'activité constructionnelle était orientée principalement vers la reconstruction d'habitations existantes, qui pour bien de raisons ne pouvaient être abandonnées. Le développement économique relativement calme de la ville, durant cette période, différemment à la croissance impétueuse de Korçë, fit qu'à Berat domine le phénomène des reconstructions par rapport aux habitations nouvelles. Ces dernières représentent, dans la composition, les principes connus de l'habitation de Korçë, sans exclure les solutions particulières.

Sur le plan urbain, en comparaison avec les autres villes du pays, Berat se fait remarquer par la variété extraordinaire du caractère des quartiers habités conditionné par le terrain varié d'un bout à l'autre, sur lequel s'élève Berat. On trouve, à Berat, des ensembles très denses tels ceux de Mangalem aussi bien que le quartier étendu de Murat Çelebi ayant les mêmes caractéristiques que ceux des villes ou des quartiers construits sur des terrains plats. Cette variété du caractère des quartiers habités, le quartier sur l'autre rive d'Osum, celui à l'intérieur des murs d'enceinte de la Citadelle, ainsi que le quartier Murat Çelebi, presque détaché du centre de la ville,

DO NOT COPY

DO NOT COPY

font de Berat une ville assez répandue. Dans ce sens, il est comparable seulement à Gjirokastër, tout en prenant en considération la différence importante, celle de la compacité des constructions de Berat, différemment aux ensembles de Gjirokastër, ou bien que les constructions forment un tout homogène, ils vont bien tout seul aussi. Gjirokastër, soit par l'emplacement des construction, soit par le caractère rude et leur composition dynamique et élancée dans la hauteur, se distingue par son caractère monumental, différemment à Berat, qui, avec ses constructions denses, son étendue accentuée horizontale, et le traitement léger et plain, de lumière de l'étage habité, se caractérise par le pittoresque.

Les habitations de Berat, dans le cadre de l'habitation urbaine albanaise, occupent une place importante, sans constituer complètement ou portiellement des types particuliers relatifs entièrement à ce centre. Les habitations de Berat, qui sont incluses dans des types différents de l'habitation albanaise, y occupent une place importante avec leur réalisations, qui, dans certains cas, comportent des valeurs accentuées. De grande importance, dans cette typologie, est le second et le troisième groupe d'habitations de Berat, présantant un exemple de grand intérêt, non seulement pour le diapason large et le répertoire compositionnel de l'habitation albanaise, mais aussi pour les phénomènes nouveaux, relatifs aux changements de l'habitation albanaise au cours de la seconde moitié de XVIIIe siècle.

L'habitation à tchardak occupe une place de premier ordre dans la typologie de ce type important de l'habitation citadine albanaise. Les causes, il faut les chercher dans la haute échelle de réalisations, ainsi que dans certains locaux, qui caractérisent cette habitation. L'habitation à tchardak de Berat peut être comparée largement, seulement avec celle de même type de Shkodër, où elle trouva une propagation et des réalisations de valeur.

Sur le plan de la composition, les habitations de Berat à tchardak, en comparaison avec celle de Shkodër de même type, ne présentent pas de différences importantes. Il est à noter la non propagation, à Berat, de la variante à maison de feu, dans la partie arrière de l'habitation. Le tchardak, l'élément le plus important de cette habitation, dans les exemples de Berat, présente une élaboration qui va plus loin que chez ceux de Shkodër, comme le démontre la fermeture de l'un des côtés latéraux du tchardak au moyen d'un rideau à la charpente de bois, où sont construites des fenêtres. Il est à souligner aussi la propagation relativement large des variantes appliquées à Berat, ayant une ou deux ailes, différemment à Shkodër, où généralement la variante à tchardak sur tout le front, fut la plus répandue, tandis que les suppléments ultérieures les y ont apportés en variantes plus développées. Le terrain en pente des quartiers de Berat a conditionné la large propagation de la composition volumétrique à semi-étage même dans ces habitations. L'étroitesse du terrain est aussi la cause des surfaces relativement petites des tchardaks, qui dans certains cas, ne sont que des surfaces de liaison, qui rendent indispensable la construction de la mezzanine aussi (fig. 15). Et finalement, l'influence du terrain sur les habitations à tchardak de Berat apparaît aussi dans leur orientation obligatoire, qui souvent s'éloigne beaucoup de celle habituelle sur les terrains plats.

L'habitation à tchardak sur terrain en pente de Berat, différemment à celle sur terrain plat, prend part dans la vue de l'ensemble où elle fait partie. Donc, elle aussi bien que le tchardak s'ouvrent aux yeux du passant. C'est justement là qu'il faut chercher la cause de l'usage à Berat des persiennes, installées entre les poutres de l'avant-toit frontal du tchardak. Le traitement de la vue principale de l'habitation de Berat à tchardak, en général, est plus réussi que celui des habitations de Shkodër. Ceci est principalement lié au traitement du front du parche, qui à Shkodër est très simple, avec des colonnes de pierre, alors qu'à Berat il atteint des réalisations très élaborées, avec une arcade, habilement jointe au volume des escaliers qui de sa part s'étale sur un système de colonnes. Cette réalisation accroît assez les valeurs esthétiques de l'habitation de Berat à tchardak, différemment aux habitations de Shkodër. Une autre différence à souligner est l'emploi assez large, à Berat, des constructions à arcs et colonnes, différemment à Shkodër, où le large usage du bois, et de la pierre, qui n'est pas très convenable, a favorisé la domination des toitures plates.

L'habitation de Berat à semi-étage perpendiculaire, par sa composition conserve les traits connus de cette habitation largement répandue à Gjirokastër, Krujë et dans la vieille-Shkodër. En ce qui concerne l'habitation à semi-étage de composition longitudinale, elle doit être considéré comme un phénomène, dans une mesure, particulier lié surtout à Berat.

En comparant Gjirokastër, Berat et Shkodër, ces trois centres citadins renommés du haut Moyen-Age dans notre pays, dans le domaine de l'architecture populaire, l'on peut dire que Berat, du point de vue typologique s'approche partiellement avec les deux autres centres albanais. Les similarités avec Gjirokastër, on les trouve dans l'habitation à semi-étage perpendiculaire, tandis qu'avec Shkodër dans l'habitation à tchardak. En ce qui concerne le répertoire constructif, jusque vers la moitié du XIXe siècle environ, Berat s'approche beaucoup avec Gjirokastër, tandis que plus tard, se fond dans le clima général architectonique et constructif de l'époque, sous la poussée de puissants phénomènes convergents, caractérisant cette époque.

Isuf SUKAJ

DO NOT COPY

URBANISTIKA DHE ARKITEKTURA E PAZARIT MESJETAR TË KAVAJËS

Qyteti i Kavajës është një qendër me rëndësi në Shqipërinë e Mesme. Ky qytet, sidomos në periudhën e mesjetës së vonë, ka luajtur një rol të rëndësishëm si qendër prodhimi dhe këmbimi për trevat përreth saj. Gjatë shekullit të XVI, qyteti i Kavajës pati një ritëm rritjeje të ngadaltë për shkak të karakterit natyror që mbizotëronte në ekonomitë e fshatarëve, karakteristike kjo për të gjitha qytetet e Shqipërisë në këtë periudhë[1].

Zhvillim të mëtejshëm, me ritme relativisht të shpejta, pati ky qytet veçanërisht gjatë shekullit të XVII, kur filloi të shthurej ekonomia natyrore e fshatarëve. Këtë zhvillim e shohim edhe nga përshkrimi i udhëtarit të njohur turk Evlia Çelebiut[2]. Sipas tij, në këtë periudhë qyteti i Kavajës ishte një qendër zejtaro-tregtare e zhvilluar me 4 lagje banimi dhe me një treg, i cili numëronte 200 dyqane. Çelebiu na njofton se Kavaja në këtë kohë kishte 400 banesa me një dhe dy kate.

Baza ekonomike e qyteteve shqiptare në këtë periudhë ishte në radhë të parë zejtaria dhe tregëtia, ndonëse ato nuk ishin të shkëputura krejtësisht nga prodhimi bujqësor[3]. Në shekullin XVII në qytetin e Kavajës përveç zejeve, që merreshin me punimin e shpatave, të patkojve, shalave për kuaj, etj. u zhvilluan edhe zejtari të tjera që lidheshin me nevojat e fshatarëve dhe të qytetarëve si farkëtaria, remtaria, poçeria, këpucëtaria, endja, etj. Rritja e hovshme e forcave prodhuese në këtë periudhë krijoi kushte të favorshme për një zhvillim të mëtejshëm e më të shpejtë të ekonomisë. Zhvillimi i forcave prodhuese i dha hov ndërtimeve edhe në qytetin e Kavajës, kështu që krahas shtrirjes dhe dendësimit të lagjeve ekzistuese, zhvillohet më tej dhe qendra e qytetit, pazari.

Në çerekun e dytë të shekullit XVI, kur Turqia ishte e zënë me luftërat kundër disa shteteve europiane, ndërmjet pashallëqeve të tjera në vendin tonë u formua edhe pashallëku i Kavajës[4] që ndikoi në zhvillimin e ndërtimeve në këtë qytet. Me pasurimin e pronarëve të tokave dhe të funksionarëve dhe me kthimin e tyre në aristokraci feudale lindën kërkesat për ndërtime më të spikatura. Për këtë Çelebiu na njofton se në Kavajë ka shumë pallate të pasurish të stolisur e të ndërtuar me qoshqe e çardaqe, banesa të mëdha me banja e shatërvane si edhe saraje[5]. Pra ecuria e jetës shoqërore u pasqyrua dhe në zhvillimin arkitektonik. Por në këto ndërtime në zgjidhjet urbanistike dhe arkitektonike duket qartë karakteri klasor i tyre që shprehet në një anë në ndërtimet e banesave të mëdha me dy kate dhe sarajeve të të pasurve dhe banesave të thjeshta përdhese të masës së varfër të qytetit në anën tjetër.

Rritja e kërkesave për ndërtimin e banesave aktivizoi një numër të madh mjeshtrish për daltimin e gurit, gdhendjen e drurit, pikturën murale, etj. të cilat dëshmohen nga gjurmët e disa ndërtesave si p.sh. shkolla e vajzave, xhamia Kubelije, kulla e sa-

1) **Historia e Shqipërisë,** V. I, Tiranë, 1967, f. 344.
2) E. Çelebi, **Shqipnia para dy shekujsh (përkthim shqip nga S. Vuçiterni),** Tiranë, 1930, f. 72 vazhd.
3) **Historia e Shqipërisë,** f. 344.
4) **Historia e Shqipërisë,** f. 422.
5) Evlia Çelebi, **Vep. Cit,** f. 74.

hatit, etj. që ruajnë traditën e artit të të ndërtuarit të kësaj periudhe.

Më vonë në shekullin XVIII qyteti i Kavajës pati një zhvillim të mëtejshëm. Rënia e rëndësisë ekonomike të qytetit të Durrësit për shkak të klimës së keqe moçalore, bëri që Kavaja të kthehet në qendrën administrative të të gjithë rrethit dhe të pajiset dhe me një skelë të vogël tregtare në vendin e kriporeve të sotme. Si pasojë e rritjes së rëndësisë së qytetit, u shtua popullsia dhe u zhvillua sistemi i esnafëve. Në këtë mënyrë zgjerohet akoma më shumë shtrirja e qytetit, shtohet numëri i banesave dhe në qendër të qytetit më 1735-36 ndërtohet xhamija Kubelije, më 1817 kulla e Sahatit dhe pranë saj bezisteni për mallrat e tregtarëve të pasur[6].

Shumë autorë të huaj që kanë vizituar Shqipërinë dhe Kavajën, në periudha të ndryshme të zhvillimit të qytetit, shkruajnë për rëndësinë ekonomike të saj, për prodhimet zejtare, bujqësore e të frutikulturës, për marrëdhëniet tregtare me shtete të Europës dhe me Rumelinë, mbi zhvillimin e ndërtimeve të pazarit dhe ndërtimet e tjera me vlera arkitektonike të këtij qyteti, etj.

Në shekullin e XVIII Kavaja kishte një pazar të bukur. Këtu voskopojarët blinin gjalpë për eksport, kurse tregtarët e Kavajës blinin pëlhura venedikase. Në vitin 1829 G. Margaroli[7] shkruan se në këtë qytet ndërtimet kryesore me vlera arkitektonike janë prej guri dhe numëri i banorëve të saj në këtë periudhë arrin 2500 veta. Më tej, në fillim të shekullit XIX, Kavaja quhej qyteti i madh me rreth 2000 shtëpi.

Ndër shumë zejtari të zhvilluara në Kavajë, më e përmendura është punimi i poçerisë. Banorët. e Kavajës ishin bërë të njohur me prodhimin e enëve prej balte[8]. Punimi i poçerisë në qytetet e Vlorës, dhe të Fierit ishte krejtësisht në duart e degëve nga Kavaja e Elbasani[9].

Në periudhën 1741-1800 qyteti i Kavajës ka marrëdhënie tregtare me Venedikun[10] dhe me qytetet të tjerë të vendit tonë e të botës së jashtme. Si qendër me rëndësi në Shqipërinë e Mesme e thekson Kavajën edhe albanologu J. G. Han i cili vizitoi Shqipërinë dhe Kavajën rreth vitit 1850[11]. Ai na njofton se tregtarët kavajas mallrat koloniale i marrin me anë të skelës së Durrësit, kurse mallrat e shtrenjta europiane, sidomos manifakturat, të mëndafshtat, etj. i sjellin nga Manastiri dhe Stambolli.

Nga këto marrëdhënie marrim një përfytyrim të rritjes së shtresës tregtare e cila duke shtënë në dorë tregun e brendshëm të qytetit, luajti një rol të rëndësishëm dhe jashtë tij, sidomos në marrëdhëniet me vendet e brigjeve të Adriatikut dhe Turqinë. Të gjitha këto na japin një pasqyrë të qartë të zhvillimit të marrëdhënieve zejtaro-tregtare të qytetit të Kavajës dhe për pasojë të zgjerimit të mëtejshëm e të vazhdueshëm të ndërtimeve në të gjithë qytetin dhe në pazarin e saj.

Qyteti ka qënë i ndarë në 4 lagje në kohën, kur atë e vizitoi Evlia Çelebiu. Këto lagje duke u mbështetur në të dhënat gojore mendojmë se kanë qënë lagjet Sallbeg, Sharrë, Zguraj dhe Bukaq. Kjo e fundit me kalimin e kohës i aneksohet lagjes Zguraj. Në vendosjen e lagjeve dhe të banesave në to, duket qartë diferencimi klasor dhe fetar.

Qyteti ka një zhvillim linear, boshti kryesor i kompozimit mbetet rruga e madhe (fig. 1) e cila lidh qytetin me qytetet e tjera të vendit. Pothuajse me kënd të drejtë ndaj kësaj rruge vendosen rrugët sekondare të qytetit si ajo e lagjes Zguraj, rruga e Kishës, e Fires, e Tabakëve, dhe e Qerexhive. Pjesën tjetër të rrjetit rrugor të qytetit e përbëjnë rrugicat, që lidhen nëpërmjet rrugëve sekondare me atë kryesore. Në të dy anët e rrugëve janë ndërtuar banesat, me oborret e tyre të rrethuara me mure të lartë, kështu banesat nuk marrin pjesë në formulimin arkitektonik sidomos në rrugët sekondare dhe terciare. Në qendër të qytetit, në mesin e rrugës kryesore u ndërtua pazari i qytetit (fig. 2). Kështu rruga kryesore në këtë pjesë merr tiparet arkitektonike dhe urbanistike mesjetare me dyqane anash duke qënë pjesa më e gjallë e qytetit.

Zhvillimi i qytetit të Kavajës si në periudhën e sundimit të marrëdhënieve ekonomiko feudale dhe më vonë në fillimin e marrëdhënieve kapitaliste është i lidhur ngushtë me zhvillimin e pazarit të tij. Ky pazar ishte qendra zejtaro-tregtare e qytetit dhe përbënte një element të rëndësishëm si qendër ekonomike e tij, i shkëputur nga lagjet e banimit. Pazari i Kavajës

6) Z. Shkodra, **Problemi i tregut shqiptar në shekullin e XVIII,** «Studime Historike» 3, 1966, f. 70.
7) G. Margaroli, **Dizionario Geografico Storico dell impero Otomano,** Milano, 1829 vol. I, f. 45.
8) Z. Shkodra, **Vep. Cit.** f. 67.
9) C. Patsch, **Das Sandschak Berat in Albanien,** Wien, 1904, f. 12.
10) Z. Shkodra, **Vep. Cit.** f. 79.
11) J. G. Hahn, **Albanesische Studien,** Wien, 1854, V.I. f. 150.

DO NOT COPY

drejta të hapura dhe lidhen me rrugën kryesore nga ana veriore në formë radiale. Nga ana jugore me rrugën e madhe lidhja bëhet nëpërmjet sheshit të Manave të Pazarit (fig. 4) që ishte pjesë përbërëse kryesore e këtij pazari.

Në organizimin planimetrik të blloqeve njësia bazë është dyqani. Dyqanet formonin rrugën e një zeje të caktuar. Kështu në pazarin e Kavajës ishin të ndara rrugët ku punoheshin ose shiteshin artikuj të ndryshëm. Gjatë rrugës së madhe kryesisht shiteshin artikuj për veshmbathje të prodhuar në vend ose të importuar. Në rrugën e Artizanatit ishin vendosur kryesisht rrobaqepësit dhe marangozët, në rrugën e Bakajve shiteshin artikuj ushqimorë të prodhuara në vend dhe importi (kafe, sheqer, oriz, etj.). Aty ishin vendosur edhe disa dyqane për shitjen e frutave dhe zarzavateve, ndërsa në rrugën e Kasapëve bëhej shitja e mishit.

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 1

formon një ansambël arkitektonik e urbanistik, i cili ishte ndërtuar i veçantë në qendër të qytetit, duke i shërbyer banorëve të tij me një rreze veprimi afërsisht të barabartë ndaj skajeve të lagjeve të banimit. Fizionomia e arkitekturës së pazarit përkon me ato të pazareve të qyteteve kryesore të vendit tonë në shekullin XVI-XIX si pazari i Shkodrës, Beratit, Krujës, Korçës, Elbasanit, Gjirokastrës, etj. Ajo përcaktohet kryesisht nga arkitektura e dyqaneve që është e thjeshtë, e hapur dhe që krijon lidhje organike të brendisë së dyqanit me rrugën. Duke studiuar planimetrinë e përgjithshme të pazarit të Kavajës (fig. 3) nga ana urbanistike, rezulton se formulimi i tij, ashtu si dhe planimetria e përgjithshme e qytetit, nuk është bërë në bazë të një plani paraprakisht të studiuar, që t'i ketë paraprirë ndërtimit. Por kjo nuk do të thotë aspak se zhvillimi i ndërtimeve të këtij pazari është bërë pa respektuar rregullat dhe kriteret e caktuara në atë kohë për ndërtimet e reja.

Pazari i Kavajës është i kompozuar me disa blloqe dyqanesh (fig. 1, 2, 3). Këto blloqe janë vendosur në drejtimin gjatësor përkundrejt njeri tjetrit gjatë 5 rrugëve: rrugës së Madhe, rrugës së Artizanatit, rrugës së Bakajve, rrugës së Kallajxhive dhe rrugës së Kasapëve. Megjënëse ky pazar ka pasur një shtrirje planimetrike të gjatë rreth 230 m, për të kryer sa më lehtë lëvizjet e blerësve, çdo bllok dyqanesh ndahej me rrugë të tërthorta me gjerësi 2.5-3 m. Ky organizim i skemës rrugore të pazarit lehtësonte shumë lëvizjen e blerësve, krijonte kushte për furnizimin e dyqaneve pa vështirësi dhe nga ana tjetër mbronte blloqet në raste zjarresh. Çdo bllok përbëhej prej 8-10 dyqane nga njera anë, me përjashtim të bllokut qendror të ndodhur në mes të rrugëve të Kallajxhive dhe të Bakajve, ku ndodheshin rreth 15 dyqane nga njera anë.

Dyqanet në këto blloqe të pazarit të Kavajës ishin të ngjitur me njeri tjetrin, si nga anët ashtu edhe nga shpina. Kështu çdo bllok kishte dyqane të ndryshme nga të katër anët e tij kundrejt rrugëve gjatësore dhe tërthore (fig. 2), pra dy rreshta dyqanesh të ndryshme. Blloqe me një rresht dyqanesh të ngjitur anash njeri me tjetrin kanë qënë vetëm ato të ndërtuar në të dy anët e rrugës së madhe.

Rrugët gjatësore janë pothuajse të gjitha të

DO NOT COPY



Fig. 3

Njëlloj si në pazarin e Shkodrës[12] zejet që krijojnë zhurmë siç janë kallajxhinjtë dhe kovaçët edhe në pazarin e Kavajës janë vendosur në periferi të pazarit nga ana lindore. Ndërsa blloqet e kasapëve për arsye higjenike janë vendosur gjithashtu në periferi nga ana verilindore e pazarit.

Në ditët e shtuna të javës, që ishte dita e pazarit në Kavajë, shitja e produkteve nga ana e fshatarëve kryhej në shesh të hapur, të cilat gjithashtu ishin të ndarë për shitje artikujsh ose prodhimesh bujqësore. Për të kryer këto funksione në pazarin e Kavajës ishin lënë tre sheshe:

1. Sheshi i Manave të Pazarit, i cili ndodhej në jug të pazarit dhe shkrihej me rrugën e madhe. Në këtë shesh shiteshin kryesisht drithëra të pabluara dhe të bluara (fig. 4).

2. Sheshi i fruta-zarzavateve, i cili ndodhej në anën lindore të qendrës së pazarit (fig. 5). Më vonë në vitin 1735 me ndërtimin e xhamisë Kubelije, ky shesh zvogëlohet dhe shitja e frutave dhe zarzavateve kryhej gjithashtu edhe nga të katër anët e rrethimeve të oborrit të kësaj xhamie deri te manat e pazarit.

3. Sheshi i shijtes së bulmetrave i cili ndodhej në hyrje të rrugës së lagjes Zguraj, shërbente për shitjen e produkteve blegtorale.

E ndarë ka qënë edhe shitja e hasrave (rogozave) dhe e gëlqeres, të cilat ishin përqëndruar në rrugicën që lidhte sheshin e bulmetrave me rrugën kryesore në drejtim të manave të pazarit.

Dyqanet në këtë pazar ishin kryesisht me një kat, kishte edhe disa dyqane me dy kate të ndërtuara vonë në fund të shekullit XIX (fig. 6). Skemat e kompozimit planimetrik dhe trajtimi arkitektonik i tyre ishte i thjeshtë dhe në përgjithësi kishin një unitet zgjidhjeje. Dyqanet që shërbenin për zejtarët,

12) R. Dizdari, **Pazari i vjetër i Shkodrës,** «Monumentet», 5-6, 1975, f. 205.

DOKUMENT COPY



Fig. 4

kishin dy funksione, atë të prodhimit zejtar dhe të shitjes së këtij prodhimi. Kështu në zgjidhjen planimetrike të këtyre lloj dyqaneve dallohej vendi i punës i cili vendosej në shpinë të dyqanit, vendi i ekspozimit dhe i shitjes së mallit, si dhe vendi i depozitimit të lëndëve të para. Për këto funksione, dyqani nuk kishte ndarje përfundimtare, por ishte i hapur. Pjesa ballore e dyqanit, që i ekspozohej rrugës gjatësore ose tërthore, përbën pjesën kryesore nga ana e trajtimit arkitektonik që ka pësuar ndryshime të vazhdueshme në periudha të ndryshme kohe në vartësi të llojeve të materialeve të ndërtimit që janë përdorur. Kjo pjesë kryente dhe funksionin e ekspozimit të mallrave. Të dhënat gojore tregojnë se edhe në pazarin e Kavajës së pari balli i dyqaneve ka qënë siguruar me taraba, ndërsa më vonë kanë hyrë qepenat me lëvizje rreth një aksi horizontal. Ashtu si edhe pazaret e qendrave të tjera dhe pazari i Kavajës duke filluar nga fundi i shekullit XIX, dhe veçanërisht gjatë shekullit tonë ka pësuar ndryshime të rëndësishme, kryesisht në trajtimin e ballit të dyqaneve. Përsa i përket tipareve urbanistike pazari i Kavajës afrohej më tepër me atë të Shkodrës, gjithnjë duke ruajtur tiparet themelore të përbashkëta në mbarë pazaret e vendit tonë. Ky pazar tregon qartë se Kavaja ka qënë një qendër relativisht e zhvilluar për kohën, me një shtresë të fuqishme zejtarësh dhe tregtarësh.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 5



Fig. 6

DO NOT COPY

URBANISME ET ARCHITECTURE DU BAZAR MOYENAGEUX DE KAVAJE

ISUF SUKAJ

DO NOT COPY

RESUME

La ville de Kavaje est un centre important en Albanie Centrale. Cette ville, surtout dans la période du haut moyen-âge, a joué un rôle important en tant que centre de production et d'échange des contrées à l'entour. Au cours du XVIe siècle, la ville de Kavajë connut un rythme d'accroissement lent, en raison du caractère naturel dominant les économies paysannes. C'est durant le XVIIe siècle, avec le commencement du démantèlement des économies naturelles des paysans.

La base économique des villes albanaises de cette époque était constituée en premier lieu par l'artisanat et le commerce, bien qu'ils ne fussent pas tout à fait détachés de la production agricole. Au XVIIe siècle, dans la ville de Kavaje, à part les métiers, s'occupant de la fabrication d'épées, de fers et selles à cheval, etc., se développèrent aussi des métiers tels la forge, la chaudronnerie, la poterie, la cordonnerie, le tissage, etc. Le développement des forces productives donna un essor aux constructions même dans la ville de Kavaje, ainsi de pair avec l'étendue et la condensation des quartiers existants, se développe encore le centre même de la ville, le bazar.

Au XVIIIe siècle, la ville de Kavaje eut un développement plus poussé. La chutte de l'importance économique de la ville de Durrës à cause du mauvais climat marécageux, fit de Kavaje un centre administratif de toute la région, qui se dota d'un petit port de commerce à l'emplacement des salines actuelles. L'accroissement de l'importance de la ville eut pour conséquence l'accroissement de la population et le renforcement du système des corporations d'artisans. Ainsi l'étendue de la ville s'élargit encore plus, le nombre d'habitations augmenta et, en 1735, fut construite, au centre de la ville, la mosquée «Kubelijé», en 1817 la tour de l'Horloge et près d'elle le «bezistan» pour les marchandises des commerçants riches.

Beaucoup d'auteurs étrangers qui ont visité l'Albanie et Kavaje, dans des périodes différentes du développement de la ville, écrivent sur son importance économique, les produits d'artisanat, agricoles et les fruits, sur les relations commerciales avec les pays d'Europe et de Roumélie, sur le développement des constructions du bazar et les autres constructions à valeur architectonique de cette ville, etc.

La ville de Kavaje a un développement linéaire, dont l'axe principal reste la grand-Rue (fig. 1) reliant la ville à d'autres centres du pays. Presque perpendiculairement sur elle se trouvent les rues secondaires de la ville, comme celle du quartier de Zguraj, la rue de l'église, de Fier, des Tabak et des Charretiers. L'autre partie du réseau routier de la ville est composée de ruelles, liées à la rue principale par les rues secondaires. Sur les deux côtés des rues s'élèvent les habitations, avec leurs cours entourées de hauts murs, par conséquent les maisons ne prennent pas part dans la formulation architectonique, surtout, des rues secondaires et terciaires. Au centre de la ville, au milieu de la rue principale a été construit le bazar de la ville (fig. 2). Ainsi la rue principale dans cet endroit revêt les traits architectoniques et urbains moyen-âgeux, avec des boutiques sur les côtés, étant la partie la plus animée de la ville.

Le développement de la ville de Kavaje aussi bien à l'époque de la domination des rapports économiques féodaux, que plus tard, au commencement des rapports capitalistes, se lie étroitement au développement de son bazar. Ce bazar était le centre artisanal et commercial de la ville et constituait un élément important en tant que son centre économique, détaché des quartiers habités. Le bazar de Kavaje forme un ensemble architectonique et urbain, construit à part dans le centre de la ville, au service des habitants, ayant un rayon d'action approximativement égal aux limites des quartiers habités. La physionomie de l'architecture du bazar s'accorde à celles des bazar des villes principales du pays au XVI-XIXe siècles, comme le bazar de Shkodër, Berat, Krujë, Korçë, Elbasan, Gjirokastër, etc. Elle est définie principalement par l'architecture des boutiques, qui est simple, ouverte et qui crée un lien organique entre l'intérieur de la boutique et la rue. En étudiant la planimétrie générale du bazar de Kavaje (fig. 3) du point de vue de l'urbanisme, il résulte que sa formulation, tout comme la planimétrie générale de la ville, n'a pas été effectuée selon un plan élaboré préliminairement, précédant à la construction.

Le bazar de Kavaje est composé de quelques blocs de boutiques (fig. 1, 2, 3). Ces blocs sont situé dans le sens longitudinal en face de l'un l'autre dans 5 rues: la Grand-Rue, la

rue de l'Artisanat, la rue des Epiciers, la rue des Etameurs et la rue des Bouchers. Puisque ce bazar avait une longue étendue planimétrique d'environ 230 m, pour que les acheteurs circulent le plus facilement possible, chaque blocs de boutiques était coupé par des rues transversales larges de 2.5-3 m. Cette organisation du schéma routier du bazar facilitait beaucoup la circulation des acheteurs, créait des conditions favorables pour l'approvisionnement aisé des boutiques et d'autre part protégeait les blocs en cas d'incendies. Tout bloc était compose de 8-10 boutiques sur l'un des côtés, sauf le bloc central situé entre la rue des Etameurs et celle des Epiciers où il y avait environ 15 boutiques sur l'un des côtés.

Les boutiques des blocs du bazar de Kavaje étaient jointes l'une à l'autre, aussi bien par les côtés que par les arrières. De cette façon chaque bloc disposait de différentes boutiques dans ses quatre côtés, donnant sur les rues longitudinales et transversales (fig. 2), donc de deux rangées de différentes boutiques. Des blocs, possédant une seule rangée de boutiques jointes par les côtés l'un à l'autre ont été uniquement ceux construits sur les deux côtés de la Grand-Rue.

Les rues longitudinales sont presque toutes droites et ouvertes, et sont liées à la rue principale dans le côté Nord, en forme radiale. Dans le côté Sud la liaison avec la Grand-Rue s'effectue au moyen de la place des Mûriers du Bazar. (fig. 4), qui était une partie constituante principale de ce bazar.

Dans l'organisation planimétrique des blocs, l'unité de base est la boutique. Les boutiques formaient la rue d'un métier déterminé. Ainsi, dans le bazar de Kavaje, les rues où l'on produisait ou vendait de différents articles étaient-elles séparées.

Les métiers causant du bruit, comme les étameurs et les forgerons sont placés dans la périphérie du bazar, au coté Est. Les blocs des bouchers, pour des raisons hygiéniques, sont également situés dans la périphérie, au côté Nord-Est du bazar.

Le samedi, qui était jour de marché à Kavaje, la vente de produits par les paysans avait lieu sur des places en plein air, qui étaient également destinées séparément à la vente d'articles ou de produits agricoles. Pour accomplir ces fonctions, dans le bazar de Kavaje on avait réservé trois places:

1. La place de Murier du Bazar, qui se situait dans le sud du bazar et se fondait avec la Grand-Rue. Sur cette place on vendait surtout des céréales moulues et non moulues. (fig. 4).

2. La place des fruits et légumes, se trouvant dans le côté Est du centre du bazar (fig. 5). Plus tard, en l'année 1735, avec la construction de la mosquée à Coupole, cette place s'est restreinte et la vente de fruits et légumes s'effectuait aussi sur les quatre côtés des murs d'enceinte de la cour de cette mosquée jusqu'aux confins du bazar.

3. La place de vente des produits laitiers, qui s'étendait à l'entrée de la rue du quartier des Zguraj et servait à la vente de produits d'élevage.

Les boutiques du bazar avaient généralement un seul étage, mais il y avait aussi certaines boutiques à deux étages construites tard à la fin du XIXe siècle (fig. 6). Leur schémas planimétriques et leur traitement architectonique étaient simples et avaient en général, une unité de solution. Les boutiques d'artisans, remplissaient deux fonctions, celle de la production artisanale et celle de la vente des produits fabriqués. Ainsi, distinguait-on, dans la solution planimétrique de ces sortes de boutiques, le lieu de travail, se trouvant dans l'arrière boutique, l'endroit d'exposition et de vente des marchandises, ainsi que l'emplacement de dépôt des matières premières.

La partie frontale de la boutique, qui donnait sur la rue longitudinale et transversale, constitue la partie principale du point de vue du traitement architectonique, qui a subi des modifications continuelles, à des périodes temporelles différentes, dépendant des matériaux de construction employés. Cette partie assumait aussi la fonction d'exposition des marchandises. Les données orales attestent que le front des boutiques du bazar de Kavajë a été au début assuré aussi de volets, tandis que plus tard s'introduisirent les stores mouvant sur un axe horizontal. Tout comme les bazars des autres centres, le bazar de Kavaje, à partir de la fin du XIXe siècle, et particulièrement au cours de ce siècle a subi des changements importants, principalement dans le traitement du front des boutiques. En ce qui concerne les traits urbains, le bazar de Kavajë ressemblait le plus à celui de Shkodër, tout en conservant toujours les traits fondamentaux communs à tous les bazars de notre pays.

FONOTOOK

Tamara GJOKA

DO NOT COPY

MBI VLERAT AKUSTIKE TË ARKITEKTURËS SË TRADITËS

Studiuesve të objekteve të kultit të periudhave të ndryshme prej kohësh u ka tërhequr vëmendjen prania e disa birave rrethore në muret e brendshme, kupolat, etj. Ato herë ruhen mirë e mund të vrojtohen me sy ndërsa herë herë fshihen pas suvatimit të mëvonëshëm. Këto bira të mbiquajtura «akustike» janë vetëm pjesët e dukshme të disa konstruksioneve të mirëfillta akustike. Mjeshtërit gjirokastritë e dinë mirë se këto konstruksione vendosen vetëm në ambientet me zhurmë të banesës, siç është dhoma e miqve, me qëllim që, siç e shpjegojnë ata zhurma të mos dëgjohet jashtë.

Cili është funksioni i tyre? A ka ndonjë rregull në vendosje? Prania e tyre në objektet e përmendura është e rastit apo e llogaritur?

Nga libri i Vitruvit «Mbi arkitekturën» i shekullit I p.e. sonë, mësojmë se në shkallaret e teatrove greke për të përmirësuar dëgjimin qenë vendosur enë bronxi. Si dimensionet e tyre ashtu edhe pozicioni, ishin të lidhur me kërkesa të caktuara muzikore, dhe me shkallën e madhësisë së theatrit. Nga Vitruvi gjithashtu mësojmë se romakët e huajtën eksperiencën greke dhe filluan ta zbatojnë me rigorozitet por duke sjellë edhe diçka të re: Ata zëvendësuan bronxin me keramikë, pasi provuan se tingëllimi ishte i ngjashëm[1]. Në arkitekturën botërore këtë eksperiencë e gjejmë gjatë mesjetës të përdorur në kisha e katedrale, sallone feudale, etj.

Në vendin tonë sipas renditjes kronologjike këto konstruksione i takojmë në: 1. Kishën e Armenit në Vlorë shek. XI-XII; 2. Xhaminë e Plumbit në Berat shek. XVI; 3. Xhaminë e Gjin Aleksit në Rusanj të Delvinës, shek. XVII-XVIII; 4. Kishën e Shën Mëhillit, në Voskopojë, shek. XVIII; 5. Teqenë e Helvetinjve, fundi i shek. XVIII (fig. 1); 6. Teqenë e Sheh Dyrrit, Tiranë shek. XIX;[2] në disa banesa gjirokastrite të shekullit XIX, etj. Këto konstruksione në fizikën teknike njihen me emërin «rezonatorë» dhe vazhdojnë të përdoren edhe sot në arkitekturë, por natyrisht duke u ndërtuar me materiale të tjera siç është betonarmeja, etj. në përputhje me mundësitë që ofrojnë materialet e reja të ndërtimit.

Me interes të veçantë është përdorimi i rezonatorëve në xhaminë e Plumbit në Berat për rregullimin akustik të faltores së saj. Meqënëse punimet restauruese i janë përmbajtur materialeve të dikurshme dhe meqënëse nga trajtimi i brendshëm gjejmë shumë pak ndryshime, joparimore përsa i përket akustikës, nga gjendja e shekullit XVI, atëhere edhe sot çdo vizitor mund të perceptojë akustikën e veçantë delikate të këtij ambienti.

Faltorja që përbën edhe sallën kryesore ceremoniale ka planimetri katrore, të pastër, pa copëzime. Ceremonia zhvillohej kryesisht brenda një volumi prej 1200 m^3, nën mbulesën me kupolë gjysmësferike. Nga sondazhet që janë bërë del se suvatimi ka qënë me patinaturë gëlqereje e pluhur tulle, me sipërfaqe të lëmuar.[3] Ceremonia zhvillohej me anë të të folurit ose këngës monotone me një diapazon të ngushtë frekuencash. Kërkesa akustike, që diktonte ceremonia ishte kuptueshmëria nga ana e besimtarëve e rrokjeve të shqiptuara. Volumi i madh i përfituar nga tavani mjaft i lartë me qëllim që të krijonte te besimtari idenë e inferioritetit përpara

1. Mark Vitruvi Polion, **de arcitett.**
2. Në Teqenë e Sheh Dyrrit birat janë suvatuar krejtësisht më vonë.
3. S. Dashi, **Një xhami e vjetër në Berat,** Monumentet, 15-16, f. 101-109.

DO NOT COPY



Fig. 1

pushtetit të Zotit, materialet reflektuese të përdorura për formulimin e hapësirës së brendshme (suvaja e lëmuar, xhami i dritareve) si edhe prania e kupolës, do të sillnin me vehte vështirësimin e kushteve akustike. Kështu për shkak të volumit të madh salla do të kishte kohë reverberimi më të madhe se 0.8 sek. që kërkonte kuptueshmëria e të folurit. Reflektimet e valëve zanore nga materialet shumë reflektuese të mureve, dyshemesë dhe sidomos nga kupola do të provokonin shpërndarjen jo uniforme të energjisë në volumin e sallës, e veçanërisht do të shfaqeshin zona me përqëndrim më të madh energjie. Ndërkaq reflektimet nga tavani mjaft i lartë dhe reflektimet e shumëherëshme nga muret e rrafshët e të lëmuar do të krijonin jehonë në zonën e dëgjuesve, gjë që do të vështirësonte së tepërmi perceptimin e të folurit.

Studimi i akustikës gjeometrike të sallës i çoi mjeshtërit në përcaktimin e drejtë të lartësisë së sallës dhe rrezes së kurbaturës së kupolës. Pikërisht

përdorimi i rrezes së kurbaturës së kupolës dy herë më të vogël se lartësia e sallës, mënjanoi përqëndrimin e energjisë në zonën e dëgjuesve. Në këtë mënyrë energjia e reflektuar përqëndrohet brenda kupolës (fig. 2). Reflektimi i kësaj energjie me intensitet të lartë në zonën e dëgjuesve do të krijonte jehonë më intensive. Kjo është arsyeja që rezonatorët u vendosën pikërisht në kupolë, në anën e bazës së saj dhe në vela. Shpërndarja e tyre, uniforme në formë fushe shahu sipas rrathëve koncetrikë dhe vijave radiale që dalin nga kulmi i kupolës krijojnë një unazë absorbuese intensive. Rezonatorët e përdorur në xhaminë e Plumbit janë prej keramike në formën e një trupi cilindrik me dimensionet e paraqitura në fig. 3. Keramika kompakte e inkastruar në mënyrë rigide në konstruksionin e kupolës përkufizon një masë ajri me volum 2601.2 cm^3 dhe e lejon të komunikojë me ajrin e ambientit vetëm nëpërmjet grykëzës së ngushtë (fig. 4). Kështu masa e ajrit në grykëz dhe volumi i ajrit V formojnë një sistem të ngjashëm me sistemin mekanik «masë-sustë» (fig. 4a). Masa e ajrit V shërben si sustë në sistemin «volum-grykëz». Frekuenca vetiake e të dyja masave do të përbëjnë frekuencën e rezonancës së rezonatorit. Për valët zanore që bien në grykëz me frekuencë të afërt me frekuencën e rezonancës së rezonatorit, presioni vepron në drejtim të lëvizjes, prandaj amplituda dhe shpejtësia e lëkundjeve rritet me kalimin e kohës. Meqënëse shpejtësia në grykëz rritet, atëhere rritet edhe fluksi S.v. (ku v = shpejtësia e valës). Me që shpejtësia e valës rënëse është konstante atëhere për të ushqyer fluksin, sipërfaqja e valës rënëse rritet afër grykëzës duke shkaktuar një deformim lokal, i cili ze një zonë aq më të madhe sa më tepër rritet shpejtësia në grykëz. (fig. 4b). Në këtë mënyrë rezonatori grumbullon energjinë kinetike, që vjen nga të gjitha drejtimet në formën e energjisë potenciale. Një pjesë e kësaj energjie do të absorbohet nga rezonatori, pjesa tjetër rikthehet në hapësirën përreth, meqënëse masa e ajrit në grykëz lëkundet si piston, si rrjedhim rezonatorët do të bëhen burim zëri. Meqënëse sipërfaqja e grykëzës është fare e vogël, 7.07 cm^2, atëhere burimi nuk ka një drejtim kryesor rrezatimi, por shpërndahet në të gjitha drejtimet si në fig. 5. Ky rrezatim do zgjasë për një farë kohe, sipas shuarjes së brendshme të rezonatorit duke e dobësuar gjithnjë e më shumë intensitetin e valës zanore. Kjo kohë që matet që nga momenti kur fillon rrezatimi deri kur niveli i tij zvogëlohet me 60 db, përbën atë që quhet koha e reverbimit e rezonatorit.

Kur shuarja është e vogël, d.m.th. energjia e absorbuar është e vogël edhe afër frekuencës së rezonancës, atëhere energjia e madhe e këtyre valëve rezatohet pothuajse plotësisht duke krijuar një kohë reverberimi të madhe të rezonatorit. Në këtë mënyrë rritet intensiteti duke përforcuar edhe një zë fare të ulët. Në këtë rast rezonatori nuk është absorbues, por përmirësues i reverberimit të ambientit në të cilin ndodhet.

Është konstatuar se efekti i rrezatimit është më i theksuar në rezonatorët e vetmuar ose të izoluar, siç përdoreshin në shkallëzat e teatrove antike.

Ndërsa kur përdoren afër njeri tjetrit një numër i madh rezonatorësh si në rastin e Xhamisë së Plumbit, shumatorja e valëve sferike elementare, që rre-

FOTOCOPY



Fig. 2



Fig. 3





Fig. 4



Fig. 5



Fig. 6

zatohen i afrohet rrafshit (fig. 6). Kështu zgjidhja e përdorur në këtë rast ka karakter të dyfishtë. Nga njera anë ndihmon në shpërndarjen uniforme të energjisë së zërit dhe nga ana tjetër mënjanon jehonën duke siguruar absorbimin e valëve me energji të madhe, frekuenca e të cilave rekomandohet të llogaritet nga formula Rayleigh:[4]

$$fo = \frac{c}{2\pi} V \frac{S}{l_k V}$$

për $r = 1.5$ cm; $l_k = 3.153$ cm dhe $V = 2601.2$ cm^3

$$fo = 158.9 \text{ hc}$$

Pra sistemi i rezonatorëve është përdorur për të absorbuar frekuencën. 158.9 hc, valë që përfshihet brenda brezit 100-200 hc. Edhe në kohën e sotme rezonatorët përdoren për absorbimin intensiv në një brez të ngushtë frekuencash, veçanërisht nën 200 hc, ku është më vështirë të sigurohet me metoda të tjera.

Provat e të dëgjuarit në çdo pikë të sallës tregojnë se dëgjimi është natyral, pra pa shtrembërime. Kjo provon se mjeshtërit tanë përballuan me sukses zgjidhjen e detyrës akustike në përputhje me nivelin e zhvillimit të shkencave të asaj kohe, dhe me mjetet që iu ofronte teknika.

Gjatë këtij artikulli paraqitëm më hollësisht vetëm zgjidhjen akustike të një objekti, duke e vlerësuar si një rast që i përmbledh të gjitha vështirësitë që mund të shtronin qëllimi, materialet dhe vetë ndijimi i hapësirës së brendshme në atë kohë. Përdorimi i suksesshëm i këtyre konstruksioneve me vazhdimësi në objekte të kulteve të ndryshëm, me zgjidhje planimetrike e vëllimore të ndryshme, me nivele zërash e zhurmash të ndryshme tregon për një bazë të formuar, një trashëgimi të qëndrueshme, të nivelit më të mirë teknik të kohës. Ndryshimet në përdorimin e tyre në ambiente me kompozime të ndryshme të hapësirës së brendshme tregojnë për një zbatim krijues gjë që buron nga njohja e mekanizmit të absorbimit. Këto konstruksione tregojnë se mjeshtërit shqiptarë iu përgjegjën problemeve që u shtroi jeta, me arritje plotësisht të merituara.

DO NOT COPY

4. L. Butera: **Architettura acustica,** Roma, 1971-1975 f. 111.

Tomara GJOKA

DO NOT COPY

SUR LES VALEURS ACOUSTIQUES DE L'ARCHITECTURE DE TRADITION

RESUME

Dans notre pays, par ordre chronologique, on trouve les constructions acoustiques: 1. dans l'Eglise d'Armen à Vlorë, XI-XIIe siècle; 2. dans la Mosquée du Plomb à Bérat, XVIe siècle; 3. dans la Mosquée de Gjin Aleks à Rusanj de Delvinë, XVII-XVIIIe siècle; 4. dans l'Eglise de Saint Mëhill à Voskopojë, XVIIIe siècle; 5. dans le monastère de derviches des Helveti, fin du XVIIIe siècle; 6. dans le monastère de derviches du Sheh Dyrri, Tirana, XIXe siècle; 7. dans certaines habitations de Gjirokastër du XIXe siècle, etc. Ces constructions, dans la physique techniques sont connues sous le nom de «résonnateurs» et continuent à être employées encore de nos jours en architecture, mais naturellement en les onstruisant en d'autres matériaux comme le béton armé, etc. conformément aux possibilités qu'offrent les nouveaux matériaux de construction.

D'intérêt particulier est l'emloi des résonnateurs dans la mosquée du Plomb à Bérat pour l'arrangement acoustique de son temple. Puisque les travaux de restauration se sont tenus aux matériaux de jadis et puisque du point de vue du traitement intérieur on remarque peu de changements, non de principe quant à l'acoustique, même aujourd'hui le visiteur peut percevoir l'acoustique de ce volume.

Le temple qui constitue même la salle principale de cérémonies possède une planimétrie rectangulaire, propre, sans morcellements. La cérémonie avait lieu principalement à l'intérieur d'un volume de 1200 m², sous la coupole semi-sphérique. Des sondages, il ressort que le crépi était un mélange de chaux et de poudre de tuile, à surface polie. La cérémonie se déroulait avec l'usage de la parole ou du chant monotone d'un diapason étroit de fréquences. L'exigence acoustique, dictée par la cérémonie, était la compréhension par les croyants, des syllabes prononcées. Le grand volume créé par le haut plafond, les matériaux de réflexion usés pour la formulation de l'espace extérieur, le crépi poli, les vitres des fenêtres, ainsi que la présence de la coupole rendraient difficile les conditions acoustiques. Par conséquent, en reaison du grand volume, la salle aurait un temps de reverbération plus grand que 0.8 sek. qu'exigeait la compréhension de la parole. Les réflexions des ondes de la voix par les matériaux très réflecteurs des murs, du plancher et surtout de la coupole provoqueraient la dispersion non uniforme de l'énergie dans le volume de la salle, et particulièrement la création de zones à concentration plus grande d'énergie. Cependant, les réflexions de la coupole assez élevée et les réflexions multiples des murs plats et polis créeraient un écho dans la zone des auditeurs, ce qui rendait très difficile la perception des paroles.

L'étude de l'acoustique géométrique de la salle, amena les maîtres à bien déterminer la hauteur de la salle et le rayon d'inclinaison de la coupole. C'est justement l'emploi du rayon d'inclinaison de la coupole deux fois plus petite que la hauteur de la salle, qui évita la concentration de l'énergie dans la zone des auditeurs. De cette façon, l'énergie reflétée, se concentre à l'intérieur de la coupole (fig. 1). La réflexion de cette énergie à haute intensité dans la zone des auditeurs créerait un écho plus intensif. C'est pour cette raison que les résonnateurs ont été placés respectivement dans la coupole, dans le côté de sa base et dans ses trompes. Leur dispersion uniforme, en forme de champs de jeux d'échecs, selon les cercles concentriques et les lignes radiales sortant du comble de la coupole créent un anneau absorbant intensif. Les résonnateurs employés dans la mosquée du Plomb sont en céramique, et ont la forme d'un corps cylindrique aux dimensions présentées à la fig. 2. La céramique compacte incluse dans la construction de la coupole, définit une masse d'air d'un volume de 2.601,2 cm³ et permet la communication avec l'air de la salle uniquement par le petit tuyau. De cette façon la masse d'air dans le tuyau et le volume d'air V forment un système similaire au système méchanique «masse-ressort».

La masse d'air V sert de ressort dans le système «volume-tuyau. La fréquence propre des deux masses constituera la fréquence de la résonnance du résonnateur. Quant aux ondes vocales qui atteignent le tuyau avec une fréquence approximative à la fréquence de la résonnance du résonnateur, la pression agit dans le sens du mouvement, par conséquent l'amplitude et la vitesse des oscillations s'accroît avec le temps. Puisque la vitesse dans le tuyau s'accroît, le flux s.v. s'accroît aussi. Puisque la vitesse de l'onde déclinée est constante, alors pour nourrir le flux, la superficie de l'onde déclinée près

du goulot s'accroît, causant ainsi une déformation locale, qui occupe une zone d'autant plus grande que la vitesse dans le goulot s'accroît (fig. 3). Ainsi le résonnateur accumule l'énergie kinétique, qui arrive de tous les sens en forme d'énergie potentielle. Une partie de cette énergie sera absorbée par le résonnateur, l'autre partie retourne dans l'espace environnante; étant donné que la masse d'air dans le tuyau bouge comme un piston, les résonnances deviendront une source de voix. Puisque la surface du tuyau est toute petite, 7.07 cm^2, la source n'a pas de sens principal de rayonnement, mais se disperce dans toutes les directions comme dans la fig. 4. Ce rayonnement durera un certain temps, selon l'apaisement intérieur du résonnateur, en affaiblissant toujours plus l'intensité de l'onde vocale. Ce temps mesuré à partir du moment où commence le rayonnement jusqu'à ce que son niveau tombe à 60 db, constitue ce qu'on appelle le temps de reverbération du résonnateur.

Lorsque l'extinction est petite, c'est-à-dire que l'énergie absorbée est petite et voisine de la fréquence de la résonnance la grande énergie de ces ondes est irradiée presque totalement, en créant un long temps de reverbération du résonnateur. De cette façon s'accroît l'intensité en renforçant même une voix très basse. Dans ce cas le résonnateur n'est pas absorbant, mais améliore la reverbération du volume où il se trouve.

Il est constaté que l'effet d'irradiation est plus grand dans les résonnateurs solitaires où isolés, qui étaient d'usage dans les gradins des théâtres antiques. Alors que, quand on les place en grand nombre l'un à côté de l'autre, comme c'est le cas de la Mosquée du Plomb, la totalité des ondes sphériques élémentaires irradiées s'approche du plan. Donc, la solution en usage dans ce cas a un double caractère. D'une part elle aide la dispersion uniforme de l'énergie de la voix et d'autre part évite l'écho en assurant l'absorption des ondes de grande énergie, dont la fréquence est calculée par la formule Rayleigh:

$$f_0 = \frac{c}{2\pi} V \frac{S}{l_k V}$$

pour $r = 1.5$ cm; $l_k - 3.153$ cm et $v = 2.601{,}2$

$f_0 = 158{,}9$ hc.

Le système de résonnateur a donc été employé en vue d'absorber la fréquence 158.9 hc, onde incluse à l'intérieur du canal 100-200 h. De nos jours aussi, les résonnateurs sont en usage pour l'absorption intensive dans un canal étroit de fréquences, particulièrement au-dessous de 200 hc, où il est difficile de l'assurer par d'autres méthodes.

Les preuves d'audition à tout point de la salle témoignent que l'audition est naturelle, sans déformations. Cela prouve que les maîtres albanais affrontèrent avec succès, la solution du problème acoustique, conformément au niveau de développement de la science de cette époque-là, et aux moyens qu'offrait la technique.

DO NOT COPY

Fatos TARTARI

DO NOT COPY

KANALIZIMET NË DURRËSIN E LASHTË

Në tërësinë e monumenteve të arkitekturës, që janë zbuluar në Durrës gjatë viteve të pushtetit popullor, nëpërmjet gërmimeve të rregullta dhe të rastit, bëjnë pjesë edhe trakte kanalesh të vjetra.[1] pjesë e një rrjeti të madh e të plotë higjeno-sanitar. Si kohë dhe arkitekturë ata mund t'i ndajmë në dy grupe të dallueshme mirë njeri nga tjetri. Në grupin e parë përfshihen kanalet sipërfaqësorë e nëntokësorë që i takojnë shekujve I-III të erës sonë, ndërsa në të dytin rrjeti nëntokësor megjithë pajisjet e tij, ndërtuar e plotësuar gjatë shekujve V-VI të erës sonë.

Në përgjithësi kanalet janë të njohur edhe në qendra të tjera antike si në: Apoloni,[2] Butrint,[3] Antigone,[4] Berat,[5] Kaninë[6] etj. ndërsa kanalet e nëndheshëm tani për tani i përfaqëson vetëm Durrësi.

Kanalet nëntokësorë në Durrës, lindën e u ritën së bashku me qendrën e banuar, madje mund të themi se u ruajtën edhe gjatë kohës kur qyteti e humbi rëndësinë e dikurshme. Si të tillë ata mbeten dëshmitarë të një zhvillimi të caktuar urban dhe plotësojnë topografinë e qytetit. Në Durrës, ku gjurmimi i lagjeve dhe i ndërtesave të lashta është gati i pamundur nëpërmjet gërmimeve të gjera sistematike, kanalet e nëndheshëm me gjithë degëzimet e tyre mund të na japin planin e dikurshëm urbanistik të qytetit.

Rrjeti i kanalizimit nuk mund të ndahet nga sistemi i fortifikimit, sidomos kur është fjala për ndërtime të njëkohshme. Unazat e mureve mbrojtës japin perimetrin e vendbanimit, shtrirjen e tij në një periudhë të caktuar, ndërsa kanalet nëntokësorë edhe sipërfaqësorë të ndërtuar brenda mureve, japin sistemin urbanistik të qendrës së banuar, grupimet e lagjeve dhe deri në një farë mase edhe dendësinë e popullsisë.

Gjurmë të sistemit të kanalizimeve të shekullit I-III e.s.

Në rrugët e lagjet e Durrësit kanë dalë herëpashere trakte të ndryshëm kanalesh. Nga rrjeti i kanaleve që kanë qenë në përdorim gjatë shekujve I-III të erës sonë kemi këto gjurmë (Shih hartën):

1) a. Nyje kanali sipërfaqësor prej tullash.[7] Nyja formohet nga dy kanale me seksione të ndryshueshëm. I sipërmi që është edhe më i vogli, del nga një ndërtesë, muret e së cilës janë ndërtuar me teknikën opus mixtum, e zakonshme për ndërtimet qy-

1. Për praninë e një rrjeti nëntokësor kanalesh të shekujve V-VI të erës sonë në Durrës, V. Toçi, **Të dhëna mbi topografinë dhe elementin ilir të Dyrrahit në dritën e zbulimeve të reja arkeologjike,** (Materiale të Konferencës së parë të studimeve albanologjike) Tiranë 1965, f. 464.
2. H. Ceka, **Muri rrethues i Apolonisë, B.U.SH.T. Seria shk. shoq. 3,** 1963, f. 135-140; si dhe L. Rey, **Albania,** II, 1927, f. 11 e v. B. Dautaj, **Një rrugë kryesore në Apoloni,** «Monumentet» 7-8, Tiranë 1974, f. 55.
3. F. Prendi, **Butrinti,** Tiranë 1959, f. 26.
4. Dh. Budina, **Antigonea,** Iliria 1, Tiranë 1972, f. 292.
5. H. Spahiu, Materiale për gërmimet e kryera në Kalanë e Beratit (Arkivi i Qendrës Arkeologjike, më tej A.Q.A.)
6. D. Komata, Materiale për gërmimet në Kaninë, (A.Q.A.)
7. Ky kanal është zbuluar në lagjen Nr. 2, rruga «Kajo Karafili». Sheshi i kufizuar nga shtëpitë me nr. 23, 25, dhe 27.

DO NOT COPY

Harté

E SKEMATIZUAR E DURRESIT ME RRJETIN E PJESESHEM TE KANALEVE ANTIKE SI DHE LINJAT E SISTEMIT MBROJTES BIZANTIN – Sh. 1:2500



Shpjegim

1 Trakt kanali shek I-III
3,4 Linja e përafërt e degëzimit kadrinor të rrjetit shek. V-VI
4,5,6,7 Kanal i shek. V-VI
2. Gjurmë të kolektorit
8,9 Një tjetër linjë e përafërt e të njëjtit rrjet
10 Trakt kanali shek V-VI
Rrethime bizantine (Sipas HEZEIT)
Fragment muri i unazës së tretë rrethuese

Shënim:
Në hartë gjerësia e kanalit nuk i përgjigjet shkallës, ndërsa vendndodhja, drejtimi dhe gjatësia janë të sakta. Edhe sistemi mbrojtës bizantin mirrë nga vizatimet e LALOSË dhe HEZEIT najek me përmërsi linjat ekzistuese

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2

tetare të shekujve I-II të erës sonë.[8] Kanali ka seksion kuadratik (0.27 x 0.30 m) (fig. 1). Gjatësia e tij, nga muri i ndërtesës prej nga del deri në shkarkimin në kanalin rrugor është 2.70 m, gjë që tregon se ai ka shërbyer vetëm për tërheqjen e ujërave të një ndërtese të veçantë. Muret e kanalit, me trashësi 0.16 m të gjerë, përbëhen nga tri radhë tullash (28 x 16 x 4 cm) të lidhura me llaç gëlqeror përzier me zhavor të imët me trashësi fuge 2.5 cm. Në dysheme dhe në mbulesën e kanalit tullat janë (35 x x 28 x 4 cm). Hidroizolimi është kryer vetëm në dysheme.

b. Kanali i poshtëm, (10.30 x 0.50 m) që është edhe më i madhi, mbledh siç duket ujërat e ndërtesave të veçanta të kësaj lagjeje kodrinore dhe ndjek drejtimin veriperëndim-juglindje. Muret formohen prej gjashtë radhë tullash të formatit të mësipërm. Kanali ndjek pjerrësinë e kodrës, për të shkarkuar në zonën e ulët.

2. Kanal me tulla (0.50 x 0.40 m), zbuluar së bashku me rrënojat e banjave publike të shekullit I-II të erës sonë, në themelet e Pallatit të Kulturës «A. Moisiu» (fig. 2). Te ky trakt muret anësore janë ndërtuar prej pesë radhë tullash të përmasave (35-37) x 25 x 4 cm) të vëna horizontalisht, lidhur me llaç të bollshëm gëlqeror, me trashësinë e fugës 4 cm. Të njëjtat tulla janë përdorur për shtrojen ku rrjedh uji si edhe për mbulesën e kanalit. Ashtu si edhe në rastin e kanalit 1, e suvatuar, është vetëm dyshemeja. Gjatësia e kanalit që nga dalja e ndërtesës gjer në shkarkim është 6 m.

3. Kanal i vogël me seksion kuadratik (0.225 x x 0.28 m), gjetur në skajin verilindor të parkut të Mauzoleut të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, në thellësi 1.70 m nga sipërfaqja. Drejtimi veriperëndim-juglindje. Për ndërtimin e tij janë përdorur tullat dhe gjysmëtullat të lidhura me llaç gëlqeror me përzierje zhavorri të imët, me trashësi fuge 2-4 cm.

8. G. Lugli, **La tecnica edilizia romana con particolare riguardo a Roma e Lazzio,** Vol. I, f. 518, Roma 1957.

Në nivelin e kanalit u zbulua një dysheme godine, shtruar me mozaikë të bardhë e të zi si dhe një kthinë me mure të zbukuruar me piktura murale, afreske, të datuara në shekujt I-II të erës sonë. Një datim i tillë vlen edhe për traktet e kanalit si pjesë përbërëse të vetë ndërtesës.

Shembujt e mësipërm i takojnë kanaleve të vegjël sipërfaqësorë të përdorur sidomos për tërheqjen e largimin e ujërave të shiut. Shtimi i popullsisë së qytetit,[9] ndërtimet e mëdha e të ngjeshura, elementet e rinj që filluan të përdoren gjerësisht në arkitekturë ndryshuan shumë koncepte e parime edhe në urbanistikë. Në këtë vështrim rrjeti sipërfaqësor i kanaleve nuk mund t'i përmbushte më kërkesat e reja për një sistemim më të plotë higjeno-sanitar. Ndërtimi i rrugëve të mëdha, i ujësjellësve, i nymfeve, etj. kërkonte edhe një sistem të ri kanalizimesh, më të gjerë e më të përsosur nga rrjeti i mëparëshëm. Vëzhgimet e gjurmët e mbledhura në Durrës tregojnë se kanalet nëntokësorë lidhen me ndërtimin e ujësjellësve e sidomos të ujësjellësit të madh të shekullit të II të erës sonë të kohës së Hadrianit[10] dhe se ato duhet t'i kërkojmë vetëm pas kësaj kohe. Nga rrjeti i kanaleve nëntokësorë të kësaj kohe kemi:

1. Një trakt të vogël dhe të dëmtuar kanali nëntokësor që i takon shekujve II-III të erës sonë e kemi ndeshur në thellësinë 3.60 m nga sipërfaqja. Kanali ndjek drejtimin e zakonshëm të rrugëve të kësaj periudhe, veriperëndim-juglindje. Seksionin e tij (0.55 x x 0.70 m) e mbuluar me qemer gjysmë rrethor e formojnë dy muret anësorë të përbërë prej gjashtë rreshta tullash (46 x 30 x 7 cm) të vëna horizontalisht me lidhje llaçi të zakonshëm dhe zhavori të imët si dhe qemeri prej 22 radhë tullash më të vogla (30 x 30 x x 4 cm) të vendosura në mënyrë rrezore me mbushje më të trashë llaçi prej 5-6 cm.[12] (fig. 3, në hartë Nr. 1).

2. Një trakt i dytë kanali nëntokësor (0.45 x 1 m) u zbulua nën nivelin e dyshemesë së një godine[13] ndërtuar me teknikën opus mixtum me dy radhë tullash të shkëmbyera me një brez gurësh me lartësi 0.35 m. Njeri mur i kanalit me gjerësi 0.40 m, ndërtuar krejtësisht me tulla i ngjitet murit të ndërtesës antike duke ndjekur po atë drejtim, veri-jug. Ndërsa muri tjetër, po aq i gjerë është realizuar me një



Fig. 3

DO NOT COPY

9. Për dendësinë e popullsisë së Dyrrahit në shekujt e parë të erës sonë të dhëna të tërthorta japin, amfiteatri me një kapacitet prej afro 20000 vetësh duke e llogaritur në përputhje me raportin klasik të ndërtimeve me karakter shoqëror 1 : 5. Amfiteatri duhej t'i shërbente një popullsie 5 herë më të madhe se kapaciteti i tij. Shih për këtë V. Toçi, **Amfiteatri i Dyrrahut,** «Monumentet» II, 1971, f. 37-41.

10. J. Adhami, **Pas gjurmëve të ujësjellësit antik të Durrësit,** B.I.SH. I, 1950, f. 127; CIL III, 709; L. Heuzey-A.. Daument, **Mission archeologique de Macedoihe** Paris 1876, f. 387; F. Miraj-H. Myrto, **Mbi tunelin e ujësjellësit antik të Durrësit,** Diskutim mbajtur në Sesionin e III Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, Tiranë 20-21 Dhjetor 1976.

11. Trakti gjendet në Bulevardin «Stalin» në themelet e banesës 394 (pranë kinema verore «Iliria».

12. Një ndërtim të ngjashëm që i përket periudhës perandorake, vërejti edhe L. Rey, në gërmimet që bëri në afërsi të kësaj zone. Muratura është ndërtuar me tulla të përmasave 0.46 x 0.31 x 0.07 cm me lidhës llaçi gëlqeror të bardhë e të fortë, të trashë rreth 4 cm, shih për këtë: L. Rey, Feuilles de la Mission français en Apoloni d'Ilyrie et à Durrazzo 1923-24; «Albania», 1925, f. 28.

13. Kanali gjendet në lagjen nr. 11, rruga D. Tabaku, sheshi midis shtëpive nr. 11 e nr. 23.

teknikë të përzier, me gurë e tulla, të vëna pa ndonjë rregull të caktuar. Seksionin trapezoidal të kanalit e formojnë tullat e mëdha (45 x 30 x 6.5 cm) të cilat mbështeten mbi muret anësorë duke formuar mbulesën në formë çatie. (Fig. 4). Në pjesën e jashtme të mbulesës janë hedhur materiale ndërtimi të lidhura me llaç, që e bëjnë më të qëndrueshme strukturën e kanalit. Gjatësia ekzistuese e kanalit është mbi 3 m. Në murin e majtë të tij afërsisht në nivelin e dyshemesë shkarkon edhe një kanal tjetër me seksion katror (0.40 x 0.40 m) me mbulesë prej pllakash horizontale guri. Për datimin e këtij trakti si të shekujve të II-III të erës sonë jemi mbështetur në teknikën e ndërtimit të vetë kanalit si edhe të godinës ku mbështetet ai, si edhe në materialet qeramike, fragmente të sigillatave vendase, poçe me hulliza horizontale, qelqe të gjetura mbi dyshemenë e godinës si edhe në të dy anët e kanalit.



Fig. 4

Rrjeti i kanaleve nëntokësorë të shekujve V-VI

Dy tërmetet e fuqishëm (v. 345 dhe 518 e.s) i sollën dëme të mëdha qytetit, por ato nuk mundën ta shkulin nga ngulimet e hershme. Në kohën e perandorëve bizantinë me origjinë nga Durrësi Anastasi I, Justini e Justiniani, vazhdoi zhvillimi intensiv i qytetit me rindërtime, sisteme mbrojtës dhe u ngritën në këmbë ndërtesa e lagje të tëra.[14]

Rrjeti i vjetër i kanalizimeve duket i dëmtuar dhe i pamjaftueshëm zëvendësohet me një sistem të ri më të plotë të përbërë nga kanale mbledhës (kolektorë) dhe ndërlidhës, që i binin kryq e tërthor qytetit, poshtë rrugëve. Ndërtuesit duke e pajisur rrjetin edhe me futje anësore, puse kontrolli, kapërderdhje, grykëderdhje patën parasysh që ai t'i qëndronte kohës, të plotësonte të gjitha kërkesat statike, hidraulike, dhe t'i përgjigjej nevojave gjithmonë në rritje të qytetit. Sistemi i përshtatur plotësonte nevojat e asaj kohe, merrte për bazë shtrirjen e bërthamës së banuar në të ardhmen. Realizimin e një rrjeti të tillë e kërkonin nevojat, por atë e ndihmonin edhe kushtet e përshtatshme të relievit: vendosja e disa lagjeve edhe në zonën kodrinore, disniveli i terenit, prania e detit dhe e një vije uji aty pranë,[15] të cilat mund të shërbenin fare mirë si grykëderdhje të volitshme të këtyre kanaleve.

Ndërtimet nëntokësore të kohës së Anastasit I janë një gjë e re për qytetin dhe për vendin tonë, ato pasurojnë dhe ndihmojnë studimin e arkitekturës së kësaj periudhe duke vendosur një lidhje të pandarë me të gjitha ndërtimet e mëparshme e bashkëkohëse. Nga ky rrjet kemi hetuar këto trakte;

1. Trakt i një kanali kryesor (kolektor),[16] (fig. 5; Tab I, 1; Në hartë Nr. 2). Pastrimi i brendshëm jep idenë e përmasave të kanalit, që duke i parë në raport me traktet e tjera, që përmend literatura arkeologjike përfshihen ndër më të mëdhatë. Është kjo arsyeja që në të jemi të prirur të shohim një nga kanalet kryesorë që i shërbente lagjes kryesore, më të ulët dhe më të populluar të qytetit antik tek i cili derdheshin prurjet e kanaleve të tjerë më të vegjël për t'u shkarkuar nëpërmjet tij në det. Qemeri i tij ndodhet në thellësinë 1.20 m nga sipërfaqja e tokës dhe formohet nga tulla katërkëndëshe (37 x 29 x 4 cm). Muret anësorë kanë nga dhjetë rreshta tullash të të njëjtit format vendosur në mënyrë horizontale. Si rreshtat e mureve mbajtës ashtu edhe ato të qemerit janë lidhur me mbushje të bollshme llaçi në tra-

14. K. Zheku, **Zbulime epigrafike në muret rrethuese të Kalasë së Durrësit,** Monumentet, 3, f. 41; Capizi C., **L'imperatore Anastasio I** (491-518) **Studio sulla sua vita, la sua opera e la sua personalita,** Roma 1969, f. 206; Gj. Karaiskaj - A. Baçe, **Kalaja e Durrësit dhe sistemi i fortifikimit përreth në kohën e vonë antike,** Monumentet, 9, f. 5 e vazhdim.

15. L. Heuzey – A. Daumet, **vep. cit.** f. 361.

16. Trakti u zbulua gjatë hapjes së themeleve të banesës 551 në lagjen nr. 3, rruga «N. Kondi» (pranë kinema verore «Iliria»).

Not for COPY



Fig. 5

shësinë 3-5 cm të përbërë nga gëlqere, copëra tullash të vogla e zhavorr, karakteristikë kjo dalluese për ndërtimet e periudhës antike të vonë dhe mesjetës së hershme. Seksioni i kolektorit është gjysmëunazor me gjerësi 2.20 m dhe lartësi 1.80 m (fig. 6). Në gjatësinë prej afro dhjetë metrash që u pastrua dhe u hetua nuk u gjet asnjë element tjetër i rëndësishëm i rrjetit, me përjashtim të ndonjë futjeje të vogël anësore. Nga sipër qemeri është i izoluar me një shtresë suvaje, ndërsa nga brenda nuk ruhet asnjë gjurmë izolimi. Prishja dhe thellësia e madhe nuk na krijuan mundësinë të hetonim shtrojën e kanalit. Gjatë pastrimit të dheut brenda në kolektor u gjet një kapitel mjaft i dëmtuar, (Fig. 7). që duket se fillimisht i përkiste një ndërtese të stilit korintik.

2. Bërryl i një kanali më të vogël nëntokësor.[17] Kanali jep një pikë referimi për degëzimin kodrinor të rrjetit. Përmasat e kanalit janë mesatare (0.90 x x 1.25 m) ndërsa seksioni i zakonshëm gjysmërrethor. Njera brinjë e kanalit e ndërtuar prej tullash katërkëndëshe (35 x 27 x 4 cm) të vëna në dhjetë rreshta horizontalë me lidhje të trashë llaçi hidraulik harkohet për të formuar bigëzimin e kanalit. (fig. 8; Tab I, 3, 4; Në hartë 1, 3). Kthesa në faqen tjetër është kënddrejtë, prej tullash të vëna sipas së njëjtës teknikë. Mbi të dy brinjët mbështetet qemeri me 27 rreshta tullash të vendosura në mënyrë rrezore me fuga 6 cm. Tabani i kanalit është shtruar me tulla, të cilat mbështeten në një shtresë zhavorri 2 cm të trashë. Edhe në këtë trakt muratura nga brenda nuk është suvatuar. Suvatimi bëhet nga jashtë. Bërryli është projektuar në rrëzë të kodrës për të mbledhur ujërat e lagjes kodrinore të qytetit dhe për t'u lidhur më tutje nëpërmjet një skeme të kurbuar me tërë rrjetin ekzistues. Me të arrihet edhe kuota më e lartë e kanaleve të njohur gjer më tani në qytet. Kthesa prej 90 gradësh që bëhet në rrëzë të kodrës orienton



Fig. 6

17. Trakti u zbulua gjatë hapjes së themeleve për ngritjen e ndërtesës me nr. 710 në rrugën «A. Goga» në thellësinë 1.50 m nga sipërfaqja. Ai kufizohet nga jugu me rrugën «7 dëshmorët» e cila ngjitet drejt kodrës me kuotë 57 m (Stani) nga jugperëndimi me shtëpinë nr. 4, nga veriu në lulishtet e Maozeleut të Dëshmorëve ndërsa nga lindja me rrugën «A. Goga».

DO NOT COPY

njerin krah në drejtimin jugperëndim-verilindje. Duke prerë rrugën «A. Goga» ky degëzim kalonte mespërmes lagjeve të sotme nr. 7, 12, mjaft të popullu-ara e të pasura edhe në Iashtësi, siç e dëshmojnë edhe gjurmët e ndërtimeve të zbuluara gjer më sot.[18] Krahu i dytë me drejtimin veriperëndim-juglindje ndiqte pjesën e ulët të shpatit lindor të kodrave të Stanit dhe të Moisiut, duke na u shfaqur përsëri përgjatë rrugës «A. Goga» në traktin nr. 4.

3. Vazhdim i të njëjtit degëzim, duhet parë edhe një pjesë kanali zbuluar pranë klubit të sotëm të gjuetarëve.[19] Kanali është në thellësinë 2.20 m nga sipërfaqja dhe është i vendosur përbri rrënojave të tri ambienteve të një ndërtese prej tullash të kohës perandorake. Duke qënë punim i mëvonëshëm, ky degëzim ka prishur muraturën 4 të ambienteve A dhe B të godinës. Duke ndjekur me kujdes relievin përreth, kuotat ekzistuese si dhe uljen e tij të butë nga juglindja, trakti 3 i kanalit lidhet me njerin krah të traktit 2. Gjatësia e tij prej tetë metrash (fig. 9, në hartë Nr. 4) na dha edhe elemente të tjerë ndihmës për plotësimin e njohjes së rrjetit dhe sistemit hidrik të qytetit. Si ndërtim ai është krejt i ngjashëm me traktin 2 dhe vazhdim i drejtpërdrejtë i tij. Mbeturinat e holluara nga brenda rrjedhin mbi një shtrojë të përbërë nga katër rreshta tullash që zenë tërë gjerësinë e kanalit dhe që vendosen mbi një shtresë zhavorri të imët rreth dy centimetra, hedhur mbi argjilin e verdhë të tabanit të fortë. Gjerësia e kanalit në këtë segment të tij është 1.40 m, ndërsa lartësia është 1.35 m. Pjesa e jashtme e qemerit është suvatuar me një shtresë llaçi hidroizolues të fortë 1-2 cm të trashë. Pastrimi si dhe hyrja në kanal, kryhet nëpërmjet një pusi kontrolli (0.55 x 0.55 m) të vendosur në pjesën e sipërme, pothuajse në mes të qemerit. Pusi i kontrollit dy brinjët e tij i ka me tulla të vëna në këmbë në mënyrë paralele ndërsa dy të tjerat po me të njëjtat tulla, por të vendosura në mënyrë rrezore. Në të dy anët e kanalit ngrihet një mur mbrojtës i lartë rreth 1 m dhe i gjerë 0.28-0.30 m i ndërtuar me tulla jo të plota, të trasha 4 cm dhe me mbushje llaçi 3.5 cm. Ky mur është ngritur si një mur i pavarur nga muri mbajtës i qemerit, por lidhet me të nëpërmjet një llaçi të cilësisë së lartë. Gjatë pastrimit të brendshëm, në një gjatësi prej 20 m, në kanal nuk u vu re asnjë çarje apo thyerje e qemerit dhe e mureve mbajtës. Në përgjithësi ai është i pastër, gjë që flet për mirëmbajtjen e tij. Përsa i përket



Fig. 7

anës konstruktive, muret mbajtës të traktit 3, përbëhen nga tetë rreshta tullash (35 (37) x 29 x 4 cm) të vëna horizontalisht me lidhje të trashë llaçi të përbërë nga gëlqere, copëra tullash e guriçkash, ndërsa qemeri nga 32 rreshta tullash (fig. 10, Tab. I, 2).



Fig. 8

18. V. Toçi, **vep. cit.,** f. 464 (Të dhëna mbi topografinë...)

19. Ai kufizohet nga jugu me banesën pesëkatëshe nr. 55 (klubi i gjuetarëve), nga perëndimi me oborrin e shtëpisë Nr. 27, nga veriu me shtëpinë dyqan nr. 31, ndërsa nga lindja me trotuarin dhe rrugën «A. Goga».

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 9

Nga ndërtesa e rrënuar, në sipërfaqen e gërmuar dallohen katër kthina. Muret janë prej tullash të mëdha të papjekura mirë (45 x 30 x 7.5 cm) me lidhës llaçi të përbërë nga gëlqere e pastër dhe e fortë me trashësi 3.5 cm, të ngritur mbi themele guri. Kthina A ka pasur formë të rregullt katrore me përmasa 5 x 5 m, me dysheme prej harasani të shtypur. Mbi dysheme, në trashësi të ndryshme të dheut të mbushur, u gjetën fragmente të shumta qeramike, monedha, qelqurina e hedhurina të tjera. Ambientet B dhe C për arsye të punimeve të pjesëshme nuk u hetuan plotësisht. Vetëm se u provua se që të dy janë pjesë e një planimetrie të madhe, siç duket e një vile me shumë dhoma. Kthina D dha një dysheme të shtruar me tulla kuadratike (42 x 42 x 3 cm). Përmasat e saj janë të ngjashme me ato të kthinës A. Gjatë hetimit të mureve nuk u vunë re hyrje apo kalime të brendshme, por ky tip ndërtese na lejon t'i kërkojmë ato pikërisht në pjesët e dëmtuara të murit 3 si dhe vijimin e murit 1 në të dy krahët. (fig. 11).

4. Së bashku me zbulimin e rëndësishëm të kompleksit të banjave publike të kohës perandorake, përbri ambienteve të tij, po në një nivel më të ngritur në themelet e Pallatit të Kulturës «A. Moisiu» u takua një tjetër fragment i madh kanali me puse kontrolli dhe degëzime të shumta anësore kanalesh më të vegjël. Kthesa që bën në anën veriperëndimore e lidh atë padyshim me traktin, ndërsa vazhdimi i tij nga jugu e lejon që të mbledhë ujërat e lagjes më të ulët detare të qytetit si edhe t'i depozitojë këto ujëra në mënyrë të pavarur në det.[20]

Segmenti afër Pallatit të Kulturës është i dukshëm në gjatësinë prej 18-19 m dhe gjerësi 1.50 m. Po aq është edhe lartësia e tij. Dy faqet anësore mbajtëse të qemerit formohen nga tetë radhë tullash (35 x 27 (29) x 4 cm) të vëna horizontalisht me mbushje llaçi 3.5 x 4.5 cm të trashë, ndërsa qemerin rrethor e formojnë 42 rreshta tullash të vëna në mënyrë rrezore (fig. 9; 1, 2; në hartë Nr. 1, 5). Nga sipër qemeri është i izoluar me suva. Traktit i janë bërë meremetime anësore në thyerjet si edhe në pusin e kontrollit. Një bllokim i mundshëm në grykëderdhje ka bërë që nga brenda ai të mos jetë shumë i pastër si traktet e tjerë. Kjo provon edhe faktin se ky kanal, në këtë pjesë të qytetit do të ketë qënë i shfrytëzuar deri në kohët e vona, para se Durrësi të pajisej me një sistem të ri kanalizimi.

Përgjatë dy faqeve nga jashtë vihet re edhe një

20. Veç gjurmëve të përshkruara më lart për këtë degëzim kanali që nis me kodrën e Stanit (Moisiut) e zbret deri në det, pak më në verilindje të stacionit të sotëm hekurudhor të Durrësit, të dhëna me vlerë na ka dhënë edhe ing. Th. Tolia. Gjatë viteve 1932-34 në drejtimin e tij u bë pastrimi dhe meremetimi i një trakti të madh kanali të lashtë, që niste me atë të klubit të gjuetarëve, (trakti 3) e shkonte gjer në det (trakti 7). Qëllimi i këtyre punimeve ishte që ky degëzim të vihej përsëri në shfrytëzim. Sipas relevimit dhe të dhënave të ing. Toles, kanali vazhdonte nga Pallati i Kulturës «A. Moisiu». Bulevardi «Stalin» dilte mbrapa lokalit të ri ushqimor të vetëshërbimit në qendër të qytetit, kalonte pak para furrës së pjekjes 6 në rrugën «7 Nëntori» dhe mbas 20-25 metrash, duke e prerë këtë rrugë vazhdon poshtë pjesëve të përparme të shtëpive të ulta nr. 34, 36, 38, skajit rrugor të shtëpisë shtetërore nr. 105 (edhe sot aty është ndër-

mur i dytë mbrojtës i bërë nga tulla të thyera, gjysma apo 3/4 të formatit të zakonshëm si në rastin e traktit 3. Në kurrizin e kanalit është një pusetë katrore e ndërtuar me tulla të vëna brinjazi, në mënyrë rrezore ose këlliç me pak pjerrësi (fig. 12; 3a, b). Prishja si edhe një meremetim i mëvonëshëm kanë formuar mbi pusetë një kornizë tullash jo të rregullta, në formë kuadratike. Nga brenda pusi është 0.60 m i gjerë ndërsa korniza e jashtme 15-20 cm e lartë dhe 25 cm e gjerë. Në të nga brenda vihen re edhe degëzime kanalesh të vogla që sillnin ujërat e shtëpive aty pranë. Njerin prej tyre e gjejmë të futur në kthesën veriperëndimore që bën kanali (fig. 2).

Gjurmët e tjera të të njëjtit rrjet, drejtimi si dhe përmasat tregojnë se ato lidhen me një degëzim të ri të rrjetit, që mund të shtrihej nga veriu dhe që i depozitonte prurjet ose në mënyrë të pavarur, paralel me grykëderdhjen e kolektorit ose në vetë atë.[21]

Gjurmët e mbledhura që u trajtuan më sipër na lejojnë tani të bëjmë disa përgjithësime lidhur me rrjetin higjieno-sanitar në Durrës, për arkitekturën e tij, si edhe për parimet themelore e konstruktive që kanë udhëhequr ndërtuesit në realizimin e punimeve të tilla.

Tipi më i hershëm e më praktik i kanalit është ai sipërfaqësori me gjithë variantet e tij. Vështirësitë e terrenit në Durrës nuk krijojnë mundësinë e ndjekjes së sistemit, e të tipit të kanaleve që në fillimet e jetës qytetare[22] Traktet e njohur i takojnë shekujve të parë të erës sonë.

Varianti i parë i kanalit sipërfaqësor, që takohet kryesisht gjatë magistraleve, është ai në formën e koritës. Në këtë variant dy faqet e rrjedhës bëheshin prej tullash të mëdha: 41 x 41 x 7 cm, 46 x 42 x 8 cm ose prej pllakash guri, ndërsa rrjedha e ujit kalonte në një shtroje tulle a guri në më të shumtën e rasteve e suvatuar.

Varianti i dytë që është edhe më i përhapuri në Durrës, përfaqësohet nga kanali me seksion këndrejtë. Në ndërtimet e shekujve I-III të erës sonë janë përdorur tullat katërkëndëshe të përmasave:



Fig. 10



Fig. 11

DO NOT COPY

tuar një pusetë e mbuluar me kapak metalik). Që këtej kanali i vjetër bënte një kthesë nga e djathta, vazhdonte drejtimin juglindor për të përfunduar në det pak më në verilindje të stacionit të sotëm hekurudhor. Përpara se të bëheshin punimet për stacionin e portin e ri, ky trakt kanali ka qënë i dukshëm mbi det në gjatësinë prej 50 deri në 60 m (në hartë Nr. 7).

Kështu që krahun ekzistues të rrjetit mund ta ndjekim pa ndërprerje në një gjatësi prej afro një mijë metra. Një pjesë e këtij krahu sidomos nga pallati «A. Moisiu», rruga «7 Nëntori» e gjer pranë stacionit hekurudhor është i shfrytëzueshëm edhe sot (në hartë Nr. 3, 4, 5, 6, 7). Këto të dhëna përputhen plotësisht edhe me gjurmët e mbledhura gjatë gërmimeve dhe punimeve të bëra në këto pika. Që këtej edhe trasimi i plotë i tij mendojmë se është i saktë.

34.5 (35) x 22 x 4 cm, 35 x 25 x 4 cm. Muret anësorë sipas madhësisë së kanalit formohen prej tre deri në gjashtë radhë tullash apo gjysmëtullash të tilla të vëna horizontalisht, me lidhës llaçi, të përbërë nga një sasi e bollshme gëlqereje të staxhionuar, përzier me zhavorr të imët dhe pak rërë, me trashësi fuge 2-4 cm. Tullat e plota përdoren zakonisht si shtroje dhe si mbulesë e kanalit. Në të gjitha rastet e njohura është suvatuar vetëm dyshemeja nëpër të cilën kalonte rrjedha, ndërsa faqet anësore janë të pa suvatuara. Përmasat e këtyre kanaleve lëvizin nga 0.22 m kur dalin drejtpërdrejt nga një godinë e veçuar, gjer më 0.50 m kur mbledhin ujërat e një lagjeje të tërë apo të një rruge. Ky tip kanali duhet të ketë qënë në përdorim edhe në shekujt e mëparshëm. Kanale të tillë më mirë se kudo janë vërejtur në Apolloni, Antigone, etj. fizionomia urbane e të cilave tashmë është bërë e njohur.[23])

Sistemi sipërfaqësor flet për funksionin e njëanshëm të kanalizimeve si vepra të ngritura posaçërisht për të tërhequr ujërat e shiut nga oborret, çatitë, sheshet e rrugët e jo për të tërhequr edhe lëndët fekale. Këtë mund ta shpjegojmë vetëm me mungesën e pajisjeve të veçanta të ujësjellësit, që krijojnë mundësi më të ngritura higjieno-sanitare. Ndoshta një siguri më e madhe dhe një ngulitje më e gjatë e më e mbrojtur, në kuadrin e përgjithshëm të një zhvillimi të pandërprerë ekonomiko-shoqëror, siç qe rasti i Durrësit, i detyroi banorët vendas të mendonin për një rrjet më të përparuar nëntokësor. Terreni mbi të cilin ishte i shpërndarë qyteti paraqiste kushte ideale për hartimin dhe realizimin e një skeme të plotë dhe perspektive. Lagjet kryesore të qytetit shtriheshin në pjesën bregdetare dhe në faqet lindore të kodrave, në mënyrë të veçantë rreth kodrës së Moisiut.[24]) Në përshtatje me këtë konfiguracion natyror edhe labirinti nëntokësor niste nga vendet më të ngritura, ndiqte trasenë që shtrihej në rrëzë të kodrës, ulej gradualisht duke përshkuar tërë lagjet bregdetare dhe drejtohej së fundi për në grykëderdhje, në bregdet. Dy traktet e zbuluara na bindin se kanali pikën më të lartë e kishte rrëzë kodrës me kuotë 57 m dhe që aty niste uljen në të dy drejtimet: i pari nga veriperëndimi në juglindje, që paraqet degëzimin më të gjatë e më të plotë, i dyti nga jugperëndimi në verilindje. Gjatë rrugës ky hark i madh lidhej me një sërë kanalesh të dytë, ndërsa në pjesën më të ulët të qytetit (lagjet nr. 4 dhe 11) shtrihej kolektori. Së fundi trakti i vogël, zbuluar në rrugën «Mujo Ulqinaku» flet për atë që projektuesit dhe ndërtuesit parashikonin rritjen dhe shtrirjen perspektive të qytetit në thellësi.



Fig. 12

Si ndërtime nëntokësore, kanalizimet ishin vepra të vështira inxhinierike që kërkonin kohë dhe studime të sakta e të gjithanëshme. Si material bazë ndërtimi shërbeu tulla me cilësi të lartë. Për ndërtimet hidrike tullat duhet të ishin të forta, të pjekura mirë dhe në forma të rregullta. Në kanalet e shekujve I-III të erës sonë qofshin ata sipërfaqësorë ose nëntokësorë, janë përdorur tullat e zakonshme me trashësi 4 cm por edhe ato me përmasa 42 x 30 x 7 cm dhe 45 x 30 x 6.5 cm. Si material lidhës shërbente në të gjitha rastet llaçi, në ndërtimet e shekujve I-III, në traktet 1, 11, 12, 13, me gëlqere të shuar mirë, përzier me zhavorr të imët dhe pak rërë, ndërsa në ato të shekujve V-VI me gëlqere të përzier me copëra tullash të vogla, guralecësh ose zhavorri në ra-

21. Gjurmët janë zbuluar në rrugën «Mujo Ulqinaku», para shtëpisë së banimit nr. 659 (në hartën 8) si dhe pranë ish-teatrit të qytetit (sot kinema «14 Nëntori» në rrugën «Prokop Meksi» nr. 9 në afërsi të pazarit të qytetit, etj.

Një trakt i veçuar kanali, punuar me të njëjtën teknikë është vërejtur edhe pranë Komitetit Ekzekutiv K.P. të qytetit në një thellësi prej 2 metrash nga sipërfaqja; shih për këtë: V. Toçi, **Të dhëna mbi topografinë...**, f. 463.

22. Gërmimet kapin vetëm shtresën kulturore që i përgjigjet kohës së pushtimit romak, kurse shtresat e poshtme dhe më të hershme janë të përmbytura nga uji. Bën përjashtim këtu vetëm zona kodrinore e qytetit.

23. Shih shënimin nr. 2.

24. L. Heuzey-A, Daumet, **vep. cit.,** f. 349-392.

Fotokopje

portin 1 : 1. Ndryshimet e dy periudhave ndërtimore shihen edhe në trashësinë e fugës. Në kanalet e shekujve I-III të erës sonë fugat horizontale lëvizin zakonisht nga 2-3.5 cm duke mos e kaluar asnjëherë trashësinë e vetë tullës, kurse në ndërtimet e më vona ajo shkon nga 3.5-6 cm. Në kanalet nëntokësorë muret anësore ngrihen drejtpërsëdrejti mbi tabanin prej argjili të fortë, pa pasur nevojë për themele gurësh. Në varësi nga seksioni muret kanë nga 6-10 radhë tullash të vendosura në mënyrë horizontale. Qemeri rrethor i kanalit realizohej me ndihmën e skelave të drunjta dhe armaturave, nëpërmjet vendosjes së tullave në mënyrë rrezore (24-40 radhë) ose në këmbë, perpendikularisht me muret anësorë, siç është rasti i kolektorit (fig. 5). Heqja e dheut nga brenda tregon se uji së bashku me mbeturinat e holluara rridhte nëpër një dysheme të formuar nga 4-6 radhë tullash të të njëjtit format. Tullat e shtrojës ngjiteshin në një shtresë zhavorri të imët dhe argjili 2 cm të trashë. Nga brenda kanali izolohej. Jemi të mendimit se rrjedha e ujit shpejtohej jo vetëm nëpërmjet pjerrësisë, por edhe nëpërmjet kapërderdhjeve, sifoneve, që i jepnin asaj një farë shtytje. Izolimi, për rastin e kanaleve të nëndheshëm ishte i detyruar në pjesën e sipërme dhe bëhej nga një shtresë suvaje me llaç të një cilësie të lartë hidraulike e cila nuk lejonte që ujërat nëntokësore të vepronin mbi muraturën. Për t'i bërë ballë presioneve e shtypjeve anësore në të dy anët e muraturës, lidhur me të ngrihen mure të dytë përforcues me trashësi 0.30-0.35 m. e deri në 1 m të lartë. (Tab. I, 2). Në muret anësorë në të dy krahët futeshin edhe degëzimet e vogla që dilnin nga rrugët e ngushta ose drejtpërsëdrejti nga banesa të ngritura përgjatë tyre (fig. 9; 1, fig. 1, 2). Këto degëzime janë 0.30-0.50 m të gjerë dhe 0.15-0.30 m të thella me seksione trapezoidale, katërkëndëshe të mbuluar ose jo (fig. 1, 4).

Për t'iu shmangur presionit të ujit dhe gërryerjeve, kanalet formonin zigzage. Bërryle dhe kthesa të menjëhereshme janë takuar në traktet e rrugës «A. Goga», poshtë Pallatit të Kulturës «A. Moisiu», në kolektorin e rrugës «N. Kondi», etj.

Projekti i sistemit urbanistik ka shërbyer kurdoherë si bazë për projektimin e kanalizimit, prandaj edhe caqet e kanaleve japin kufijtë e qytetit. Në etapën e parë të realizimit të rrjetit, si objekte më të nevojshme janë kolektorët dhe kanalet e rrugëve me popullsi më të dendur. Degëzimet trasoheshin paralel me caqet e godinave, nën shetitoret e rrugët e tjera të qytetit dhe si të tillë ata duhet të mblidhnin edhe



Fig. 13

ujin e shiut për t'i mbajtur të pastra e të papërmbytura rrugët. Për këtë arsye në çdo 20 m mbi kurrizin e kanalit vendoseshin puseta në të njëjtin nivel me rrugën ose pak nën to.[25] Në të gjitha rastet e njohura pusetat kanë seksion kuadratik (fig. 13). Brinjët e tyre formohen nga tulla të vëna në këmbë ose rrezore me mbushje më të trashë se vetë trashësia e tullës. Si mbulesë për këto puseta shërbente një pllakë masive guri që ishte edhe shtroje e rrugës. Në traktin 4 kemi ndeshur edhe pusetë të rrethuar me një kornizë drejtëkëndëshe mbi qemerin e kanalit, si një ndërtim të dytë të mëvonëshëm. (fig. 9; 1, fig. 12; 3). Kjo mund të ketë lidhje me kohën kur rruga humbi rëndësinë e mëparshme, kurse kanali mbeti në sipërfaqe pa lidhje të veçanta me të, kështu që fillimisht puseta duhej të mbyllej me një lloj skare apo mbulese.

Në të gjitha gjetjet nëntokësore në Durrës, përdorej mbulimi me qemer rrethor. Për realizimin e këtij rrjeti u morrën për bazë parimet dhe teknikat e njohura e të përhapura në krejt Perandorinë Romake, ku arti i ndërtimit të ujësjellësve dhe kanaleve nëntokësorë arriti një zhvillim të madh. Por ndërtuesit vendas këto teknika i zbatuan në përshtatje me relievin dhe planimetrinë e veçantë të qytetit. Aq me kujdes janë kryer këto punime, sa në asnjë trakt të zbuluar gjer më sot nuk është gjetur qoftë edhe një e çarë e vetme e vogël nga brenda ose nga jashtë. Kjo na forcon bindjen se kanalet ishin llogaritur t'u

25. T. Ivanov, **Raskopki na Nikopolis adistrum prez 1945 god.** në IBAI XVIII, Sofie, 1952, f. 245 e vazhdim

DO NOT COPY



Fig. 14

bënin ballë lëkundjeve të fuqishme sizmike, presioneve nëntokësore dhe ngarkesave të sipërfaqes siç ishte trafiku, i cili nga koha në kohë bëhej më i dendur.

Rrjetin më kompleks, më të plotë të sistemit të kanalizimeve e jep Durrësi. Edhe në kohën antike të vonë qyteti e ruajti rëndësinë e tij si port i madh dhe qendër e zhvilluar e perandorisë. Arritjet më të shënuara teknike të forcave krijuese dhe ndërtuese të vendit do të gjenin zbatim para së gjithash aty dhe pastaj do të rrezatoheshin nëpërmjet tij. Megjithëse ndërtimet nëntokësore, sidomos kanalet, njiheshin shekuj më parë, jemi të mendimit se në Durrës nuk ishin krijuar ende kushtet e domosdoshme për realizimin e tyre. Në radhë të parë, mungonin ujësjellësit e mjaftueshëm që duhet të siguronin një sasi të madhe uji të pishëm. Burimet mbishkrimore na flasin për praninë e puseve dhe nymfeve, por asnjëherë të ujësjellësve që do të kushtëzonin nevojën e përmirësimit rrënjësor të kushteve higjieno-sanitare të qytetit dhe banorëve të tij. Rritja e aftësisë konstruktive të mjeshtërve të asaj kohe, përvoja e grumbulluar, përmirësimi i dukshëm i cilësisë së materialeve të ndërtimit bënë të mundur projektimin dhe realizimin edhe në qytetin e Durrësit, si qendër e rëndësishme dhe e zhvilluar e perandorisë, të një rrjeti të gjerë e të plotë kanalesh.

Qyteti rritej e shtrihej në bazë të një plani të studiuar e perspektiv. Lagje të rëndësishme ishin ato kodrinoret, ato detaret rreth bastionit të marinës, lagjia e poshtme si dhe një lagje e re në veri, që po rritej nga dita në ditë.[26] Ndërtimi i ujësjellësit, sigurimi i ujit të bollshëm lejoi ndërtimin e një rrjeti të dendur nëntokësor. Traktet e zbuluara kohët e fundit (fig. 3-4) tregojnë se ndërtimi i këtij rrjeti po bëhej sipas të gjitha teknikave dhe parimeve konstruktive të njohura. Për datimin e këtyre trakteve si edhe të trakteve të tjerë që mund të dalin në qytet, si një terminus post quem, na shërben ujësjellësi kryesor i qytetit, ndërtimi i të cilit u krye gjatë kohës së perandorit Hadrian (117-138 të erës sonë). Tullat e përdorura, teknika e ndërtimit, lidhësi prej gëlqereje të bardhë e solide, materiali qeramik i mbledhur përreth tregojnë se këta trakte i takojnë kanalizimeve ekzistues nëntokësorë të shekujve II-III të erës sonë.

Pjesa më e madhe e kanaleve që janë zbuluar në Durrës i përket periudhës antike të vonë e kryesisht shekujve V-VI të erës sonë. Qyteti përfundon në këtë kohë sigurimin e jashtëm të tij nëpërmjet

26. L. Heuzey – A. Daumet, **vep. cit.**, f. 355.

rrethimit me tri unaza muresh masivë.[27] Në të njëjtën kohë fillon edhe sistemimi i brendshëm urbanistik. Kujdes të veçantë për këtë tregoi perandori Anastas I, i cili u shqua sidomos për ndërtimet e shumta që realizoi në të gjitha skajet e perandorisë. Jemi të mendimit, megjithse për aktivitetin ndërtues të Anastasit nuk ekziston ndonjë literaturë e posaçme, se ai ndërtoi brenda një kohe të shkurtër tërë rrjetin e kanaleve të Durrësit. Tullat e përdorura me shenjat e shumta simbolike dhe që janë karakteristike për shekullin V-VI (fig. 14), llaçi i gatuar me gëlqere përzier me copëra tullash e guralecësh, fugat rrezore e krejt teknika janë të ngjashme me ato të përdorura në murin rrethues, në harqet, qemeret, e kullat e tij.[28] Për ndërtimin sa më shpejt dhe në më nyrë ekonomike të kanaleve ai mobilizoi forca të mëdha nga qyteti dhe rrethi.

Drejtimet e kapura deri tani në atë gjatësi kanali të zbuluar na lejojnë të japim disa mendime edhe për sistemin urbanistik të qytetit. Kanali i madh (kolektori) i përkiste një lagjeje shumë të populluar. Mbi të ose anash tij duhet të ishte shetitorja ose portiku qendror i qytetit. Në të dy krahët, siç e provojnë edhe monumentet e zbuluara, ndodheshin dyqane dhe shtëpi banimi. Kjo lagje duhet kërkuar midis lagjeve të sotme 4 dhe 11. E populluar duhet të ishte edhe lagjja kodrinore (sot lagjet 7 e 9). Kanali i saj ndiqte rrëzën e kodrës, pastaj me zigzage të lehta merrte rrugën që të çonte te porta. Njeri krah i këtij kanali kthehej në drejtim të juglindjes për të mbledhur ujërat e lagjes më pak të populluar të limanit që po e humbiste rëndësinë e dikurshme dhe i drejtonte ujërat përsëri në det pranë portit të ri, ndërsa krahu tjetër që drejtohej nga verilindja, i cili mund të degëzohej, i takonte lagjes më të re e më me perspektivë (lagjet e sotme 5 dhe 16).

Rrënojat e dala tani së fundi e mbështesin plotësisht këtë mendim. Krahu i shkëputur, i ndodhur gjatë rrugës «Mujo Ulqinaku» kish të bënte me shtrirjen e qytetit nga veriu. Si skemë, megjithse e pakapur në tërë drejtimet e saj, mund të pranojmë atë rrethoren; me degëzime të shumta anësore sipas shtrirjes së vetë qytetit. Si sistem ai ka qënë i përbashkët. Ujët e shiut dhe mbeturinat depozitoheshin në një kanal dhe të holluara derdheshin së bashku përfundimisht në det. Llogaritja e përpiktë e pjerrësisë hidraulike në raportin 3%, 2% në seksionet e veçanta, kujdesi i vazhdueshëm për pastrimin dhe mirëmbajtjen e tyre i bën dhe sot e kësaj dite këto kanale vepra të rëndësishme ndërtimore. Realizimi i tyre ka qënë frut i një mendimi të pjekur, i një studimi kompleks që përfshinte njohuritë më të rëndësishme inxhinierike të asaj kohe.

Jemi të mendimit se ndjekja e këtyre kanaleve nëpërmjet gërmimit sistematik sipërfaqësor do të japë të dhëna të reja më të plota për topografinë e qytetit të lashtë, të vendosjes së godinave dhe rrugëve kryesore si edhe të sistemeve të përdorura gjatë shekuish.

PHOTOCOPY

27. Capizzi C., **vep. cit.,** f. 206.
28. Gj. Karaiskaj – A. Baçe, **vep. cit.** f. 5 e vazhdim

DO NOT COPY

TABELË PËRMBLEDHËSE E TRAKTEVE TË KANALEVE HIGJIENO-SANITAR, TË GJETUR NË DURRËS ME TË DHËNAT TEKNIKE

Nr.	Lloji i kanalit	Vendndodhja	Seksioni	Përmasat		Fuga	Tullat e përdorura
				Gjerësi	Lartësi		
	A. Kanale sipërfaqësorë të shekullit të I-III e.s.	1. L. Nr. 2, rruga K. Karafili, sheshi midis	Kuadratik	0.27 m	0.30 m	0.02-0.025 m	gjysma tulle 0.28 x 0.16 x x 0.04 m
		2. Po aty	»	0.30 m	0.50 m	" "	të plota 0.345 x 0.280 x x 0.04 m
		3. L. Nr. 11, në themelet e pallatit të Kulturës «A. Moisiu»	»	0.50 m	0.40 m	0.04 m	0.35 (0.37) x 0.25 x 0.04 m
		4. Skaji verilindor i lulishtes së Mauzoleut të luftës Nac. çlirimtare	»	0.225 m	0.280 m	0.02-0.04 m	x 0.16 x 0.04
	B. Kanale nëntokësorë të shekullit I-III e.s.	1. Bulev. Stalin, themelet e banesës 394 pranë kinema verore «Iliria».	me qemer rrethor	0.55 m	0.75 m	0.05-0.06 m	0.46 x 0.30 x 0.07 m; 0.30 x 0.04 m
		2. Lagja 11, rruga D. Tabaku, midis shtëpive Nr. 11 e 23	me kulm	0.45 m	1.00 m	0. 03-0.035 m	0.45 x 0.30 x 0.065 m
	C. Kanale nëntokësorë të shek. V-VI e.s.	1. *Kolektor:* 1. Nr. 3, rr. N. Kondi banesa 551	me qemer rrethor	2.20 m	1.80 m	0.03-0.06 m	0.37 x 0.29 x 0.04 m
		2. Lagja Nr. 7, banesa 710 rruga «A. Goga»	» »	0.90 m	1.25 m	0.06	0.35 x 0.27 x 0.04 m
		3. Rr. «A. Goga», banesa 55 (Klubi i gjuetarëve)	» »	1.40 m	1.35 m	0.035-0.06 m	0.37 (0.35) x 0.29 x 0.04
		4. Themelet e Pallatit të Kulturës «A. Moisiu» lagja Nr. 5.	» »	1.50 m	1.50 m	0.035-0.06 m	0.35 (0.37) x 0.27 (0.29) x x 0.04 m
		5. Pranë tregut fshatar	» »	1.40 m	1.35 m	0.035-0.06 m	0.35 (0.37) x 0.27 (0.29) x x 0.04 m



1



2



3



4

DO NOT COPY

Fatos TARTARI

DO NOT COPY

LES CANALISATIONS DANS LE DURRËS ANTIQUE

RESUME

Dans la totalité des monuments d'architecture, découverts à Durrës, au cours des années de pouvoir populaire, ou moyen de fouilles régulières ou fortuites, prennent part aussi les restes de canaux anciens, parties d'un grand réseau complet hygiéno-sanitaire. Quant à l'époque et à l'architecture on peut les classer en deux groupes bien distingués l'un de l'autre. Dans le premier groupe on inclut les canaux superficiels et souterrains, appartenant au I-IIIe siècles de notre ère, tandis que dans le second le réseau souterrain y compris ses équipements, construit et complété au cours du V-VIe siècles de notre ère.

Le type le plus ancien et le plus pratique est le canal superficiel avec toutes ses variantes. Les difficultés que présente le terrain à Durrës, ne créèent pas la possibilité de poursuivre le système, le type de canaux depuis les débuts de la ville citadine. Les restes connus appartiennent au premiers siècles de notre ère.

La première variante de canal superficiel qu'on rencontre partout sur les lignes magistrales est celle en forme d'abrevoir. Les deux parois de cette variante de canal étaient faits de grandes briques: 41 x 41 x 7 cm, 46 x 42 x 8 cm ou de plaques de pierre, alors que le cours d'eau coulait sur un pavé de briques ou de pierre et qui dans la plupart des cas était crépi.

La seconde variante, qui est aussi la plus répandue à Durrës, est représentée par le canal à section rectangulaire. Dans les constructions du I-IIIes siècles de notre ère, on s'est servi de briques quadrangulaires aux dimensions suivantes: 34.5(35) x 22 x 4 cm, 35 x 25 x 4 cm. Les murs latéraux, selon la taille du canal, sont composés de trois à six rangées de briques ou de semi-briques posées horizontalement, avec de la liaison de mortier dont la teneur était faite d'une quantité abondante de chaux conditionnée, mêlée à du gravier fin et à un peu de sable, et l'épaisseur de la liaison étant de 2-4 cm. Les briques entières sont usées dans la construction du fond du canal ou de sa couverture. Le fond du canal, dans tous les cas connus, est crépi, alors que les parois latéraux ne le sont pas. Les dimensions de ces canaux vont de 0.22 m, lorsqu'ils sortent directement d'un bâtiment particulier, à 0.50 m lorsqu'ils recueillent les eaux de tout un quartier ou de toute une rue. Ce type de canal a dû être en usage même au cours des siècles antérieurs. De tels canaux, mieux qu'ailleurs, se sont fait évaloir à Apollonia, Antigonéa, etc., dont la physionomie urbaine était déjà connue 23).

Le système superficiel témoigne de la fonction unilatérale des canalisations, en tant qu'ouvrages construits expressément en vue d'accueillir les eaux de précipitations, provenant de cours, de toits, de places et de rues et non pour évacuer les eaux sales. Ceci peut s'expliquer seulement par le manque d'équipements propre au viaduc, créant des possibilités plus grandes hygiéno-sanitaires.

Peut-être, c'est la sécurité plus grande et l'implantation plus longue et plus protégée, dans le cadre général du développement ininterrompu économique et social, comme fut le cas de Durrës, qui obligèrent les habitants autochtones à penser à un réseau plus avancé souterrain. Le terrain sur lequel s'élevait la ville, présentait des conditions idéales pour l'élaboration et la réalisation d'un schéma complet et de perspective. Les quartiers principaux de la ville, s'étendaient sur la partie côtière et sur les versants orientaux de collines et de façon particulière, autour de la colline de Moisi. Conformément à cette configuration naturelle, le labyrinthe souterrain partait des endroits le plus élevés, suivant le tracé s'étendant au pied de la colline, descendait graduellement en traversant tout le quartier côtier et enfin se dirigeait vers son embouchure, au bord de la mer. Les deux restes découverts nous persuadent que le point le plus élevé du canal était au pied de la colline à la côte de 57 m et de là commençait la descente dans les deux sens: le premier du Nord-Ouest vers le Sud-Est, ce qui représente l'embranchement le plus long et le plus complet, le second du Sud-Ouest au Nord-Est. En cours de route, ce grand arc était lié à une série de canaux secondaires, tandis que dans la partie la plus basse (les quartiers nr. 4 et 11) se trouvait l'égout collecteur. Finalement le petit reste, découvert dans la rue «Mujo Ulqinaku», témoigne que les auteurs du projet ainsi que les constructeurs, prévoyaient la croissance et l'étendue en perspective de la ville vers l'intérieur.

DOKUMENTI

En tant que construction souterraines, les canaux étaient des ouvrages d'éngineering (difficiles) qui exigeaient du temps et des études précises et approfondies. En tant que matériel, de base pour la construction servit la brique de haute qualité. Les briques, employées à construire des ouvrages hydrauliques, devaient être fortes, bien cuites et avoir, des formes régulières. Dans les canaux des I-IIIes siècles de notre ère, qu'ils soient superficiels ou souterrains, on a fait usage de briques ordinaires d'une épaisseur de 4 cm, mais même aussi de celles aux dimensions 42 x 30 x 7 cm et 45 x 30 x 6,5 cm. En tant que matériel de liaison, servait toujours le mortier, dans la construction du I-IIIe siècle, dans les restes 1, 11, 12, 13, la chaux bien préparée, mêlée à du gravier fin et avec un peu de sable, tandis que chez celles du V-VIe siècle la chaux mêlée de petits morceaux de briques, de cailloux ou de gravier, ayant le rapport de 1 : 1. Les différences des deux périodes de construction s'aperçoivent aussi dans l'épaisseur de la liaison. Les couches de liaison horizontales des canaux du I-IIIe siècle d'habitude vont de 2-3.5 cm ne dépassant jamais l'épaisseur des briques elles-mêmes, tandis que chez les constructions postérieures, l'épaisseur de la liaison va de 3.5-6 cm. Les parois des canaux souterrains l'élèvent directement sur les assises d'argile dur, sans nécessitant des fondements de pierre. Selon la section les murs ont de 6-10 rangées de briques disposées de façon horizontale. L'arche circulaire du canal était réalisée à l'aide d'échafaudages de bois et d'armatures, en plaçant les briques en forme de rayons (24-40 rangées) ou sur pied, perpendiculairement aux murs latéraux, comme c'est le cas de l'égout collecteur (fig. 5-6).

L'évacuation de la boue de l'intérieur témoigne que l'eau et les restes liquiéfiés coulaient sur un pavé formé de 4 – 6 rangées de briques de même format. Les briques du pavé étaient collées sur une couche de gravier fin et d'argile d'une épaisseur de 2 cm. Quant à l'intérieur, le canal était isolé. L'isolation, quant aux conduits souterrains, était obligatoire, sur la partie supérieure et se réalisait au moyen d'une couche de crépi à base de mortier de haute qualité hydraulique qui empêchait les eaux souterraines d'agir sur les murs. Afin de faire face à la pression latérale sur les deux parois, y joint s'élèvent des murs de renfort d'une épaisseur de 0.30-0.35 m et d'une hauteur allant jusqu'à un mètre (Tableau 1, 2). C'est dans les deux parois qu'entraient les petits branchements sortant des rues étroites ou directement des habitations, qui s'élevaient au long d'elles (Tab. III, 1; fig. 1, 2). Ces branchements ont 0.30-0.50 m de large et 1.15-0.30 m de profondeur et ont des sections en forme de trapèze, ou quadrangulaire couvertes au non (fig. 1, 4).

Afin d'éviter la pression de l'eau et les érosions, les canaux formaient des zigzags.

Le projet du système urbain a toujours servi de base à l'établissement du réseau d'égouts, c'est pourquoi les limites des égouts déterminent les limites de la ville. Dans la première étape de réalisation du réseau, les objets les plus nécessaires sont les égouts collecteurs et ceux des rues de dense population. Les branchements étaient tracés parallèlement aux limites des bâtiments, sous les promenades et les autres rues de la ville et en tant que telles, elles recueillaient l'eau de pluie, pour que les rues restent propres et ne s'inondent pas. Pour cette raison, tout les 20 m, au-dessus de l'égout on installait des bouches au même niveau que les rues ou à un niveau un peu plus bas. Dans tous les cas connus, les puits de contrôle ont une section carrée (fig. 10). Leur côtés sont faites de briques placées sur pied ou en rayons, avec une liaison étant plus épaisse que l'épaisseur de la brique. Dans toutes les constructions découvertes à Durrës, on se servait de la couverture en voûte circulaire. Pour la réalisation de ce réseau, il a été pris pour base les principes et les techniques connus et répandus dans tout l'Empire Romain, où l'art de la construction de viaducs et de conduits souterrains connut un grand développement. Mais les constructeurs du pays appliquèrent ces techniques en les adaptant au relief et à la planimétrie particulière de la ville. Les travaux ont été effectués avec tant de soin, que, dans tout ce qu'on a découvert jusqu'à ce jour, on n'a trouvé même pas une seule petite fissure à l'intérieur ou à l'extérieur. Ceci renforce notre conviction que ces égouts étaient prévus faire face aux puissants tremblement sismiques. au pressions souterraines et aux charges de la surface, comme le trafic, qui devenait de jour en jour plus dense.

Le réseau le plus complexe, le plus complet du système de canalisations est présenté par Durres. Même au cours de la haute époque antique, la ville conserva son importance en tant que grand port et centre développé de l'Empire. Les réalisations techniques les plus réussies des forces créatrices et des constructeurs du pays seraient appliquées tout d'abord-là, et ensuite en seraient irradiées. Bien que les constructions souterraines et surtout les canalisations soient connues depuis des siècles, nous sommes d'avis, qu'à Durres, les conditions requises pour leur réalisations n'étaient pas encore créées. Tout d'abord manquaient les viaducs qui suffiraient à assurer une grande quantité d'eau potable. Les sources d'inscriptions nous parlent de la présence de puits et de nymphée mais jamais de viaducs qui conditionneraient le besoin d'amélioration radicale des conditions hygiéniques et sanitaires de la ville et de ses habitants. La croissance de l'aptitude constructive des maîtres de ce temps-là, l'expérience accumulée, l'amélioration évidente de la qualité des matériaux de construction ont rendu possible le projet et la réalisation, même dans la ville de Durres, en la descente dans les deux sens: le premier du Nord-Ouest, tant que centre important et développé de l'empire, d'un réseau vaste et complet de canalisations.

La ville croissait et s'étendait selon un plan étudié et de perspective. Importants étaient les quartiers de collines, ceux du bord de mer autour du bastion de la marine, le quartier d'en bas, ainsi qu'un quartier nouveau dans le nord, qui croissait d'un jour à l'autre. La construction du viaduc, l'assurance de l'eau en abondance permit la construction d'un dense réseau

souterrain. Les découvertes advenues ces derniers temps (fig. 3-4) démontrent que la construction de ce réseau s'effectuait selon toutes les techniques et les principes de construction connus. Quant à la datation de ces découvertes, ainsi que d'autres découvertes qui peuvent être mises à jour dans la ville, en tant que terme post quem, sert le viaduc principal de la ville, dont la construction fut entreprise à l'époque de l'empereur Hadrian (117-138 de notre ère). Les briques employées, la technique de construction, la liaison en chaux blanc et solide, le matériel de céramique recueilli aux environs démontrent que ces découvertes appartiennent aux canalisations souterrains existantes aux IIe-IIIe siècles de notre ère.

La majeure partie des canalisations découvertes à Durres, appartiennent à la haute époque antique et principalement aux Ve-VIe siècle de notre ère.

A cette époque, la ville termine la construction de trois murs d'enceinte massifs, pour sa défense. A la même époque commença aussi l'aménagement urbain intérieur. Une attention particulière fut prêté à cela par l'emprereur Anastase Ière, qui se distingua par les nombreuses constructions réalisées dans tous les recoins de l'empire. Bien qu'il n'existe pas quelque littérature particulière relative à l'activité de l'Anastase constructeur, nous sommes d'avis que c'est lui qui construisit en un temps très court tout le réseau des canalisations de Durrës. Les briques employées aux nombreux signes symboliques, caractéristiques pour les Ve-VIe siècles, le mortier composé de chaux mêlée à des morceaux de briques et de cailloux, les laisons en rayons et toute la technique sont semblables à ceux usés dans le mur d'enceinte, dans les arcs, les arches, et ses tours.

Pour la construction rapide et de façon économique des canalisations il mobilisa de grandes forces de la ville et de la campagne autour.

Les directions saisies jusqu'à ce jour, sur la longueur de l'égout découvert, nous permettent de porter quelques réflexions même sur le système urbain de la ville. L'égout collecteur appartenait à un quartier très peuplé. Au-dessus ou à côté de lui, devait se trouver la promenade ou le portail central de la ville. Sur les deux côtés, comme les monuments découverts le prouvent, s'élevaient des boutiques et des maisons d'habitation. Ce quartier doit être cherché entre les quartiers actuels 4 et II. Le quartier de collines devait aussi être peuplé (aujourd'hui les quartiers 7 et 9). Son égout suivait le pied de la colline, ensuite, avec de petits zigzags prenait le chemin menant à la porte. L'un des branchements de cet égout tournait dans le sens du Sud-Est afin d'accueillir les eaux du quartier le moins peuplé du port qui perdait l'importance de jadis et dirigeait les eaux de nouveau vers la mer, près du nouveau port tandis que l'autre branchement allait vers le Nord-Est, pouvant avoir d'autre branchements, et appartenait au quartier le plus nouveau et de plus grande perspective (quartiers actuels 5 et 16).

Les vestiges découvertes ces derniers temps appuient, complétement cette opinion. Le branchement détaché, se trouvant le long de la rue «Mujo Ulqinaku» concernait l'étendue de la ville vers le Nord. En tant que schéma, bien qu'incomplète dans ses directions, l'on peut admettre celui circulaire; aux nombreux branchements latéraux, conformément à l'étendue de la ville même. En tant que système, il a été unique. Les eaux de pluie et les immondices se déposaient dans un égout et, liquéfiées, elles se déversaient ensemble définitivement dans la mer. Le calcul exact de la pente hydraulique dans le rapport 3%, 2% dans les sections particulières, le soin continuel pour leur nettoyage et leur entretien fait que ces égouts sont encore de nos jours des ouvrages importants de la construction. Leur réalisation a été le fruit d'une pensée mûre, d'une étude complexe incluant les connaissances les plus importantes d'engineering de cette époque-là.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

tra,[7] që duke filluar me Rusanjin afër Delvinës, e duke mbaruar me Tatzatin në skajin më të largët të saj, (fig. 3) janë të vendosur, thuajse të gjithë, në rrëzë të masivit të Malit të Gjerë. Rrëzoma përfaqësohet nga lugina e Kalasës, që ka formë trekëndëshe të zgjeruar në fushën e Delvinës. Lugina kufizohet prej Malit të Gjerë majtas, ndërsa djathtas prej masivit malor të Bregut të Detit. Për arsye të terrenit të ashpër malor të bregut buzë lumit të Kalasës, fshatrat e Rrëzomës janë vendosur të gjitha në anën e majtë të lumit, rrëzë Malit të Gjerë. Nga gjurmimet në vend, rezulton se krahina e Rrëzomës, ka qënë banuar që nga periudhat e hershme historike e vijimisht deri në ditët tona. Për këtë dëshmojnë vendbanimet e hapura në Vilë pranë Tatzatit (fig. 4) dhe në majën para qytezës së Tatzatit, në Ledhës të Kalasës si dhe vendbanimet e fortifikuara të Qytezës e të Dragasit, respektivisht në Tatzat e Kalasë.[8] Gjatë mesjetës, përmendet kalaja e fshatit Kalasë me formë pesëkëndëshe me gjatësi rreth 600 hapa, me shtatë shtëpi, një mesxhide, një depo ushqimi dhe një derë nga lindja.[9] Një tjetër vendbanim mesjetar me rëndësi në Rrëzomë ka qënë Kamenica, me rreth 230 shtëpi në vitin 1431.[10] Qëndra më e madhe e banuar në këto anë gjatë periudhës së mesjetës ka qënë Delvina. Në shekullin XVII ajo qe një nga gjashtë sanxhaqet e Shqipërisë, ndërsa në çerekun e dytë të shekullit të XVIII ajo ishte pashallëk.[11]

Duke qënë një qendër e spikatur zejtaro-tregtare[12] e gjithë sanxhakut, në Delvinë bëheshin dhe



Fig. 4

7. Studimi i banesave të Rrëzomës është trajtuar në artikullin e L. Sulit, **Ndërtimet e vjetra popullore në zonën e Rrëzomës në rrethin e Sarandës,** në «Tradita në arkitekturë dhe në art, Tiranë 1980, f. 41.
8. Ekspedita e Rrëzomës në mars të vitit 1981 u krye bashkë me L. Papajanin, i cili këto vendbanime do t'i trajtojë në një studim të veçantë.
9. E. Çelebi, **Seyahatname,** (në përkthimin shqip «Shqipnia para dy shekujsh», Tiranë, 1930, f. 25.
10. **Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë,** Vëll. II, f. 241.
11. Historia e Shqipërisë, Vëll. I. Tiranë 1967, f. 462.

DO NOT COPY



Fig. 5

pazaret e pasura javore me produkte të ndryshme të ekonomisë fshatare, ku një aktivitet të rëndësishëm tregtimi dhe shkëmbimi kryenin dhe banorët e Rrëzomës.

Rrëzoma, gjatë periudhës së mesjetës ka pasur një pozitë të rëndësishme në rrugët që lidhnin pashallëkun e Janinës e atë të Delvinës me zonën e Bregut të Detit. Gjithashtu nëpër Rrëzomë kalonte dhe rruga që lidhte Kardhiqin me gjithë pashallëkun e Delvinës nëpërmjet Qafës së Skërficës.[13] Rruga nga Delvina nëpër Rrëzomë e më tej në bregdetin e Himarës ndiqte këtë drejtim: Delvinë - Rusanj - Qafa e Katalatit - Lugina e Katalatit - Qafa e Duk Tasos - Fiqtë Lape - Lumi i Vrrizit - Palavli - Gjorizë (Kopaçezë) - Vergo - Fushë Vërri - Olenë - Kickë - - Dragas - Kalasë - Ura e Çines - Vila (Tatzat) - Qyteza - Sasaj. Kjo ishte rrugë e shtruar me kalldrëm të ngushtë, gjurmë të të cilit ruhen mirë në Katalat e Duktaso - Vrrizë. Nëpër të qarkullonin vetëm karvane me kafshë.

Për të gjykuar mbi ndërtimet e Ali Pashës në këtë zonë, duhen studiuar së pari marrëdhëniet e pashallëkut të Janinës me atë të Delvinës. Me ardhjen në fuqi të Ali Pashës, roli ekonomik i Janinës u rrit mjaft. Si qendër e rëndësishme zejtaro-tregtare, Janina filloi të tërhiqte gjithnjë e më shumë krahinat ekstreme të Shqipërisë Jugore, sidomos Sanxhakun e Delvinës.[14] Në vitin 1798 Ali Pasha pushtoi Nivicë Bubarin dhe Shën Vasijën, fshatra në kufi me krahinën e Rrëzomës.[15] Më vonë në tetor të vitit 1811 ai pushtoi Delvinën dhe Mustafa Pasha i Delvinës me bejlerë të tjerë u detyrua të largohej në kalanë e Kardhiqit.[16] Kështu, pas kësaj kohe në krahinën e Delvinës, pra edhe në Rrëzomë, Aliu ushtroi pushtetin e tij politiko-ushtarak dhe ekonomik. Kuptohet se Aliu, si derven-pasha i dikurshëm,[17] do t'i kushtonte një rëndësi të veçantë krahas të tjerave ndërtimit të rrugëve si dhe urave të lidhura me to, elemente të domosdoshëm për zhvillimin ekonomik e tregtar të vendbanimeve. Akoma dhe sot, në Qafën e Muzinës ruhen gjurmë të qarta të rrugës së karvaneve, që lidhte Delvinën me Gjirokastrën dhe luginën e Drinos, skajet e së cilës të nxirrnin në Janinë, nëpërmjet Kakavisë, ose në Vlorë e në Shqipërinë e Mesme nëpërmjet ngushticave të Leklit.

Rruga për në bregdetin e Himarës, nga Delvina nëpër Rrëzomë deri në Kalasë ndiqte rrëzën e Malit të Gjerë duke i kaluar fshatrave pranë. Në fshatin Kalasë kjo rrugë kalon lumin mbi një urë guri, të quajtur Ura e Çines, e cila duket se ka qënë ura më e rëndësishme ndër gjithë urat e Rrëzomës (Tab. I). Këtu rruga devijon në të djathtë të lumit, vijon për në vendbanimin e Vilës dhe nëpër një qafë rrëzë majës së Qytezës, del në fshatin e Bregut, në Sasaj.

Ura e Çines lidhet drejtpërdrejt me rrugën Delvinë-Bregdet. Duke u nisur nga Kalasa pasi kalon urën e Çines, pranë saj në të djathtë të lumit, ruhen mirë gjurmë kalldrëmi të rrugës së vjetër (fig. 5). Këtu rruga kalon rrëzë shkëmbit. Kalldrëmi është ndërtuar me gurë të mëdhenj kavoje të vendosur pa rregullsi e të plotësuar me gurë më të vegjël në brendësi. Nga ana e pjerrët e bregut të lumit shihen blloqe të mëdhenj që mbartnin trasenë, së fundi në të janë përdorur shkallëzimet për zbritjen e pjerrësisë. Kjo teknikë duket e mesjetës para turke dhe ngjason me traktet e kalldrëmit në grykën e Shkallës së Zezë në Krujë, të cilin e kemi datuar si të mesjetës para turke,[18] që flet për ekzistencën e rrugës së Rrëzomës që në kohë të hershme, pavarësisht se urat i takojnë një periudhe më të vonë. Kjo të bën të mendosh se duhet të ketë pasur dhe ura

12. Z. Shkodra, **Esnafet shqiptare,** Tiranë, 1973, f. 295.
13. A. Baçe, **Kështjellat e Kardhiqit dhe Delvinës,** Monumentet, 13, f. 55.
14. Z. Shkodra, **vep. cit.,** f. 296.
15. Historia e Shqipërisë. Vëll. I, 1967. f. 456.
16. **Po aty,** f. 462.
17. **Po aty,** f. 435.
18. V. Shtylla, **Ndërtime të vjetra inxhinierike në Krujë,** Monumentet, 18, f. 137.

DO NOT COPY



Fig. 6



Fig. 7

më të vjetra se ato që shohim sot, lidhur kjo dhe me vendbanimet antike të Qytezës së Vilës, të cilat lidheshin detyrimisht me Finiqin e lashtë dhe me qytetin antik të Butrintit.

Ura e Çines sipas gojëdhënës popullore është ndërtuar për nder të një gruaje me emrin Çine. Ajo ka vetëm një hark në formë segmenti rrethor me mbështetje të pjerrëta, që qëndrojnë rreth 2,5 m mbi nivelin e ujit. Trashësia e qemerit të harkut ndryshon nga mbështetjet në kyç (0.47-0.53 m) ku harku merr formën e harkut shigjetë. Harku me hapësirë drite 7.6 m është ndërtuar me një qemer i cili konturohet sipër me një hark dekorativ ballor (0.20 m).

Ura ngrihet me kurriz në kyçin e harkut (fig. 6). Kalldrëmi i saj është ndërtuar me gurë kavoje gëlqerorë të vendosur pa rregullsi, ratë e këlliç, e të ndërprerë çdo 0.80-0.90 m me breza tërthorë prej guri shtufi në formë shkallësh. Gjerësia e urës është 2 m. Kalldrëmi ka qenë i siguruar nga të dy anët me parapet guri me 0.40 m lartësi të realizuar me kollona guri të inkastruara në muraturën e urës sipas drejtimit paralel me aksin e qemerit të urës. Kjo teknikë e parapetit haset dhe në urat e Zagorisë e Pogonit, ndërmjet tyre dhe në urën e Limarit e në atë të Hoshtevës, për të cilat të dhënat gojore ngulmojnë se janë objekte të ndërtuara në kohën e Ali Pashë Tepelenës. Është fakt se ky lloj parapeti ha-



Fig. 8



Fig. 9

DO NOT COPY



Fig. 10



Fig. 11

set vetëm në urat e Rrëzomës e të Zagori-Pogonit, për të cilat mendojmë se duhet të jenë ndërtime të periudhës së Aliut.

Ura e Tatzatit. Ura më e largët e krahinës së Rrëzomës është ura e Tatzatit e ndërtuar mbi lumin e Kalasës, pikërisht pranë burimeve të tij, nën kreshtën shkëmbore mbi të cilën ngrihet vetë fshati Tatzat. Kjo urë mbart rrugën që lidh fshatin me bregdetin, e cila kalon nëpër Vilë, qafën e Qytezës dhe del në Sasaj të Bregut të Detit. (Tab, II) Ura e gurtë e Tatzatit ka vetëm një hark me qemer në formë lundre, me hapësirë rreth 9 m (fig. 7). Qemeri (0.47 m) ka sipër një kornizë (0.13 m). Gjatësia e urës arrin 18 m. Kalldrëmi i saj ka gjerësi 2.7 m dhe pjerrësi nga të dy anët, me ngritje në pjesën e kyçit. Ai është ndërtuar me gurë kavoje me dy, tre shkallare nga të dy anët e kyçit. Ura ka qënë pajisur me parapet guri, si ai i urës së Çines, 0.50 m i lartë. (fig. 8). Në ndërtimin e muraturës së urës është përdorur gur gëlqeror paksa i punuar.

Ura Jesir. Rreth 200 m më poshtë se ura e mësipërme, ndodhet ura Jesir e Tatzatit,[19] e cila sot nuk përdoret pasi shtrati i lumit të Kalasës është zhvendosur rreth 30 m më majtas. (Tab. III).

Ka mundësi që kjo urë të jetë ndërtuar më parë se ura e Tatzatit, ndoshta kur lumi i Kalasës ndërroi shtratin, vendasit zgjodhën një grykë ure të ngushtë, më lart urës Jesir dhe ndërtuan urën e sotme funksionale të Tatzatit. Mund të pranohet dhe mundësia se urat e mësipërme janë të njëkohëshme. Në këtë rast ura e Jesirit e ndodhur në një terren më fushor, mund të ketë shërbyer për lëvizjen e bagëtive në kullotat e përshtatshme majtas e djathtas rrjedhës së lumit të Kalasës. Qemeri i urës ka formën midis segmentit rrethor dhe harkut shigjetë (fig. 9). Hapësira e dritës së harkut është 8.6 m, ndërsa lartësia deri në kyç 3.2 m. Mbi qemerin e harkut gjendet një kornizë me gurë gëlqerorë pllоçakë. Muret anësore të urës janë punuar me gurë gëlqerorë kave me një farë latimi. Kalldrëmi me ngritje në kurriz në kyçin e qemerit, 2.43 m i gjerë ka gjurmë shkallëzimesh nga të dy anët e kyçit. Nga ana e bjefit të poshtëm ruhet një gjurmë kollone në anë të kalldrëmit, që dëshmon se edhe kjo urë ka pasur parapet si në rastin e urave të tjera të përmendura më sipër.

Ura e Çines. Duke vazhduar rrjedhën e tij lumi i Kalasës pasi kalon urën e Çines vijon afër fshatit Kalasë. Në hyrje të fshatit, buzë lumit, ndodhet një mulli (9 x 8 m) (fig. 10). Ndërtimi i mullirit ka kaluar nëpër dy faza, prej tyre faza e dytë sipas një mbishkrimi në paturën e derës i takon vitit 1910. Mulliri furnizohet me ujë nga kanali i vjetër vaditës Tatzat - Kalasë. Kanali, 2 m i gjerë, vende vende është me gurë shtufi. Ngjitur me mullirin ndodhet dërstila, një vaskë sferike e hapur në shkëmb, ku nëpërmjet një hinke piramidale bie me presion kollona e ujit e cila përpunon leshin e hedhur në vaskë.

Ura e gurtë e Kalasës, ndodhet ngjitur me mullirin. Ura lidh Kalasën me lagjen djathtas lumit, lagjen e Fshatarëve. Njëkohësisht këtej hedh

19. Jesir- pa ujë. Botuar nga L. Suli në **vep. cit.,** 47.



Fig. 12



Fig. 13

lumin dhe rruga që lidh Kalasën me Nivicën dhe Përparimin (Shën Vasijën) (tab. IV). Ura e Gurtë me gjatësi 20 m, është me një hark në formë segmenti rrethor me hapësirë 9 m. Qemeri me trashësi 0.45 m ka mbështetje të pjerrëta. Sipër ai konturohet nga një kornizë me rrasa guri (fig. 11). Kalldrëmi i urës, me gjerësi 2.70 m, është realizuar me gurë kave vendosur ratë dhe këlliç. Ura nuk ka pasur parapet.

Në hyrje e dalje të urës ruhen gjurmët e kalldrëmit të rrugës Kalasë-Bregdet. Në dalje të saj, në bregun e djathtë të lumit, ruhet një pjesë kalldrëmi me gjerësi 1.5 m i punuar me gurë kave vendosur ratë e këlliç, me pjesët kufizuese anësore të punuara me gurë më të mëdhenj dhe më me tepër kujdes, për rritjen e qëndrueshmërisë së kalldrëmit (fig. 12).

Ura Jesir (e dyta). Në qendër të fshatit Kalasë ndodhet një urë tjetër me emrin Jesir. (Tab. V). Ndërsa ura e Gurtë që pamë më sipër lidhte Kalasën dhe rrugën e Rrëzomës me fshatrat e parë të bregdetit, ura Jesir e Kalasës lidhte lagjet më të vjetra të Kalasës Frataj e Ajdin, të ndodhura majtas lumit, me lagjen më të re, lagjen e Fshatarëve djathtas lumit. Sot ajo ndodhet mbi tokë e jo mbi shtratin e lumit Kalasë, që tani ndodhet rreth 30 m më majtas urës.

Ura Jesir e Kalasës ruhet në gjëndje të mirë e të imponohet me linjën e saj vertikale. Ura 35 m e gjatë është me një hark në formë segmenti rrethor me hapësirë 12 m (fig. 13). Qemeri (0.52 m) përshkohet sipër nga një kornizë guri (0.20 m). Kalldrëmi i urës me gjërësi 2.4 m ka dy faza ndërtimi. Kalldrëmi origjinal është me gurë gëlqerorë kavoje vendosur këlliç me kontur prej pllakash guri të shtrira ratë. Në një fazë të dytë, mbi të u shtrua një kalldrëm me gurë shtufi, me shkallëzim tërthor që del 12 cm mbi rrafshin e kalldrëmit. Në gjysmën e djathtë deri në 2 m nga kyçi, kalldrëmi është me gurë gëlqerorë këlliç pastaj deri në fund vijon me gurë shtufi këlliç me shkallëzim, çdo 0.70-0.80 m që del 0.10 m mbi rrafshin e kalldrëmit. Muret e bregut të urës i kanë faqet me gëlqerorë me fuga të qarta horizontale.

Ura e Gjovrakës. Duke vazhduar rrjedhën e lumit të Kalasës, në rrugën nga Kalasa në Bajkaj, majtas lumit ndodhet fusha Yzeiraj, ku ruhen rrënojat e një fshati të braktisur të cilin nga burimet gojore e emërtojnë Fushë-Bardhë. Në mes të fushës ku kalonte përroi i Gjovrakës, që derdhej në lumin e Kalasës ndodhet një urë e vogël guri (Tab. VI). Ura me një hark ka qemer në formë segmenti rrethor me hapësirë 5 m dhe trashësi 0.45 m. Kalldrëmi 1.85 m i gjerë është punuar me gurë kave ratë e këlliç ndërprerë çdo 0.70-0.90 m me shkallare tërthore. Kalldrëmi sigurohej anash me parapetin e zakonshëm 0.50 m të lartë (fig. 14).

Ura e Baburajt. Ura e parë e rrugës Delvinë-Rrëzomë haset mbi përroin e Baburajt në dalje të fshatit të vjetër Rusanj të Delvinës, ku ndodhet xhamia e Gjin Aleksit e shekullit të XVIII[të].[20] Këtej fi-

20. A. Meksi, **Arkitektura e kultit mysliman në Shqipëri,** në «Studime historike» 1, 1980, f. 203.

DO NOT COPY



Fig. 14

llonte rruga e karvaneve të Rrëzomës që më tej vijonte në Qafën e Katalatit. Ura është e vogël me qemer segmenti rrethor me hapësirë drite rreth 3 m. (Tab. VII). Qemeri (0.22-0.26 m) konturohet sipër prej një kornize me rrasa guri me trashësi. Kalldrëmi i urës me gjatësi 6 m e gjerësi 1.90 m është i çrregullt me gurë kave gëlqerorë.

Urat e rrugës Sarandë-Delvinë. Në fushën e Vanajt pranë Delvinës, pak kilometra para derdhjes së Kalasës në lumin e Bistricës, afër kryqëzimit të rrugës Sarandë-Delvinë me rrugën e Finiqit, ndodhen disa rrënoja urash të rrugës së vjetër Sarandë-Delvinë.



Fig. 15

Nga gjurmët duket se Kalasa, në pjesën afër derdhjes e ka ndrruar shtratin. Njëri shtrat, më i hershëm, ka qënë rreth 400 m djathtas të sotmit, në drejtim të Sarandës. Këtu ka qënë ura me tre harqe në formë segmenti rrethor. Duke qënë harku i mesit më i madh, ura ngrihej me kurriz mbi të (fig. 15). Këto harqe janë punuar me qemer të dyfishtë me trashësi rreth 1 m. Qemerët janë punuar me gurë pllakë gëlqerorë. Gjerësia e urës është 4.30 m.

Rreth 200 m djathtas kësaj ure, më në afërsi të Sarandës, duken gjurmët e një ure, që duken të kenë qënë të shtratit më të vonë të lumit. Edhe këtu ruhen tre harqe në formë segmenti rrethor, i pari i dëmtuar. Qemeri është punuar me rrasa gëlqerorë të skuadruara mjaft mirë sikurse dhe muratura ndërmjet harqeve. Rreth 0.80 m mbi tokë, qemerët mbështeten mbi thembra të drejta, ndërsa kyçi ndodhet 3 m mbi tokë (fig. 16). Kjo urë duket një ndërtim i shekullit tonë.

Në shtratin e sotëm të lumit ruhen gjurmë të një ure guri me dy harqe, ndërsa pranë saj ruhet një urë e vogël me një hark e quajtur Ura e Zotos (fig. 17).

Urat e Rrëzomës. Veç të dhënave gojore që e lidhnin ndërtimin e tyre me periudhën e Ali Pashës, këto ura kanë dhe disa karakteristika teknike të përbashkëta ndërmjet tyre, si dhe me objektet e tjera që njihen si të ndërtuara në periudhën e pashallëqeve shqiptare.

Në urën e Tatzatit, në urën e Çines si dhe në urën e braktisur në fushën e Yzeirajt në Kopaçezë, ruhen qartë gjurmët e parapetit të kalldrëmit të urës, të ndërtuar me gurë në trajtë kollone të ngulur në murin e urës. Kjo teknikë e parapetit të urave prej guri shihet edhe në urën e Limarit në Përmet[21] si dhe në urat e Zagorisë, për të cilat thuhet se janë ndërtuar në kohën e Ali Pashës. Në ndërtimin e urës së Gurit dhe urës Jesir në Kalasë shihet teknika e mureve, karakteristikë e ndërtimeve të periudhës së pashallëqeve, gurë pllloçakë me fuga horizontale pak a shumë të rregullta. Përmendim këtu urën e Ali Pashës në përroin e Manalatit, mbi të cilën kalonte ujësjellësi i kalasë së Gjirokastrës,[22] Urën e Mesit në Shkodër,[23] urën e Vashës mbi lumin Mat

21. V. Shtylla, **Disa ura të vjetra në Shqipërinë e Jugut,** Monumentet, 14, f. 107.
22. V. Shtylla, **vep cit.,**
23. V. Shtylla, **Disa ura të vjetra prej guri në vendin tonë,** Monumentet, 11, 1976, f. 223.

DO NOT COPY

në Klos, etj.[24] Teknika e kalldrëmit e urave të Rrëzomës është e njëllojtë. Gurë kave të vendosur ratë ose në këmbë ndërprerë çdo 0.70-1.00 m me shkallëzim tërthor për të lehtësuar ngjitjen në kurrizin e kyçit të urës.

Krahinat Pogon e Zagori të rrethit të Gjirokastrës të orientuara nga Jug-lindja në veri-perëndim shtrihen në luginën që krijojnë lumenjtë e Sopikut e Kaçarellos në Pogon dhe ai i Zagorisë në krahinën e Zagorisë. Këto krahina të populluara ndodhen ndërmjet vargut malor Trebeshinë-Dhëmbel-Nëmërçkë në kurriz të Përmetit dhe vargut tjetër Shëndelli-Lunxheri-Bureto, që i ndan ato nga fusha e Dropullit.

Këto krahina malore, sipas burimeve historike gjatë mesjetës kanë ushtruar dhe një veprimtari të gjerë tregtare. Panairi i Pogonit ku në gjysmën e shekullit të XVIII-të vinin tregtarë nga Bosnja Lindore, Shqipëria e Sipërme, Thesalia, Epiri dhe Maqedonia çelej më 15 Gusht dhe vazhdonte 15 ditë.[25] Burimet historike theksojnë se në Pogon Ali Pasha ndëhyri pas vitit 1760 për qetësimin e trazirave me motive fetare ndërmjet popullatës së kësaj krahine dhe asaj të zonës së Karamuratit, ku përfshihej fusha e mesit të Vjosës (Përmetit) dhe Kazaja e Konicës, e cila para islamizimit, ishte përfshirë në peshkopatën e Pogonit.[26]

Kuptohet se duke qënë krahinë me një aktivitet të dendur tregtar, ku Ali Pashë Tepelena ka ushtruar pushtetin e tij politiko-ekonomik, Zagoria dhe Pogoni kanë qënë lidhur me rrugë karvanesh me qendra të tjera të banuara. Nëpër grykën e lumit Suhë ndërmjet malit të Lunxheris dhe atij të Buretos, atje ku sot kalon rruga automobilistike që lidh Gjirokastrën me Zagori-Pogonin, kalone rruga e karvaneve tregtare që vinin kryesisht nga pashallëku i Delvinës nëpërmjet Qafës së Muzinës. Kjo rrugë ndiqte itinerarin: Sarandë - Delvinë - Sofratikë - Libohovë - Labovë-Selckë-Poliçan-Sheper - Nivan - Konckë - Hoshtevë-Mbrezhdan-Këlcyrë e më tej në Buz e Berat. Në Hoshtevë pushimi bëhej në manastirin e Shën Sotirit.

Në këtë rrugë që punohej nga karvanet tregtare, në grykën e Selckës pak kilometra para Poliçanit, buzë rrugës së sotme majtas lumit të Suhës, ruhen gjurmët e një vendroje (karakolli) me planimetri kënddrejtë, ku qëndronin dervenxhinjtë, ruajtësit e rrugës së karvaneve. Kuptohet se nëpër grykën e Suhës apo të Selckës ka pas kaluar dhe rruga që lidhte Gjirokastrën e Dropullin me Zagori-Pogonin. Megjithatë, nga Gjirokastra për në Zagori ka pas punuar edhe rruga nëpër Çajup, e cila sigurisht duhet të ketë qenë dhe rruga që lidhte Kardhiqin me krahinat në shqyrtim. Kjo rrugë kalonte nga Erindi në qafën e Çajupit-Zhej-



Fig. 16



Fig. 17

24. V. Shtylla, **Në gjurmët e rrugës së vjetër Durrës-Fushë** e Tiranës-Dibër. Kumtesë në Sesionin e IV Shkencor të IMK, Dhjetor 1980 (në shtyp).
25. T. Stoianovich, **Modeli dhe pasqyra e qytetit ballkanik paramodern,** në «Studia Balcanica», 3, f. 110
26. I. Aravantinoi, Historia e Ali Pashë Tepelenës, Rumani 1923, f. 31.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 18



Fig. 19

-Topovë-Nderan-Hoshtevë. Në këtë rrugë karvanesh nën Qafën e Çajupit, tek rruga e Zhejit, ruhet një karakoll që vendasit e quajnë tabor. Kjo kullë mbrojtëse, ndërtim karakteristik i rrugëve tregtare për ato kohë, ka planimetri rrethore me diametër rreth 4 m dhe mbulohet sipër me një kupol sferike. Ka vetëm një derë dhe 4-5 frengji përreth, në muret anësore 1 m të trasha. Nën Zhej ruhen gjurmë të kalldrëmit të rrugës së postës Tepelenë-Peshtan-Limar-Zhej-Topovë-Nderan-Grykë e Selckës. Përmendëm më lart se Zagoria e Pogoni kanë zhvilluar aktivitet të dendur tregtar dhe me Janinën. Rruga nga Janina shkonte në Sopik-Skore, nga Skoreja rruga të çonte në Poliçan-Sheper-Nivan-Konckë-Hoshtevë prej nga lidhej me Këlcyrën e Beratin. Rruga e Janinës tek sheshi i Vllahëve në juglindje të Hoshtevës ka pasur një han për pushimin e karvaneve, tek vendi që sot thirret Rrëza e Hanit. Ky rrjet i gjerë rrugor në këto krahina malore ndërpritej nga disa lumenj e përrenj mbi të cilët u ngritën një sërë urash prej guri që ruhen edhe sot në gjëndje të mirë.

Ura e madhe e Kaçarellos.[26] Në Pogon rruga nga Sopiku në Hllomo kalon mbi lumin e Kaçarrellos mbi të cilin ngrihet ura e madhe e Kaçarellos e fshatit Hllomo (Tab. VIII). Kjo urë është ndër-



Fig. 20



Fig. 21

tuar me dy harqe me qemere rrethorë. Harku kryesor, i djathti, ka hapësirë drite 16 m; mbi të ura lartësohet me kurriz (fig. 18). Qemeri i harkut kryesor është i dyfishtë 1.05 m. Nga të dy ballet ky qemer ka nga tetë ganxha që lidhin gurët fqinjë për të mos lejuar shkëputjen tërthore. Harku i majtë është po rrethor me qemer të dyfishtë (0.90 m) dhe hapësirë drite 8 m.

Këmba ndërmjet dy harqeve në pjesën e poshtme, nga të dy anët është trajtuar me majë, për çarjen e rrjedhës së ujit. Në pjesën e sipërme të këmbës, nga të dy anët, janë hapur dy kamare për mbishkrime por në to nuk ruhet gjë. Këmba është punuar me pllaka shtufi me trashësi të vogël, me fuga thuajse të rregullta. Gjatësia e urës gjatë kalldrëmit arrin 36 m. Kalldrëmi me gjerësi 2.9 m është punuar me pllaka shtufi të vendosura këlliç të ndërprera çdo 80 cm, me shkallëzime tërthore (fig. 19). Kalldrëmi i urës është i siguruar anash me parapetin tipik të kohës së Ali Pashë Tepelenës, kollona guri 0.80 m të larta të ngulura çdo 0.50 m në murin e qemerit të urës e me hapësirën midis tyre të mbushura (fig. 20).

Ura e vogël e Kaçarellos ndodhet mbi përroin e Buçuvallës. Edhe kjo pjesë e rrugës Hllomo-Sopik, ka dy harqe gjysëm rrethorë (fig. 21). Harku i madh, i djathti, me hapësirë drite 4 m, ka qemerë të dyfishtë me trashësi 0.60 m. Mbi të ura ngrihet me kurriz. Harku i vogël, majtas, ka hapësirë 1.10 m me qemer tek (0.27 m). Gjatësia totale e urës është rreth 13 m. Kalldrëmi i punuar me gurë shtufi pllakë është siguruar me parapetin tipik dhe shtruar me gurë këlliç, me breza çdo 0.40-0.60 m. Pas kësaj ure rruga e karvaneve vijonte për në Hllomo.

Pranë fshatit ruhen gjurmë të qarta të një kalldrëmi punuar me një kujdes të veçantë (fig. 22). Ai është i gjerë 2.3 m. dhe i punuar me pllaka masive shtufi me gjerësi 0.40-0.60 m të ndërprera në këto intervale me pllaka tërthore. Ky është një lloj kalldrëmi i veçantë i trajtuar sipas materialeve rrethanore.

Çezma e Hllomosë. Në fshatin Hllomo, veç disa banesave të vjetra karakteristike, ruhet ende në funksion një çezmë interesante e ndërtuar në vitin 1841 (fig. 23). Pjesa e vjetër është mbuluar me kupolë, kurse gjysma, më e vonë, me çati druri. Konstruksioni i mbulesës mbështetet mbi kollona të gurta



Fig. 22

që në kreun e tyre lidhen me qemerë. Rreth 6 m mbi çezmë ndodhet depozita dekantuese e çezmës, ku uji vjen me tuba qeramike nga kodra e Shën Kristoforit, rrëzë malit të Buretos. Mbishkrimi me datën e ndërtimit 1841 ndodhet në rrëzë të strehës së çatisë, në ballin e çezmës.



Fig. 23

Document COPY

26') Në këtë urë, nën kyçin e harkut kryesor ruhet ende një copë zinxhir me gjatësi rreth 1 m ku dikur ka qënë varur një këmbanë. Kur frynte erë e fortë këmbana tundej dhe tingujt e saj paralajmëronin kalimtarët që të mos kalonin mbi urë pasi rrezikoheshin nga era e fortë.

DO NOT COPY



Fig. 24



Fig. 25

Ura e Çiminxhit ndodhet mbi lumin e Sopikut (Tab. IX) (fig. 24). Kjo urë ka qënë pjesë e rrugës Grykë e Selckës-Skore-Hllomo-Çatistë. Në qendër të saj mbi shtratin e lumit ndodhet harku i madh tip lundër, tip i rrallë ky në harqet e mëdha të urave tona mesjetare për arsye të vështirësive në zbatim. Harku tip lundër e më shpesh ai tip shigjetë, i afërt me të, në rastin e urave ka gjetur përdorim në harqet apo dritaret lehtësuese ndërmjet harqeve kryesore, ku hapësirat janë të vogla.

Qemeri kryesor i urës së Çiminxhit i dyfishtë (0.82 m) ka mbështetje të pjerrëta. Hapësira e dritës është 12 m. Në ballet e qemerit ka nga katër ganxha metalike për lidhjen e gurëve ballorë me anën e tiranteve të tërthorta. Anash harkut kryesor në të dy brigjet ka dy harqe më të vegjël gjysëm rrethorë me hapësirë 2 km, mjaft lart shtratit të lumit, të ndërtuar me qemer tek. Kalldrëmi i urës ka gjatësi 27 m e gjerësi 2.7 m, lartësohet me kurriz në kyçin e harkut qendror (fig. 25). Shtresa e kalldrëmit është punuar me gurë të zinj vendosur këlliç, të ndërprerë me rripa të tërthorë çdo 0.65-1.00 m. Edhe në këtë urë ruhet parapeti si i urave të tjera me lartësi 0.60 m. Muratura e urës është punuar me gurë të zinj të fortë.



Fig. 26

Ura e Paspalit, ndodhet në hyrje të krahinës së Pogonit mbi lumin e Suhës. Ura përbëhet nga dy mbështetjet bregore me mur guri me rrasa të rregullta si dhe nga dy këmbët qëndrore të ngritura mbi masive shkëmbore në shtratin e lumit. Në nivelin e kreut të tyre është hedhur konstruksioni i drunjtë i pjesës së kalimit. Kjo urë është ndërtuar për nevojat e vetë fshatit Hllomo për shfrytëzimin e tokave dhe kullotave.

Ura e Hoshtevës. Ura e Hoshtevës është ndërtuar mbi lumin e Zagories, i cili buron në Sheper nga mali i Dhëmbelit (Tab. X). Nëpër Hoshtevë ka pas kaluar rruga e karvaneve që lidhte Gjirokastrën me Përmetin sipas këtij itenerari: Gjirokastër - Erind - Çajup - Ura e Hoshtevës - Hoshtevë - Gjurmë Mushkë - Bual - Lipë - Përmet. Lidhur me kohën e ndërtimit të kësaj ure ka një gojëdhënë popullore sipas së cilës Ali Pasha ndërtoi urën e Hoshtevës e të Nivanit si shpërblim ndaj popullit të Nivanit që e strehoi në manastir dhe e mbrojti nga ushta-

DO NOT COPY



Fig. 27



Fig. 28

rët turq, ngjarje kjo e kohës së rinisë së Aliut, para se ai të bëhej pasha.[27]

Nga burimet historike dhe të thënat e popullit rezulton se Ali Pasha njerëzve që i bënin shërbime ju bënte dhurata të ndryshme si toka, ndërtime me karakter të ndryshëm, etj. Burimet gojore shprehen se Dervish Hasanit, njërit nga trimat e tij, Aliu i bëri dhuratë urën e Limarit dhe kalldrëmin nga ura deri në Limar. Theksojmë se ura e Limarit është e ngjashme me urat e Zagori-Pogonit përsa i takon teknikës së ndërtimit, formës dhe elementeve përbërës.

Në qendër të kompozimit të urës së Hoshtevës ndodhet një hark i madh me hapësirë drite rreth 15 m në formë gjysëm rrethi, me qemer të dyfishtë, (1.10 m) me mbështetje të pjerrëta e mjaft të larta, 3.5 m mbi shtratin e lumit (fig. 28). Nga katër ganxha në të dy ballet lidhin në drejtim tërthor gurët ballorë të qemerit të poshtëm. Në bregun e majtë, mjaft lart mbi shtratin e lumit, është hapur një dritare lehtësuese në formë çerek rrethi.

Kalldrëmi i urës me gjatësi 28 m lartësohet me kurriz në kyçin e harkut kryesor. Ai ka gjerësinë 2.80 m dhe çdo 0.60-0.80 m përshkohet nga breza tërthorë në formë shkallareje. Anash kalldrëmi kufizohet me parapetin tipik me lartësi 0.60 m. Në ndërtimin e urës është përdorur guri i zi kompakt.

Ura e Nivanit. Një aks tjetër rruge që lidhte Gjirokastrën me Përmetin ka qënë ajo që kalonte nëpër urën e Nivanit sipas këtij itinerari; Gjirokastër - Erind - Çajup - Hija e Mallkuar - Topovë - Ura e Nderanit (Nivanit)- manastiri i Nivanit - Sheper - Qafa e Dhëmbelit - Përmet. Gjurmë të kësaj rruge të karvaneve tregtare ruhen qartë pranë urës së Nivanit, pranë mullirit te ura. Këtu shihet kalldrëmi me gjerësi 2.8 m i ndërtuar me gurë mali vendosur pa rregullsi, që



Fig. 29

27. Kjo gojëdhënë mund të quhet bindëse pasi është dëgjuar nga disa burime, të gjitha me të njëjtën përmbajtje.



Fig. 30



Fig. 31

kufizohet anash me një kornizë më të rregullt, 0.35-0.40 m të gjerë (fig. 30).

Ura e Nivanit mbi lumin e Zagories lidh sot Nivanin me Nderanin e Topovën. (Tab. XI). Ajo ndodhet ngjitur me mullirin me dy kate të fshatit dhe afër manastirit të Nivanit, ndërtim i shekullit të XVIII-të. Kjo urë e madhe, ngrihet me kurriz mjaft të lartë në kyçin e harkut kryesor. Si kompozim është zgjidhur me një hark të madh mbi rrjedhën e lumit, me një më të vogël mbi tokë, djathtas tij, dhe me një dritare lehtësuese ndërmjet tyre. Harku i madh me hapësirë 13.4 m është i punuar me qemer të dyfishtë (1.12 m) e me mbështetje të pjerrët rreth 3.5 m mbi nivelin e ujit.

Sigurimi tërthor i balleve është arritur me anën e pesë ganxhave nga çdo anë ballore. Harku i djathtë mbi tokë me hapësirë 4 m është punuar me qemer tek në formë rrethore. Rrethore është dhe dritarja lehtësuese me hapësirë 1.5 m, këmba nën të është trajtuar e mprehtë nga ana e sipërme dhe e rrumbullakosur nga ana e pasme e ardhjes së ujit. Kalldrëmi është punuar me gurë këlliç me breza tërthorë çdo 0.80-1.00 m. Gjatësia e tij arrin 34 m, gjerësia 3.15 m. Mbi të ka pasur një parapet me kollona guri si ai i urave të përshkruara më lart, por sot i dëmtuar. Në hyrje të urës nga ana e Nderanit, në bregun e majtë, në anën e sipërme të rrjedhës, në kalldrëm, është ngulur një bllok masiv guri me seksion kuadratik (0.52 x 0.52 m) e lartësi 1.20 m i cili nga ana e bregut ka një kamare e cila mund të ketë qënë vendi i mbishkrimit ose ndoshta në të mund të vendosej ndonjë kandil për kalimtarët e natës (fig. 31).

Urat e krahinave Zagori-Pogon, që të dhënat gojore i cilësojnë si ndërtime të periudhës së Ali Pashë Tepelenës, i cili në këto anë ka ushtruar një aktivitet të gjerë, kanë mjaft ngjasime ndërmjet tyre. Megjithë dallimet rrethanore në varësi të shtratit të lumit ku ndërtoheshin, në lidhje me prurjet e lumit apo formacionin gjeologjik shtrat-breg, ato kanë mjaft pika takimi përsa i përket trajtimit të formës së tyre. Ura e madhe e Kaçarellos në Hllomo, me dy harqe të madhësive të ndryshme është identike me atë të Nivanit, po ashtu me dy harqe. Ura e Hoshtevës, ajo e Çiminxhit dhe e Limarit, në rrjedhën e poshtme të lumit të Zagories, kanë një trajtim si formë, me një hark të madh kryesor me një ose dy dritare lehtësuese anash mjaft të larta ndaj shtratit të lumit. Të gjitha këto ura në aspektin kompozicional janë me kurriz mjaft të lartë në kyçin e harkut kryesor, zgjidhje kjo tipike për urat e gurit në mesjetë. Në aspektin konstruktiv të gjithë harqet kryesorë të këtyre urave, përgjithësisht të formës gjysëm rrethore, janë zgjidhur me qemere të dyfishë me ganxha përforcuese lidhur me tiranta tërthore në ballet e tyre të kundruellta. Kalldrëmi i tyre në të gjitha rastet është me breza tërthorë për të lehtësuar ngjitjen në kurrizin mjaft të pjerrët, që krijohet në kyçin e harkut të madh të urës. Një tjetër element i përbashkët i këtyre urave është dhe mënyra e zgjidhjes së parapetit të pjesës kaluese të urës, me kollona, blloqe vertikale gurësh të inkastruar çdo 0.60-0.70 m në murin e urës me hapësira ndërmjet, me blloqe vertikale të të njëjtit seksion të mbështetur mbi kalldrëm. Ballet e qemerëve janë punuar me gurë pllakë të

DO NOT COPY

gdhendur më me kujdes se sa brendia e qemerit. Faqet ballore të mureve bregorë apo të këmbëve të ndërmjeme janë punuar me gurë pak a shumë të rregullt që krijojnë fuga horizontale të dallueshme. Kjo teknikë e realizuar në fshatra të largëta me vështirësi komunikimi e organizimi, megjithëse e njëjtë si koncept me teknikën e mureve të kalave të Ali Pashës, përsëri ka një farë ndryshimi me to, ku kërkesa për mbrojtjen diktonte mure më solide. Po të vërehet muratura e kalave të Tepelenës, Libohovës, Vivarit, etj. objekte të periudhës së pashallëkut të Janinës, dallohen menjëherë fugat mjaft të rregullta horizontale, rezultat i latimit mjaft të mirë të gurëve në faqet e mureve.

Urat e ndërtuara në kohën e Ali Pashë Tepelenës zenë një vend të rëndësishëm në gjithë aktivitetin ndërtimor të këtij prijësi shqiptar, aktivitet i cili ka lënë gjurmë të rëndësishme në historinë e artit shqiptar të ndërtimit. Studimi dhe trajtimi i këtyre ndërtimeve inxhinierike, vepra të mjeshtërve shqiptarë të ndërtimit, janë një hallkë e historisë së ndërtimit të objekteve inxhinierike në vendin tonë.

DO NOT COPY

TAB. I



DO NOT COPY



DO NOT COPY

TAB. III



DO NOT COPY


URA E GURTË NË KALASË Delvinë
455
267
800
950
1050
140
0 1 2 3 4 5M

DO NOT COPY

TAB. V

DO NOT COPY



DO NOT COPY

FUSHA E PALAVLISE - *Sarandë*



DO NOT COPY


URA BABURAJ - RUSAN - Delvine
190
8
22
90
270
14
14
0
2 M
GEN - PLAN
0
2
4
6 M

DO NOT COPY



TAB. IX

DO NOT COPY

URA E ÇIMINXHIT HLLOMO – *Gjirokastër*



DO NOT COPY



KISHA E SHEN GJERGJIT-NOKOVË







KISHA E FJETJES SHEN MERISE-Shoré"





DO NOT COPY



KISHA SHEN E PREMTES
– Përmet









DO NOT COPY

KISHA E SHEN MERISE - *Topík*







KISHA E SHEN MEHILLIT - *Gjirokastër*







DO NOT COPY



KISHA E SHEN SOTIRIT – Gjirokastër







KISHA E SHEN KOLLIT – Kroporë







DO NOT COPY

KISHA E SHEN KOLLIT - LIPE - *Përmet*









KISHA E SHEN THANASIT - BOROVE - *Kolonjë*









KISHA E SHEN MERISE *Berat*



KISHA E SHEN MERISE -KONCKE





0 2 4 6 8m

DO NOT COPY

BAZILIKAT ME KUPOLË TË RRAFSHËT

KISHA E SHËN MËRISË – *Ardenicë*









0 2 4 6 8 m.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

KISHA E SHËNÎ MERISË NICE – Pogradec











DO NOT COPY



KISHA E SHËN MERISË - LASHOVË
Gjirokastër







DO NOT COPY

KISHA E SHËN ILLIU - Voskopojë









DO NOT COPY



KISHA E SHËN MËRISË-*Postenan*

KISHA E SHËN THANASIT-*Leshnicë*













KISHA E SHËN KOZMAIT-*Kolkondas*



KISHA E SHËN MËRISË-*Leussë*"-PËRMET







DO NOT COPY

DO NOT COPY



KISHA E SHËN PJETRIT
- Vithkuq



KISHA E SHËN MËHILLIT
Mingul - GJIROKASTER

0 2 4 6 8m.









DO NOT COPY



KISHA E SH. MËRISË KRIMAROVES - *Piqeras*







KISHA E SHËN THANASIT - *Poliçan*





BAZILIKAT ME KUPOLE

KISHA E SHËN MERISE - *Vrahо-Goranxi*





KISHA E SHËN E PREMTES - *Lukovë*





KISHA E SHËN MËHILLIT - *Nivan*







DO NOT COPY

don me një rresht gurësh dhëmbësharre dhe rrasash të drejta mbi të.

Mbas ndërtimit të kishës, në një kohë të dytë shtohen hajatet. Duhet thënë se në muret gjatësorë të kishës, nën dritaret janë vënë njëkohësisht me ndërtimin në intervale të caktuara gurë të nxjerrë e të profiluar për të shërbyer si mbështetje për mbulesën e hajatit. Kjo tregon se që në fillim është pasur parasysh një nevojë e tillë për t'i shtuar kishës hajate. Hajati me tre krahë me mbulesë me tjegulla me një kullim ka si të rindërtuar ambientin në qoshen jugperëndimore që duket i njëkohëshëm me këmbanaren në vitin 1924.

Kisha e Shën Todrit në Kadipashaj të Lushnjes ndërtuar në vitin 1801[36] përbëhet nga naosi dhe narteksi në të njëjtin vëllim dhe hajati në anën veriore i shtuar më vonë. Në narteksin e shtuar më vonë nën të njëjtën çati me kishën hyhet nga porta në anën perëndimore. Narteksi lidhet dhe me hajatin me një portë në anën jugore dhe ka gjithashtu një portë në anën veriore. Narteksi është dykatësh. Në katin e dytë hipet me shkallë druri. Kati i dytë ndriçohet nga dy dritare në anën veriore e dy në anën jugore. Në naos hyhet nga porta në anën perëndimore me dy dritare anash. Naosi ndahet në tre nefe nga dy rradhë kolonash druri veshur me dërrasa, mbi të cilat kalojnë në drejtimin gjatësor harqe.

DO NOT COPY

36. Pikturuar nga Joani dhe Nikolla Çetiri; Material në A. I. H.

KISHA E SHEN KOLLIT – *Voskopojë*







DO NOT COPY

BAZILIKA ME MBULESE QEMERESH E KESULASH SFERIKE.

0 2 4 6 8m.





KISHA E SHEN MEHILLIT-VITHKUQ

KISHA E SHEN MERISE – Voskopojë

0 2 4 6 8m.









DO NOT COPY

Valter ŠHTYLLÁ

DO NOT COPY

LES TRAVAUX D'ENGINEERING DU DEBUT DU XIXème SIECLE DANS QUELQUES REGIONS DE L'ALBANIE DU SUD

RESUME

Dans cet article nous allons traiter des ponts de pierre et des routes de caravanes construits durant le premier quart du XIXème siècle à Rrëzome de Delvina, dans la région de Saranda et celles de Pogon de Zagori à Gjirokastër. Il paraît que la plupart de ces constructions ont été réalisées pendant le règne d'Ali Pacha Tepelena. Ce matériel a été basé sur les données des expéditions effectuées en lieu même, pendant l'année 1980.

D'après les nombreuses sources historiques et les différents objets conservés jusqu'à nos jours, il ressort qu'il y a eu dans notre pays, sous le règne d'Ali Pacha, un grand nombre de constructions, parmi lesquelles les forteresses ont eu le dessus, telles: celle de Tepelena, Libohova, Saint Triadhe etc. Une attention particulière a été consacrée aux objets d'engineering tels que: routes, ponts, aqueducs, etc. Il convient de mentionner l'aqueduc de la forteresse de Gjirokastër, long de 12 km, ainsi que celui de la forteresse de Tepelena, construit sous le règne d'Ali Pacha.

Des sources nous informent que pendant ce temps-là ont été construits et refaits un grand nombre de ponts, sans nous préciser lesquels.

Au cours des expéditions dans les régions de Rrëzome, Zagori et Pogon, nous avons rencontré de nombreux ponts à voûte de pierre, qui gardent encore leur fonction. Nous admettons que la plupart d'eux ont été construits pendant le règne d'Ali Pacha parce que: primo, ils se ressemblent tant par la construction que par la technique de construction; secondo, ces régions faisaient partie du territorire où régnait Ali Pacha et où il y a eu une large activité constructive; tercio, sur les objets, dont nous traitons dans cet article, il y a beaucoup de sources orales qui qualifient les ponts comme étant des constructions d'Ali Pacha.

La région de Rrëzome de Delvinë, qui s'étend du sud-est au nord-ouest, de Delvinë jusqu'à Tatzat, appartient à la vallée de la rivière de Kalasë, qui prend sa source à la gorge de Tatzat et se jette à la rivière de Bistrice, avant que celle-ci se jette à la mer.

Rrëzomë, a occupé une position importante dans les routes qui liaient le pachalik de Janina et celui de Delvina avec la zone de Bregu i Detit (le Bord de Mer). C'était à travers Rrëzomë aussi, que passait la route qui liait Kardhiq au pachalik de Delvina passant par le Col de Skërficë. La route de Delvina à travers Rrëzomë et plus loin aux côtes de Himara, suivant la direction suivante:

Delvinë - Rusanj - Qafa e Katalatit - Lugina e Katalatit - Qafa e Duk Tases - Fiqtë Lape - Lumi i Vrrizit - Palavli - Gjorizë (Kopaçezë) - Vergo - Fushë Vërri - Olenë - Kickë - Dragas - Kalasë - Ura e Çines - Vila (Tatzat) - Qytеza - Sasaj.

La route des côtes de Himara, de Delvina, à travers Rrëzomë, jusqu'à Kalasë, suivait le pied de la montagne dite «Mali i Gjërë», passant tout près des villages. Dans le village de Kalasë cette route franchit la rivière au moyen d'un pont de pierre, nommé le pont de Çine, le plus important paraît-il, des ponts de Rrëzomë.

Le pont de Çine faisait partie de la route Delvinë-Bord de Mer. En partant de Kalasë, après avoir franchi le pont de Çine, tout près de celui-ci, sur le côté droit de la rivière, se conservent en bon état, des traces de pavé de l'ancienne route.

Le pont de Çine, est composé d'un seul arc en forme de segment en plein cintre avec des appuis de pente. Dès deux côtés du pavé, il y a eu un parapet de pierre, d'une hauteur de 0.40 m, une hauteur réalisée au moyen de pierre, d'une hauteur de 0.40 m, une hauteur réalisée au moyen de colonnes de pierres incastrées dans la muraille du pont. On rencontre une telle technique de parapet, même sur les ponts de Zagori et Pogon, de Liman et Hoshteve, lesquels d'après les données orales sont des objets construits pendant le règne d'Ali Pacha. C'est un fait qu'une telle sorte de parapet se rencontre seulement sur les ponts de Rrëzomë et Zagori-Pogon, qui doivent être des constructions d'Ali Pacha.

Le pont de Tatzat. Le plus lointain pont de la région de Rrëzoma, c'est celui de Tatzat, construit sur la rivière de Kalasë, notamment près de ses sources, sour la crête rocheuse, au-dessus de laquelle s'élève le village de Tatzat. Ce pont fait partie de la route qui fait la liaison du village avec le bor de mer, en traversant Vile, le col de Qytezë, jusqu'à Lasaj de Bregu i Detit (Le Bord de Mer). Le pont de pierre de Tatzat est composé d'un seul arc en accolade, avec une ouverture d'environ 9 m (fig. 7).

Le pont Jesir. Environ 200 m plus bas que l'autre, se trouve le pont Jesir de Tatzat, lequel aujourd'hui ne fonctionne plus à cause du déplacement du lit de la rivière de Kalasë, 30 m à gauche (tab. III). Il est possible que ce pont soit construit avant celui de Tatzat. On peut admettre

même que les deux ponts sont construits simultanément. La voûte du pont a une forme intermédiaire à celle en plein cintre et l'arc en ogive (fig. 9).

Le pont de pierre de Kalasë, fait la liaison de Kalasë avec le quartier qui se trouve du côté droit de la rivière, le quartier des Paysans. Le pont de pierre, d'une longueur de 20m, est doté d'un arc en forme d'un segment en plein cintre avec une ouverture de 9m. Sur les deux extrémités du pont se conservent les traces du pavé de la route Kalasë-Berat.

Le pont Jesir (le second). Au centre du village il y a un autre pont nommé le pont de Jesir. (tab. V). Le pont de pierre, que nous avons mentionné plus haut, avait pour but de joindre Kalasë et la route de Rrëzomë, aux premiers villages du bord de mer, tandis que le pont de Jesir, liaient les plus anciens quartiers de Kalasë, Frataj et Ajdin du côté gauche de la rivière, au plus récent quartier, le quartier des Paysans, à droite de la rivière. Aujourd'hui il ne se trouve plus sur le lit de la rivière, puisqu'il est déplacé 30 m à gauche.

Le pont de Jesir de Kalasë se conserve en bon état. Il est d'une longueur de 35 m avec un seul arc en plein cintre et une ouverture de 12 m.

Le pont de Baburajt. Le premier pont de la route Delvinë-Rrëzomë se rencontre sur le torrent de Baburajt à la sortie de l'ancien village de Rusaj de Delvinë, où se trouve la mosquée de Gjin Aleks du XVIIème siècle. C'est là que commençait la route des caravanes de Rrëzomë, qui passait plus loin, le col de Katalat.

Les ponts de la route Sarandë-Delvinë. Sur la plaine de Vandajt, près de Delvinë, quelques kilomètres avant que la rivière de Kalasë se jette à celle de Bistricë, au voisinnage du croisement des routes Sarandë-Delvinë et Finiq, existent quelques restes de ponts de l'ancienne route Sarandë-Delvinë et Finiq, existent quelques restes de ponts de l'ancienne route Sarandë-Delvinë.

D'après les traces, il parait que la rivière de Kalasë a déplacé son lit. Le plus ancien a été 400 m à droite de celui d'aujourd'hui, en direction de Sarandë. Il y a eu là un pont à trois arcs en plein cintre. L'arc du milieu, étant, plus grand que les deux autres, le pont s'incline des deux côtés sur celui-ci. (fig. 15).

Presque 200 m à droite de ce pont, au voisinnage de Sarandë, se conservent les traces d'un pont, qui paraîssent appartenir au deuxième lit de la rivière. Même ici, se conservent trois arcs en plein cintre, dont le premier est endommagé.

Dans le lit actuel de la rivière, se conservent les restes d'un pont de pierre à deux arcs, tandis que tout près se trouve un petit pont à un arc, nommé le Pont de Zoto. (fig. 17).

Les ponts de Rrëzoma. Indépendemment des traditions orales qui attribuaient leur construction à Ali Pacha, ces ponts, du point de vue technique, se caractérisent de traits communs entre eux et avec les autres objets qui sont reconnus comme des constructions de la période des pachaliks albanais.

Les régions de Pogon et Zagori, de Gjirokastra, orientées de sud-est, nord-ouest, s'étendent sur la vallée formée des rivières de Sopik et Kaçarello à Pogon et celui de Zagori à la région de Zagori. Ces régions peuplées se trouvent entre les chaînes des montagnes Trebeshinë-Dhëmbel-Nëmërçkë et Shëndelli-Lunxheri-Bureto, qui les séparent de la plaine de Dropull.

Il est évident qu'étant une région de dense activitée commerciale où Ali Pacha Tepelena a exercé son pouvoir politique-économique, Zagorie et Pogon ont été au moyen de routes de caravanes à d'autres centres habités. A travers la gorge de la rivière de Suhe, entre la montagne de Lunxhëri et celle de Bureto, là où aujourd'hui passe la route carrossable qui joint Gjirokastra à Zagori-Pogon, autrefois passait la route de caravanes de commerçants qui venaient généralement du pachalik de Delvina à travers le Col de Muzinë. Cette route suivait l'intinéraire: Sarandë-Delvinë-Sofratikë-Libohovë-Labovë--Selckë-Poliçan-Sheper-Nivan-Konckë-Hoshtevë-Mbrezhdan-Këlcyrë et plus loin Buz-Berat.

Il est évident qu'à travers la gorge de Suhe ou de Selckë, passait la route qui liait Gjirokastër et Dropull avec Zagori et Pogon. Quand même, de Gjirokastra à Zagori, il y a eu une autre route qui traversait Çajup, laquelle certainement a dû être aussi la route qui liait Kardhiq avec les régions mentionnées. Cette route passait par Erind au col de Çajup-Zhej-Topovë-Nderan-Hoshtevë. Sur cette route de caravanes, au dessous du Col de Çajup, sur la route de Zhej, se trouve le siège d'un corps de garde que les habitants nomment «Tabor». Cette tour de défense, une construction caractéristique des routes de commerçants pendant ce temps-là, a une planimétrie circulaire d'un diamètre de 4 m environ, couvert d'une coupole sphérique. A Zhej se conservent les traces du pavé de la route de poste Tepelenë-Peshtan-Liman-Zhej-Topovë-Nderon-Grykë e Selcës.

Nous avons dit plus haut que Zagori et Pogon ont eu une large activité commerciale avec Janinë. De Janinë, la route passait à Sopik-Skore puis à Poliçan-Sheper-Nivan-Konckë-Hoshtevë plus loin à Këlcyrë et à Berat. Le long de la route de Janinë, à la place des «Vllah» au sud-est de Hoshtevë, il y a eu une auberge où se reposaient les caravanes, à l'endroit, aujourd'hui appelé «Rrëza e Hamit». Ce large réseau routier dans ces régions montagneuses était coupé de quelques rivières et torrents au-dessus desquels ont été construit des ponts de pierre qui se conservent en bon état même de nos jours.

Le grand pont de Kaçarello. A Pogon, la route de Sopik à Hllomo, passe sur la rivière de Kaçarello, au-dessus de laquelle s'élève le grand pont de Kaçarello, au village Hllomo. (tab. VIII). C'est un pont à deux arcs avec des voûtes, en plein cintre. Le pavé du pont est assuré des deux côtés par le parapet typique du temps d'Ali Pacha Tepelena, des colonnes de pierre hautes de 0,80 m, enfoncées dans le mur

DO NOT COPY

de la voûte du pont, à une distance bouchée de 0,50 m. (fig. 20).

Le petit pont de Kaçarello se trouve sur le torrent du Bu-çuvallë. Il est composé, lui aussi, de deux arcs en plein cintre.

Au voisinnage du village se gardent des traces d'un pavé travaillé avec un soin particulier (fig. 22). Il est large de 2,3 m avec des plaques massives de ponce d'une largeur de 0,40-0,60 m. C'est une sorte particulière de pavé, traité selon les matériaux du milieu.

La fontaine de Hllomo. Dans le village de Hllomo, à part les quelques anciennes habitations caractéristiques, se conserve une fontaine assez intéressante construite en 1941, qui fonctionne encore aujourd'hui (fig. 23). L'ancienne partie est couverte d'une coupole, tondis que la deuxième partie, construite plus tard, d'un toit en bois.

Le pont de Çiminxhi se trouve sur la rivière de Sopik (tab. IX) (fig. 24). Ce pont a fait partie de la route Gryka e Selckës - Skore - Hllomo - Çatistër. A son centre, au-dessus du lit de la rivière, se trouve le grand arc en accolade, un type rare parmi les grands arcs de nos moyen-âgeux à cause des difficultés de construction. L'arc en accolade, ou plus souvent celui en ogive, très proche de lui, dans le cas des ponts a fait usage dans les arcs au les fenêtres entre les arcs principaux, là où les ouvertures sont petites.

Le pont de Paspal se trouve à l'entrée de la région de Pogon, sur la rivière de Suhë. Le pont est composé de deux supports latéraux ainsi que de deux pieds centraux élevés sur des massifs rocheux du lit de la rivière.

Le pont de Hoshtevë. Il est construit sur la rivière de Zagori, qui prend sa source à Sheper de la montagne de Dhëmbel (tab. X). A travers Hoshtevë, autrefois passait la route qui liait Gjirokastër à Përmet, d'après cet itinéraire: Gjirokastër-Erind-Çajup-Ura e Hoshtevës-Hoshtevë-Gjurmë mushkë-Bual-Lipë-Përmet.

Des données historiques et des données orales du peuple, il résulte qu'Ali Pacha faisait des cadeaux tels: les terres, les différentes constructions etc, à tous les gens qui lui rendaient des services. Les données orales nous racontent qu'Ali Pacha, a fait cadeau à Dervish Hasani, l'un de ses braves hommes, le pont de Limar et le pavé depuis le pont jusqu'à Limar. Il est à noter que le pont de Limar, du point de vue de la technique de construction, de la forme et des éléments constituants, est pareil à ceux de Zagori-Pogon. Au centre du pont de Hoshtevë il y a un grand arc en plein cintre, avec une ouverture d'environ 15 m.

Le pont de Nivan. Une autre route qui liait Gjirokastra avec Përmet, a été celle qui passait par le pont de Nivan, avec itinéraire: Gjirokastër-Çajup-Hieja e Mallkuar-Topovë-Ura e Nderonit (Nivan)-Manastiri i Nivanit-Sheper-Qafa e Dhëmbelit-Përmet. Des traces de cette route de caravanes de commerçants se conservent au voisinnage du pont de Nivan, près du moulin. On peut y apercevoir un pavé d'une largeur de 2,8 m construit avec des pierres de montagne, placées sans ordre, qui se limite des deux côtés d'une corniche plus régulière, large de 0,35-0,40 m (fig. 30).

Le pont de Nivan sur la rivière de Zagori, lie aujourd'hui Nivan à Nderon et Topove (tab. XI). Il se trouve tout près du moulin à deux étages du village, et du monastère de Nivan, construit au XVIIIème siècle. Ce pont est composé d'un grand arc au-dessus du cours de la rivière, d'un autre plus petit sur terre, à la droite du premier, avec une fenêtre entre les deux arcs.

Les ponts des régions de Zagori-Pogon ont entre eux un grand nombre de ressemblances. Malgré les différences à cause du terrain, du lit et du débit de la rivière, de la formation géologique lit-rivage, ils ont beaucoup de ressemblances en se qui concerne leur forme. Le grand pont de Kaçarello à Hllomo, avec deux arcs de différentes dimensions est identique à celui de Nivan, lui aussi avec deux arcs. Les ponts de Hoshtevë, Çiminxh et Limar, ont la même forme, un grand arc principal avec une ou deux fenêtres des deux côtés placées très haut du lit de la rivière. Tous ces ponts sous l'aspect compositionnel sont très courbés au niveau de la clé de l'arc principal, solution typique des ponts de pierre dy Moyen-Age sous l'aspect de construction, tous les arcs principaux de ces ponts, généralement en plein cintre, sont dôtés de double voûtes avec des crampons de renforcement.

Le pavé, dans tous les cas est formé de bandes de pierres mises de travers afin de faciliter l'ascension sur le dos assez escarpé formé au niveau de la clé du grand arc du pont. Un autre élément commune de ces ponts de la construction du parapet, avec des colonnes, des blocs verticaux de pierres incastrés dans le mur du pont à une distance de 0,60-0,70 m avec des ouvertures entre les blocs verticaux, de même section, appuyés sur le pavé. Les fronts des voûtes sont exécutés avec des dalles de pierre gravée mieux que la partie intérieure de la voûte. Les parties frontales des murs de la rive ou des poutres intermédiaires sont travaillés avec des pierres de forme plus ou moins régulière qui créent des intervalles horizontaux évidents. Cette technique réalisée dans des villes lointains où la communication était difficile, bien que la conception en soit pareille à celle des murs des citadelles d'Ali Pacha diffère d'elles du point de vue de la solidité des murs (les citadelles ayant une fonction défensive). Si l'on regarde bien les murs des citadelles de Tepelena, Libohova, Vivar etc., des objets de la période du pachalik de Janine, on s'aperçoit tout de suite des jointures horizontales très régulières, résultat d'une bonne gravure des pierres dans les parois des murs.

Les ponts construits pendant le règne d'Ali Pacha Tepelena, occuppent une place importante dans toute l'activité de ce pacha albanais, dont l'activité a laissé d'importantes traces dans l'historie de l'art albanais de construction. L'étude de ces constructions d'engineering, ouvrage des maîtres albanais de la construction, est un noyau de l'histoire de la construction des objets d'engineering dans notre pays.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI - Pirro THOMO

DO NOT COPY

ARKITEKTURA PASBIZANTINE NË SHQIPËRI (BAZILIKAT)

Në tërësinë e ndërtimeve të kultit të krishterë të periudhës së pushtimit turk, bazilikat përbëjnë një grup të rëndësishëm për shtrirjen e tyre territoriale, zgjidhjen arkitektonike dhe përmasat.[1] Edhe për tipat e tjerë të kësaj arkitekture është karakteristike prirja për një zgjatje të aksit gjatësor, për një lidhje më të mirë hapsirore të vëllimeve në brendësi të ndërtesës si dhe për një trajtim të pamjes së tyre të jashtme. Por këto prirje arrijnë zhvillimin e tyre më të plotë pikërisht në kishat me ndërtim bazilikal, që me variantet e tyre të ndryshme hasen në Shqipërinë e Mesme dhe Jugore kryesisht gjatë shekujve XVII-XVIII dhe fillimit të shekullit XIX. Pjesa më e madhe e tyre shquhet për përmasat dhe arritjen arkitekturore. Këto kisha janë kryesisht katedrale qytetesh, kisha fshatrash të mëdhenj dhe në disa raste e kisha manastiresh.

Duke vështruar ndërtimin planimetriko-vëllimor të tyre dallojmë tre nëngrupe: bazilikat me kupolë, bazilikat e mbuluara me sistem qemeresh dhe kësulash sferike dhe bazilikat me tavan të rrafshtë.

1. BAZILIKAT ME KUPOLË

Ky nëngrup dallohet nga kishat me strukturë në formë kryqi me kupolë për numrin më të madh se katër të mbështetjeve të kolonave që i jep një aks të ndjeshëm gjatësor godinës dhe një ndarje të qartë në tre nefe nga të cilët qëndrori më i lartë dhe më i gjerë se anësorët. Karakteristikë e këtij nëngrupi është kupola mbi një tambur të lartë që ngrihet në nefin qendror. Zakonisht nefi qendror mbulohet me qemer cilindrik me formuese lindje perëndim. Në disa nga monumentet që ruhen, mbulesa e nefeve anësorë është me qemere cilindrikë me prerje çerek rrethi, në të tjerë me prerje gjysëm rrethi dhe që shkojnë pa ndërprerje në tërë gjatësinë e nefit duke i dhënë godinës një formë të qartë bazilikale, si në brendësi ashtu dhe në anën e jashtme, duke u ndërprerë kjo vetëm nga kupola mbi tambur. Jo në të gjitha rastet brendësia i përmbahet këtij ndërtimi të mirëfilltë bazilikal. Në disa prej tyre në nefin qendror mbi kolonat kalojnë harqe tërthor, brinjë qëndrueshmërie, ndërsa nefet anësorë mbulohen me qemere që hapen ndaj nefit qendror.

Kisha e Shën Mërisë në Vrahogoranxi të Gjirokastrës, pikturuar në vitin 1622 nga Onufër Kipriioti,[2] përbëhet nga naosi me ambientin e altarit të cilëve më vonë u është shtuar një narteks. Pjesa e vjetër e kishës ka në brendësi gjashtë kolona prej rrotullash guri të lidhura me llaç e kapitele guri. Mbi to kalojnë dy harkada, të cilat e ndajnë kishën në tre nefe. Në katër kolonat më nga lindja nëpërmjet një sistemi harqesh mbajtëse ngrihet tamburi me kupolën. Të katër kolonat janë vendosur në kulmet e një katërkëndëshi kënddrejtë. Për këtë arsye, që të formojnë bazën katrore për tamburin cilindrik janë përdorur dy harqe pranë kolonave veriore e atyre jugore, në nivelin e harqeve mbajtës perëndimor

1. Ky shkrim është vijim i dy artikujve të mëparshëm që trajtojnë kishat njënefshe dhe ato me strukturë kryqi me kupolë, të botuara në «Monumentet» 19 dhe 20 të vitit 1980. Mbishkrimet janë marrë nga **Mbishkrimet e kishave të Shqipërisë** (Dorëshkrim, Arkivi i Institutit të Historisë).
2. Dh. Dhamo, **Piktura e Onufër Qipriotit në Kishën e Vllaho - Goranxisë,** Studime Historike, Nr. 1, 1978, f. 129-142.

e lindor, në fillimet e të cilave edhe mbështeten. Krahu perëndimor i nefit qendror, më i gjeri nga të tre nefet, mbulohet me qemer cilindrik të vazhduar, po kështu edhe pjesa ndërmjet tamburit dhe absidës. Nefet anësorë, të vazhdueshëm që nga muri lindor deri tek ai perëndimor, mbulohen me qemer cilindrik me prerje çerek rrethi. Naosi ndriçohet nga tre dritare të ngushta e të larta që vijnë e zgjerohen në pjesën e brendshme duke marrë formë drejtkëndëshe. Hyrja për në naos është në murin perëndimor.

Ambienti i altarit ndahet nga naosi nëpërmjet ikonostasit të vendosur te dy kolonat më nga lindja. Nga ana lindore është edhe absida gjysëm rrethore si në brendësi ashtu edhe në anën e jashtme. Ajo ndriçohet nga një dritare e ngushtë e vendosur me një shmangje drejt jugut. Pjesa gjysëm rrethore nuk fillon në rrafshin e murit lindor por pak më brenda duke patur një shkallëzim mbuluar me hark. Ambienti i altarit ndriçohet edhe nga një dritare në anën jugore.

Narteksi është shtuar në një kohë të dytë, për këtë flasin fugat në takimin me naosin. Ai mbulohet me strukturë qemeresh si të naosit. Ai ndahet në tre pjesë nga dy harqe që shkojnë nga muri perëndimor i naosit në pilastrat në murin perëndimor të nartekstit. Nga një kolonë është vënë më vonë si përforcim nën kyçet e këtyre harqeve. Pjesët anësore të narteksit mbulohen me qemere cilindrikë me pamje çerek rrethi dhe formuese lindje perëndim. Narteksi ndriçohet nga një dritare e vogël në anën jugore, pranë së cilës ka një kamare.

Në anën e jashtme kisha ka një trajtim të thjeshtë, me mure të rrafshta me gurë gëlqerorë e shtufi lidhur me llaç gëlqereje. Ajo mbulohet me çati dyujëse me rrasa guri. Në qendër të saj dalin tamburi cilindrik dhe pjesë të vogla si frontone që i takojnë harqeve mbajtës verior dhe jugor, që përbëjnë në këtë rast bazamentin e tamburit. Tamburi është relativisht i lartë, ai ka katër dritare e katër nike që këmbehen me njëra tjetrën. Ato janë të shkallëzuara dhe mbulohen me harqe tullash. Po me tulla është dhe një shirit dhëmbësh sharre dhe korniza, elemente zbukurimi të marrë nga kisha e Labovës së Kryqit që ndodhet pranë.

Kisha e Shën Thanasit të Mazharit në Poliçan të Gjirokastrës, ka mjaft ngjashmëri me kishën e mësipërme. Kisha përbëhet nga naosi dhe ambienti i altarit. Në brendësi të kishës kemi dy pilastra dhe dy kolona. Mbi to dhe në pilastrat në muret lindorë dhe perëndimorë kalojnë harkada treshe që e ndajnë kishën në mënyrë të qartë në tre nefe dhe i japin asaj ndërtimin hapsiror të bazilikës. Nefi qendror që është dhe më i gjerë mbulohet me qemer cilindrik me formuese lindje perëndim. Nefet anësorë sot janë të mbuluar me çati me strukturë të drunjtë, ndërsa dikur mbuloheshin me qemer cilindrik me prerje çerek rrethi, gjurmët e të cilit ruhen në thembrat e qemerit në muret anësorë. Mbi kolonat dhe pilastrat ngrihet tamburi i lartë me kupolën. Tamburi ngrihet mbi harqet mbajtës dhe qemeret e nefit qendror në mënyrë të çrregullt, me trekëndsha thuajse sferikë, dëshmi kjo e një aftësie të kufizuar të ndërtuesve. Në anën e jashtme mbi çatinë dyujëse në dy nivele (më lart ajo e nefit qendror) mbuluar me rrasa guri del bazamenti katror i tamburit, muret jugor e verior të të cilit kanë në dukje harqe të verbër. Tamburi cilindrik ndriçohet me katër dritare dyshe që kanë nga një kolonë guri çmërsi të rrumbullakosur në anët e ngushta dhe një kapitel mbi të.

Ambienti i altarit ndahet sot nga naosi vetëm nëpërmjet një muri shtesë nga pilastri në murin jugor. Për këtë gjë bindemi nga gjurmët e një harku të vonë që krijonte një hapsirë sot të murosur. Në anën lindore është absida gjysëm rrethore që ka për ndriçim një dritare dyshe si të tamburit. Në anën më nga jugu kemi një pilastër në mur për absidën veriore dhe dy nike rrethore për protezisin. Edhe te ky monument kemi përdorimin e një shkallëzimi të mbuluar me hark në fillimin e absidës, të cilin e takuam dhe në kishën e Vrahogoranxisë.

Në kishë hyhet nga porta perëndimore sot e murosur dhe me një nike mbi të si dhe nga porta jugore që paraprihet nga një portik.

Kisha e manastirit të Shën Mërisë së Krimarovës në Piqeras të Sarandës, ndërtuar në vitin 1672 ngrihet në një kodër mbi fshatin. Kisha është ndërtuar në mes të manastirit duke pasur konakët nga ana veriore dhe perëndimore. Kisha përbëhet nga narteksi dykatësh në anën perëndimore, naosi dhe ambienti i altarit. Narteksi lidhet me naosin nga porta perëndimore e tij. Në katin e dytë hyhet nga një shkallë e jashtme që shërben dhe për konakët, që edhe pse pjesërisht të rrënuar shihet qartë se janë të vonë. Naosi ka gjithashtu dhe një portë në anën jugore mbuluar me arkitra të rrafshtë, në një kamare mbi të cilën lexohet data e ndërtimit të kishës. Në brendësi janë gjashtë kolona, prej rrotullash guri të lidhura me llaç dhe të suvatuara për t'u dukur një cope. Nefi qendror që është dhe më i gjerë dhe në nivel më të lartë mbulohet me qemere cilindrikë, me formuese lindje perëndim. Nefet anësorë mbulohen me qemere cilindrikë, të veçantë për çdo hapsirë ndërmjet kolonave, dhe që hapen ndaj nefit qendror. Për këtë ata ngrihen mbi harqe të vegjël të ulët që nga kolonat shkojnë në muret anësorë. Kjo veçanti takohet në

PO NOT COPY

një sërë kishash të Bregut të Detit si në Kakome e Krorëz[3] dhe Lukovë. Mbi katër kolonat më nga li-ndja ngrihet me trekëndsha sferikë dhe pas një kornize tamburi me kupolën.

Si pjesa më e madhe e kishave të manastireve monumenti është me tre absida. Nën suvanë e re dallohet që ato janë pesë faqëshe të ndërtuara si të gjitha kishat me gurë gëlqerorë në rreshta me tendencë horizontaliteti lidhur me llaç gëlqereje. Kornizat e absidës janë me rrasa guri të nxjerra pak nga muri.

Ambienti i altarit në të cilin hipet me një këmbë shkallë ndahet nga naosi me një ikonostas të drunjtë pa vlera të veçanta. Në anën lindore të tij është absida rrethore dhe në veri një nike për protezis.

Në anën e jashtme kisha shquan për trajtimin e rrafshtë të mureve që ndërpriten nga absidat dhe kornizat me tulla, sot të suvatuara. Kisha mbulohet me çati dyujëse mbi të cilën ngrihet mbi një bazament të ulët tamburi që nën suva mund të jetë dhe tetëfaqësh. Në të janë katër dritare të ngushta. Pas prerjes së tirandave për të përballuar shtytjet e qemereve, në muret verior e jugor janë vendosur përkatësisht dy dhe tre kundërforca.

Kisha e Shën e Premtes në Lukovë të Sarandës është një shembull tjetër i bazilikave me kupolë të Bregut të Detit. Kisha përbëhet nga naosi dhe ambienti i altarit. Në të hyhet nga dy dyer në anët jugore e perëndimore. Në brendësi kemi gjashtë kolona, nëpërmjet të cilave kisha ndahet në tre nefe. Mbi kolonat në drejtimin veri-jug kalojnë harqe, më të ulët ata të nefeve anësorë më të lartë të nefit qendror që shërbejnë si brinjë qëndrueshmërie për mbulesën e nefit qendror me qemer cilindrik me formuese lindje perëndim. Nefet anësorë mbulohen me qemere cilindrikë që hapen drejt nefit qendror dhe që ngrihen mbi harqet e ulët nga kolonat te muret. Mbi katër kolonat më nga lindja nëpërmjet trekëndshave sferikë ngrihet tamburi me kupolën. Në tamburin tetëfaqësh ka katër dritare të ngushta e të larta që shërbejnë për ndriçimin e naosit, krahas dritareve të tilla në murin jugor dhe atë perëndimor.

Si në mjaft nga kishat e Bregut të Detit ambienti i altarit ndahet nga naosi nëpërmjet një ikonostasi prej druri. Në anën lindore kemi absidën rrethore në brendësi dhe me nike në anën e jashtme. Si protezis dhe diakonikon shërbejnë nike të vogla të harkuara në muret verior, jugor e lindor.

Muret e kishës janë ndërtuar me gurë gëlqerorë të çrregullt e të lidhur me llaç gëlqereje. Ata janë të rrafshtë dhe përfundojnë me korniza prej pllakash guri. Kisha mbulohet me çati dyujëse me rrasa guri, mbi të cilën del tamburi mbi një bazament të çrregullt.

Duke u nisur nga gjasimet në ndërtimin planimetriko-vëllimor vendosjen e dritareve dhe teknikën e ndërtimit, në kishat e tjera të Bregut të Detit, mendojmë se kisha e Shën e Premtes në Lukovë duhet të jetë ndërtuar në fund të shekullit XVII.

Kisha e manastirit të Shën Mërisë në Nivan të Gjirokastrës është ndërtuar në vitin 1702 dhe përbëhet nga naosi, ambienti i altarit dhe narteksi. Narteksi në anën perëndimore është shtuar më vonë. Ai mbulohet me çati me strukturë të drunjtë, dhe është i ndërtuar me teknikë më të dobët. Në narteks hyhet nga porta në anën perëndimore, mbuluar me arkitra të rrafshtë, mbi të cilin në një kamare ruhen datat 1777 dhe 1889. Data e parë është ajo e ndërtimit të narteksit e dyta e ndonjë rindërtimi të mundshëm. Dy dritare të ngushta si frengji janë në të dy anët e portës, një tjetër në murin verior, ndërsa një kamare në atë jugor. Nëpër narteks me një portë në murin perëndimor të kishës kalohet në naos, në brendësi të të cilit janë gjashtë kolona të vendosura në dy rreshta që e ndajnë në tre nefe kishën.

Në drejtimin veri jug-kalojnë një sërë harqesh të ulët nga kollonat në muret anësorë, ndërsa harqe në nivel më të lartë ndërmjet kolonave. Këto të fundit shërbejnë si brinjë qëndrueshmërie për qemerin cilindrik me formuese lindje perëndim të nefit qendror. Nefet anësorë janë mbuluar me qemerë cilindrikë me formuese veri jug duke rezultuar kështu të hapura ndaj nefit qendror. Mbi katër kolonat më nga lindja ngrihet mbi trekëndësha sferikë tamburi cilindrik me kupolën sferike. Naosi ndriçohet nga katër dritare të vogla në tambur dhe dy dritare në murin verior dhe jugor.

Ambienti i altarit ndahet nga naosi nga një ikonostas i vendosur përpara kolonave lindore. Ambienti i altarit përbëhet nga bema gjysëm rrethore, protezisi e diakonikoni anash saj me një nike të vogël gjysëm rrethore. Një kamare është në murin verior, një dritare e mbyllur më vonë në absidë.

Në anën e jashtme kisha paraqitet me mure të rrafshtë dhe pa ndonjë zbukurim. Muret janë ndërtuar me gurë gëlqerorë lidhur me llaç gëlqereje dhe me një suvatim më të vonë dhe mjaft të hollë. Në suvatimin e tamburit dhe absidës rrethore ja-

3. A. Meksi, P. Thomo, **Arkitektura pasbizantine (kishat me strukturë në formë kryq me kupolë),** «Monumentet» 20, 1980 (në shtyp).

DO NOT COPY

DO NOT COPY

në formuar disa harqe të lehtë. Në ndërtimin e saj vëllimor kisha e manastirit të Nivanit afrohet me bazilikat e Bregut të Detit, ndërsa trajtimi i saj është i njëjtë me të gjitha kishat e zonës së Gjirokastrës.

Kisha e Shën Mëhillit në Mingul të Gjirokastrës përbëhet nga narteksi, naosi dhe ambienti i altarit, që i takojnë ndërtimit të parë dhe një narteks i dytë në anën perëndimore me një hajat të hapur mbi pilastra guri në anën jugore të shtuar më vonë. Kjo shtesë e dallueshme ngaqë del si vëllim i veçantë, është me mure guri lidhur me llaç gëlqereje dhe mbuluar me çati druri e rrasa guri. Ajo përbëhet nga dy ambiente nga të cilët ai veriori nuk komunikon me kishën. Në të hyhet me portën në anën perëndimore anash së cilës janë dy dritare të mëdha kuadratike. Ambienti tjetër, më i çrregullt në plan, ka një portë në anën jugperëndimore dhe shërben për hyrjen në kishë. Në naos hyhet gjithashtu edhe nga portiku jugor i hapur mbuluar me çati druri mbi pilastra. Narteksi me planimetri drejtkëndëshe ka në brendësi dy pilastra nga të cilat në muret perëndimor e lindor kalojnë harqet e harkadave që e ndajnë në tre pjesë. Harqe kalojnë gjithashtu edhe në muret verior dhe jugor për të krijuar mbështetjen për kësulat sferike të mbulimit të pjesëve anësore të narteksit, nga dy për çdo krah. Pjesa qendrore mbulohet në nivel më të lartë me qemer cilindrik me formuese lindje perëndim. Narteksi ndriçohet nga dy dritare këndrejta në anën veriore.

Në brendësi të naosit kemi gjashtë pilastra me prerje katrore mbi të cilat kalojnë harkadat që ndajnë nefet dhe harqet e ulët në muret verior dhe jugor. Për pjesën e naosit mbulimi i nefeve anësorë bëhet me kësula sferike, ndërsa nefi qendror mbulohet me qemere cilindrikë me formuese lindje perëndim. Mbi pilastrat më nga lindja ngrihet tamburi mbi trekëndsha sferikë nëpërmjet një ngushtimi me dy harqe në drejtimin lindje perëndim. Naosi ndriçohet nga dy dritare në anën jugore dhe një e madhe në anën veriore, si dhe katër dritare të ngushta dhe të vogla në tamburin e kupolës.

Ambienti i altarit ndahet nga naosi me ikonostas druri. Ai përbëhet nga bema, absida gjysëm rrethore e mbuluar me qemer, vazhdim i atij të nefit qendror, protezisi dhe diakonikoni. Protezisi mbulohet me qemer cilindrik me prerje çerek rrethi. Në të kemi dy nike rrethore, njëra nga të cilat del me absidë të vogël në murin e jashtëm. Diakonikoni mbulohet me qemer cilindrik me formuese veri jug dhe ka në murin lindor një nike dhe një kamare. Ambienti i altarit ndriçohet nga një dritare në murin jugor dhe një dritare e vogël mbi absidë.

Muret e kishës janë ndërtuar me gurë shtufi lidhur me llaç gëlqereje. Dyshemeja e kishës është shtruar me pllaka guri të bardhë. Muret e jashtme mbarojnë me një kornizë të rrafshtë. Çatia është me rrjedhje uji nga veriu dhe jugu. Në anën lindore, pjesa qëndrore ka rrjedhje uji nga lindja. Mbi çatinë e mbuluar me rrasa guri del bazamenti i kupolës, me fronton në anën veriore dhe atë jugore e mbi të tamburi cilindrik i suvatuar në një kohë të dytë.

Nga ndërtimi planimetrik e vëllimor, një hallkë e ndërmjetme me bazilikat që mbulohen me qemere e kësula sferike, nga teknika e ndërtimit kisha duhet të jetë e ndërtuar gjatë shekullit të XVIII.

Kisha e manastirit të Shën Pjetrit në Vithkuq të Korçës është qendra kompozicionale e një kompleksi ndërtimesh që formojnë manastirin e ngritur mbi një kodër në verilindje të fshatit.[4] Kisha rrethohej nga konakët e manastirit, ndërsa në lindje të saj ishte ndërtuar një faltore e vogël me dy kate, e cila shërbente dhe si varrezë. Nga dëshmitë e ruajtura dhe fotografitë përpara shkatërrimit të manastirit mësojmë se konakët ishin ndërtesa mjaft të forta, të ndërtuara me gurë dhe shquheshin për një trajtim të pasur arkitektonik e dekorativ.

Një mbishkrim mbi portën veriore, në anën e brendshme, dëshmon se kisha është e pikturuar në vitin 1764.[5] Nga ana arkitektonike kisha përfaqëson një nga shembujt më të arritur dhe të avancuar të këtij nëngrupi. Në gjendjen e sotme ajo përbëhet vetëm nga naosi, Në anën perëndimore ruhen gjurmët e narteksit. Hyrja veriore e kishës paraprihet nga një portik katror. Në këndet e katrorit ngrihen pilastrat, të cilat lidhen me harqe në të katër drejtimet dhe mbi to mbështetet një kalotë sferike.

Naosi ndahet në tre nefe gjatësorë nga dy rreshta me nga katër kolona secila. Në çiftin lindor të kolonave, me prerje katrore në ndryshim me kolonat e tjera që kanë prerje rrethore, është mbështetur ikonostasi, që ndan ambientin e altarit. Është e vetmja ndarje që e veçon këtë pjesë, sepse nga ana

4. Nga ndërtimet e manastirit ruhet vetëm kisha dhe një faltore e vogël varrezë, ndërsa konakët që e rrethonin atë janë djegur dhe shkatërruar gjatë Luftës së Dytë Botërore.
5. V. Puzanova, **Prapë mbi artin shqiptar të shekullit XVIII,** «Buletin i Universitetit Shteteror të Tiranës», Seria për Shkencat Shoqërore, 2, 1958, 152.

strukturale e mbulesës, ambienti i altarit nuk dallon nga pjesa tjetër e kishës. Në anën lindore dalin jashtë tre absida rrethore, që përfundojnë në tre nefet, nga të cilat ajo qëndroria është me përmasa më të mëdha, si në plan, ashtu dhe në lartësi. Po kështu si zakonisht nefi qendror është më i gjerë dhe më i lartë se dy nefet anësorë. Ai mbulohet me qemerë cilindrikë me formuese lindje perëndim, të cilët fitojnë një shkallëzim të lehtë në lartësi, duke filluar nga bërthamat skajore, lindore e perëndimore, në drejtim të qendrës, për të arritur në një theksim të dukshëm vertikal në pjesën qendrore, nëpërmjet kupolës së ngritur lart me anë të një tamburi.

Nefet anësorë nuk e kanë atë aks të vazhduar gjatësor, që vërehet në nefin qendror. Ata janë ndarë në bërthama katrore, të formuara nga harqe që lidhin ndërmjet tyre kolonat dhe këto të fundit me muret anësore. Katër bërthama skajore të çdo nefi janë të mbuluara me kalota sferike, ndërsa bërthamat qendrore që kanë gjerësinë dhe lartësinë e nefit qendror, mbulohen me qemerë dhe formojnë në këtë mënyrë një nef tërthor, në ndërprerjen e të cilit me nefin qendror ngrihet kupola.

Çatia e gjerë dyujëse, që mbulon të tre nefet, kryqëzohet nga çatia e nefit tërthor dhe në ndërprerjen e tyre lartësohet tamburi tetëfaqësh. Nefi tërthor del në pamjet veriore dhe jugore në formën e frontoneve trapezoidalë.

Ekzistenca e nefit tërthor, pasqyrimi i tij në ndërtimin volumor të jashtëm dhe kupola mbi tambur të lartë, bëjnë që në formulimin arkitektonik të jashtëm kjo kishë të shëmbëllejë me kishat e grupit të dytë tipologjik, ato me strukturë kryqi me kupolë.

Kisha është e ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqereje. Punimi i muraturës është i pastër, por pa përpunim dekorativ. Kisha shëmbëllen me një masë të gurtë e të rrafshtë, e mbuluar gjithashtu me rrasa guri. Të vetmet elementë që e thyejnë këtë masë të mbyllur janë dritaret e hapura në murin verior dhe lindor, meqënëse në anën jugore kisha i është afruar sëtepërmi një ngritjeje të terrenit si dhe konakëve të dikurshëm.

Por megjithatë proporcioni harmonik i brendshëm dhe i jashtëm lëvizja e volumeve në mbulesë në faqen lindore, me nxjerrjen e tre volumeve të absidave dhe thyerjen që i jep portiku në anën veriore duke shtuar dhe realizimin e mirë teknik të muraturës dhe të sistemeve të kurbuara, dëshmojnë për një nivel të lartë profesional dhe artistik të mjeshtërve, të cilët duket se zotëronin mirë njohuritë mbi ndërtime të tilla, dinin t'i organizonin mirë volumet dhe e kishin ndjenjën e hapsirës së brendshme.

Kisha e Shën Mërisë në Postenan të rrethit të Ersekës për nga ndërtimi planimetriko-vëllimor i brendësisë afrohet me kishat e nëngrupit të dytë, nga të cilët dallohet vetëm për kupolën mbi tambur të ulët që del vetëm pak mbi çatinë dyujëse me rrasa guri.

Kisha përbëhet nga narteksi, naosi dhe ambienti i altarit që janë të ndërtimit të parë, të cilave u janë shtuar një hajat i hapur në anën jugore dhe një ambient me planimetri drejtkëndëshe në anën veriore për ku është hyrja për në kishë. Narteksi në anën perëndimore është i mbuluar me çati druri. Muri perëndimor i tij shërben për të mbajtur dherat në këtë anë dhe ka vetëm dy dritare. Dy dritare të tjera janë në anën perëndimore. Për në naos kalohet nga porta në murin perëndimor që ka anash dy dritare. Me pesë këmbë shkallë zbritet në naosin e ndarë në tre nefe nga dy rreshta shtyllash mbi të cilat kalojnë harqe gjatësorë (lindje-perëndim), e tërthor (veri-jug). Këto harkada përbëjnë strukturën mbajtëse të mbulesave të nefeve. Nefi qendror mbulohet me qemer cilindrik me formuese lindje perëndim me brinjë qëndrueshmërie harqet tërthor. Në hapsirën e mezit ngrihet kupola mbi tamburin e ulët me dritare vetëm në anët jugore e veriore që dalin mbi çati. Nefet anësorë mbulohen me qemerë çerek rrethi.

Ambienti i altarit ndahet nga naosi nëpërmjet një ikonostasi prej muri me dy hyrje, njëra, më e madhja, në qendër, tjetra, afër murit verior. Bema me absidën rrethore mbulohet me qemer cilindrik vazhdim i atij të nefit qendror. Protezisi dhe diakoni me qemer si nefet anësorë. Protezisi ka një nike rrethore me një dritare të vogël dhe një kamare në murin verior. Ambienti i altarit ndriçohet dhe nga dritarja e ngushtë e absidës dhe një tjetër në murin mbi të.

Muret e kishës janë ndërtuar me gurë shtufi lidhur me llaç gëlqereje. Trajtimi i tyre është pa më të voglin zbukurim. Kisha mbulohet me çati dyujëse me rrasa guri, mbi të cilën del vetëm tamburi i ulët. Duke u nisur nga ndërtimi vëllimor dhe teknika e ndërtimit kisha duhet të jetë ndërtuar në shekullin e XVIII.

Kisha e Shën Mërisë në Leusë të Përmetit përbëhet nga narteksi dy katësh në anën perëndimore, naosi me ambientin e altarit të cilave u shtohen në një kohë të dytë një hajat i hapur mbi harkada në tërë gjatësinë e kishës në anën veriore dhe një paraklis në anën jugore.

Në narteks hyhet nga porta në anën perëndimore anash të cilës janë dy dritare. Narteksi ka dy kate të ndara nga dy harqe që mbështeten në gjashtë shtylla të vendosura në dy radhë. Në katin e dytë hipet nëpërmjet shkallëve të vendosura në qoshen jugperëndimore. Ky kat ndriçohet nga dy dritare në anën veriore. Narteksi komunikon me naosin nëpër-

Botim

mjet portës në murin perëndimor me nga dy dritare në anët e saj.

Në naos zbritet me katër këmbë shkallë. Naosi ndahet në tre nefe nëpërmjet dy harkadave të larta me nga katër shtylla e një pilastër në anën lindore secila. Harqe kalojnë gjithashtu mbi kolonat në drejtimin veri-jug, më të ulët harqet e nefeve anësorë, më i lartë ai i nefit qendror. Në këtë mënyrë krijohet struktura mbajtëse e mbulesës me qemer e kësula sferike të kishës. Nefet anësorë mbulohen me kësula sferike, ndërsa nefi qëndror me qemer cilindrik me formuese lindje perëndim që ka si brinjë qëndrueshmërie harqet e harkadave tërthore. Në hapsirën e mesit kemi kupolën me tamburin e ngushtë e të lartë. Meqënëse kjo hapsirë është drejtkëndëshe, katrori nga i cili me trekëndësha sferikë krijohet baza rrethore e tamburit, formohet me dy harqe anash harkadës gjatësore dhe një ngushtim të harkuar. Tamburi ka dymbëdhjetë dritare të ngushta. Naosi ndriçohet nga katër dritare në anën jugore dhe pesë në anën veriore. Dritaret janë të mëdha, drejtkëndëshe dhe në brendësi vinë duke u zgjeruar në anën e poshtme për të rritur ndriçimin.

Ambienti i altarit përbëhet nga bema me absidën e mbuluar me qemer cilindrik, nga protezisi dhe diakonikoni me nga dy nike në murin lindor dhe kamare në muret anësorë. Ambienti i altarit ndahet nga naosi me një ikonostas druri me vlera artistike të mëdha. Ambienti i altarit ndriçohet nga tre dritare në faqen lindore dhe një në atë veriore. Hajati i shtuar më vonë është hapur në anën veriore mbi shtylla guri dhe i suvatuar. Në anët e mureve ai ka sofate, karakteristikë e këtij lloj hajati.

Muret e kishës janë ndërtuar me gurë shtufi e llaç gëlqereje ato janë të rrafshta dhe pa ndonjë zbukurim. Çatia është dyujëse me rrasa guri dhe mbi të del tamburi. Si kohë e ndërtimit, duke u nisur nga ndërtimi i brendshëm, forma e strukturave e teknika e ndërtimit duhet të jetë fundi i shekullit XVIII.

Kisha e Shën Thanasit në Leshnicë të Poshtëme të Sarandës është ndërtuar në vitin 1797. Përbëhet nga narteksi mbuluar me çati druri dikur i hapur me harkada në të tre faqet, naosi dhe ambienti i altarit. Naosi është i ndarë në tre nefe nga gjashtë kolona të gurta mbi të cilat kalojnë dy harkada në drejtimin lindje perëndim. Harkada të tjera kalojnë nga muri verior në kolonat dhe në murin jugor. Nefi qëndror mbulohet me qemer cilindrik me formuese lindje perëndim duke patur harqet e mësipërm si brinjë qëndrueshmërie. Nefet anësorë mbulohen në dy hapsirat e para nga perëndimi me kësula sferike dhe me qemer cilindrik me formuese veri-jug në hapsirën qëndrore. Pjesa që i takon nefit qëndror mbulohet me kupolë mbi trekëndsha sferikë dhe me një tambur relativisht të lartë. Naosi ndriçohet nga katër dritare të ngushta si frengji, një dritare tjetër në anën jugore dhe dritaret e vogla të tamburit.

Ambienti i altarit ndahet nga naosi me ikonostas druri dhe përbëhet nga bema me absidën rrethore në brendësi dhe trefaqëshe në anën e jashtme. Protezisi dhe diakonikoni mbulohen me kësula sferike dhe kanë nga një nike rrethore në murin lindor dhe një kamare në muret anësorë.

Në anën e jashtme kisha ka mure të rrafshët, që përfundojnë me një kornizë prej gurësh në formë dhëmbë sharre. Muret janë ndërtuar me gurë gëlqerorë lidhur me llaç gëlqereje, me tendencë horizontaliteti të rradhëve. I vetmi zbukurim është trajtimi me nike të gjata e të ngushta mbuluar me harqe tullash i faqeve të absidës. Kisha mbulohet me çati dyujëse me rrasa guri. Mbi të del tamburi tetëfaqësh, në secilën prej të cilave ka nga një nike. Mbi to kalon një brez me tulla të vendosura pjerrtas. Në mes të këtij brezi dhe nikeve ka kryqe prej guri të gdhendur. Tamburi përfundon me kornizë prej gurësh të vendosur në formë dhëmbësh sharre.

Kisha e manastirit të Shën Kozmait në Kolkondas të Fierit ndërtuar në vitin 1814 me ndihmën e Ali Pashë Tepelenës, në ndërtimin planimetrik e vëllimor paraqitet mjaft e zhvilluar. Ajo është vendosur pranë konakëve të vona të manastirit, me të cilët lidhet me një ambient në anën perëndimore, bashkëngjitur narteksit. Aty pranë ndodhen edhe rrënojat e kishës së Shën Mërisë ndërtuar në vitin 1782.[6] Kisha përbëhet nga naosi me ambientin e altarit. Në të hyhet nga porta perëndimore dhe ajo veriore, që sot shërben si hyrje kryesore e mbrojtur nga një portik me shtylla e çati druri. Porta me shpatulla guri njëcopësh mbulohet me hark trefletësh.

Naosi treabsidësh ndahet në tre nefe nga dy harkada që mbështeten në pilastra në murin perëndimor, në katër kolona me pilastra prapa ikonostasit dhe në murin lindor. Nga kolonat dhe pilastrat kalojnë harqe të ulët në murin verior e jugor për të krijuar mbështetjen për kupolat e nefeve anësorë. Nefi qendror dhe krahët verior dhe jugor të kryqit mbulohen në nivel më të lartë me qemere cilindrikë përkatësisht me formuese lindje perëndim dhe veri jug. Në veri dhe jug krahët e kryqit që dalin

6. Material në Arkivin e Institutit të Historisë (më tej A. I. H.)

Document

dhe mbi çatinë dyujëse me tjegulla të naosit, përfundojnë me frontone, në formë transepti. Në kryqëzimin e krahëve të kryqit me ndihmën e trekëndshave sferikë ngrihet tamburi me kupolën. Në anën e jashtme, tamburi sot i suvatuar, është tetëfaqësh dhe ngrihet mbi një bazament kubik. Tamburi ka katër dritare të ngushta dhe përfundon me kornizë horizontale dy rradhësh prej guri. Naosi ka në krahët jugor e verior të kryqit dy absida gjysëm rrethore si në brendësi dhe në anën e jashtme, të cilat nuk kanë dritare. Naosi ndriçohet edhe nga tre dritare në murin verior dhe tre në atë jugor. Dritaret janë të mëdha me shpatulla dhe arkitra të rrafshët guri njëcopësh.

Ambienti i altarit ndahet nga naosi me një ikonostas prej druri. Ai përbëhet nga bema me absidën rrethore, protezisi dhe diakonikoni me nga një nike rrethore në anën lindore e një dritare në muret anësorë. Bema mbulohet me qemer cilindrik vijim i atij të naosit, ndërsa anët me kupola si të nefeve anësorë. Në anën e jashtme absida është shtatëfaqëshe me shtatë nike të shkallëzuara me kolonetа në qoshet dhe mbuluar me harqe gurësh të skuadruar. Mbi to vijojnë dy rreshta gurësh dhe korniza në formë dhëmbë sharre. Në hapsirën e mesit në vendin e zakonshëm të dritares që këtu mungon, është pllaka me mbishkrimin ndërtimor.

Kisha është ndërtuar me gurë gëlqerorë të lidhur me llaç gëlqereje. Si në gjithë ndërtimet pasbizantine të vona ka rëndësi dhe pamja e jashtme që këtu me krahët e kryqit në dukje, pjesët ndërmjet tyre nga ana lindore më të ulta, merr një ndërtim piramidal të afërt me kishat e periudhës para pushtimit turk, shembullin më të afërt nga të cilat e kemi në Pojan nga vinë materiali ndërtimor dhe mjaft fragmente antike.

BAZILIKAT E MBULUARA ME SISTEM QEMERESH E KËSULASH SFERIKE

Në monumentet e këtij nëngrupi janë realizuar arritjet më të larta arkitektonike e konstruktive të arkitekturës sonë pasbizantine krijime pikërisht të kësaj periudhe. Dallimi i pjesëve ose i bërthamave të veçanta në hapsirën e brendshme të naosit, vihen re edhe në ndërtimet e grupit të parë. Por në monumentet e këtij nëngrupi këto orvatje kthehen në koncept kompozicional, duke na dhënë një larmi zgjidhjesh strukturale dhe figurative. Në dallim me nëngrupin e parë kompozimi dinamik i brendësisë nuk shfaqet në pamjet e jashtme, por mbetet i fshehur nën mbulesën e gjerë dyujëse. Monumentet e këtij nëngrupi dallohen gjithashtu nga përmasat e mëdha dhe nga përkujdesja për trajtimin arkitektonik e dekorativ të pamjeve të jashtme. Monumente të tilla u ndërtuan kryesisht gjatë shekullit XVIII në zonën e Korçës, por nuk mungojnë ndërtime me interes edhe në Berat dhe në fshatrat e Gjirokastrës.

Kisha e Shën Mëhillit në Vithkuq është ndërtuar në vitin 1682[7] pra ndërtimi më i vjetër që njohim deri më sot nga kishat e këtij nëngrupi. Në këtë kishë fillojnë e forcohen prirjet për diferencime pjesësh, për një konceptim më të larmishëm hapsiror dhe për theksime qendrore jo më nëpërmjet një kupole mbi tambur por të izoluar, si te kishat e nëngrupit të parë, por nëpërmjet një kompleksi më të lidhur hapsiror.

Kisha përbëhet nga naosi, narteksi, që i bashkëngjitet në anën perëndimore dhe hajati që shtjellohet gjatë gjithë gjatësisë së kishës në anën jugore. Dy rreshta me nga katër kolona dhe një pilastër secila e ndajnë naosin në tre nefe gjatësorë, nga të cilët nefi qendror është më i gjerë dhe i lartë nga nefet anësorë. Kolonat lidhen ndërmjet tyre dhe me muret perimetralë me harqe në të dy drejtimet. Por ndërsa në nefet anësorë krijohen bërthama të vogla, të mbuluara me kësula sferike, në nefin qendror ato dalin si brinjë qëndrueshmërie të qemerit gjatësor që mbulon gjithë hapësirën. Në këtë bazilikë fuqizohet nefi tërthor, me mbulesë që hapet ndaj nefit qendror. Hapësira e madhe e këtij nefi e ka thyer ritmin e shpeshtë të kolonave, duke krijuar në pjesën qëndrore të naosit një ambient hapësinor, i cili fiton një theksim vertikal të dukshëm nëpërmjet mbulimit me kupolë, të ngritur në kryqëzimin e nefit qendror me atë tërthor. Megjithatë kjo strukturë e larmishme është e fshehur nga çatia e gjerë dyujëse.

Në anën lindore del jashtë absida, e cila është trajtuar me një varg pilastrash, të lidhura me harqe të shkallëzuar, në formë fund lundre dhe që përfundon me një kornizë guri të gdhendur. Motivi i harkut fund lundre i thelluar në krahasim me rrafshin e muraturës takohet dhe në dritaret e hapura në faqen lindore, në absidë dhe në faqet e plota.

Narteksi i është shtuar në një kohë më të vonë kishës. Ai ruan një rresht me kolona guri të lidhura me harqe në drejtimin gjatësor, ndërsa rreshti i dytë ka shtylla druri. Mbulesa është me çati druri pa tavan.

7. Material në A. I. H.

DOKTORATA.AL

Hajati në anën jugore hapet në një harkadë mbi kolona të holla guri në pjesën e përparme.[8] Mbulesa e hajatit ishte me konstruksion druri, pa tavan, si vazhdim i flegrës së çatisë së kishës.

Materiali i përdorur gjerësisht në ndërtimin e kishës, është guri çmërs, mjaft i lehtë e i punueshëm, që gjendet me shumicë në vend. Ky gur është përdorur jo vetëm për mbulesat por edhe për muraturën.

Prirjet për krijimin e një ambienti sa më hapsinor dhe të lidhur që shfaqen në kishën e Shën Mëhillit të Vithkuqit shihen më tej dhe arrijnë të kristalizohen dhe të përsosen si koncept kompozicional në kishat e Vithkuqit, të gjysmës së parë të shekullit XVIII. Është kjo periudha e lulëzimit më të madh ekonomik e kulturor të qytetit të Voskopojës.[9] Gjatë kësaj periudhe Voskopoja merr një zgjerim të madh, me një strukturë të përparuar urbanistike dhe me ndërtime të shumta, më të rëndësishmet e të cilave janë «Akademia e Re», shtypshkronja, një numër i madh ndërtimesh kulti, etj.[10] Aktiviteti i madh ndërtimor dhe mundësitë materiale të këtij qyteti dëshmohen dhe nga ndërtimi brenda një kohe të shkurtër, katër vjeçare, e tri bazilikave me përmasa të konsiderueshme dhe me një nivel arkitektonik e konstruktiv të lartë.[11] Nga këto ndërtime kanë arritur deri në ditët tona pesë bazilika të mëdha.

Kisha e Shën Mërisë në Voskopojë ka qënë kisha katedrale e qytetit, e ndërtuar në lagjen Sharxa (më vonë e emëruar lagja e Shën Mërisë) në vitin 1712, sipas një mbishkrimi të ndodhur mbi portën perëndimore të kishës.[12] Është kjo data më e hershme e ndërtimeve të tilla bazilikale në qytetin e Voskopojës, i cili në vitet e mëvonëshme u pasurua dhe me ndërtime të tjera të këtij tipi.

Siç shihet nga një fotografi e marrë para djegies së Voskopojës në vitin 1916,[13] si dhe nga gjurmët e rrënojave, këtu kemi pasur të bëjmë me një kompleks ndërtimesh. Në oborr, ngjitur me këmbanaren duhet të ketë qënë selia e mitropolisë dhe ngjitur me të, në anën lindore, një kishë tjetër. Në pjesën perëndimore të kishës së sotme shtjellohej narteksi, që formonte me kishën një planimetri në formën e gërmës L. Ky duhet të ishte një ndërtim dykatësh. Në, pamjen lindore kati përdhe ishte trajtuar me një harkadë ndërsa kati i dytë me dritare. Në gjendjen e sotme nga ky kompleks ka mbetur vetëm kisha dhe një ndërtim i vogël që i bashkëngjitet asaj në pjesën veriore.[14] Ky ndërtim përmban kriptën e mbuluar me sistem të kurbuar.

Edhe vetë kisha nuk ruhet e plotë. Në pjesën e jugut të saj duken gjurmët e qemerëve që mbulonin hajatin, të cilët u prishën gjatë Luftës së dytë botërore, ndërsa arkada ballore u rrëzua përfundimisht nga tërmeti i vitit 1960. Nga fotografitë e vjetra, gjurmët e mbetura si dhe analogjia me kishat e tjera po të këtij tipi nuk është i vështirë rikonstruktimi i hajatit. Mbi një parapet prej muri guri ngriheshin gjashtë kolona të holla guri me prerje rrethore, që përfundonin me kapitele piramidale. Kolonat lidheshin ndërmjet tyre, me pilastrat në skajet lindore e perëndimore, si dhe me murin jugor të kishës, me harqe në të dy drejtimet, duke krijuar në këtë mënyrë shtatë bërthama të cilat duhet të kenë qënë mbuluar me kalota sferike ose sisteme të tjera të kurbëzuara si qemere të kryqëzuar. I gjithë ky sistem mbulohej nga zgjatimi i flegrës së çatisë së kishës.

Megjithëse ndërtimi i jashtëm krijon përshtypje për një ndërtim solid dhe madhështor, ai nuk mund të zbulojë madhështinë që hapet përpara vizitorit kur ndodhet brenda naosit. Niveli i dyshemesë së kishës është mjaft më i ulët se ai i jashtmi për të rritur në mënyrë të ndjeshme lartësinë e kishës. Naosi është një ndërtim bazilikal me tre nefe të ndara me dy rreshta kalotash, me nga pesë kolona dhe një pilastër secila. Por kolonat që kufizojnë akset e nefeve dhe mbajnë sistemin e mbulesave, me përmasat, proporcionimin dhe vendosjen e tyre nuk e copëtojnë hapësirën e brendshme.

8. Gjatë tërmetit të vitit 1960, krahu lindor i harkadës u rrëzua dhe u ringrit nga Ateljeja e Monumenteve të Korçës.
9. S. Adhami, **Të dhëna rreth fizionomisë urbanistike dhe arkitektonike të qytetit mesjetar të Voskopojës,** «Monumentet» 3, 1972, 101.
10. Po aty, 103, 109.
11. S. Adhami, **Tri bazilika të ndërtuara në Voskopojë brenda katër vjetëve,** «Monumentet» 14, 1977, 146.
12. V. Puzanova, **Shënime mbi artin shqiptar në shekullin e XVIII,** «Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës», 1, 1975, 50, S. Adhami, **Katedralja «Fjetja e Shën Mërisë» në Voskopojë,** «Monumentet» 15-16, 1978, 89-95. Autori mendon se ndërtimi i kishës duhet të jetë kryer më parë, ndërsa viti 1712 duhet të jetë data e përfundimit të pikturës, 97-98.
13. Po aty, 92, fig. 9.
14. Duhet të jetë ndërtuar më vonë dhe është kishëza e Shën Marenës. Haterial në A. I. H., S. Adhami, **vep. cit.,** 91.

Botoret.org

Ato janë të grupuara për të diferencuar pjesët e ndryshme të naosit. Kështu çifti lindor i pilastrave, ku mbështetet ikonostasi ndan nga naosi ambientin e altarit. Ky është mbuluar me qemer cilindrik në nefin e mesit dhe me dy kalota në anësorët. Në pjesën lindore del jashtë një absidë e gjerë dhe e lartë. Kolonat e tjera janë grupuar katër e nga katër, duke krijuar në këtë mënyrë dy bërthama hapsinore të mbuluara me kalota sferike në pjesën qendrore, të mbështetura mbi sistemet e kurbëzuara që mbulojnë krahët e këtyre bërthamave. Në këtë mënyrë përshtypja e akseve gjatësorë bazilikalë humbet në sistemin e mbulesës dhe krijohet ideja e ndërprerjes së dy bërthamave në formë kryqi me kupolë. Ambientet këndore mbulohen me kalota sferike ose qemerë të kryqëzuar. Në këtë mënyrë krijohet ndjenja e një hapësire unike nëpërmjet krijimit të dy theksimeve qëndrore në nefin qendror në lartësi, përmasa dhe trajtim të njëjtë, hapësira e të cilave përhapet dhe në nefet anësorë, nëpërmjet formimit të dy neteve tërthore. Kisha ndriçohet relativisht bollshëm nga dritaret e hapura në muret verior dhe jugor. Ajo komunikonte gjithashtu me narteksin në anën perëndimore, me ane të portës e dy çifte dritaresh të mëdha të harkuara dhe të ndara me një kolonë të vogël. Dyshemeja e narteksit ka qënë më e lartë nga ajo e kishës. Sipas gjurmëve të ruajtura narteksi duhet të ketë qënë i mbuluar me një sistem të kurbëzuar, tre nefësh, nga të cilët nefi qendror ka qënë më i lartë.

Ndërtimi i kishës është mjaft solid, muratura është realizuar me gurë të skuadruar e të lidhur me llaç gëlqereje. Të bie në sy faqja lindore, e cila dëshmon më mirë për përkujdesjen në trajtimin e jashtëm. Absida është përpunuar me një varg nikesh të rrafshta e të ngushta që mbyllen në pjesën e sipërme me harqe. Kjo arkadë e rrafshtë vazhdon edhe në faqet e rrafshta të murit lindor. Sipër saj në absidë kalon një friz dekorativ me tulla të vendosura në formë kurriz peshku dhe mbi të një i dytë në formë dhëmbë sharre. Trajtimin arkitektonik dhe dekorativ do ta plotësonte më mirë prania e hajatit i cili siç do ta shohim në shembujt e tjerë, ka tërhequr vëmendjen e mjeshtërve.

Sot kisha është e rrethuar me një mur të ulët, i cili ndërpritet në anën jugore nga porta e hyrjes. Hyrja për në oborr dikur për në kompleks, është trajtuar në mënyrë monumentale, me qemerë e harqe që mbajnë njëkohësisht këmbanaren elegante e te lartë katërkatëshe që ngrihet mbi të, u ndërtua në vitin 1887.[15]

Në mënyrë mjaft të ngjashme me katedralen «Fjetja e Shën Mërisë» janë ndërtuar edhe tri bazilikat e tjera të mëdha të Voskopojës. Ngjashmëria duket si në trajtimin hapësinor të brendësisë, në sistemet konstruktive, teknikën e ndërtimit, në përpunimin dekorativ, ashtu dhe në përmasat. Kështu që më poshtë do të theksojmë vetëm ndonjë veçanti të kishave të tjera.

Kisha e Shën Kollit është ndërtuar për 17 muaj, nga qershori i vitit 1721 deri në shtator të vitit 1722. Është përfunduar së pikturuari nga kryemjeshtëri i shekullit të XVIII David Selenica, i ndihmuar nga nxënësit e tij Kostandini dhe Kristua në tetor të vitit 1726.[16] Kisha e Shën Kollit të Voskopojës është një nga monumentet më të rëndësishëm të vendit tonë, jo vetëm si realizim arkitektonik por edhe nga niveli i pikturës që vesh gjithë brendësinë e kishës dhe të hajatit, por këto të fundit të punuara nga mjeshtra të tjerë të njohur të shekullit XVIII, vëllezërit korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi, në gusht të vitit 1750.[17]

Kisha ruhet e plotë, me naosin, narteksin në anën perëndimore dhe hajatin në anën jugore. Në qoshen juglindore lartësohet këmbanarja katërkatëshe, e cila sipas mbishkrimit është ndërtuar në vitin 1936. Është monumenti më i plotë që ruhet nga katër bazilikat e tjera të Voskopojës, por edhe kjo e cunguar përsa i përket ndërtimeve të tjera të kompleksit. Ashtu si dhe kishat e tjera, kisha e Shën Kollit ishte pjesë e një kompleksi ndërtimor, ku përfshiheshin përveç saj një konak dhe kishëza e Shën Thimiut.[18]

Hajati është trajtuar me një sërë kolonash prej guri me ball të ngritura mbi një parapet ose xokol të ulët të ndërtuar me gurë. Lartësia e kolonave është e vogël, me prerje rrethore dhe përfundon me kapitele guri të thjeshtë e të ulët, në formë trungu piramide. Kolonat lidhen me harqe ndërmjet tyre, duke krijuar një harkadë gjatësore, ndërsa në drejtimin tërthor lidhen me murin jugor të kishës dhe formojnë shtatë bërthama katrore, gjashtë nga të cilat mbuloheshin me kalota sferike dhe njëra nga to, ajo e skajit perëndimor, me qemer të kry-

15. S. Adhami, **vep. cit.,** 92, Tiranë 1961, 63.
16. V. Puzanova, **vep. cit.** 46, 50.
17. Material në A. I. H.
18. S. Adhami, **Tri bazilika...,** 149.

DO NOT COPY

qëzuar.[19] Nga portiku ose hajati zbritet me disa këmbë shkallë në naos dhe vetëm atëhere ndjehet madhështia e hapësirës së brendshme.

Ndërtimi i brendshëm i kishës është i njëjtë me atë të Shën Mërisë. Edhe këtu qëndron i njëjti koncept kompozicional, d.m.th. grupimi i kolonave për të krijuar dy bërthama hapësinore të mbuluara në pjesën qëndrore me kupolë.[20] Ndjenjën e hapësirës së brendshme të rrjedhshme, e fuqizon akoma më tepër aplikimi i sistemeve konstruktive, ku mbizotërojnë linjat e kurbëta, e bëjnë më të rrjedhshme kalimet nga planet vertikalë në mbulesë.

Në anën perëndimore kishës i bashkëngjitet narteksi, me planimetri në formë trapezi që del tej konturit të kishës. Një rresht kolonash me aks veri-jug e ndan narteksin në dy nefe gjatësorë. Megjithatë ai mbulohet me një sistem paralele qemeresh cilindrikë, me formuese lindje perëndim. Qemerët mbështeten në harqet që lidhin kolonat me muret anësorë lindorë e perëndimorë të narteksit, ndërsa harkada që lidh kolonat ndërmjet tyre shërben si brinjë qëndrueshmërie e këtyre qemerëve. Narteksi lidhet me naosin nëpërmjet një porte dhe dritareve të hapura në murin perëndimor. Në anën jugore duken shenjat e një ndërtimi që i bashkëngjitej narteksit në këtë krah.

Në trajtimin e jashtëm ndjehet preokupacioni për një përpunim dekorativ, gjë që kompenson kompozimin e thjeshtë volumor, që e fsheh strukturën e brendshme të larmishme. Muratura është e zhveshur por dallohet për një zbatim mjeshtëror e të pastër, me gurë të skuadruar e të lidhur me llaç gëlqereje. Përpunimi dekorativ mjeshtrat janë përpjekur ta bëjnë nëpërmjet futjes dhe kombinimit, të tullës me gurë dhe nëpërmjet krijimit të frizave dekorativë me tulla. Kështu absida e dalë në anën lindore është gjallëruar me harkadën e rrafshtë dhe mbi të frizi me tulla të vendosura në formë kurriz peshku. Harqet janë të ndërtuar me gurë të alternuar me dy tulla dhe të qarkuar me një rradhë tullash. Një ndërtim të tillë kanë dhe harqet e harkadës së portikut. Fasada e portikut përveç frizës së vazhduar me tulla të vendosura në formë kurriz peshku përmban ornamente të tjerë si rrathë, kryqe korniza në formë dhëmbësh sharre, mbishkrime brënda motiveve, etj. I gjithë ky dekor është realizuar me gurë çmërsi dhe tulla të holla.

Në këtë ndërtim të bie në sy jo vetëm niveli i lartë arkitektonik në organizimin dhe proporcionimin e hapësirës së brendshme, por edhe aftësia ndërtimore e mjeshtërve. Kjo shfaqet në njohjen e mirë dhe në zbatimin e shkathët të strukturave të kurbëzuara, në punimin e muraturës, zbukurimet. Strukturat e kurbëzuara në kishat e këtij tipi në Voskopojë, nuk janë të ngarkuara me mbushje. Mbi to mbështetet struktura prej druri e çatisë, e mbuluar me pllloça guri. Një ndërtim i tillë krijonte kushte të mira termoizoluese dhe ajrosjeje. Në strukturat e mbulesës janë vendosur dhe qypa qeramike, me grykën e ngushtë (∅ 3-4 cm) të kthyer në drejtim të brendësisë, të cilat kanë shërbyer për efekte akustike, por nuk përjashtohet mundësia dhe e ajrosjes dhe e shkëmbimit të temperaturës, gjë që është një masë për eliminimin e lagështisë së kondensimit. Largimi i ujërave të nëntokës ka qënë një tjetër problem që është zgjidhur me sukses. Nën dyshemenë e kishës kalon një rrjet ka-

19. Në artikullin: **«Tri bazilika të ndërtuara në Voskopojë»,** 148, 156, 160, autori mendon se portikët në këto kisha do të jenë shtuar më vonë për arsye të shkëputjes së muraturës së tyre nga ato të kishës, dhe të lidhjes së dobët me to. Për mendimin tonë këto kisha që në fillim janë konceptuar me portik, gjurmët e harqeve në muraturën jugore të kishës dëshmojnë më së miri për këtë.

Por duke qënë i ndërtuar me konstruksione e peshë të ndryshme nga ato të kishës konstruktivisht ishte e domosdoshme lënia e një fuge ose lidhjeje jo solide me muraturën e kishës, e cila do të loste rolin e fugës së cedimit dhe diletacionit.

Gjatë tërmetit të vitit 1960 portiku u dëmtua mjaft duke u çarë në harqet tërthorë dhe shkëputur nga volumi i kishës. Për këtë u morrën masa restaurimi në vitin 1962, gjatë të cilave u afrua i gjithë portiku me kishën, u konsoliduan harqet dhe kalotat dhe u fiksuan ato me tiranta metalike në drejtimin tërthor. Ekspedita e restaurimit u drejtua nga B. Strazimiri, me pjesëmarrjen edhe të autorëve të këtij artikulli (shih raportin e ekspeditës, Ark. Inst. Mon.). Në vitin 1980 Ateljeja e Korçës, kreu punime të tjera restauruese në këtë monument, që konsistonin në rigjallërimin dhe plotësimin e dekoracionit të portikut.

20. S. Adhami, **Tri bazilika...** (vep. cit.) fq. 147, gabimisht shprehet se ndërtesa është **«...me dy kupola mbi tambur».** Në fakt kalotat sferike ose kupalat ngrihen mbi harqet dhe qemerët që i mbajnë, pa ndërmjetësinë e tambureve. Ky gabim është bërë edhe për kisha të tjera, Shën Mëhillin, f. 155, dhe Shën Thanasin, fq. 160.

DO NOT COPY

nalesh drenazhimi, të paisura në pika të ndryshme dhe në kënde me puseta kontrolli. Një sistem i tillë drenazhimi është ndërtuar edhe jashtë kishës, në drejtimin verior. Si puse kontrolli janë përdorur qypa të mëdhenj qeramike, të hapur nga sipër dhe me vrimat e hyrjes e të daljes së tubave në nivele të ndryshme. Kanalet e drenazhimit janë ndërtuar dhe mbuluar me pllloça guri.

Kisha e Shën Mëhillit. Kronologjikisht është bazilika e tretë e këtij tipi, e ndërtuar në Voskopojë në vitin 1722. Edhe nga ky kompleks ndërtimesh, ku bënin pjesë dhe faltoret e Shën Spiridhomit dhe të Shën Vernerës[21] ka mbetur vetëm kisha e Shën Mëhillit edhe kjo e dëmtuar, jo e plotë. Kisha përbëhej nga naosi, narteksi në anën perëndimore, hajati në anën jugore dhe një ndërtim që i bashkëngjitej kishës në anën veriore. Nga hajati i dikurshëm jugor ka mbetur bërthama më lindore, parapeti ose xokoli ku mbështeteshin kolonat e ballit dhe gjysmës së harqeve në murin jugor të kishës. Por nga disa fotografi të vjetra fitohet një përfytyrim i plotë mbi formulimin arkitektonik të jashtëm.[22] Ashtu si kisha e Shën Kollit edhe kjo kishë kishte hajatin me tetë kolona në ballë, ndërmjet dy daljeve të mureve të ngushtë lindorë e perëndimorë, ato lidheshin me një harkadë me nëntë harqe në drejtimin gjatësor. Nga pjesa e ruajtur në skajin lindor të hajatit dëshmohet prania e bërthamave të mbuluara me kësula sferike ose qemerë të kryqëzuar.

Ndërtimi i brendshëm i naosit është i njëjtë si koncept me atë të kishave të mësipërme. Por në ndryshim me kompozimin e lirshëm e të rrjedhshëm dhe larminë e sistemeve të kurbëzuara të Shën Kollit këtu kemi një kompozim më rigoroz. Nefi qendror mbulohet me qemer cilindrik i cili ndërpritet me dy nefet tërthorë për të krijuar dy theksimet qendrore të mbuluara me kupola. Bërthamat katrore, të formuara me katër harqe në të dy drejtimet, që krijohen vetëm në nefet anësorë, janë të mbuluara me kësula sferike.

Një ndërtim me interes paraqet dhe narteksi në anën perëndimore. Kolonat dhe pilastrat e vendosura në brendësi të tij lidhen ndërmjet tyre dhe me muret anësorë me harqe në dy drejtimet duke krijuar dymbëdhjetë bërthama të vogla të mbuluara me kësula sferike, qemerë cilindrikë, qemerë të kryqëzuar dhe qemerë me prerje çerek rrethi.

Në naosin verior duken gjurmët e një ndërtimi që i bashkëngjitej kishës nga kjo anë, i cili lidhet me narteksin. Por nga gjurmët e ruajtura nuk mund të kuptohet në ka qënë ndërtim i hapur (portik) apo i mbyllur. Sidoqoftë lartësia e tij ishte më e vogël nga ajo e kishës dhe mbi çatinë e tij janë hapur dritaret nga merr dritë kisha në anën veriore. Ky fakt na bën të mendojmë se duhet të ketë qënë ndërtim i mbyllur në ndryshim me anën jugore, ku dritaret e kishës hapen në hajatin e saj, pra jo ashtu siç mendon S. Adhami,[23] për prezencën e një hajati të dytë nga kjo anë.

Një veçanti në sistemin konstruktiv të kësaj kishe është dhe kalimi nga bërthamat katrore në kësulat sferike. Ky kalim nuk bëhet me trekëndsha sferikë por në këndet e katrorit kupola mbështetet në kolona të vogla ose pilastra prej guri. Në dekorimin e absidës ruhet koncepti i gjallërimit të saj me harkadën e rrafshtë, por kjo harkadë nuk vazhdon edhe te muri lindor i kishës. Gjithashtu frizi me tulla sipër harkadës mungon. Megjithatë absida është punuar më me elegancë, niket janë më të hedhura në lartësi, të ndara me pilastra të holla e të profiluara. Harqet kurorëzohen me një rresht tullash të holla dhe mbi to kalon korniza e punuar me gurë të skalitur. Kisha merr dritë nga dritaret e hapura në murin verior, lindor, nga të cilat tre dritare mbi absidë janë rrethore dhe nga ato të hapura në hajatin e kishës. Në murin jugor mbi gjurmët e harqeve, vërehen gjashtë dritare të murosura. Dritaret kanë formë katërkëndëshi këndrejtë, me arkitra të rrafshtë prej guri, por mbi to janë ndërtuar harqe shkarkues.

Kisha e Shën Thanasit, është bazilika e katërt e ndërtuar në Voskopojë sipas të njëjtit tip, në vitin 1724 dhe është pikturuar nga vëllezërit korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi, në vitin 1745. Nga ndërtimi i dikurshëm është rrëzuar narteksi në anën perëndimore, si dhe një faltore e vogël e Shën Triadhës.[24] Kështu që edhe ky monument e kompleks nuk ruhet i plotë.

Nga ana tipologjike kjo kishë nuk ndryshon nga bazilikat e tjera të Voskopojës. Ka po të njëjtin kompozim planimetrik e volumor sistem konstruktiv dhe formulim të jashtëm. Megjithatë mbetet më prapa të tjerave përsa i përket proporcionimit dhe përmasave. Nefi qendror këtu është më i ngushtë, lartësia më e vogël dhe nuk ka arritur të japë atë

21. V. Puzanova, **Shënime mbi...,** 50. S. Adhami, **vep. cit,** 157.
22. **Po aty,** 156, fig. 19, 20, 21.
23. **Po aty,** 155.
24. V. Puzanova, **Shënime mbi...,** 50; S. Adhami, **vep. cit.** 161.

Do not copy

DO NOT COPY

përshtypje madhështie të hapësirës së brendshme si te kishat e tjera.

Edhe në pamjen e jashtme portiku është më i vogël me gjashtë hapësira i ngritur mbi një xokol të ulët. Kolonat i ka monolite, me prerje tetëkëndore që përfundojnë me kapitele të lartë në formë trungu piramide me qoshe të prera. Portiku është i mbingarkuar me dekoracion të ndërtuar me tulla. Gurët e çmërsit, me të cilat është ndërtuar portiku, janë të inkuadruara me tulla dhe ndërmjet tyre ornamente të ndryshme, rrathë, kryqe, motive bimore që shëmbëllejnë pishën, friza në formë kurriz peshku, etj. Në hajat gjithashtu janë lënë dhe emrat e mjeshtërve[25] të shkruar me copa tullash e tjegullash. Po kështu absida nga ana e poshtme është dekoruar me nike të rrafshta e të shkallëzuara të cilat vazhdojnë edhe në muret lindorë. Tek-tuk në gurët e absidës dhe murit lindor janë gdhendur mjaft rrafshtë figura shpendësh e kafshësh.

Në anën perëndimore ngrihej dikur narteksi, me dysheme më të lartë se ajo e kishës. Nga gjurmët e harqeve në murin perëndimor të kishës dëshmohet se edhe ky narteks, si te kishat e tjera ka qënë i mbuluar me një sistem harqesh e qemeresh.

Kisha e Shën Gjergjit - Shipskë. Në afërsi të Voskopojës në veri të saj ngrihet fshati i Shipskës, i cili gjatë shekullit XVII-XVIII ishte një qendër e rëndësishme krahas Voskopojës dhe Vithkuqit. Për këtë dëshmon dhe kisha e saj, e ngritur mbi një breg në të hyrë të fshatit dhe e rrethuar nga varrezat e fshatit.

Kisha është ndërtuar sipas të njëjtëve principeve kompozicionalë me ata të bazilikave të Voskopojës, por megjithatë nuk ka mundur të arrijë atë nivel të lartë arkitektonik të tyre, si në përmasa, në zgjidhjen hapësinore të brendshme, në trajtimin arkitektonik të jashtëm, në nivelin e realizimit teknik e konstruktiv.

Tre pjesët kryesore përbërëse, naosi, narteksi dhe hajati janë vendosur gjatë një aksi gjatësor lindje perëndim. Naosi është një ndërtim bazilikal, i ndarë në tre nefe nga dy rreshta me nga tre kolona e një pilastër secili. Kolonat dhe pilastrat kanë formuar dy bërthama hapësinore, të mbuluara me kupolë në pjesën qëndrore. Kupolat mbështeten mbi qemeret cilindrikë në nefin qëndror dhe mbi qemerët e kombinuar të nefeve anësorë, që hapen ndaj atij qëndrorit, duke krijuar kështu dy nefe tërthorë. Pjesët këndore të bërthamave qëndrore në nefet anësorë janë të mbuluara me kësula sferike. Në pjesën lindore dalin tre absida që përfundojnë nefet, nga të cilat ajo qëndrorja është më e gjerë dhe e lartë.

Në ndryshim nga kishat e Voskopojës në organizimin hapësinor të brendshëm, këtu mungon një ambient suplementar altari. Ai krijohet nga një krah i një bërthame. Në këtë mënyrë theksimi i parë vertikal i nefit qëndror vjen menjëherë mbas ikonostasit, që ndan naosin nga ambienti i altarit, pa shkallëzimin karakteristik të bazilikave të Voskopojës.

Naosi paraprihet nga narteksi dhe lidhet me të nëpërmjet një porte. Narteksi ka një ndërtim tipik bazilikal, i ndarë në tre nefe, nëpërmjet dy rreshta kolonash, me nga dy kolona secili. Nefet mbulohen me qemere cilindrikë me formuese lindje perëndim, të cilat mbështeten mbi harqet lidhës të kolonave qëndrori, dhe mbi to e në muret verior e jugor dy anësorët.

Në gjithë pamjen perëndimore shtjellohet hajati i hapur me një rradhë kolonash guri në ballë. Kolonat janë punuar trashë, të ulta me bazamente dhe kapitele guri ku mbështeten trarët e çatisë. Hajati është pa tavan. Në plan del tej gjerësisë së kishës. Në murin jugor janë hapur nike për shërbesën fetare, ndërsa në qoshen jugore të saj lartësohet një këmbanare e lartë. Në anën jugore të kishës i është bashkëngjitur një ndërtim i më vonë i cili ka shërbyer si faltore e dytë. Ajo ka planimetri katërkëndëshe këndrejtë, është paisur me tavan dërrase dhe paraprihet, në anën perëndimore nga një ambient, në rolin e narteksit për këtë faltore.

Trajtimi arkitektonik dhe dekorativ i jashtëm është i varfër. Proporcionet janë të ulta dhe të rënda, ku mbizotëron masa e madhe shtypëse e çatisë së gjerë të mbuluar me plloça guri. Muratura e ndërtuar me gurë nuk shquhet për teknikë të lartë. Elemente që thyejnë volumin e plotë e të mbyllur të kishës janë tre absidat që dalin në pamjen lindore dhe këmbanarja e thjeshtë në qoshen jugperëndimore.

Ky realizim jo i lartë konstruktiv e teknik ka bërë që kisha të pësojë dëmtime të ndjeshme, sidomos nga tërmeti i vitit 1960, që ka sjellë çarje të muraturës, të harqeve e qemereve. Për përforcimin e kishës janë marrë masa duke ndërtuar kontraforte, kryesisht për të ndihmuar muraturën në thithjen e shtytjeve të sistemeve të kurbëzuar.

Kisha e Shën Gjergjit në Nakovë të Gjirokastrës ndërtuar në vitin 1772 përbën një rast të veçantë për mbulimin me qemere vetëm të nefit qendror. Kisha përbëhet prej narteksit në anën perëndimore, naosit me ambientin e altarit dhe një

25. Po aty, 159.

hajat me çati druri mbi shtylla druri në anën veriore në tërë gjatësinë e kishës. Në kishë hyhet nëpër derën e naosit në anën veriore. Përballë saj, në portik është ndërtuar vonë një këmbanare. Narteksi ka një shtyllë në mes dhe mbulohet me çati e tavan druri. Narteksi lidhet me naosin me një derë në murin në mes të tyre që ka dhe dy dritare anash, dhe ndriçohet nga dritarja jugore. Naosi ndahet me tre nefe nëpërmjet dy arkadave me dy shtylla e tre harqe secila. Nefi qendror i formuar në këtë mënyrë mbulohet me qemer cilindrik me formuese lindje perëndim. Nefet anësorë ndryshe nga gjithë kishat e tipit mbulohen me tavan të rrafshtë dërrase. Nga një vrojtim mbi tavan rezulton se edhe çatia është prej druri. Naosi ndriçohet nga dy dritare mbuluar me arkitrarë druri në anën jugore. Ambienti i altarit ndahet nga naosi me një ikonostas druri. Ai ka bemën me absidën gjysëm rrethore, pa dritare, protezisin dhe diakonikonin me nga dy nike në murin lindor dhe një në atë anësor. Ambienti i altarit ndriçohet nga dy dritare në murin jugor dhe një dritare rrethore mbi absidë. Absida është zbukuruar me nëntë nike të ngushta mbuluar me hark dhe përfundojnë me një kornizë me një rresht dhëmbësh sharre.

Muret e kishës janë ndërtuar me gurë shtufi e gurë çmërsi të cilët përdoren tepër tek absida. Çatia është mbuluar me rrasa guri.

Kisha e Shën Mërisë në Skore të Gjirokastrës, ndërtuar në vitin 1773 paraqet interes për zgjidhjen e mbulesës së naosit e narteksit me një sistem kupolash të përsëritura në mënyrë të njëjtë në pesë hapësira drite. Në këtë bën dallim hapësira e gjashtë, ambienti i altarit, mbuluar me kupola më të vogla në anët dhe qemer cilindrik me formuese lindje perëndim në qendër.

Kisha ndahet në tre nefe nëpërmjet dy arkadave gjatësore mbi pilastra në muret lindorë e perëndimorë, në kolona dhe pilastra në ndarjet e naosit me narteksin dhe ambientin e altarit. Harqe tërthorë kalojnë nga pilastrat në muret anësorë veriorë dhe jugorë mbi kolonat duke qënë më të lartë në hapësirën e mesit - nefi qendror, më të gjerë se anësorët. Kolonat janë prej guri me kapitele prej stuko reliefi. Duke qënë hapsirat e dritës drejtkëndëshe, baza rrethore e kupolës formohet nëpërmjet një ngushtimi të kurbuar të brinjës më të gjatë në anët veriore dhe jugore. Në narteks hyhet nga porta në anën perëndimore. Ai ndahet nga naosi vetëm me nefet anësorë me një mur të ulët guri e perde dërrasash mbi të. Narteksi zë dy hapësira drite të strukturës së kishës dhe ndriçohet nga dy dritare në anën jugore dhe një në atë veriore.

Naosi, në të cilin hyhet nga një portë veriore e një jugore që ka tre hapsira drite, ndriçohet bollshëm nga dy dritare në jug dhe dy në veri. Naosi ndahet nga ambienti i altarit nga një ikonostas druri me vlerë dhe zë një hapësirë drite të strukturës, por pak më të ngushtë, dhe për pasojë kupolat anësore janë më të vogla. Bëma ka absidën rrethore pa dritare, për shkak të nivelit të terrenit jashtë saj, protezisin me dy nike dhe diakonikonin vetëm me një.

Në anën e jashtme, kisha është me muraturë të ndërtuar me breza gurësh që këmbehen me rrasa gurësh shtufi. E tillë është edhe këmbanarja e lartë e shtuar më vonë në këndin veri perëndimor. Absida është trajtuar me shtatë nike që mbulohen me harqe në formë fundi lundre, influencë e arkitekturës së ndërtimeve të kultit mysliman.

Në anën veriore kisha ka një hajat të hapur, mbi pilastra, nga i cili mbulohet me kupolë mbi harqe mbajtës pjesa përballë portës, që të fut në naos. Hajati mbulohet me çati vazhdim i çatisë me katër kullesa të kishës.

Me strukturën e saj kompakte dhe hapsirën e brendshme të goditur e ritmike, kisha dëshmon për mjeshtërinë e ndërtuesve të saj.

Kisha e Shën e Premtes në Përmet ndërtuar në vitin 1776[26] përbëhet nga narteksi, naosi me ambientin e altarit dhe hajati në anën veriore. Narteksi në anën perëndimore është në nivel më të lartë se naosi dhe në të hipet nëpërmjet shkallësh. Në narteks ka dritare që shohin në naos dhe dritare në anën perëndimore. Në naos hyhet nga porta në murin verior. Naosi ndahet në tre nefe nëpërmjet dy arkadave që kanë secila tre kolona dhe një pilastër me prerje katrore në anën lindore. Mbi këto kolona dhe pilastrat kalojnë harqe të tjerë rrethorë të ulët, në drejtimin veri jug. Mbi këtë sistem harqesh ngrihet mbulesa me kësula sferike e pjesës qëndrore të naosit. Hapësira e parë e naosit mbulohet me qemerë cilindrikë, më të ulët e me formuese veri-jug anësorët, më i lartë dhe me formuese lindje-perëndim qemeri qendror. Naosi ndriçohet nga dy dritare në anën jugore dhe një në anën veriore.

Ambienti i altarit ndahet nga naosi me një ikonostas druri të vendosur përpara pilastrave. Ai formohet nga bema me absidën gjysëm rrethore, protezisi dhe diakonikoni. Këta kanë të njëjtin ndërtim, dy nike rrethore në anën lindore dhe nga një tjetër

26. V. Puzanova, **Prapë mbi...**, 156.

DOKUMENT

DOKTORATË

në muret anësorë. Ndriçimi i ambientit të altarit bëhet nga dritarja e absidës, një tjetër mbi të dhe dy dritare në pjesën e sipërme të protezisit dhe diakonikonit.

Në anën veriore ndodhet portiku i hapur me arkadë mbi kolona prej rrotullash guri. Ai mbulohet me qemer cilindrik duke pasur dy harqe tërthor në pjesën e hyrjes për në kishë.

Muret e kishës janë ndërtuar me gurë shtufi, lidhur me llaç gëlqereje. Pjesa e absidës shtatëfaqëshe është punuar me gurë të skuadruar dhe me nike mbuluar me harqe tullash. Nga dy nike ka dhe në murin lindor në të dy anët e absidës.

Kisha e Shën Mëhillit në Lagjen «Varosh» në Gjirokastër ndërtuar në vitin 1776 dhe rindërtuar në vitin 1833 pas djegies së vitit 1828.[27] Është një kishë me përmasa të mëdha në një vëllim brenda të cilit janë krijuar naosi dhe ambienti i altarit. Kisha nëpërmjet dy arkadave ndahet në tre nefe. Secila arkadë ka gjashtë harqe që mbështeten në muret lindorë e perëndimorë në dy pilastra dhe në tre kolona ndërmjet tyre. Mbulesa e kishës paraqet një ndërtim struktural të veçantë që nuk e hasim në kisha të tjera. Mbi kolonat dhe pilastrat në drejtimin veri jug kalojnë arkada në nivel më të ulët se harkadat gjatësore që ndajnë nefet. Harqe të tjerë, në nivel më të lartë janë në të dy anët e harkadave gjatësore. Pjesët e formuara në mes kolonave mbulohen në këtë mënyrë me kupola, gjithsej pesë gjatë gjithë nefit qendror në pjesën që i takon naosit. Nefet anësorë mbulohen me qemere cilindrikë çerek rrethi. Naosi ndriçohet nga pesë dritare drejtkëndëshe në anën veriore e pesë të tjera në atë jugore. Hyrja për në naos bëhet nga jugu dhe perëndimi nëpërmjet dy portave që paraprihen nga portikë.

Ambienti i altarit përbëhet nga bëma me absidën rrethore, protezisin dhe diakonikonin me nga një absidë rrethore dhe një nike rrethore ndërmjet tyre e bemës. Mbulesa e tyre është me qemerë cilindrikë me formuese lindje perëndim.

Në anën e jashtme në muret ndërtuar me teknikën tradicionale të Gjirokastrës, shquajnë tre absidat shtatëfaqëshe me nike të mbuluara me harqe të shkallëzuar. Mbi to ka një kornizë horizontale të hollë dhe më lart muri përfundon me kornizë të dyfishtë dhëmbësh sharre. Kisha mbulohet me çati dyujëse e rrasa guri që ka pjesë me rrjedhje uji në murin lindor.

Kisha e Shën Mërisë në Sopik të Gjirokastrës ndërtuar në vitin 1782 paraqet një ndër kishat që zhvillon më tepër temën e bazilikës me kupola dhe qemere në aspektin e krijimit të një hapësire të brendshme ku mbizotëron si vëllimi i nefit qendror ashtu dhe ngritja në lartësi. Ajo është pararendëse e bazilikave të fundit të shekullit XVIII e fillimit të shekullit XIX qoftë dhe me mbulesë me tavan, në të cilat ngritja në lartësi dhe krijimi i një vëllimi qendror gjatësor është tema bazë. Kisha përbëhet nga narteksi dykatësh, naosi dhe ambienti i altarit dhe hajati i hapur në këmbanaren e vonë.

Në narteks hyhet nën këmbanaren, në hapsirën qëndrore të hajatit e cila është e vetmja e mbuluar me kësula sferike sepse pjesët e tjera janë me çati druri, vazhdim i asaj të kishës. Hajati ka pilastra në hyrje dhe në këndet. Harkada është mbi kolona guri. Narteksi është i ndarë në pjesën e poshtme me një mur nga naosi, ndërsa kati i dytë vështron në të nëpërmjet tribunës. Në katin e dytë hipet me dy palë shkallë. Si dyshemeja ashtu dhe çatia e narteksit janë me strukturë druri.

Naosi tre nefësh ndahet nga dy harkada me nga pesë pilastra me prerje katrore por në qoshet të prera që gati formohet një tetëkëndësh. Harkada mbi to është e ulët. Nga kolonat në muret gjatësorë të kishës kalojnë harqe të tjerë në këtë nivel, për të formuar mbështetjen e kupolave të nefeve anësorë. Duke qënë gjerësia e nefit qendror sa dyfishi i atyre anësorë, harqet mbajtës të mbulesës janë më të lartë dhe në krye dy pilastra. Në këtë mënyrë nefi qendror bëhet mbizotërues dhe me një ritëm që përcaktohet jo nga mbulesa e tij por nga harkadat. Këtë skemë e përsërit dhe kisha e Shën e Premtes në Hllomo ndërtuar në vitin 1829. Naosi ndriçohet nga tre dritare në anën jugore dhe dy në atë veriore. Ambienti i altarit ndahet nga naosi me një ikonostas druri, të gdhendur me teknikën e shpuarjes tej për tej, me vlera artistike të dorës së parë.

Ambienti i altarit mbulohet me kupola si të nefeve anësorë me protezisin dhe diakonikonin dhe me qemer cilindrik me formuese lindje perëndim në pjesën e bemës. Ambienti i altarit ka tre absida gjysëm rrethore në anën e brendshme, më e madhja në qendër dy të voglat anash. Bema ka dhe një nike rrethore në anën e djathtë të absidës, protezisi një të tillë në murin verior. Ambienti i altarit ndriçohet nga një dritare në jug dhe dritarja mbuluar me hark të shkallëzuar e absidës qëndrore. Në anën e jashtme faqja lindore është trajtuar me përkujdesje të veçantë. Ajo është ndërtuar me gu-

27. L. Rey, **Guide d'Albanie,** Paris 1930, 37; E. Riza, **Qyteti muze i Gjirokastrës,** Tiranë 1981, 47.

rë gëlqerorë me rreshta horizontalë lidhur me llaç gëlqereje ndryshe nga muret e kishës që janë me gurë shtufi. Absidat janë mbi bazamente rrethore duke qënë shtatëfaqëshe qëndrorja dhe pesë anësoret. Faqet krijohen prej nikesh që mbulohen me harqe gurësh të rrethuara nga një rresht tullash përgjatë harkut. Absidat përfundojnë me kornizë dhëmbë sharre.

Për të përballuar shtytjet e harqeve në muret anësorë dhe rrezikun e hapjes së tyre, në veri dhe jug janë vendosur si masa konservuese disa kundërforca.

Kisha e Shën Sotirit në lagjen «Pazar i Vjetër» në Gjirokastër ndërtuar në vitin 1784[28] paraqet një vëllim të vetëm, brënda të cilit janë ambienti i altarit, naosi dhe narteksi. Brendësia ndahet në tre nefe nëpërmjet dy arkadave me dy pilastra e katër kolona secila. Pilastrat katrore janë në vendet ku ndahen narteksi me naosin dhe ky i fundit me ambientin e altarit. Narteksi me madhësinë e dy hapësirave të harkadës mbulohet me qemere cilindrike me formuese lindje perëndim për nefet anësorë dhe veri jug për nefin qendror. Për këtë një harkadë tërthor kishës kalon nga muri verior nëpër pilastrat e murit jugor. Në narteks hyhet nga porta perëndimore dhe nga një portë tjetër në anën jugore. Në gjysmën e lartësisë së narteksit është krijuar në një kohë të dytë një kat i dytë në të cilin hypet nëpërmjet një shkalle të jashtme në anën veriore pranë portikut të hyrjes për në naos.

Naosi edhe ai tre nefësh, mbulohet me qemerë cilindrike në tërë gjatësinë e tij, me formuese lindje perëndim, më i lartë në qendër, më i ulët në anësorët. Naosi ndriçohet nga tre dritare drejtkëndëshe në anën jugore. Ambienti i altarit ndahet nga naosi nëpërmjet një ikonostasi druri me vlerë të vendosur përpara pilastrave në anën jugore, mbi të cilët kalon një harkadë në drejtimin veri-jug. Ambienti i altarit përbëhet nga bema, protezisi dhe diakonikoni. Bema mbulohet me qemer cilindrik me formuese veri jug. Ajo ka absidën rrethore, me fronin e peshkopit, tre kamare anash saj në pjesën veriore dhe një dritare të vogël në qendër. Protezisi mbulohet me qemer cilindrik me formuese lindje perëndim dhe ka absidën në anën lindore dhe një nike rrethore në anën veriore, pranë së cilës është një portë e vogël. Diakonikoni mbulohet edhe ai me qemer cilindrik të njëjtë me të protezisit, dhe ka në anën lindore absidën dhe një nike rrethore. Ambienti i altarit ndriçohet nëpërmjet tre dritareve të vogla mbi secilën nga absidat.

Në anën e jashtme kisha karakterizohet nga sipërfaqet e rrafshta të muraturës me gurë gëlqerorë të lidhur me llaç gëlqereje dhe të vendosur në rreshta horizontalë, karakteristikë kjo për ndërtimet e Gjirokastrës. Muret përfundojnë me korniza të drejta prej guri. Me interes është punimi i absidave me shtatë nike mbuluar me harqe prej gurësh. Absida përfundon me korniza prej rreshtash horizontalë gurësh dhe rreshta gurësh të vendosur në formë dhëmbësh sharre.

Kisha e Shën Kollit në Topovë të Gjirokastrës, ndërtuar në vitin 1788 përbëhet nga vëllimi i vjetër me narteksin, naosin dhe ambientin e altarit si dhe nga një shtesë e vonë në anët jugore dhe veriore që përfshin kishën. Në narteks hyhet nga porta në anën veriore mbuluar me hark. Narteksi ka dy kolona në brendësi mbi të cilat ngrihet mbi një sistem harqesh gjatësorë dhe tërthorë që shërbejnë si harqe mbajtës, mbulesa me kupolën. Më të ulët janë harqet lindje perëndimorë më i lartë ai veri-jugor. Narteksi ndriçohet nga një dritare në murin verior.

Narteksi lidhet me naosin nëpërmjet një porte dhe dy dritareve anash saj. Ai ndahet në tre nefe nga dy arkada me dy kolona e një pilastër në lindje secila. Arkada të tjera kalojnë tërthor nga muri verior në atë jugor mbi kolonat. Ato kanë të ulta harqet e nefeve anësorë e të lartë atë qëndrorin. Mbi këtë rrjet harqesh mbajtëse ngrihet mbulesa me kupolën e naosit. Meqënëse hapësirat qëndrore janë drejtkëndëshe baza rrethore e kupolës formohet me një ngushtim. Ky ndriçohet nga dy dritare, një në murin verior tjetri në jugorin duke pasur një portë në murin jugor. Naosi ndahet nga ambienti i altarit me një ikonostas druri përpara pilastrave. Ambienti i altarit përbëhet nga bema me absidën rrethore, protezisi me një nike e dy kamare anash saj dhe diakonikoni me një nike e një kamare në murin jugor. Të tre pjesët mbulohen me qemere cilindrikë me formuese lindje perëndim. Muret e kishës janë të rrafshtë e të ndërtuar me gurë shtufi. I vetmi zbukurim është ndërtimi me nëntë nike i absidës. Kisha mbulohet me rrasa guri mbi çati katër kullimesh.

Në një kohë të dytë kishës i shtohen hajati në anët jugore e veriore, një ambient pranë murit jugor të narteksit dhe këmbanarja në qoshen juglindore. Këto janë të mbuluara me çati me strukturë druri e rrasa guri, vijim i asaj të naosit për krahun jugor dhe duke mbuluar absidën krahu lindor. Portiku jugor ka një harkadë mbi pesë kolona ai lin-

28. E. Riza, **Vep. cit.,** f. 44-47, fig. 35.

DOWNLOADY

DOKUMENTI

dori mbi katër kolona. Në portikët hyhet nga një hapësirë në bazamentin e harkadave në anën jugore e një në atë veriore.

Kisha e Shën Thanasit në Borovë të Ersekës është një ndërtim i ngjashëm me shumë nga kishat e Shqipërisë Juglindore. Nga ajo ruhet vetëm naosi ndërsa pjesët e tjera janë të rrënuara duke u ruajtur vetëm një pjesë e mureve. Në kishë hyhet nga porta në anën perëndimore. Kisha ndahet në tre nefe nga dy harkada me dy kolona e një pilastër secila. Harqe tërthor kalojnë nga kolonat e pilastri në muret verior e jugor ku ka pilastra të dala pak nga faqja e murit. Harqet tërthorë janë dhe ndërmjet kolonës më nga lindja dhe pilastrave për të shërbyer si haqe mbajtës të kësulave sferike nga të cilat ajo në lindje më e vogël. Nefet anësorë mbulohen me qemere në formë çerek rrethi, sipas zgjidhjes tradicionale të zonës. Ambienti i altarit në këtë kishë është më i ngushtë se zakonisht e mbulohet me qemerë cilindrikë. Në anën lindore ka tre absida trefaqëshe njëra për bemën dhe dy të tjerat më të vogla, për protezisin dhe diakonikonin. Protezisi ka një nike tjetër në faqen lindore dhe dy kamare të vogla.

Kisha ndriçohet nga disa baxha. Ajo karakterizohet në anën e jashtme nga faqet e rrafshëta të mureve të ndërtuara me gurë shtufi. Po me gurë shtufi por të skuadruar është dhe portiku me pilastra dhe harkadë në anën jugore. Një sërë kundërforcash janë në anën veriore. Sipas ndërtimit vëllimor, kisha duhet të jetë ndërtuar në fund të shekullit XVIII.

Kisha e Shën Mërisë në Athal të Himarës - Vlorë ndërtuar në vitin 1795 është në anën veriore të rrënojave të manastirit. Kisha përbëhet nga naosi dhe ambienti i altarit, të ndarë ndërmjet tyre me një ikonostas të lartë prej muri të pikturuar, si shumica e kishave të bregdetit. Naosi tek i cili hyhet nga porta në murin perëndimor mbi të cilin ka një nike të cekët, ndahet në tre nefe nga dy rradhë me nga dy kolona secila.

Ndërtimi vëllimor i naosit është mjaft interesant. Ai është i ndryshëm nga kishat e nëngrupit, gjithë duke pasur element të njëjtë me to. Nefi qendror i kishës mbulohet me tavan dërrase. Nefet anësorë mbulohen me qemere cilindrikë të veçantë për çdo hapsirë të harkadës, me formuese veri jug, që hapen në këtë mënyrë ndaj nefit qendror. Një strukturë e tillë nefe anësorë me qemerë dhe ai qëndrori me strukturë druri do të ishte e justifikuar në se nuk do të ishte forma e vjetër, por mbulesa e dikurshme e nefit qendror me strukturë qemerësh në nivel më të lartë do të ishte rrëzuar dhe zëvendësuar në këtë mënyrë me çati druri. Nga vrojtimi rezultoi se dritarja mbi niken në faqen perëndimore ishte zënë nga tavani ndërsa piktura vijon mbi të. Rrëzimi i mbulesës me qemerë të nefit qendror mund të ketë ndodhur nga ndonjë hapje e brendshme e mureve anësorë, që do të shpjegonte dhe nevojën e njëmbëdhjetë kundërforcave.

Në ambientin e altarit hypet me dy këmbë shkallë e nëpër tre hapësira të ikonostasit, i cili për nefin qendror shkon deri afër tavanit. Ambienti i altarit ndodhet në bemën me absidën rrethore, protezisin me një nike e një kamare dhe diakonikoni. Këto dy të fundit mbulohen me qemer cilindrik me formuese veri jug ndërsa nefi qendror me tavan dërrasash. Ambienti i altarit ndriçohet nga një dritare e vogël në absidë. Muratura e kishës është me gurë gëlqerorë në rreshta me tendencë horizontaliteti. Qoshet e mureve dhe shpatullat e portës janë me gurë të skuadruar. Muret përfundojnë me kornizë rrasash guri, ndërsa absida me kornizë dhëmbësh sharre po prej gurësh. Një kambanare është në murin perëndimor. Çatia është dyujëse me tjegulla vendi.

Kisha e Shën Mërisë në Kala të Beratit ndërtuar në vitin 1797[29] e përfshirë në strukturën urbanistike të lagjes Kala, ka qënë katedralja e qytetit dhe kisha më e madhe e tij. Ajo përbëhet nga vëllimi i kishës me naosin, ambientin e altarit si dhe një sërë ambientesh ndihmëse njëkatëshe në anën veriore, dykatëshe në atë perëndimore dhe një portiku në anën jugore, me harkada mbi shtylla guri.

Në anën veriore nëpërmjet disa këmbë shkallëve hipet në krahun verior të hajatit të mbyllur në të cilin kalohet nëpër hapësirën mbuluar me harqe nga muri verior i kishës në murin e hajatit. Dy dhoma që komunikojnë me njëra tjetrën janë në anën lindore të hajatit. Ndriçimi i këtij krahu të hajatit bëhet nga pesë dritare. Prej këndej futesh në kishë ose kalon në krahun e hajatit perëndimor, dykatësh me dysheme druri që mbështetet mbi dy pilastra. Në katin e dytë hipet në një shkallë druri. Nga kati i dytë kalohet në tribunën që ze një hapësirë drite të strukturës me qemere e kupola të naosit. Në këtë mënyrë krahu perëndimor i hajateve shërben si narteks.

Në naos hyhet nëpërmjet tre portave, nga veriu, jugu dhe perëndimi. Naosi ndahet në tre nefe nga dy rradhë prej pesë kolonash e një pilastri. Mbi to në drejtimin veri-jug kalojnë harqe, më të ulët anësorët dhe më i lartë ai i nefit qendror. Rit-

29. Material në A. I. H.

të parë dhëmbë sharre që është me gurë. Protezisi dhe diakonikoni kanë nga një nike rrethore e nga një kamare në muret anësorë të kishës. Dy dritare mbuluar me arkitra të rrafshtë janë anash absidës.

Muratura e kishës është ndërtuar me gurë shtufi në mënyrë të çrregullt lidhur me llaç gëlqeror e suvatuar me llaç të hedhur në mënyrë të çrregullt. Kisha mbulohet me çati dyujëse me pjesë të vogla dhe me rrjedhje uji nga lindja e perëndimi. Hajati është me çati me një rrjedhje në secilin krah.

Kisha e Shën Gjergjit në Vithkuq, Korçë, është përfaqësuesja e këtij nëngrupi në Vithkuq, ku siç e kemi vënë re dhe më sipër, janë ndërtuar kisha të tipeve dhe varianteve të ndryshme. Kisha është e tipit bazilikal, e ndarë nga një harkadë mbi kolona në tre nefe. Nefi qendror ngrihet mbi dy anësorët dhe ndriçohet nga sipër, nga dritare të mëdha. Ai është mbuluar me çati katërujëse. Nefet anësorë më të ulët, kanë mbulesë të pjerrët, sipas flegrës së çatisë. Në anën lindore del jashtë absida e gjallëruar me nike të rrafshta e të larta, të harkuara nga sipër. Në anën jugore hapet hajati.

Muratura është e ndërtuar me gurë të skuadruar dhe është përforcuar me breza druri që dalin në sipërfaqe. Teknika e muraturës në pjesën e sipërme të nefit qendror dhe verior është e ndryshme, siç duket si rezultat i ndonjë riparimi. Muratura është e lidhur dhe me tiranta metalike, të vendosura kryesisht në pjesën e riparuar. Kisha është mjaft e varfër në përpunimin dekorativ. Faqet e muraturës janë të rrafshta dhe të zhveshura.

Kisha e Shën Gjergjit, në ndryshim me kishat e tjera të Vithkuqit të cilat paraqisnin vlera qoftë si prototipe (kisha e Shën Mërisë, kisha e Shën Mëhillit), qoftë në realizimin e goditur arkitektonik (kisha e Shën Pjetrit), nuk shquhet nga vlerat e saj arkitektonike. Megjithatë ajo dëshmon për shkallën dhe kohën e përhapjes së këtij nëngrupi në vendin tonë. Mendojmë se ajo do të jetë ndërtuar gjatë fundit të shekullit XVIII dhe duhet të ketë pësuar një riparim të ndjeshëm nga fundi i shekullit XIX.

Kisha e Shën Mërisë në Kozare të Beratit, ndërtuar në vitin 1806[34] përbëhet nga naosi me ambientin e altarit, që i takojnë ndërtimit të parë si dhe narteksi në anën perëndimore, hajati i mbyllur në anën veriore e hajati i hapur në anën jugore që i takojnë një faze të dytë ndërtimi.

Naosi, tek i cili hyhet nga porta perëndimore ndahet me kolona druri në tre nefe. Mbi kolonat kemi tavanin e drurit që fsheh strukturën e drunjtë të çatisë. Naosi ndriçohet nga katër dritare në anën jugore dhe tre të tjera në atë veriore. Naosi ndahet nga ambienti i altarit me një ikonostas druri. Ambienti i altarit përbëhet nga bema me absidën rrethore, protezisi me dy nike e një kamare dhe diakonikoni me një nike rrethore. Absida në anën e jashtme është nëntëfaqëshe ndërtuar me gurë gëlqerorë të skuadruar me një dritare të vogël në mes. Secila faqe ka nga një nike që mbulohet me hark të verbër. Absida përfundon me një kornizë dhëmbësh sharre me gurë.

Muret e kishës janë ndërtuar me gurë shtufi lidhur me llaç gëlqereje, po kështu dhe muret e fazës së parë. Narteksi ka në anën jugore një ambient me dysheme dërrasash, pak të ngritur nga toka në të cilin hipet me disa këmbë shkallë. Në të hyhet edhe nga ana perëndimore nëpërmjet një porte. Ky ambient ndriçohet nga tre dritare një në perëndim dhe dy në jug në të dy anët e oxhakut. Një ambient nëpërmjet një ndarje me çatma është dhe në këndin veriperëndimor të hajatit. Në anën jugore kemi dhe hajatin e hapur me një harkadë të vënë mbi kolona të trasha dhe të ulëta. Pranë është dhe këmbanarja.

Kisha e Shën Kollit në Krutje të Sipërme të Lushnjes ndërtuar në vitin 1811[35] është një ndërtim i ngjashëm me tërë kishat e Myzeqesë. Ajo përbëhet nga hajati i vonë që e rrethon në të tre anët, vetë kisha, në një vëllim të vetëm ka naosin dhe ambientin e altarit të ndarë nga një ikonostas druri. Në brendësi naosi ndahet në tre nefe nga dy rradhë kolonash druri të suvatuara me harkada harqesh të ulta prej çatmaje e të suvatuara mbi to. Mbi kolonat ka kapitele prej druri të gdhendura. Naosi mbulohet me tavan dërrasash të rrafshët. Naosi ndriçohet nga katër dritare në anën veriore mbuluar me arkitrarë të rrafshtë dhe po aq në anën jugore. Ambienti i altarit ndahet nga naosi me një ikonostas druri me vlerë. Ai përbëhet nga bema, me absidën rrethore në brendësi e nëntëfaqëshe në anën e jashtme, protezisin e diakonikonin me nike rrethore. Ambienti i altarit ndriçohet nga dritarja e ngushtë në absidë. Në anën e jashtme është me mure të rrafshta të suvatuara keq që përfundojnë me strehën e çatisë. Absida është me gurë të skuadruar dhe të gdhendur pastër. Në secilën nga të nëntë faqet ka nike që shkojnë deri në tokë dhe mbulohen me harqe guri. Muri përfun-

34. Pikturuar nga Joani dhe Naum Çetiri; Material në A. I. H.
35. Pikturuar naa Nikolla Çetiri; Material në A. I. H.

Botim

DOKTORE

të larta që mbajnë muraturën kufizuese të nefit qendror, i cili ngrihet më lart se nefet anësorë. Nga katërt dritare mbuluar me hark rrethor janë në muret verior dhe jugor. Nefi qendror mbulohet me tjegulla mbi çati me kapriata të fshehura nga një tavan dërrase i gdhendur. Po me tavan dërrase fshihet dhe çatia e nefeve anësorë, të cilët ndriçohen secili me tre dritare të mëdha mbuluar me arkitra të rrafshët që del mbi çatinë e hajatit. Ambienti i altarit ndahet me një ikonostas druri të vendosur përpara pilastrave të mëdha të arkadave. Ai përbëhet nga bema me absidën rrethore në anën e brendshme e shtatë faqëshe në anën e jashtme, të zbukuruar me harqe të verbër prej tullash e gurësh dhe korniza prej tullash. Në të djathtë të bemës është diakonikoni me një nike rrethore në murin lindor dhe në të majtë të saj është protezisi me një nike në murin lindor e një në atë verior. Ambienti i altarit ndriçohet nga një dritare e ngushtë në absidë.

Në një kohë të vonë, fillimi i shekullit XX po të gjykojmë nga përdorimi i tullave, kishës i shtohet në anët veriore, jugore e lindore një hajat trepjesësh. Pjesa perëndimore e hajatit që është dhe më e gjerë ka katër shtylla druri për mbajtjen e çatisë. Në hajat hyhet nga perëndimi nëpër kullën e këmbanares, sot të rrënuar, dhe nga veriu e jugu nëpër porta mbuluar me harqe gjysëm rrethorë. Me harqe të ulët janë mbuluar hapësirat e shumta të murit rrethues të hajatit. Është me interes të shënohen fragmentet antike sigurisht të ardhur nga Apollonia, që ruhen në një ambient në këndin veri perëndimor të hajatit e që shërbente si vend pagëzimi.

Kisha e Shën Spiridhionit në Vuno të Vlorës ndërtuar në vitin 1778 është një bazilikë e madhe e përbërë nga hajati i hapur në anën perëndimore, narteksi, naosi dhe ambienti i altarit. Hajati në anën perëndimore, ku është dhe hyrja kryesore për në kishë, ze një pjesë të ballit të ndërtesës, ai rrethohet nga tre anë me harkadë të hapur me pilastra në qoshet dhe në muret dhe kolona ndërmjet tyre. Tre harqe janë në anën perëndimore dhe dy në anët veriore dhe jugore. Nga hajati në kishë hyhet nga porta në murin perëndimor që ka dy dritare anash. Katër kolona të vendosura tërthor kishës në drejtim veri-jug ndajnë narteksin dykatësh nga naosi nëpërmjet një perde druri. Në katin e dytë hipet me dy shkallë në të majtë dhe në të djathtë të portës. Mbas kolonave fillon naosi i cili ndahet në tre nefe nga dy arkada mbi kolona. Nefi qendror mbulohet me tavan dërrase të gdhendur mbi të cilin është struktura e drunjtë e çatisë. Nefet anësorë mbulohen edhe ata me tavan dërrasash të gdhendur në lartësi pak më të ulët se tavani i nefit qendror. Naosi ka dhe dy hyrje të tjera në muret verior dhe jugor. Naosi ndriçohet nga dritare në muret gjatësorë të kishës. Naosi ndahet nga ambienti i altarit me ikonostas prej muri, në të cilin mbështeten dhe arkadat e nefeve. Ikonostati ka hyrje të veçantë për bemën, protezisin dhe diakonikonin. Këta të fundit janë të ndarë me perde muri nga bema, me mure të ulët dhe porta dhe ndriçohen me dritare nga muret verior e jugor. Bema ka në anën lindore absidën rrethore dhe një nike në veri të saj.

Kisha është e ndërtuar me muraturë me gurë gëlqerorë. Gurët janë të gdhendur për dritaret kuadratike dhe qoshet. Ata janë të lidhur me llaç gëlqeror.

Trajtimi i jashtëm është i thjeshtë, mure të rrafshta e të suvatuara që përfundojnë me korniza prej rrasash guri e çati dyujëse mbuluar me tjegulla.

Kisha e Shën Mërisë në Bishqethëm të Lushnjes ndërtuar në vitin 1798[33] është një bazilikë trenefshe me hajate në tre anët. Ajo përbëhet nga naosi me ambientin e altarit, ndërtim i vjetër, dhe hajatet në veri, jug dhe perëndim. Hajati perëndimor është më i gjerë se krahët verior ose jugor dhe për këtë ka shtylla druri. Mbi çati ngrihet këmbanarja me shtylla druri. Në hajat hyhet nga ana perëndimore, veriore e jugore me porta mbuluar me hark gjysëm rrethi. Në krahun jugor ka gjithashtu katër dritare. Një dritare është mbi portën perëndimore.

Në naos hyhet nga porta perëndimore me dy dritare dhe nëpër dy porta në anën veriore e jugore. Naosi ndahet në tre nefe nga dy arkada me nga katër kolona secila. Mbi këto harqe është një mur i ulët që mban strukturën e çatisë dhe tavanin e gdhendur. Naosi ndriçohet nga tre dritare këndrejtë të mbuluara me arkitra të rrafshtë në anën jugore e po aq në atë verioren.

Një ikonostas druri ndan naosin nga ambienti i altarit që përbëhet nga bema, protezisi dhe diakonikoni. Në anën lindore është absida gjysëm rrethore në brendësi me një dritare të vogël kuadratike e ndërtuar me katër gurë të skuadruar. Në anën e jashtme absida është shtatëfaqëshe e ndërtuar me një rradhë gurësh të skuadruar e tre rradhë tullash. Mbi to është korniza e dyfishtë dhëmbë sharre ndërtuar me tulla me përjashtim të rreshtit

33. Pikturuar në po atë vit nga Joan Çetiri; Material në A. I. H.

me nga gjashtë kolona secila. Mbi kolonat ngrihet një arkadë gjatësore që e thekson akoma më tepër shtrirjen gjatësore të sallës, ndërsa mbi to ngrihen mure të cilat i veçojnë në hapësirë nefet nga njëri tjetri. Nefi qendror fiton në këtë mënyrë më tepër lartësi gjë që shfaqet edhe në pamjen e jashtme, me daljen e muraturës mbi çatitë e nefeve anësorë. Kjo ngritje krijon mundësinë e ndriçimit të nefit qendror me dritare të shumta të hapura në muret veriorë e jugorë, si dhe nga ato në muret perëndimorë e lindorë. Nefi qendror është i paisur me tavan të rrafshët i ndarë me listela çibukë në një rrjet katrorësh të vegjël dhe i ngarkuar me fashatura të gjera e të dekoruara. Dritaret e sipërme janë punuar me allçi, duke lënë pjesët për ndriçim. Nefi qendror mbulohet me çati me katërkullime.

Nefet anësorë i nënshtrohen nefit qendror. Ato janë më të ulta të mbuluara vetëm me një flegër të thjeshtë. Nefet anësorë ndriçohen nga dritare të hapura në murin verior dhe në atë jugor, të cilat dalin në hajat. Në anën lindore del jashtë absida e gjerë rrethore që përfundon në nefin qendror. Nga jashtë ajo është përpunuar me shtatë nike të rrafshta e të harkuara nga sipër, e të ndara nga pilastra të holla e të shkallëzuara. Kjo arkadë e rrafshtë vazhdon edhe në pjesët e rrafshta të murit lindor.

Hajati në anën jugore ka në ballë një arkadë me nëntë harqe të ngritur mbi kolona të holla e me prerje rrethore. Kolonat kanë bazë të thjeshtë kubike dhe përfundojnë me kapitele në formë trungu piramide. Hajati mbulohet nga zgjatimi i flegrës së çatisë së nefit anësor jugor. Niveli i hajatit është më poshtë se niveli i terrenit. Nëpërmjet hajatit kalohet në naos, dyshemeja e të cilit është mjaft më poshtë nga ajo e hajatit. Për qark kalon sofaja, ndërsa në murin lindor përfundon me një kungë të gjerë rrethore. Në murin perëndimor të saj hapet një hapësirë e gjerë, harkuar nga sipër, e cila siç duket do të ketë qënë ndërlidhëse me narteksin. Narteksi lidhej gjithashtu me naosin me portë dhe dritare. Niveli i narteksit ishte gjithashtu më i lartë nga ai i naosit.

Kisha është e ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqereje. Materiali dhe teknika është e ngjashme me ato të bazilikave të tjera të Voskopojës. Gjithashtu mbulesat e harkuara këtu kanë gjetur përdorim edhe në dyert e dritaret. Por këtu mungon krejtësisht dekoracioni me tulla. Këtë mungesë mjeshtri është munduar ta kompesojë duke ndërtuar arkadën e hajatit me gurë me ngjyrë të ndryshme, ndërsa në brendësi duke e pajisur me tavan të pikturuar.

Kisha e Shën Gjergjit në Libofshë të Fierit ndërtuar në vitin 1776[31] si gjithë kishat e pellgut të Myzeqesë përbëhet nga naosi me ambientin e altarit që i takojnë ndërtimit fillestar, hajatit në tre anët që i takon një shtese të vonë që ka si një shtesë akoma më të vonë një portik të hapur me shtylla druri me këmbanaren në qendër. Në naos hyhet nga porta kryesore në anën perëndimore që ka dy dritare anash dhe nga dy porta të tjera në muret verior dhe jugor në afërsi të murit perëndimor, nëpërmjet të cilave me disa këmbë shkallë zbritet në dyshemenë e shtruar me pllaka guri të kishës. Në brendësi janë dy rradhë me nga katër shtylla druri secila që mbajnë dhe strukturën e çatisë të fshehur nga tavani i rrafshtë në një nivel për të tre nefet që formohen nga shtyllat e drunjta. Në këtë mënyrë formohet një vëllim i vetëm për tërë kishën. Naosi ndriçohet nga tre dritare drejtkëndëshe në murin verior dhe tre në atë jugor të vendosura në lartësi.

Ambienti i altarit ndahet nga naosi me një ikonostas druri. Ai përbëhet nga bema me absidën rrethore, nga protezisi me dy nike, një në murin verior tjetra në atë lindor dhe diakonikoni me një nike. Ambienti i altarit ndriçohet nga dritarja e ngushtë e absidës dhe dritare të vogla anash kësaj të fundit. Në anën e jashtme absida shtatëfaqëshe përbën pjesën e vetme të zbukuruar të kishës. Ajo është ndërtuar me gurë gëlqerorë të skuadruar, ka shtatë nike të shkallëzuara që përfundojnë në pjesën e sipërme me harqe të verbër prej tullash e gurësh. Absida përfundon me një kornizë prej disa rreshta gurësh pak të nxjerrë ndaj murit. Muret e tjera të kishës janë prej gurësh kryesisht shtufi të lidhur me llaç gëlqereje.

Hajati që e rrethon në të tre anët kishën është shtesë e vonë e ndërtuar keq dhe ka gjashtë dritare dhe një portë në anën jugore veç asaj në anën perëndimore.

Kisha e Shën Thanasit në Karavasta të Lushnjes përbëhet nga naosi me ambientin e altarit ndërtuar në vitin 1778[32] dhe një hajat që e rrethon nga të tre anët i shtuar më vonë. Në naos hyhet nga porta në murin perëndimor anash së cilës janë dy dritare të mbuluara me hark të ulët. Naosi ndahet në tre nefe nga dy rradhë prej katër kolonash dhe një pilastër prej murature secila. Mbi to kalojnë harqe

31. Material në A. I. H.; Pikturuar në vitin 1782 nga Kostandin e Terpo Zografi.
32. Pikturuar më 1797 nga Gjergji e Joan Çetiri; Material në A. I. H.

Botoqy

proporcionuar e ngrihet mbi një mur të lartë. Në pjesën lindore të portikut është një ambient i mbyllur, stere uji me çesmën në nivel më të ulët, dikur mbuluar me çati mbi kolona. Në portik hipet me disa këmbë shkallë për shkallë se në anën jugore terreni është mjaft i ulët.

Monumenti i vendosur brenda manastirit në një kodër që dominon fushën e Myzeqesë, shquhet si për pamjen e jashtme ashtu edhe për brendësinë karakteristike të bazilikave të shekullit XVIII.

Kisha e Shën Mërisë në Nicë të Pogradecit është një bazilikë treabsidëshe dhe përbëhet nga naosi me ambientin e altarit, të cilat në një kohë të dytë janë shtuar në anën perëndimore me narteksin me një këmbanare. Në narteksin me planimetri drejtkëndëshe me brinjë më të gjatë në anët perëndimore e jugore hyhet nga porta në anën veriore mbuluar me arkitra druri dhe ndriçohet nga një dritare në anën veriore dhe dy në anën jugore. Në perëndim të narteksit pak e dalë nga muri perëndimor është këmbanarja e lartë. Në dy të tretat e lartësisë ajo është me gurë shtufi e breza druri, në pjesën e sipërme me strukturë druri veshur me dërrasa, dhe me nga një dritare në çdo anë. Në këmbanare hipet me shkallë nëpërmjet portës në anën veriore të cilat ndriçohen nga dritare si frengji.

Në kishë hyhet nga ana perëndimore. Një portë ndodhet gjithashtu në anën jugore. Naosi ndahet në tre nefe me dy rradhë shtyllash druri me nga tre shtylla secila. Kisha mbulohet me strukturë druri dhe tavan dërrasash. Në pjesën qëndrore të tavanit është krijuar një kupolë sferike. Naosi ndriçohet nga dritaret e absidës dhe një dritare pranë absidës jugore. Abienti i altarit përbëhet nga bema me absidën gjysëm rrethore, protezisi me një nike e një kamare dhe diakonikoni me një nike rrethore.

Muret e kishës janë ndërtuar me gurë të rregullt, për lidhjen e mirë të të cilëve përdoren dhe gurë të vegjël ndërmjet tyre. Një brez gjatësor kalon përgjatë mureve. Ky vlen dhe për të mbështetur me pajanda strehën e çatisë katërujëse e cila në zonën mbi absidën lindore ka një strukturë mjaft interesante. Absidat veriore e jugore mbulohen direkt nga çatia me rrasa guri, ndërsa ajo lindore mbulohet nga çatia e kishës. Në secilën nga absidat rrethore ka një dritare dyshe me kolona guri mbi të cilën ka një nike. Absida përfundon me kornizë dyfishe gurësh të vendosur në formë dhëmbësh sharre.

Nga teknika e ndërtimit, planimetria, kisha duhet të jetë e fundit të shekullit XVII, fillimit të shekullit XVIII.

Kisha e Shën Mërisë në Lashovë të Ersekës paraqet interes për vendosjen e saj në kompleks me ambientet ndihmëse në një terren të pjerrët çka ka kërkuar ndërtimin e tyre për krijimin e një platforme për kishën. Kështu që e parë nga ana jugore e perëndimore nuk është e lehtë të dallohet nga një banesë banimi.

Kisha përbëhet nga narteksi dykatësh, naosi me ambientin e altarit, hajati i hapur në anën jugore me një ambient të vogël në këndin juglindor. Në nivelin e katit hipet nëpërmjet një palë shkallësh që ndjekin terrenin dhe që pranë godinës krijojnë një kalim të harkuar për të lejuar shfrytëzimin e katojve në katin përdhe. Portiku në anën perëndimore të shpie në dy dyert, atë të narteksit dhe atë të konakut në qoshen jugperëndimore. Konaku ndriçohet nga dy dritare në jug dhe ka në atë anë një qoshk me strukturë druri. Nga konaku nëpër një portë me dy këmbë shkallë kalohet në hajatin e hapur me harkadë mbi kolona. Një paraklis ndodhet në fund të tij.

Në kishë zbritet me disa këmbë shkallë nga porta që e lidh me narteksin. Dy dritare janë anash saj. Naosi ndriçohet nga tre dritare të vogla në murin jugor që shohin nga hajati. Ai ndahet në tre nefe nga dy rradhë kolonash druri që mbajnë strukturat e çatisë dhe tavanin e rrafshët. Naosi ndahet nga ambienti i altarit me një ikonostas druri me mjaft vlerë. Ai përbëhet nga bema me absidën rrethore, protezisin me dy nike dhe diakonikonin me një nike. Në anën e jashtme absida është pesëfaqëshe.

Muratura është me gurë shtufi e llaç gëlqereje. Çatia mbulohet me rrasa guri. Nga ndërtimi planimetrik e vëllimor kisha duhet të jetë ndërtuar në fundin e shekullit XVII fillimin e shekullit XVIII.

Kisha e Profet Ilisë - Voskopojë - Korçë, është ndërtuar në vitin 1751, Kisha e Profet Ilisë në Voskopojë është një nga shembujt e arritur të këtij nëngrupi, megjithëse në trajtimin e përgjithshëm arkitektonik ajo mbetet prapa bazilikave të tjera të Voskopojës. Ajo ngrihet mbi një breg, në anën perëndimore të fshatit nga ziente fill rruga e vjetër e karvaneve që e lidhte këtë qendër me një qendër tjetër të rëndësishme të vendit, Beratin.

Kisha përbëhej nga tre njësitë kryesore, naosit, narteksit në anën perëndimore dhe hajatit të hapur në anën jugore. Në gjendjen e sotme narteksi është i rrënuar. Kisha rrethohej me mure, mbi të cilat ngrihej këmbanarja e lartë. Në oborr ka patur dhe ndërtime të tjera.

Naosi ka një theksim të qartë bazilikal. Ai është ndarë në tre nefe ajatësorë me dy rreshta kolonash

Fotokopje

në formulimin arkitektonik të jashtëm, i cili është mjaft i thjeshtë. I gjithë sistemi i brendshëm i qemereve është mbështjellë nga masa prizmatike e muraturës, e mbuluar nga çatia e gjerë dhe e vazhduar dyujëse. I vetmi volum i dalë është absida e cila nga ana e jashtme është përpunuar me pilastra të holla të kurorëzuara me harqe. Ndriçimi është i mjaftueshëm nëpërmjet dritareve të mëdha të hapura në murin verior. Muratura është e ndërtuar me gurë e llaç gëlqereje, me fugatura të trasha llaçi. Cilësia e muraturës është e dobët. Ky ka qënë dhe shkaku që nga lëkundjet sizmike kisha kishte pësuar dëmtime në muraturë dhe në strukturat e mbulesës, që u riparuan me punimet e vitit 1964.

Kisha e Shën Mërisë së Konckës, si ndërtim i fundit të shekullit XVIII dhe fillimit të shekullit XIX ndonëse shembujt e avancuar nuk kanë munguar, dëshmon për një rënie të kësaj veprimtarie ndërtimore. Mjeshtërit e ndërtimit duket se i kishin konceptet konstruktive dhe figurative, por atyre u mungonte preokupimi për të krijuar mjete të reja shprehjeje arkitektonike. Ato kanë një zgjidhje të thjeshtë, të pa ndërlikuar, duke përdorur vetëm një element konstruktiv, qemerin cilindrik dhe duke u përpjekur të japin ndjenjën e hapsirës së brendshme, sidomos në nefet anësorë me anë të ngritjes në lartësi dhe të bashkimit të hapësirës së bërthamave të tyre me ato të nefit qendror. Por ndonëse në brendësi ndjehet një farë përkujdesje për një trajtim hapësinor, kjo mungon plotësisht në trajtimin arkitektonik të jashtëm.

BAZILIKAT ME TAVAN TË RRAFSHËT

Ndërtimet e këtij nëngrupi janë me mbulesë me çati me strukturë druri me tavan të rrafshët dërrase. Brendësia e tyre ndahet në tre nefe nëpërmjet dy rreshtash kolonash guri ose druri. Kolonat në një sërë kishash janë të lidhura me arkada, në të tjera mbi to mbështetet direkt tavani, me ndërmjetësinë ose jo të trarëve gjatësorë.

Thuajse të gjitha kishat e këtij nëngrupi kanë përmasa të mëdha, përsa i përket organizimit të hapësirës së brendshme mbeten pas shembujve të nëngrupit të dytë. Këtu kemi një thjeshtëzim të saj një vëllim statik e që kapet lehtë, faqe të rrafshëta. Kësaj i shmangen ato kisha tek të cilat përdoren harqet mbi kolona dhe nefi qendror është më lartë se anësorët. Gjithashtu një rol të tillë lot dhe dekori i tavaneve, i ngjashëm me atë të banesave popullore.

Kisha e manastirit të Shën Mërisë në Ardenicë të Lushnjes ndërtuar në vitin 1743.[30] është një nga shembujt më të vjetër të bazilikave me tavan të rrafshët, ndërtuar me mjaft mundësi mbi ndonjë ndërtim të vjetër. E vendosur në mes të konakëve të manastirit, kisha përbëhet nga narteksi dykatësh i paraprirë nga një hajat në anën perëndimore, nga naosi me ambientin e altarit, nga një portik i hapur në anën jugore.

Në sheshin përpara portikut të hapur në anën perëndimore, ku ndodhet dhe stera e ujit, hipet me disa këmbë shkallë, prej aty nëpërmjet portikut me arkadën mbi pesë kolona guri kalohet në narteksin dykatësh i gjerë sa naosi dhe me një ambient jashtë tij në anën jugore. Në katin e dytë hipet nga shkallët në këndin veriperëndimor. Si kati i parë edhe ky shikon naosin me dy dritare në murin perëndimor, që i lidh të dy. Nga ana perëndimore kati i dytë i narteksit komunikon me hajatin e sipërm me shtylla druri.

Nga narteksi nëpërmjet një porte të mbuluar me arkitra të rrafshët kalohet në naos ku zbritet me disa këmbë shkallë. Dy porta të tjera janë në muret veriore dhe jugorë më pranë murit perëndimor. Naosi ndahet në tre nefe nga dy rradhë kolonash me nga katër shtylla secila që mbajnë çatinë me strukturë druri të fshehur nga një tavan i rrafshët i gdhendur. Katër dritare në anën veriore dhe po aq në atë jugore të vendosura në lartësi ndriçojnë naosin. Dritaret janë mbuluar me arkitra të rrafshtë një cope mbi të cilin ka një hark shkarkues e një nike gjysëm rrethore në fushën që krijohet. Prej gurësh të skuadruar janë dhe shpatullat e dritareve.

Ambienti i altarit ndahet nga naosi nëpërmjet një ikonostasi druri të gdhendur me vlera artistike. Ai përbëhet nga bema me absidën rrethore, protezisi me dy nike rrethore dhe diakonikoni me një nike e një kamare në murin verior. Ambienti i altarit ndriçohet nga disa dritare. Nga një dritare si të naosit ka në muret verior dhe jugor, tre dritare në murin lindor një në absidë e dy anash saj mbuluar me arkitra të rrafshët guri. Ndërsa muret e kishës janë ndërtuar me gurë shtufi e llaç gëlqereje, absida është e mbuluar me gurë gëlqerorë të skuadruar. Absida ngrihet mbi një bazament të ulët gjysëm rrethor, dhe vazhdon më lart si shtatëfaqëshe. Në secilën faqe ka nga një nike të shkallëzuar mbuluar me hark gurësh e tullash. Mbi të vijon me dy rreshta gurësh dhe një rresht gurësh që këmbehen me tulla. Mbi to korniza me gurë të profiluar.

Në anën jugore kisha ka portikun e hapur me harkadë guri mbi gjashtë kolona guri. Ajo është e

30. Pikturuar nga Kostandin Shpataraku në vitin 1744, Material në A. I. H.

Pa fotokopje

mit i mbulesës pra dhe i kolonave është jo i njëjtë, alternohen hapësira të ngushta me hapësira sa gjerësia e nefit qendror për të krijuar vendin e kupolave mbi tambur të ulët. Të tilla janë dy, në hapësirën e dytë e të katërt, në të cilat nefet anësorë mbulohen qemerë cilindrikë me formuese veri-jug që shërbejnë dhe si harqe mbajtës për tamburin. Në anën e jashtme këta mbulohen me çati që përfundon me fronton. Për nefin qendror hapësirat e tjera mbulohen me qemerë cilindrikë me formuese lindje perëndim. Nefet anësorë për hapësirën e parë, të pestë e të gjashtë mbulohen me kupola, ndërsa hapësira e tretë, që është më e ngushta mbulohet me qemer cilindrik me formuese veri jug. Naosi ndriçohet nga tre dritare në anën veriore e tre në atë jugoren. Veç tyre ka dritare në frontonet mbi çatinë dyujëse të naosit dhe në kupolat.

Naosi ndahet nga ambienti i altarit me një ikonostas druri të gdhendur të dorës së parë. Ambienti i altarit përbëhet nga bema me absidën rrethore në brendësi e pesëfaqëshe në anën e jashtme, nga protezisi me një sërë nikesh e kamaresh dhe diakonikoni. Ambienti i altarit ndriçohet nga një dritare në anën jugore.

Muret e kishës janë me gurë gëlqerorë të formacioneve të shtresëzuara lidhur me llaç gëlqereje. Në anën e jashtme kisha është përfshirë në tërësinë e lagjes pa u shquar prej saj. Ajo mbulohet me çati dyujëse mbi të cilën dalin tamburet dhe çatitë tërthore me frontone në të dy anët e tyre. Brendësia dëshmon për një mjeshtëri arkitekturore të ndërtuesve, për aftësi teknike të tyre. Ajo është e proporcionuar me një hapësirë ku ndihet aksi gjatësor, për ritmin e kolonave si dhe ai vertikal, për tamburët. Kjo kishë paraqet një hallkë ndërmjetëse nga kishat e shekullit XVIII në atë të shekullit XIX që shquhen për vëllimin e madh e ngritjen në lartësi.

Kisha e Shën Kollit në Lipë të Përmetit, është një bazilikë, ndërtimit të vjetër të së cilës në një kohë të dytë i është shtuar në anën veriore një portik i hapur me harkada mbi pilastra mbuluar me çati me rrasa guri, vazhdim i çatisë së kishës por me strukturë druri.

Në narteks hyhet nga ana perëndimore nga një portë e mbuluar me arkitra druri, anash së cilës janë dy dritare të mëdha mbuluar me arkitra. Narteksi është mbuluar me çati druri. Në naos hyhet nga një portë në murin që lidh me të narteksin që ka nga dy dritare në të dy anët. Në të zbritet me katër këmbë shkallë. Ai ndahet në tre nefe nga një harkadë me dy kolona e një pilastër secila. Po tre nefet mbulohen me qemere cilindrikë të vazhduar në tërë gjatësinë e nefit me formuese lindje perëndim. Naosi ndriçohet me tre dritare në murin jugor dhe dy në atë verior, ku ndodhet dhe porta që e lidh me portikun. Me një ikonostas druri te pilastrat naosi ndahet nga ambienti i altarit. Nga pilastrat në muret verior dhe jugor dhe në atë lindor kalojnë harqe të ulët që shërbejnë si harqe mbajtës për mbulesën me kupol të protezisit dhe diakonikonit. Bema mbulohet me qemer cilindrik me formuese lindje perëndim por që është në nivel më të ulët se qemeri i naosit, me të cilin lidhet me një kalim të kurbuar. Bema ka absidën rrethore e cila në anën e jashtme ka një sërë nikesh e mbuluar me hark gurësh të skuadruar. Në murin mbi të ka dy shiritë gurësh të vendosur në formë dhëmbësh sharre.

Muratura është me gurë shtufi e llaç gëlqereje. Çatia me katër kullime dhe mbulesa janë me rrasa guri. Për nga ndërtimi vëllimor dhe strukturat e mbulesave kisha duhet të jetë ndërtuar në fund të shekullit XVIII dhe në fillim të shekullit XIX.

Kisha e Shën Mërisë në Konckë të Gjirokastrës, është ndërtuar në vitin 1800. Ajo përbëhet nga naosi, narteksi në anën perëndimore dhe hajati që del në pamjen jugore.

Naosi është një ndërtim bazilikal me tre nefe. Në anën lindore del jashtë absida që përfundon me nefin qendror. Nefet ndahen nga dy rreshta kolonash, me nga tre kolona me prerje rrethore secila. Çdo çift kolonash si dhe kolonat në muret anësorë veriorë dhe jugorë lidhen me një arkadë në drejtimin tërthor. Në këtë mënyrë në nefin qendror, i cili është mbuluar me qemer cilindrik, me formuese lindje perëndim, këto harqe dalin si brinjë rigjiditeti të strukturës së mbulesës. Ndërsa në nefet anësorë ku lartësia e tyre është më e vogël ato e thyejnë aksin gjatësor duke formuar bërthama të mbuluara me qemerë cilindrikë që mbështeten mbi këto harqe dhe hapen ndaj nefit qendror.

Një ndërtim i njëjtë është edhe narteksi, që i bashkëngjitet naosit në anën perëndimore. Narteksi ka planimetri thuajse katrore, në mes të të cilit ngrihen dy kolona. Këto lidhen ndërmjet tyre dhe me muret anësorë me një arkadë me tre harqe që krijojnë brinjën e qemerit në nefin qendror, ndërsa në nefet anësorë bërthamat e mbuluara me qemerë që hapen në nefin qendror.

Në anën jugore përgjatë kishës hapet hajati, një pjesë e të cilit formon një ndërtim të mbyllur. Pjesa e hapur e hajatit është e thjeshtë, me një rresht kolonash në ballë, ku alternohen kolona me prerje rrethore me pilastra katrore. Mbulesa e hajatit është e thjeshtë me konstruksion druri, vazhdim i flegrës së çatisë së kishës.

Ndërtimi struktural i brendshëm nuk pasqyrohet

Valter SHTYLLA

DO NOT COPY

NDËRTIME INXHINIERIKE TË FILLIMIT TË SHEKULLIT XIX[të] NË DISA KRAHINA TË SHQIPËRISË SË JUGUT

Në këtë shkrim do të trajtojmë urat e gurit dhe rrugët e karvaneve, të ndërtuara në çerekun e parë të shekullit të XIX[të] në krahinën e Rrëzomës në Delvinë të Sarandës dhe në krahinat e Pogonit e Zagorisë të rrethit të Gjirokastrës. (fig. 1). Mendojmë se shumica e tyre duhet të jetë ndërtuar në kohën e Ali Pashë Tepelenës. Materiali është trajtuar në bazë të ekspeditave të kryera në vend gjatë vitit 1980.[1]

Nga burimet e shumta historike dhe nga objektet e ndryshme të ruajtura deri më sot, del e qartë se, në kohën e pashallëkut të Ali Pashë Tepelenës, në vendin tonë është ushtruar një aktivitet i gjerë ndërtimor, ku vendin kryesor e zunë kalatë si, ajo e Tepelenës, e Libohovës, e Shën Triadhës në Lunxheri, të Vivarit në Butrint, etj.[2] Një vëmendje e posaçme iu kushtua dhe ndërtimit të objekteve inxhinierike si rrugë, ura, ujësjellësa, etj. Për t'u përmendur janë ujësjellësi i kalasë së Gjirokastrës, me gjatësi rreth 12 km, dhe ai i kalasë së Tepelenës, i ndërtuar në kohën e Ali Pashës.[3]

Burimet përmendin se, në kohën e Aliut, janë ndërtuar dhe meremetuar një numër i madh urash, por pa caktuar konkretisht asnjerën prej tyre. Duke kaluar në fillim të shekullit të XIX[të] nëpër rrugën Janinë-Strugë, Pukëvili thekson se gjatë kësaj rruge që kalonte nëpërmjet Leskovikut, Kolonjës dhe Korçës, ai hasi 28 ura të ndërtuara prej Ali Pashë Tepelenës,[4] të cilat mendohet se mund të jenë ngritur nën drejtimin e Petro Korçarit, kryearkitektit të tij.[5] Sot për sot, me emrin e Ali Pashës, nga goja e popullit njihet vetëm ura - kanal e Ali Pashës mbi përroin e Manalit, ujësjellësit të kalasë së Gjirokastrës.[6] (fig. 2)

Gjatë ekspeditave në krahinat Rrëzomë, Zagori e Pogon, hasëm një numër të konsiderueshëm urash me qemer guri, që ruhen ende në funksion të plotë. Mendojmë se shumica e tyre duhet të jenë ndërtuar në kohën e Ali Pashë Tepelenës për këto arsye: së pari këto ura kanë ngjashmëri me njera tjetrën si për nga konstrukti ashtu dhe nga teknika e ndërtimit; së dyti këto krahina kanë qenë përfshirë në territorin e pashallëkut të Ali Pashës, në të cilin ka pasur një veprimtari të gjerë ndërtuese; së fundi për objektet që trajtohen në këtë artikull ka mjaft të dhëna gojore, që i datojnë urat si të kohës së Ali Pashë Tepelenës.

Krahina e Rrëzomës së Delvinës, që shtrihet nga jug-lindja në veri-perëndim, prej Delvine deri në Tatzat i përket luginës së lumit të Kalasës, i cili buron në grykën e Tatzatit dhe derdhet në lumin e Bistricës pak para derdhjes së tij në det.

Krahina e Rrëzomës përbëhet nga disa fsha-

1. Ekspeditat për gjurmim dhe dokumentim të objekteve janë kryer nga autori dhe E. Haxhiraj. Përpunimi nga E. Haxhiraj dhe A. Qyshka. Fotot të autorit. Falenderojmë L. Sulin për njoftimet e dhëna për krahinën e Rrëzomës.
2. Gj. Karaiskaj, **Fortifikimet mesjetare pranë kanalit të Vivarit në Butrint dhe restaurimi i tyre,** Monumentet, 11, f. 147.
3. V. Shtylla, **Ujësjellësi i vjetër i kalasë së Gjirokastrës,** Monumentet, 20, (në shtyp).
4. Pouqueville F. C. H. L, **Vouage dans la Grece,** V. III, f. 56.
5. DH. S. Shuteriqi, **Petro Korçari, kryearkitekt i Ali Pashë Tepelenës,** Tiranë, 1978, 36.
6. V. Shtylla, **vep. cit.**

DO NOT COPY



Fig. 1

KISHA E SHËN MËHILLIT - *Voskopojë*









DO NOT COPY

DO NOT COPY

KISHA E SHEN THANASIT - *Voskopojë*









KISHA E SHEN GJERGJIT - *Shipskë*









DO NOT COPY

URA E HOSHTEVES - Zagori









TAB. XI



DO NOT COPY

DO NOT COPY



KISHA E SHËN GJERGJIT
-Libofshë





0 2 4 6m

DO NOT COPY



KISHA E SHËN THANASIT–*Karavasta*







DO NOT COPY

KISHA E SHËN SPIRIDHONIT – *Vuno*







KISHA E SHËN TODRIT – *Kadipasha*







KISHA E SHËN MËRISË -
-Bishqethëm

0 2 4 6 8 m







DO NOT COPY

DO NOT COPY

KISHA E UNGJILLIZIMIT – *Kozaré*







KISHA E SHEN GJERGJIT – *Vithkuq*







DO NOT COPY

KISHA E SHËN KOLLIT – *Krutje*











Aleksandër MEKSI Pirro THOMO

L'ARCHITECTURE POSTBYZANTINE EN ALBANIE (LES BASILIQUES)

RESUME

Dans l'ensemble de constructions du culte chrétien, pendant la période de l'Occupation ottomane, les basiliques constituent un groupe important par leur extension territoriale, la solution architectonique et les dimensions. Même pour les autres types de cette architecture, il est caractéristique la tendence d'un rallongement de l'axe longitudinal, une meilleure liaison des volumes à l'intérieur de la construction ainsi qu'un traitement de leur vue extérieure. Mais, ces tendences, atteignent leur développement parfait dans leur différentes variantes, particulièrement dans le midi et le sud de l'Albanie, pendant les XVIIe-XVIIIe siècles et le début du XIXe siècle. La plupart d'elles se font remarquer par les dimensions et le résultat architectonique. Ces églises sont les cathédrales des villes, les églises des grands villages, ainsi que, dans quelques cas, les églises des monastères.

Vu leur construction planimétrique et volumétrique, nous distinguons trois sous-groupes: les basiliques à coupole, les basiliques couvertes d'un système de voûtes et de calotte, sphériques et les basiliques à plafond plat.

1. Les basiliques à coupole

Ce sous-groupe se distingue des églises à structure en forme de croix, avec coupole, parce que ses églises contiennent plus de quatre colonnes qui attribuent à la construction un axe longitudinal sensible, ainsi qu'une séparation nette, en trois nefs, desquels celui du centre est plus haut et plus large que les autres. Il est caractéristique de ce sous-groupe la coupole sur un haut tambour, qui s'élève lans le nef centrale. D'habitude, la nef centrale est couverte d'une voûte à berceau. Dans une partie des monuments conservés, les nefs latérales sont couvertes de voûtes à berceau, d'une section de demi cercle, qui continuent sans s'interrompre dans toute la longueur de la nef, en attribuant à la construction la forme nette de basilique à l'intérieur aussi bien qu'à l'extérieur, étant interrompue seulement de la coupole sur le tambour. L'intérieur ne tient pas dans tous les cas à la propre construction de basilique.

Dans quelques cas, dans le nef centrale sur les colonnes il y eu des arcs qui passent de travers, des nervures, tandis que les nefs latérales sont couvertes de voûtes qui s'ouvrent vers la nef centrale, signe qui les attache aux églises du type à structure en forme de croix avec coupole.

Les basiliques qui sont couvertes d'un système de voûter et de calottes sphériques

Dons les monuments de ce sous-groupe on remarque les résultats les plus réussis architectoniques et constructifs de notre architecture postbyzantine. La manifestation des parties ou des nucléoles particulières dans l'espace intérieur du naos, se font remarquer même dans les constructions du premier groupe. Mais dans les monuments de ce sous-groupe, ces tendences se convertissent en conception compositionnelle en nous donnant une variété de solutions structurales et figuratives. A la différence du premier sous-groupe, la composition dynamique de l'intérieur ne se voit pas dans la vue extérieure, il reste caché sous la large couverture à deux pentes. Les monuments de ce sous-groupe se font remarquer aussi par les grandes dimensions et le soin prêté au traitement architectonique et décoratif des vues extérieures.

De tels monuments ont été construits généralement dans la région de Korçë pendant le XVIIIe siècle, mais il n'en manque pas d'autres d'intérêt à Berat et dans les villages de Gjirokastër.

DO NOT COPY

Les basiliques à plafond plat

Les constructions de ce sous-groupe sont couvertes de toit à structure de bois avec un plafond plat également en bois. Leur intérieur se répartit en trois nefs au moyen de deux rangées de colonnes en pierre ou en bois. Dans plusieurs églises, les colonnes sont liées par deux arcades, dans d'autres, le plafond s'appuie directement sur les colonnes. Presque toutes les églises de ce sous-groupe ont de grandes dimensions, mais en ce qui concerne l'organisation de l'espace intérieure, elles se rangent après les exemples du deuxième sous-groupe. Nous avons à faire ici avec sa simplification, un volume statique qui s'aperçoit facilement, des façades plates. Cela ne se passe pas ainsi dans les églises où il y a des arcs sur les colonnes, et la nef centrale est plus haute que les latérales. C'est le même rôle que joue la décoration des plafonds, pareille à celles des habitations populaires.

DO NOT COPY

Dhorka DHAMO

DO NOT COPY

FIGURA ANTROPOZOOMORFE E MOZAIKUT TË ANTIGONESË

Në periudhën kalimtare nga antiku i vonë në mesjetën e hershme, kur u krye procesi i dyfishtë i krijimit të marrëdhënieve feudale dhe formimit të popullit shqiptar, arti në rrugën e zhvillimit të stilit të ri u mbështet dhe eci në shumë pikëpamje në gjurmët e traditës. Mbi këtë bazë mozaikët paleokristianë, të zbuluar në një masë të konsiderueshme pas çlirimit te ne, studimet e deritanishme me të drejtë i shohin të lidhur me mozaikun antik.[1] Por duke theksuar kryesisht këtë anë është lënë disi pasdore njohja dhe evidentimi i tipareve dhe vlerave estetike të reja që përftoi arti i mozaikut, i kultivuar në kushtet e ndryshuara materiale dhe shpirtërore të atyre shekujve. Nuk është qëndruar si duhet për të treguar se çfarë elementesh përqafoi ky art nga e kaluara dhe në ç'drejtim tradita ilire u zhvillua dhe u përpunua në shërbim të kultit e të dogmës kristiane, të shpallur zyrtarisht qysh në shekullin e IV, fe e perandorisë romake, në të cilën përfshiheshin asokohe edhe trojet tona.

Mozaiçistët paleokristianë u muarrën kryesisht me motivet ornamentale dhe thurrën me to ansamble të tërë të organizuar me një ndjenjë dekorative të rrallë, karakteristike për krijimtarinë figurative popullore. Motivet e njohur antike u përdorën nga mozaiçistët paleokristianë më shpesh si simbole të kultit kristian pa marrë parasysh domethënien fillestare të tyre. Duke u dhënë atyre një kuptim të ri, dora dorës u arrit që të kristalizohet edhe një trajtesë e ndryshme në stil. U krijuan kështu ansamble të qarta me prirje monumentale, kompozime simetrike e ndonjëherë gjeraldike, tipike për artin e lindjes së lashtë. Format u stilizuan dhe gama e ngjyrave u bë më intensive. Edhe pse u përdorën ashtu si më parë gurët me ngjyrë natyrore, mermeri, balta e pjekur dhe vetëm rrallë herë brumi i xhamit, tingulli i përgjithshëm kolloristik u rrit nga përdorimi i ngjyrave të forta plotësuese, nga kombinimet dhe fqinjësia e tyre. Kjo prirje e pikturës monumentale për ngjyra të efektshme është realizuar në mozaikun e pagëzimores së Butrintit me një bukuri të rrallë dhe në mënyrë më të ndjeshme ajo është shprehur në mozaikun e murit, shembullin e të cilit e gjejmë të ruajtur mirë në kishën e vogël në amfiteatrin antik të Durrësit. Gjurmë të mozaikut muror gjejmë gjithashtu edhe në disa monumente të shekujve II-III në Butrint.

Shumica e mozaikëve paleokristianë të dyshemesë sikundër u theksua përmbajnë motive të thjeshtë ornamentalë, gjeometrikë, bimorë dhe motive shtazore. Të tillë janë mozaiku i pagëzimores së Butrintit, i Sarandës, i Mesopotamit, Linit pranë Pogradecit, Tiranës, Tepes së Elbasanit etj. Vetëm në dy raste në mozaikun e dyshemesë në Antigone dhe Mesaplik janë paraqitur motive tepër të rrallë antropozoomorfe dhe antropomorfe. Mozaiku i parë u zbulua nga gërmimet arkeologjike në vitin 1974,[2] kurse i dyti më 1979.[3]

Ne do të trajtojmë vetëm mozaikun e Antigonesë, paraqitjen qendrore të tij, me dëshirën dhe synimin për ta dëshifruar dhe shpjeguar atë në pikëpamje të ikonografisë.

1. S. Adhami, S. Anamali, **Mozaikët e Shqipërisë,** Tiranë 1974.
2. Dh. Budina, **Mozaiku i Antigonesë,** revista «Ylli», 1975, VI.
3. D. Komata, **Zbulohet një mozaik,** Shqipëria e Re, Nr. 15, 1979.

DO NOT COPY

Antigonea, është një nga qytetet e përmendur në burimet antike i identifikuar në vitin 1972 prej Dh. Budinës me kaltanë e Jermës që ndodhet përballë qytetit të Gjirokastrës për matanë lumit të Drinos.[4] Në vitin 167 para erës sonë Antigonea u shkatërrua nga konsulli romak Pal Emili, së bashku me 100 qytetet e tjerë të Epirit. Për vazhdimin e jetës në Antigone deri në prag të mesjetës flasin dëshmi të ndryshme arkeologjike, midis të cilave dhe mozaiku i mësipërm. Gjer sot mund të themi se mozaiku përbën veprën artistike më të rëndësishme që është zbuluar në fushën e pikturës në Antigone dhe zonën përqark saj. Mozaiku i Antigonesë që në vështrim të parë të befason me stilin dekorativ dhe në radhë të parë, me motivin e tij antropozoomorf.

Mozaiku është i aplikuar në dyshemenë e një kishe trikonkëshe me përmasa 15 x 10 m, të orientuar me altar nga lindja. Kisha ndodhet në skajin juglindor të qytetit. Të njëjtin pozicion zë edhe tempulli i hershëm në Amantie i adaptuar nga një godinë e vjetër.[5] Kisha, krahas me detyrën e mishërimit të dogmës kryesore përmes simbolit të shprehur në formën planimetrike të trikonkut, plotëson edhe kërkesën e ritualit. Drejtimi gjatësor i planit të saj përputhet plotësisht me lëvizjen e besimtarëve që hynin nga dera e hapur në faqen e ngushtë,[6] ndryshe nga bazilikat romake që e kishin hyrjen në faqen anësore dhe synonin në drejtim të altarit, atje ku afërsisht ndodhet emblema, kuadri kryesor i mozaikut të saj.

Dyshemeja është e shtruar me mozaikë me ngjyrë të kuqe, të zezë, të bardhë, kryesisht me origjinë nga formacionet gëlqerorë të zonës përqark. Motivet janë vizatuar me konturë të dukshëm. Ka mjaft motive gjeometrike dhe motive bimore, mes të cilëve spikasin trekëndëshat në varg, rrathët e brendashkruar (foto 1) me origjinë pagane, dhe ornamente të vona antike si motivi me gjethe në trajtë zemre, (foto 2) i stilizuar në atë variant që haset në pagëzimoren e Butrintit. Edhe motivet zoomorfe që përbëhen nga gjarpërinj të trashë, ndofta për të rënë në sy nga larg, gjithashtu nuk janë të panjohur në vepra të tjera paleokristiane.[7] E pazakontë në këtë kompozim është figura që paraqet qënien fantastike me trup njeriu dhe kokë kafshe vizatuar me qëndrim thuajse ballor, me këmbët paksa të hapura dhe me kokën e çuar përpjetë e të paisur me motivin karakteristik të gjethes në formë zemre. (foto 3). Gjarpëri pranë duket sikur e ka kafshuar dhe e ka paralizuar me njerën dorë lart e tjetrën poshtë. Motivi antropozoomorf dhe i gjithë mozaiku i Antigonesë ndryshon shumë për nga trajtimi nga mozaikët e tjerë të dyshemeve. Ai dallohet nga një trajtim i thjeshtë, naiv e deri diku skematik. Objektet vijëzohen në format themelore me një ndjenjë dekorative të spikatur, në frymën e artit popullor.



Fig. 1

Paraqitja qëndrore në mozaikun e Antigonesë thuajse kthehet në një hieroglif, në një enigmë, për shkak të kokës prej kafshe që ka. Karakteri i kok-

4. Dh. Budina, **Antigonea,** Iliria II, Tiranë, 1972, f. 316.
5. S. Anamali, **Amantia,** Iliria II, Tiranë 1972,
6. Allpatov, **Vseobshçaja istorija iskustv,** Moskva, 1948, Vëll. I,
7. A. Baçe, **Arkitektura e dy kishave paleokristiane dhe e varreve në kështjellën në Paleokastër,** «Monumentet» 15-16, f. 82.



Fig. 2

lavitur dhe mungesa e sinjaturës u ka dhënë shkas autorëve për të parë në të herë një kokë zogu me sqep të hapur,[8] herë një ujk,[9] e herë një dragua.[10]

Nga vizatimi skematik dhe pozicioni i veçantë, veshët në një rast janë marrë gabimisht për brirë. Si përfundim motivi antropozoomorf është parë si element i papërcaktuar kristian apo pagan, ose si qënie mitologjike pa emër.

Nga kombinimi në këtë figurë i elementit antropomorf me atë zoomorf, mendja të shkon edhe te centaurët e lashtë edhe te sfinksat që ndeshim të modeluar në Antigone në objektet e ndryshme të përdorimit të përditëshëm. Ky konstatim vlen për të vënë në dukje se krijimi i qënieve të tilla fantastike nuk përbën në artin e antigonasve një dukuri të shkëputur, por të vijuar e të zhvilluar më tej prej së lashti.

Më të afërta janë analogjitë e motivit të Antigonesë me perëndinë egjiptiane Anubis. Por fakti që mozaiku është aplikuar në ambientin e një tempulli të krishterë dhe i përket një ansambli paleokristian e zhvendos vëmendjen nga perëndia e Lindjes dhe përgjithësisht nga qëniet mitologjike të lashtësisë në favor të Kristoforit, të cilin në pikturën tonë mesjetare e ndeshim në dy raste: në afreskat e David Selenicës të vitit 1726 në kishën e Shën Kollit të Voskopojës (foto 4) dhe në një nga ikonat pasbizantine të vitit 1812 të ardhur në fondin e Muzeut të Artit Mesjetar të Korçës nga Ogrena e Përmetit, të përfytyruar si Anubis me fytyrë qeni. Në historinë e pikturës njihen paraqitje edhe më të hershme të Kristoforit cynocephalus. Të tilla janë ikonat ruse e bullgare në Muzeun rus të Leningradit dhe të Sofies që i përkasin shekullit XV. Ka gjithashtu dhe një miniaturë në fondin historik të bibliotekës së Shtutgardit të shekullit XII[11]



Fig. 3

8. Dh. Budina, V. Bereti, **Studime dhe materiale arkeologjike,** Iliria VI, Tiranë 1979, f. 340-346.
9. H. Ulqini, **Cikli mbi traditat,** «Pionieri» 1978, VI.
10. A. Baçe, **vep. cit.,** f. 82, dallon një qënie të fuqishme në atë paraqitje: «Simboli kryesor i mozaikut të dyshemesë në kishën paleokristiane në Antigone, e një kohe me atë të Paleokastrës paraqet një njeri dragua, i cili qarkohet prej gjarpërinjsh».
11. L. Reau, **Iconographie de l'art chretien,** Paris 1958. Vëll. III, f. 306-307.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

Sipas L. Reo dhe literaturës së cituar prej tij, ikonografia e Kristoforit është shumë e pasur, ndërsa kishat me emrin e tij fare të pakta. Kristofori është atestuar si shenjt sipas një mbishkrimi grek të Azisë së Vogël në vitin 450. Adhurimi i tij ka qënë shumë i përhapur në Kostandinopojë dhe në Siçili gjatë shekullit V. Këto të dhëna janë të rëndësishme pasi edhe përfytyrimet thjesht antropomorfe të Kristoforit si mozaikët në Shën Llukë të Fokidës, në Greqi dhe në Santa Maria Antika të Romës, nuk janë më të hershme se shekulli X.[12]

Paraqitjet thjesht antropomorfe e japin Kristoforin shpesh si gjigand, vetëm ose me Krishtin në qafë, kryesisht nëpër fasada. Sipas legjendës ai pat ndihmuar Krishtin të kapërcente një lumë. Në pikturën tonë paraqitje të tilla të Kristoforit hasim në fillim të shekullit XVII në kishën e Shën Mitrit në kalanë e Beratit dhe në Shelcan të Elbasanit, duke mbajtur Krishtin mbi sup dhe shkopin e lulëzuar si atribut. Ky variant s'është veçse shtjellim i materializuar i emrit të tij që do të thotë Krishtmbajtës. Por kur përfytyrohet vetëm për vetëm me foshnjën, Kristofori shpesh ka kuptimin e një figure zëvendësuese të Krishtit. Me sa duket edhe për mozaikun e Antigonesë është i huaj kuptimi i krishtmbajtësit thjesht nga ana fizike dhe më se i përshtatshëm ai i krishtmbajtësit nga ana ideore. Kuptimin e Kristoforit të themi krishtërimbartës, në Antigone e shpjegojnë qartë edhe ato tri rrathë shkruar mbi gjoks të tij afër qafës, të barabartë e të baraslarguar nga njëri tjetri, që duken në vështrim të parë si tri pulla të mëdha. Prej tyre dallohen mirë dy, kurse i treti vetëm pjesërisht pasi është i dëmtuar. Për të krishterët e hershëm rrethi simbolizonte trininë e shenjtë. Ndodh që tre rrathët ndërpresin njëri tjetrin ose brëndashkruhen, sikundër një motiv i tillë shihet rreth e qark emblemës në shqyrtim. Krahas rrethit është përdorur edhe trekëndëshi i vargëzuar, (fig. 5) i cili gjithshtu ka kuptim simbolik dhe paraqet karakterin e trefishtë të periudhës së krishterë. Motivi i Antigonesë me tre rrathë të veçuar nga njëri tjetri, si tri kulmet e një trekëndëshi, do nënvizuar si variant i rrallë i pahasur deri më sot i simbolizmit gjeometrik i lidhur me zbukurimoren ilire protohistorike. Shembujt e tjerë që përmendëm nga piktura jonë mesjetare e vonë, edhe pse ruajnë në vijat themelore ikonografinë e vjetër, nuk përmbajnë kuptim kaq të gjerë e thelbësor dogmatik. Prej kohësh në pikturën bizantine ishte kristalizuar tipi i pantokratorit si figurë që përmblodhi në një perëndinë at e bir, duke zhvendosur të gjithë variantet e tjerë që lidheshin me perëndinë kryesore. Por piktorët megjithatë, pak për inerci e të nisur nga traditat, pak të nxitur edhe nga gojëdhënat që erdhën e u shtuan nga shekulli XI e tëhu, vazhdojnë të paraqesin Kristoforë në variantin antropozoomorf. Por kjo nuk do të thotë se në mes të Kristofor kokëqenit të pikturës mesjetare dhe mozaikut paleokristian të Antigonesë nuk ka kurrfarë dallimi në pikëpamje ikonografike. Në afreskun e Voskopojës dhe në ikonën e Korçës mungon motivi i gjarpërit. Shenjti ka pozicion dhe pamje krejt të qetë. Gjar-

12. Louis Reau, **Po aty.**

DOKTORATURA

përi nuk shoqëron as edhe ndonjë nga paraqitjet e tjera antropomorfe të Kristoforit. Si përfundim si zgjidhje ikonografike mozaiku i Antigonesë mbetet një shembull i veçantë. Me sa duket motivi i gjarpërit me kalimin e kohës ka mbetur jashtë vëmendjes dhe riprodhimi i tij nga mjeshtrit pasues është gjykuar si i tepërt. Megjithatë do theksuar se në miniaturën e Shtutgardit vazhdon të riprodhohet koka e qenit me veshët e çuar përpjetë dhe goja e hapur me gjuhën e varur teposhtë, pozicionin e të cilave e bën të shpjegueshëm prania e gjarpërit në paraqitjen e Antigonesë.

Me zgjidhjen e veçantë e më të plotë ikonografike mozaiku i Antigonesë shpreh dy ide të rëndësishme që lidhen me përhapjen në masë të krishterimit dhe me faktin tjetër që tregon se sa shumë i ishte dashur kishës të përpunonte ndërgjegjen e të luftonte për t'i mbajtur të lidhur pas vetes besimtarët, sepse kishte vazhdimisht prirje heretike dhe kundërshtime për të mos e pasuar dogmën e saj. Pra kemi të fiksuar aty gjithsesi edhe momentin historik të pastabilitetit shpirtëror real, karakteristike për periudhën kalimtare, në se gjarpëri merret si simbol i paganizmit dhe në se përmes tij nuk është synuar të paraqitet krijimi i zvarranikëve nga Zoti.

Mozaiçistët e Antigonesë kanë qënë të lidhur me traditën dhe mjedisin rrethues. Ata kanë pasqyruar me kujdes në veprat e tyre veshjen e krahinës që ishte në përdorim nga masat e gjera nga e cila ata kishin dalë dhe së cilës i përkisnin, veshje që njiheshin e dalloheshin nga të gjithë. Kur e vështron veç pjesën e trupit të Kristoforit të Antigonesë thua se ke të bësh me paraqitjen e një njeriu real si nga vizatimi e nga qëndrimi, por sidomos nga veshja e përbërë nga brekeshat e bardha prej liri apo gjineshtre, nga pelerina tip klamide që i ngjan brucës së bariut dhe nga opingat prej lëkure me reshpre të gjata mbështjellë pas këmbëve deri në pulpat. Kjo është veshje karakteristike burrash për zonat malore e fushore në krahina të ndryshme të vendit që nga Hasi, Zadrima, Mokra etj. Opinga të të njëjtit tip kemi hasur edhe në piktura të tjera kishtare e laike të vendit, por Antigonea deri tani ruan dëshminë më të lashtë të tyre, zbuluar brenda vendit. Ajo ndihmon me materialin e saj që të sqarohet edhe çështja e fjalës opingë si fjalë me origjinë sllave që është futur vonë në gjuhën tonë pasi nuk përputhet me origjinën e vetë objektit që ishte në përdorim kohë më parë.[13] Mjafton të kujtojmë se në punishtet antike të Antigonesë në banesën e «lëkurëregjësit» janë gjetur vegla pune për përpunimin e lëkurës dhe pesë qypa të mëdhenj të ngulur në tokë që shërbenin për regjien e saj.[14]

Mozaiku i Antigonesë nuk lidhet nga stili me pikturën e shekullit XII e as me atë të shekullit X. Ai është më i vjetër. Nga rrethanat dhe objektet arkeologjike të gjetura aty dhe nga karakteri i gërmave të mbishkrimit, autorët e gërmimit me të drejtë e vendosin atë në shekujt V-VI. Edhe motivet gjeometrike bimore që e qarkojnë emblemën, trekëndëshat barabrinjës, rrathët bashkëqendrorë të trefishtë apo kantari - vazo e madhe etj. tregojnë me simbolikën e tyre karakteristike për një ansambël të tipit paleokristian që lidhet me datimin e sipërm. Si kufi i ulët kronologjik mbetet padyshim viti 450 kur u atestua Kristofori.

Si rrjedhim mozaiku i Antigonesë ndihmon që të sqarohen edhe disa çështje me karakter më të gjerë. Së pari motivi i Antigonesë është paraqitja më e hershme e njohur e Kristoforit si brenda dhe jashtë vendit. Është gjashtë shekuj më i vjetër se mbishkrimi i Shtutgardit dhe katër shekuj më i vjetër se paraqitja e Kristoforit në manastirin e Shën Llukës në Fokidë të Greqisë dhe Santa Maria Antika të Romës. Së dyti deri tani për mungesë provash materiale është menduar se kulti dhe ikonografia e shenjtit nuk përputheshin në kohë me njëra tjetrën. Mozaiku i Antigonesë me të drejtën e paraqitjes më të hershme sjell në këtë drejtim korigjimin e rëndësishëm se krahas kultit të Kristoforit ka ekzistuar dhe përfytyrimi i tij.

Së treti gjetja e Antigonesë tregon se varianti më i lashtë i përfytyrimit të Kristoforit nuk ka karakter antropomorf por antropozoomorf dhe lidhet me mitologjinë antike të lindjes. E nënvizojmë këtë sepse materiali ekzistues krijon përshtypje të kundërt, përderisa paraqitjet e shekullit X e Shën Llukës në Fokidë e në

13. A. Buda, **Disa probleme të historisë së hershme mesjetare,** Studime historike, Tiranë 1980, Nr. II, f. 331.

14. Dh. Budina, **Antigonea.** Përpunimi i lëkurës u përsos më tej tek ne dhe arriti deri në atë shkallë sa të përgatiteshin prej saj sasira të mëdha fletë pergamenti të nevojshme për të riprodhuar shkrimet e shenjta, të ashtuquajturit kode, librat e parë në doreshkrim, ndër të cilët më i vjetri, kodi i kuq i Beratit, Codex purpureus beratinus, i cili sipas P. Batiffol **(Les manuscrits grecs de Berat d'Albanie et le codex purpureus,** Paris 1886, f. 11-13) i përket shekullit VI dhe përbën një nga kodet më të vjetër që njihen përgjithësisht.

Santa Maria Antika e paraqesin Kristoforin me pamje njeriu, ndërsa miniatura e Shtutgardit, e shekullit XII e paraqet me kokë kafshe.

Mund të shtohej diçka gjithashtu lidhur me hipotezat e shumta mbi origjinën e shenjtit. Disa e mbajnë me origjinë nga legjendat armene që thonë se njeriu me kokë qeni ka ardhur me vrap nga skaji tjetër i universit për të dëgjuar meshën. Më i besueshëm na ngjan varianti që e lidh Kristoforin me perëndinë e lashtë egjiptiane, Anubisin kokëqen. Por po ta lidhim edhe me figurat e mitologjisë siç janë centaurët gjysëm njeri e gjysëm kafshë e me shpjegimin që u bëhet atyre si qënie fantastike të sajuara nga vizioni i njeriut në vrap të shpejtuar, atëhere Kristofori mund të shikohet edhe si një kombinim i bariut me qenin e tij si dy figura të pashkëputura nga njera tjetra që vëzhgojnë tufën e bagëtisë. Të mos harrojmë se Krishti për shumë kohë në periudhën paleokristiane u nënkuptua e u paraqit me të tjera figura me rrugë të tërthorta. Dhe bariu i mirë ishte një nga më të preferuarat dhe më të hershmet. Kristofori mund të jetë kështu fare mirë një variant i këtillë i sajuar posaçërisht për nevojat e kultit të ri në shekujt V-VI, kur ende nuk ishte kristalizuar ikonografia e perëndisë së krishterë. Kjo situatë në pjesën e brendshme të vendit, në zonat që kishin kontakte më të pakta me qendrat e mëdha të Perandorisë bizantinte vazhdoi për një periudhë kohe më të gjatë. Nisur nga mozaiku i Antigonesë, nga repertori ikonografik i veçantë i tij e në radhë të parë nga figura e rrallë antropozoomorfe, nxitemi për të vënë në dukje praninë e elementit popullor në ikonografinë e artit të hershëm kristian rolin e rëndësishëm përpunues të gjeniut popullor që u shfrytëzua për të shtjelluar në trajtë të ngjeshur e lakonike dogmën themelore sa të ndërlikuar aq edhe absurde të fesë së re në fushën e pikturës që aplikohej në dysheme.

Kërkesat në rritje për të pikturuar figura të shenjta antropomorfe i detyruan mjeshtërit mozaiçistë të lenë dyshemetë e t'i ngrenë ato lart në mure duke zgjidhur kështu një varg problemesh të reja stilistike dhe të karakterit teknik. Mozaiku i murit krijoi mundësi më të mëdha për të shtjelluar artistikisht idetë religjioze të krishtërimit, në një sistem të bashkëlidhur figurativ.

Mozaiku i Antigonesë qëndron si hallkë e cila lidh mozaikun e periudhës paleokristiane me mozaikun e hershëm mesjetar të aplikuar në mur. Si një etapë ndërmjetëse ai shërben në pikëpamje të ikonografisë dhe të stilit dekorativ si mozaik i bazuar tërësisht në vizatimin e thjeshtëzuar skematik dhe në njollën e gjerë e të fuqishme kolloristike të thurrur me kubikë që kanë përmasa të mëdha në krahasim me mozaikët e tjerë paleokristianë, që janë zbuluar gjer më sot në vendin tonë.

DO NOT COPY

Dhorka DHAMO

DO NOT COPY

FIGURES «ANTHROPOZOOMORPHE» DE LA MOSAÏQUE D'ANTIGONEA.

RESUME

Antigonéa, ville mentionnée dans les sources antiques, est située en face de la ville de Gjirokastër de l'autre côté de la rivière de Drino. En l'année 167 avant notre ère, Antigonéa fut détruite par Pal Emil, en même temps que les 100 autres cités d'Epire. De différents témoignages archéologiques, y compris la mosaïque mentionnée plus haut, attestent la continuité de la vie à Antigonéa jusqu'au seuil du Moyen-Age. Jusqu'à ce jour nous pouvons dire que cette mosaïque constitue l'oeuvre artistique la plus importante découverte dans le domaine de la peinture à Antigonéa et dans la zone alentours. La mosaïque d'Antigonéa, dès la premère vue, surprend par son style décoratif et tout d'abord, par son motif anthropozoomorphe.

La mosaïque est appliquée sur le plancher d'une église à trois conques aux dimensions 15 x 10 m, don l'autel est orienté vers l'Est. L'église se situe dans la limite Sud-Est de la ville. L'eglise, de pair avec la tâche d'imagination du héros principal au moyen du symbole de sa peine, la croix, exprimée dans la forme planimétrique du troisconque, remplit aussi les exigences du rituel. La direction longitudinale de son plan concorde complétement avec le mouvement des croyants qui entraient par la porte auverte sur la face étroite, à peu près là où se place l'emblême, le cadre principal de sa mosaïque.

Le plancher est couvert de tesselles de couleurs rouge, noire, blanche, essentiellement d'origine des formations calcaires de la zone alentours. Les motifs sont dessinés avec des contours visibles. Il y a bien des motifs géométriques, et des motifs végétaux, parmi lesquels on relève les triangles en rang, les cercles intérieurs, d'origine pagane, et des ornements antiques de plus tard, comme le motif à feuilles en forme de coeur, stylisé selon la variante qu'on rencontre dans le baptistère de Butrint. Les motifs zoomorphes composés de serpents se trouvent aussi dans l'église voisine paléo-chrétienne de Paleokastër. Ce qui est insolite dans cette composition est l'image qui représente un être fantastique au corps d'homme et à la tête d'animal dessiné presque de face, les jambes un peu écartées et la tête relevée. Le serpent, près de lui, semble l'avoir piqué et paralisé, un bras levé et l'autre relaché. Le motif antropozoomorphe ainsi que toute la mosaïque d'Antigonéa diffère beaucoup des autres mosaïques de plancher, quant au traitement simple, naïf et jusqu'à un certain point schématique. Les objets se présentet dans leurs formes fondamentales avec un sentiment décoratif mis en relief, dans l'esprit de l'art populaire.

La représentation centrale dans la mosaïque d'Antigonéa devient presque un hiéroglyphe, une énigme, à cause de la tête d'animal qu'elle possède. Le caractère compliqué et le manque de signature a fait que les auteurs y ont vu parfois une tête d'oiseau à bec auvert, parfois un dragon.

La combinaison, dans cette figure de l'élément anthropomorphe avec celui zoomorphe, fait penser aux centaures ancienys et aux sphinxs qu'on trouve à Antigonéa modelés sur les différents objets d'usage quotidien. Cette constatation est valable pour mettre en valeur que la création de tels êtres fantastiques ne constitue pas dans l'art des habitant d'Antigonéa, un phénomène à part, mais continu et développé encore depuis longtemps.

Les analogies du motif d'Antigonéa avec le dieu égyptien Anubis sont plus fortes. Mais le fait que la mosaïque est appliquée à l'intérieur d'un temple chrétien déplace l'attention du dieu d'Orient et généralement des êtres mythologiques de l'antiquité en faveur de Christophore, qu'on rencontre deux fois dans notre peinture moyen-âgeuse; dans les fresques de David Selenica, en 1726, dans l'église de Saint Nicola à Voskopojë et dans l'une des icônes postbysantines de fonds du Musée de l'Art Moyen-âgeux de Korçë, représentée comme Anubis à figure de chien. Dans l'histoire de la peinture, on rencontre des représentations encore plus anciennes du Christophore cynocéphalus. Telles sont les icônes russes et bulgares du Musée russe de Léningrad et de Sofia, appartenant au XVe siècle. Il y a aussi une miniature dans la bibliothèque de Shtuttgard, appartenant au XIIe siècle.

Selon L. Réo et la littérature citée par lui, l'icônographie de Christophore est très riche, alors que les églises de son nom très peu nombreuses. Christophore est attesté en tant que saint, selon une inscription grecque d'Asie Mineure, en l'année 450. Sa vénération a été très propagée à Constandinople et en Sicile, au cours du Ve siècle. Les données sont très importantes parce que même les représentations simplement anthropomor-

DOKTORSKY

phe de Christophore, telles les mosaïque de Saint Luc à Fokida, en Grèce et de la Santa-Maria Antica de Rome, ne sont pas antérieures au Xe siècle.

Les représentations simplement antropomorphes présentent Christophore souvent comme un géant, seul ou portant le Christ à son cou, principalement sur des façades. Selon la légende il avait aidé le Christ à traverser une rivière. Dans notre peinture, on trouve de telles représentation de Christophore, au début du XVIIe siècle dans l'église de Saint Mitri, dans la citadelle de Berat et à Shelcan d'Elbasan, où il porte le Christ sur l'épaule et l'hostie fleurie en tant qu'attribut. Cette variante n'est que l'explication matérialisée de son nom qui veut dire Porteur du Christ. Mais lorsqu'il est tout seul, sans l'enfant, Christophore a souvent le sens d'une figure remplaçant le Christ. A ce qu'il paraît, même pour la mosaïque d'Antigonéa, il est étranger le sens de Porteur du Christ simplement physique, mais il convient celui de Porteur du Christ du point de vue d'idée. Le sens de Christophore, soit Porteur du Christ, à Antigonéa, s'explique clairement par les trois cercles tracés sur sa poitrine, près du cou, cercles égaux et à distance égale l'un de l'autre, qui ressemblent à première vue à trais grosses tâches. On discerne bien deux d'entre exu, tandis que le troisième partillement seulement parce qu'il est endommagé. Pour les chrétiens anciens le cercle symbolisait la Trinité sainte. Il arrive que les trois cercles s'entrecoupent ou se tracent à l'intérieur l'un de l'autre tel un motif vu tout ou tour de l'emblême en question. De pair avec les cercles on a employé aussi les triangles équilatéraux en rang, qui ont aussi un sens symbolique et représentent le caractère triple du dieu chrétien. Le motif d'Antigonéa, à trois cercles séparés l'un de l'autre, comme les trois combles d'un même triangle, doit être souligné comme une variante rare, jamais rencontrée jusqu'à ce jour, du symbolisme géométrique chrétien. Les autres exemples mentionnés, relatifs à notre peinture du haut Moyen-Age, bien que conservant dans les traits fondamentaux l'icônographie ancienne, ne continnent pas un sens dogmatique aussi large et essentiel. Depuis longtemps, dans la peinture byzantine était cristalisé le type en tant que figure contenant en un seul dieu le père et le fils, en deplaçant toutes les autres variantes relatives au dieu principal. Mais les peintres tout de même, un peu par inertie et partant des traditions, un peu incités aussi par les traditions orales qui vinrent se multipliant, à partir du XIe siècle, continuent à représenter Christophore dans la variante antropozoomorphe. Mais, cela ne veut pas dire qu'entre le Christophore à tête de chien de la peinture mayen-âgeuse et la mosaïque paléo-chrétienne d'Antigonéa, il n'y a aucune différence du point de vue icônographique. Dans la fresque de Voskopojë et l'icône de Korçë, manque le motif du serpent. Le saint a une pasture et un air tout à fait calme. Le serpent n'accompagne aucune autre représentation antropomorphe de Christophore. En conclusion quant à la solution icônographique, la mosaïque d'Antigonéa reste un exemple particulier. Il paraît donc que le motif du serpent avec le temps est resté hors de l'attention et sa reproduction a été jugé superflue. Tout de même, il faut souligner que dans la miniature de Shtuttgard continue la reproduction de la tête du chien aux oreilles dressées et à la bouche auverte et la langue pendante, la position desquelles devient explicable par la présence du serpent dans la représentation d'Antigonéa.

Avec sa solution particulière et plus complète icônographique, la mosaïque d'Antigonéa exprime deux idées importantes liées à la propagation en masse de la chrétienneté et à l'autre fait qui atteste combien il avait fallu à l'église à façonner la concience et à combattre pour tenir attachés à elle les croyants, parce qu'il existaient toujours des tendances hérétiques et des oppositions pour ne pas suivre son dogme. On a là bien fixé tout de même aussi le moment historique de la non stabilité spirituelle réelle, caractéristique de la période de transition, si le serpent est le symbole du haptême et si à transition, si le serpent est le symbole du paganisme et si à des reptiles par dieu.

Les maîtres d'Antigonéa ont reflété, avec soin, dans leurs oeuvres, les habits de la région, en usage parmi les larges masses, d'où ils étaient nés et auxquelles ils appartenaient, des habits connus et discernés par tout le monde. Lorsqu'on considère séparément la partie du corps du Christophore d'Antigonéa, on dirait qu'on a à faire â la représentation d'un homme réel, tant par le dessin que par la posture, mais surtout par les habits; pantalons blancs de lin ou de genêt, «opinga» en cuir à la pointe fermée. Ce sont des habits caractéristiques des zones montagneuses et de plaine de différentes régions du pays, de Has, Zadrimë, Mokër, etc. On a déjà rencontré des «opinga» de ce type dans d'autres peintures religieuses et laïques du pays, mais Antigonéa, jusqu'à maintenant, garde leur témoignage le plus ancien, parmi nos monuments, découvert dans notre pays. Elle aide, avec ses matériaux, à clarifier le sens du mot «Opingë» (sandales) en tant que mot d'origine slave, introduit tard dans notre langue, puisqu'il ne concorde pas avec l'origine de l'objet même, en usage il y a bien du temps. Il suffit de rappeler que dans les ateliers antiques d'Antigonéa, dans l'habitation du «tanneur de peaux» on a découvert des outils de travail relatifs au traitement des peaux et cinq grandes jarres plantés dans le sol et qui servaient à tanner les peaux.

La mosaïque d'Antigonéa n'a pas de liens, quant au style, avec la peinture du XIIe siècle ni avec celle du Xe siècle. Elle est plus ancienne. Partant des circonstances aussi bien que des objets archéologiques qui y sont découverts, ainsi que du caractère des lettres de l'inscription, les entrepreneurs des fouilles ont eu raison de la situer aux V-VIe siècles. Les motifs géométriques végétaux aussi, qui entourent l'emblême, les triangles équilatéraux, les cercles concentriques triples ou bien le «kantar» - grand vase, etc. attestent avec leur symbolisme caractéristique d'un ensemble de type paléo-chrétien lié à la datation ci-dessus. En tant que limite chronologique demeure sans doute l'année 450, où Christophore fut attesté.

Par conséquent, la mosaïque d'Antigonéa aide à tirer au clair certaines questions de caractère plus large. Premièrement

DO NOT COPY

le motif d'Antigonéa est la représentation la plus ancienne connue de Christophore, aussi bien à l'intérieur du pays, qu'à l'étranger. Il est six siécles plus ancien que celui du manuscrit de Shtuttgard et quatre siècles plus ancien que la représentation de Chistophore dans le monastère de Saint-Luc à Fokide de Grèce et à Santa Maria Antica de Rome. Deuxièmement, jusqu'à nos jours, foute de preuves matérielles, on a pensé que le culte et l'icônographie du saint ne concordaient pas dans le temps l'un avec l'autre. La mosaïque d'Antigonéa, par le droit que lui réserve le fait qu'elle constitue la représentation la plus ancienne, apporte dans ce sens la correction la plus importante que, de pair avec le culte de Christophore, a existé aussi son imagination.

Troisièmement la découverte d'Antigonéa montre que la variante supérieure de l'imagination de Christophore n'a pas de caractère antropomorphe mais antropozoomorphe et se lie à la mythologie antique de l'Orient. Nous sailignons ceci parce que le matériel existant donne l'impression contraire si l'on prenait pour base les dates. Ainsi les représentations de Saint Luc à Fokide et à Santa Maria Antica, qui appartiennent au Xe siècle et représentent Christophore comme un homme, tandis que la miniature de Shtuttgard, du XIIe siècle le représente avec une tête d'animal.

Il existe bien des hypothèses relatives à l'origine du saint. Certains considèrent qu'il tire son origine des légendes arméniennes qui disent que l'homme à tête de chien est venu en courant du bout de l'univers pour écouter la messe. Plus croyable semble la variante qui établit un lien entre Christophore et le dieu ancien égyptien, l'Anubis à tête de chien. Mais si l'on le liait aux figures de la mythologie tels les centaures semi-homme, semi-animal, et à l'explication qu'on leur fait en tant qu'êtres fantastiques inventés par la vision, ajouter encore quelque chose, le fait que Christophore représente une combinaison du berger et de son chien, comme deux figures inséparables l'une de l'autre, gardant le troupeau. N'aublions pas que le Christ pour bien du temps fut sousentendu et représenté par d'autres figures, par des voies de traverse. Et le berger fut des préférés et des plus anciens. Christophore peut très bien être une variante de cette sorte inventé spécialement pour les besoins du nouveau culte, durant les V-VIe siècles, lorsque l'iconographie du dieu chrétien n'était pas encore cristalisée. Cette situation, dans l'intérieur du pays, dans les zones qui entretenaient des contacts plus complets avec les grands centres de l'Empire bysantin, continua pour une période de temps plus longue. Partant de la mosaïque l'Antigonéa, de son répertoir icônographique particulier, et avant tout de la figure rare antropozoomorphe, nous nous incitons à mettre en relief la présence de l'élément populaire dans l'icônographie de l'art ancien chrétien, le rôle important d'élaboration du génie populaire qui fut mis à profit afin d'expliquer de façon dense et laconique, mais compréhensible, le dogme compliqué de la nouvelle religion, dans le domaine de la peinture, qu'on appliquait sur les planchers.

Les exigences en hausse pour peindre des figures saintes ont obligé les maitres de la mosaïque de quitter les planchers et de les porter plus haut, sur les murs, en resolvant ainsi une série de problèmes de styes nouveaux et de caractère technique. La mosaïque murale créa des possibilités plus grandes pour expliquer les idées religiuses du christianisme, dans un système figuratif unifié. La mosaïque d'Antigonéa constitue le maillon reliant la mosaïque de la période poléo-chrétienne à la mosaïque ancienne moyen-âgeuse appliquée sur les murs.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
Pranë Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës

Adresa e Redaksisë: Rruga «Alqi Kondi» Nr. 7

Tirazhi 1005 copë | Formati 70 x 100/12 | **Stash 2204-72**

Shtypur: Kombinati Poligrafik Shtypshkronja «Mihal Duri» Tiranë

DO NOT COPY

DO NOT COPY

NDREQJE GABIMESH

Faqe	Kollona	Rreshti	Është	Duhet
20	2	10	XVIII	XIX
69	2	7	prroi i Ma-	prroi i
			nalit	Manalatit
72	2	39	Zbritjen	Zbutjen
77	1	44	majtas	djathtas

DO NOT COPY

Çmimi 10 lekë

ND
11